

EFEKTI I SISTEMIT PROPORCIONAL TE SISTEMI POLITIK DHE FORMIMI INSTITUCIONAL NË KOSOVË

XHAVIT SHALA


Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Fakultetin Juridik, me profil **E Drejta Publike**, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor i Shkencave Juridike”

Udhëheqës shkencor: Prof. assoc. dr. Ervis Iljazaj

Numri i fjalëve: 73,291

Tiranë, 2018



DEKLARATA E AUTORËSISË

Përmbajtja e këtij punimi është krejtësisht autentike. Unë, deklaroj se kjo temë përfaqëson punimin tim origjinal (përveç rasteve të citimeve dhe referencave) dhe nuk është përdorur më parë në këtë universitet apo institucione të tjera. Mendimet e shprehura në këtë temë janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë ato të Universitetit Evropian të Tiranës.

ABSTRAKT

Sistemi politik dhe i qeverisjes në Kosovë përfaqëson një demokraci konsensuale të bazuar në sistemin qeverisës parlamentar. Demokracia elektorale dhe përfaqësuese në Kosovë është zhvilluar në dy dekadat e fundit. Në këtë periudhë kohore (2001-2017) janë mbajtur gjashtë cikle zgjedhore për Kuvendin e Kosovës. Historia e zhvillimit të parlamentarizmit në Kosovë (2001-2017) tregon se procesi i formimit dhe funksionimi i institucioneve është përballur me vështirësi, bllokada, kriza politike dhe institucionale. Dy faktorët kryesorë të identifikuar janë sistemi zgjedhor proporcional dhe korniza normative për formimin e institucioneve. Në këtë punim është trajtuar korniza zgjedhore në përgjithësi dhe korniza normative që rregullon formimin e institucioneve në veçanti. Ky punim shtjellon efektet e sistemit zgjedhor proporcional me votim preferencial me një zonë të vetme zgjedhore dhe me prag prej pesë përqind në formimin e institucioneve, mënyrën e qeverisjes dhe demokracinë përfaqësuese e sidomos përfaqësimin e grave dhe minoriteteve në institucionet e Kosovës sipas kuotës etnike dhe gjinore. Ky punim është dizajnuar për të pasqyruar përveç pikëpamjeve të autorëve për efektet e sistemit zgjedhor edhe analizën dhe interpretimin e akteve juridike, gjetjet nga hulumtimi i opinionit të target grupeve që kanë ndihmuar në hartimin e propozimeve për nevojat e domosdoshme për reforma elektorale, ligjore dhe institucionale.

Metodologjia e përdorur është metoda cilësore dhe sasiore, metoda e përshkrimit, krahasimit, analizës ligjore dhe analizës së të dhënave dhe informacionit të mbledhur gjatë procesit të hulumtimit.

Fjalët kyçe: sistem zgjedhor, përfaqësim, qeverisje, sistem politik, sistem partiak, parti politike, kuotë gjinore dhe etnike

Abstract

Based on the parliamentary system of government, the political and governance system in Kosovo represents a consensual democracy. Electoral and representative democracy in Kosovo has developed in the last two decades. In this period of time (2001-2017) six rounds of elections were held for the Assembly of Kosovo. The history of parliamentary development in Kosovo (2001-2017) indicates that the process of formation and functioning of institutions has faced difficulties, blockades and political and institutional crises. The two key factors identified are the proportional electoral system and the normative framework for institution building. This paper in general deals with the electoral framework and in particular is focused on the normative framework governing the formation of institutions. The paper outlines the effects of the proportional electoral system with preferential voting with a single electoral zone and a five percent threshold in institution building, governance modalities and representative democracy especially representation of women and minorities in Kosovo's institutions according to ethnic and gender quotas. This paper is designed to reflect not only the views of the various authors on the effects of the electoral system but also the analysis and interpretation of legal acts, findings from opinion research of target group that have helped to draft proposals for the necessary electoral, legal and institutional reform needs .

The methodology used is qualitative and quantitative method, method of description, comparison , legal analyzis and data and information analysis collected during the research process.

Key words: electoral system, representation, governance, political system, political parties, party system gender and ethnicity quote

DEDIKIMI

Për familjen shumë dashuri, respekt dhe mirënjohje për jetë!

FALËNDERIM

Falënderoj prof. dr. Ferit Duka, prof. dr. Migena Leskoviku, prof. dr. Dariel Sina, prof. Dr. Klejd Këlliçi dhe kolegët e miqtë e mi si dhe gjithë qytetarët-respondent, anëtarët e strukturave drejtuese të partive politike, deputetët dhe drejtuesit e institucioneve, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmueshëm në realizimin e këtij punimi.

Gjithashtu shpreh falënderimet më të sinqerta për udhëheqësin shkencor prof. assoc. dr. Ervis Iljazaj, oponenten prof.assoc.dr.Eriona Canaj dhe vlerësuesen metodologjike prof. Evelina Çela, PhD për kujdesin e treguar gjatë procesit të finalizimit të punimit.

Një falënderim i veçantë, shkon për familjen time.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

DEKLARATA E AUTORËSISË	II
Abstract.....	IV
DEDIKIMI	V
FALËNDERIM.....	VI
PËRMBAJTJA E LËNDËS.....	VII
LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE	XII
Tabelat:.....	XII
Grafikët:.....	XIII
Figurat:	XIV
LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT	XVI
KAPITULLI I : HYRJA DHE BAZIMI TEORIK.....	1
1.1. Hyrja	1
1.2. Qëllimi i punimit.....	15
1.3. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza.....	18
1.4. Metodot dhe Metodologjia e Kërkimit	19
1.4.1. Burimet e studimit.....	21
1.5. Objektivat e punimit.....	22
1.6. Shtrimi i problemit	23
1.7. Struktura e punimit	26
KAPITULLI II: ASPEKTI TEORIK PËR MODELET E SISTEMEVE ZGJEDHORE.....	29
2.1. Koncepti për sistemet zgjedhore.....	29
2.2. MODELET E SISTEMEVE ZGJEDHORE	33
2.2.1. MODELI MAZHORITAR.....	36
2.2.1.1. I Pari i listës merr postin (IPLMP)	37
2.2.1.2. Vota Bllok dhe Vota e Bllokut Partiak.....	41
2.2.1.3. Vota alternative (VA).....	42
2.2.1.4. Sistemi dy raundesh (SDR)	42
2.2.2. MODELI PROPORCIONAL	43
2.2.2.1. Lista e përfaqësimit proporcional (LPP).....	43

2.2.2.2.	<i>Vota e vetme e transferueshme (VVT)</i>	46
2.2.2.3.	<i>Sistemet e përziera (PM)</i>	47
2.2.3.	MODELI GJYSMËPROPORCIONAL	48
2.2.3.1.	<i>Vota e vetme e patransferueshme (VVPT)</i>	48
2.2.3.2.	<i>Sistemet paralele - të përziera</i>	49
2.2.4.	Votimi i Kufizuar dhe Borda Count	51
KAPITULLI III: ANALIZË KORNIZËS LIGJORE PËR SISTEMIN ZGJEDHOR NË KOSOVË		52
3.1.	Analizë kornizës normative për të drejtën zgjedhore në Kosovë.....	52
3.2.	Analizë kornizës ligjore për zgjedhjet e përgjithshme: Sistemi zgjedhor, Listat, Preferencat, Kuota gjinore dhe pragu zgjedhor	57
3.3.	Analizë kornizës ligjore për zgjedhjet lokale: Sistemi zgjedhor, listat dhe preferencat	67
3.4.	ANALIZË DISPOZITAVE LIGJORE PËR MENAXHIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR DHE DREJTËSISË ZGJEDHORE NË KOSOVË.....	76
3.4.1.	<i>Menaxhimi i Procesit Zgjedhor në Kosovë</i>	76
3.4.1.1.	<i>Përbërja e strukturave të administrimit të procesit zgjedhor</i>	78
3.4.2.	Drejtësia Zgjedhore: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	84
3.2.1.	Procedura për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore në procesin zgjedhor.....	85
3.5.	Gjetjet nga hulumtimi për domosdoshmerinë e reformës ligjore, administrimin zgjedhor dhe opinionin e respondentëve për sistemin zgjedhor	89
KAPITULLI IV: ZGJEDHJET DHE PJESËMARRJA E ULËT E QYTETARËVE NË ZGJEDHJE: Një Trend në Rritje		102
4.1.	Zgjedhjet dhe pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhjet nacionale.....	102
4.2.	Zgjedhjet dhe pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhjet lokale	108
4.3.	Zgjedhjet dhe pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhjet për Kryetar të Komunave	109
4.4.	Votat e mbetura apo të humbura	111
4.5.	Abstenimi si reflektim për votën e humbur	114
4.6.	Gjetjet nga hulumtimi për faktorët që po ndikojnë në rënien e pjesëmarrjes në zgjedhje.....	119
KAPITULLI V: EFEKTI I SISTEMIT ZGJEDHOR TE SISTEMI PARTIAK NË KOSOVË		125
5.1.	Fillimet e pluralizmit në Kosovë	125

5.2. Analizë kornizës ligjore për Regjistrimin dhe Veprimtarinë e Partive Politike në Kosovë.....	127
5.3. Sistemi partiak në Kosovë.....	135
5.4. Gjetjet e hulumtimi për masat dhe aktivitetet që kërkohet të ndërmerren nga partitë politike.....	140
KAPITULLI VI: SISTEMI POLITIK DHE KUSHTETUES NË KOSOVË.....	149
6.1. Konteksti dhe historiku	149
6.2. Sistemi Politik dhe Kushtetues i Republikës së Kosovës.....	151
6.3. ANALIZË KORNIZËS NORMATIVE DHE REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE NACIONALE NË KOSOVË (2001-2017) SI DHE FORMIMIT TË INSTITUCIONEVE PËRFAQËSUESE DHE EKZEKUTIVE	155
6.3.1. Analizë kornizës normative për formimin e institucioneve.....	155
6.3.2. Formimi i institucioneve sipas Kornizës Kushtetuese dhe rezultatit zgjedhor për Legjislaturën e Parë (2001-2004).....	157
6.3.2.1. <i>Qeveria Rexhepi. Koalicioni i LDK-së me PDK-n dhe AAK-n (2002-2004)</i>	162
6.3.3. Formimi i institucioneve sipas Kornizës Kushtetuese dhe rezultatit zgjedhor për Legjislaturën e dytë (2004-2007)	165
6.3.3.1. <i>Qeveria Haradinaj I. Koalicioni LDK dhe AAK (2004-2008)</i>	167
6.3.4. Formimi i institucioneve sipas Kornizës Kushtetuese dhe rezultati zgjedhor për Legjislaturën e tretë (2007-2010).....	168
6.3.4.1. <i>Qeveria Thaçi I. Koalicioni PDK dhe LDK (2008-2010).....</i>	172
6.3.5. Formimi i institucioneve sipas Kushtetutës së Republikës të Kosovës dhe rezultatit zgjedhor për Legjislaturën e katërt (2010-2014).....	174
6.3.5.1. <i>Qeveria Thaçi II. Koalicioni PDK dhe AKR (2010-2014).....</i>	179
6.3.6. Formimi i institucioneve sipas Kushtetutës së Republikës të Kosovës dhe rezultatit zgjedhor për Legjislaturën e pestë (2014 -2017).....	180
6.3.6.1. <i>Qeveria Isa Mustafa. Koalicioni PDK dhe LDK (2014-2017).....</i>	187
6.3.7. Formimi i institucioneve sipas Kushtetutës së Republikës të Kosovës dhe rezultatit zgjedhor për Legjislaturën e gjashtë (2017-)	188
6.3.7.1. <i>Qeveria Haradinaj II. Koalicioni PAN- me AKR dhe Minoritet- Qeveri e shumicës apo qeveri stabile?</i>	196
6.4. Gjetjet e hulumtimit për mungesë të relacionit votues -përfaqësues dhe të përfaqësimit jo të drejtë të vullnetit të tyre në Kuvend	198

KAPITULLI VII: ANALIZË KORNIZËS NORMATIVE DHE EFEKTIT TË SISTEMIT ZGJEDHOR PROPORCIONAL NË ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT NGA KUVENDI: krizat politike dhe evitimi i tyre	203
7.1. Analizë kornizës normative për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës.....	203
7.2. Zgjedhja e Kryetarit të Kosovës sipas Kornizës Kushtetuese (2002-2008)	205
7.3. Zgjedhja e Presidentit sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.....	208
7.4. Gjetjet e hulumtimit: Zgjedhja e Presidentit drejtpërsëdrejti nga populli domosdoshmëri e kohës dhe opsion i mbështetur nga opinioni	213
KAPITULLI VIII:ANALIZË KORNIZËS NORMATIVE MBI KONTROLLIN POLITIK TË QEVERISË DHE PRESIDENTIT NGA KUVENDI (2001-2017)	216
3.1. Analizë kornizës normative mbi kontrollin politik të Qeverisë dhe Presidentit nga Kuvendi i Kosovës	216
3.2. Mocioni i votëbesimit dhe shkarkimi i qeverisë	218
3.3. Procedura e Impeachment-it ndaj Presidentit	220
KAPITULLI IX : PËRFAQËSIMI I GRAVE NË INSTITUCIONE SIPAS KORNIZËS NORMATIVE PER KUOTËN GJINORE DHE REZULTATIT ZGJEDHOR	225
9.1. Barazia gjinore vlerë kushtetuese	225
9.2. Analizë Kornizës ligjore për kuotën gjinore që promovon përfaqësimin e grave në institucionet e Kosovës	227
9.3. Përfaqësimi i grave në institucionet e Kosovës - kuota gjinore	229
6.4. Të gjeturat e hulumtimi për mënyrat se si të veprohet në të ardhmen për avancimin e gruas në pozitë vendimmarrëse	234
KAPITULLI X: PËRFAQËSIMI I MINORITETEVE NË INSTITUCIONE SIPAS KORNIZËS NORMATIVE PËR KUOTAT ETNIKE DHE REZULTATIT ZGJEDHOR	240
10.1. Analizë Kornizës Ligjore për kuotat etnike që sigurojnë përfaqësim të komuniteteve Minoritarë në Kosovë	240
10.2. Përfaqësimi në Kuvendin e Republikës.....	243
10.3. Përfaqësimi i komuniteteve në Qeveri	247
10.4. Përfaqësimi i komuniteteve në pushtetin lokal: Qeverisjen e Komunave	248
KAPITULLI XI: KONKLUZIONE DHE PROPOZIME	253
Përfundime dhe Rekomandime	253
LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA	281
Shtojca 1. Struktura e respondentëve, qytetarët dhe përfaqësuesve politikë.....	306

Shtojca 2 Pyetësorët	311
----------------------------	-----

LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE

Tabelat:

Tabela 1. Modelet e sistemeve zgjedhore

Tabela 2. Sistemi zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme (2001-2017)

Tabela 3. Sistemi zgjedhor për zgjedhjet lokale (2000-2013)

Tabela 4. Sistemi zgjedhor për zgjedhjen e Kryetarit të Komunës (2007-2013)

Tabela 5. Elektorati dhe pjesëmarrja në zgjedhjet e përgjithshme (2001-2017)

Tabela 6. Elektorati dhe pjesëmarrja në zgjedhjet lokale (2000-2013)

Tabela 7. Elektorati dhe pjesëmarrja në Zgjedhjet për Kryetar të Komunave (2007-2013)

Tabela 8. Numri i kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhjet e përgjithshme (2001-2014)

Tabela 9. Numri i Përfaqësuesve nga Komunitat në Kuvend (2001-2014)

Tabela 10. Numri i Partive Politike të regjistruara dhe të çregjistruara

Tabela 11. Numri i Subjekteve Politike të certifikuara për zgjedhjet e përgjithshme (2001 - 2017)

Tabela 12. Numri i Subjekteve Politike të certifikuara për zgjedhjet lokale dhe përkatësia e tyre etnike (2000-2013)

Tabela 13. Numri i Partive Politike të certifikuara për zgjedhjet nacionale dhe përkatësia e tyre etnike (2001-2014)

Tabela 14. Numri i subjekteve politike elektorale dhe Parlamentare (2001-2017)

Tabela 15. Pjesëmarrja e partive, koalicioneve, iniciativa, Kandidatë të pavarur në zgjedhjet e përgjithshme (2001 - 2017)

Tabela 16. Rezultatet përfundimtare për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2007

Tabela 17. Rezultatet përfundimtare për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010

Tabela 18. Rezultatet përfundimtare për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014

Tabela 19. Rezultatet përfundimtare për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017

Tabela 20. Numri i deputetëve sipas gjinisë në Kuvend (2001 - 2017)

Tabela 21. Numri i deputetëve shqiptarë dhe minoritarë në Kuvend (2001 - 2017)

Tabela 22. Përbërja e Kuvendit të Kosovës sipas përkatësisë etnike (2001 - 2017)

Grafikët:

Grafiku 1. Trendi i daljes së qytetarëve në zgjedhjet e përgjithshme (2001-2017)

Grafiku 2. Votat e mbetura në tri palë zgjedhje të përgjithshme (2010-2017)

Grafiku 3. Subjektet e certifikuara elektorale dhe parlamentare (2001-2017)

Grafiku 4. Pjesëmarrja e partive politike, koalicioneve, iniciativa qytetare dhe Kandidatët e pavarur në zgjedhjet përgjithshme (2001 - 2017)

Grafiku 5. Mandatet sipas subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në zgjedhjet e vitit 2001

Grafiku 6. Mandatet sipas subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në zgjedhjet e vitit 2004

Grafiku 7. Mandatet sipas subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në zgjedhjet e vitit 2007

Grafiku 8. Mandatet sipas subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në zgjedhjet e vitit 2010

Grafiku 9. Mandatet sipas subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në zgjedhjet e vitit 2014

Grafiku 10. Mandatet sipas subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend në zgjedhjet e vitit 2017

Grafiku 11. Përfaqësimi sipas gjinisë në Kuvendin e Kosovës (2001-2017)

Grafiku 12. Numri i deputetëve sipas përkatësisë etnike shqiptare dhe minoritetet e tjera

Grafiku 13. Pasqyra etnike e përfaqësimit në Kuvend (2001-2017)

Grafiku 14. Përbërja etnike e përfaqësimit të Kryetarëve të Komunave (2013-2017)

Figurat:

Figura 1. Preferenca e qytetarëve për të ardhmen për mënyrën e votimit

Figura 2. Preferenca e përfaqësuesve politikë për të ardhmen për mënyrën e votimit

Figura 3. Faktorët që ndikojnë negativisht në pjesëmarrje të ulët në zgjedhje

Figura 4. Mënyrat më efektive për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje

Figura 5. Llojet e aktiviteteve të fushatës që duhet të bëjnë kandidatët apo partitë për të rritur pjesëmarrjen në zgjedhje

Figura 6. Cilat cilësi janë më të rëndësishme për zgjedhjen e liderit të partisë

Figura 7. Kushtet për kandidatët për deputet dhe a duhet të jetë anëtar i partisë para se të bëhet pjesë e listës së partisë

Figura 8. Sa bashkëveprojnë partitë politike apo kandidatët me përkrahësit/votuesit e tyre

Figura 9. Sa partia është e hapur të rekrutojë anëtarë apo jo

Figura 10. Kush duhet të vendosë për listën zgjedhore kandidat për deputet

Figura 11. Përqindja e votave sipas subjekteve politike në zgjedhjet e përgjithshme 2001

Figura 12. Opinioni i qytetarëve lidhur me performancën e Parlamentit në vitet e fundit

Figura 13. Opinioni i qytetarëve lidhur me përfaqësimin e drejtë të vullnetit të votuesve në parlament prej deputetëve

Figura 14. Opinioni i qytetarëve lidhur me përfaqësimin e pikëpamjeve të votuesve në mënyrë të kënaqshme prej partive politike në Kosovë

Figura 15. Opinioni i qytetarëve lidhur me kontaktet e tyre me deputetë ose zyrtarë qeveritarë

Figura 16 . Opinioni i respondentëve se kush duhet të zgjedhë Presidentin e Kosovës

Figura 17. Opinioni i qytetarëve për pjesëmarrjen e gruas në politike dhe në vendimmarrje

Figura 18. Opinioni i qytetarëve lidhur me mbështetjen e njëjtë nga partia për burrat dhe gratë

Figura 19. Opinioni i përfaqësuesve politikë lidhur me mbështetjen e njëjtë nga partia për kandidatet gra ashtu edhe burra

Figura 20. Grupmosha e target grupit qytetar

Figura 21 Gjinia e target grupit qytetar

Figura 22. Vendbanimi i target grupit qytetar

Figura 23. Interesimi për politikën nga target grupi qytetar

Figura 24 . Grupmosha e respondentëve me funksion publike dhe politike

Figura 25. Gjinia e respondentëve me funksion publik dhe politik

Figura 26. Niveli arsimor i respondentëve me funksion publik dhe politik

Figura 27. Vendbanimi i respondentëve me funksion publik dhe politik

Figura 28 . Funksioni në parti i respondentëve me funksion publik dhe politik

Figura 29. Niveli i përgjegjësisë në parti i respondentëve me funksion publik dhe politik

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKR	Aleanca e Kosovës së Re
ASI	Assembly Support Initiative Newsleter
BC	Borda Count
BD	Bashkimi Demokratik
BE	Bashkimi European
BK	Balli Kombëtar
BSDAK	Bošnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova
CDS	Crnogorska Demokratska Stranka
CEC	Central Election Commission
DnV	Demokracia në Veprim
ENEMO	Rrjeti Evropian i Organizatave për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
EU ROM	Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
EU	Unioni Evropian,
F	Fletëvotimi
FER	Fryme e Re
FSK	Forcat e Sigurisë të Kosovës
GiG	Gornaska iniciativa Gore
ICG	International Crisis Group
IDEA	Interntional Institute for Demoracy and Election Assistance
IDK	Instituti Demokratik i Kosovës
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
IPLMP	I pari i Listës merr Postin
IQ	Iniciativa Qytetare
IQK	Iniciativa Qytetare e Kosovës
IRDK	Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
JSL	Jedinstvena Srpska Lista

KDTP	Kosova Demokratik Türk Partisi
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
KFOR	Organizata e Forcave të Atlantikut të Veriut në Kosovë
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
KKZ	Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
KODI	Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Dokumentim
KP	Koalicioni Povratak (kthimi)
KPM	Komisioni i Pavarur i Medieve
KQZ	Komisioni Qendror Zgjedhor
KS	Këshilli i Sigurimit
KVV	Këshilli i Vendvotimeve
KZAP	Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
KZAZ	Komisioni Zonal për Administrimin Zgjedhor
LA	Lëvizja Alternativa
LB	Lëvizja për Bashkim
LBD	Lëvizja e Bashkuar Demokratike e Kosovës
LDD	Lidhja Demokratike e Dardanisë
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LKCK	Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës
LPK	Lëvizja Popullore e Kosovës
LPP	Lista e përfaqësimit proporcional
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
Mn	Minoritetet
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
ND	Nova Demokratija
NDS	Nova Demokratska Stranka
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OKP -	Opstanak Kosovskog Pomoravlja

Ora	Partia ORA
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
ODIHR	Office for Democratic Institutions and Human Rights
PAD	Partia e Aksionit Demokratik e Boshnjakëve të Kosovës,
PAI	Partia e Ashkalinve për Integrim
PD	Partia e Drejtësisë
PDASHK	Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PDS	Progresivna Demokratska Stranka
PDSK	Partia Social-Demokrate e Kosovës,
PDTK	Partia Demokratike Turke e Kosovës
PF	Partia Fshatare
PGJK	Partia e Gjellbër e Kosovës
PIPS	Instituti i Prishtinës për Studime Politike
PLE	Partia Liberale Egjiptiane
PLK	Partia Liberale e Kosovës
PLSH	Partia Liberale Shqiptare
PM	Proporcionaliteti mikst
PNDSh	Partia Nacionale Demokratike Shqiptare
PP	Përfaqësimi Proporcional
PPK	Partia Parlamentare e Kosovës
PQLK	Partia e Qendrës liberale të Kosovës
PR	Proporcional
PREBK	Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
PSHDK	Partia Shqiptare Demokristiane
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
QNR	Qendra e numërimit
Rreg	Rregullorja
R-2	Raundi i dytë

SDA	Stranka Demokratske Akcije
SDR	Sistemi dyraundesh
SDSKiM	Srpska Demokratska Stranka Kosova i Metohije
SDSKiM	Srpska Demokratska Stranka Kim
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SKMS	Srpska Kosovsko Metohijska Stranka
SKQZ	Sekretaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
SLS	Serbska Liberalna Stranka (Partia Liberale Serbe)
SM	Sistemi mazhoritar
SNS	Srpska Narodna Stranka
SNSDKiM	Savez Nezavisnih Socijaldemokrata Kosova i Metohije
SPM	Sistemi proporcionalitetit Mikst
UA	Udhëzimi Administrativ
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UN	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VA	Vota alternative
VAKAT	Koalicioni Demokratska stranka -Vatan, Ujedinjena Stranka Boshnjaka dhe Nova Boshnjačka Stranka
VATAN	Demokratska stranka –Vatan,
VB	Vota bllok
VBP	Vota bllok partiake
VK	Vota e Kufizuar
VLAN	Koalicioni, Vetëvendosje - Lidhje Demokratike e Kosovës - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma për Kosovën
VT	Vota e transferueshme
VVPT	Vota e vetme e patransferueshme
ZKM	Zyra e Kryeministri

KAPITULLI I : HYRJA DHE BAZIMI TEORIK

1.1.Hyrja

Koncepti për votën dhe demokracinë elektorale është në proces të vazhdueshëm të zhvillimit, duke krijuar hapësirë për shprehjen e vullnetit të elektoratit në njërën anë si dhe të realizimit të këtyre kërkesave prej institucioneve demokratike, nga ana tjetër. Në fakt, vota është themel për ndërtimin e sistemit (shtetit juridik) dhe qeverisjes demokratike. Mirëpo sistemi demokratik, qoftë i krijuar dhe zhvilluar si formë e qeverisjes, mënyrës së përfaqësimit dhe funksionimit në shoqëri, krijon hapësirë më të gjerë për shprehjen e vullnetit politik, si për subjektet politike ashtu edhe për qytetarin dhe grupet e ndryshme të shoqërisë dhe institucioneve demokratike. Roli i sistemit zgjedhor dhe rëndësia e demokracisë elektorale është ndër faktorët kryesorë për ndërtimin e institucioneve, qeverisjes dhe sistemit demokratik. Në kuadër të ndërtimit të sistemit demokratik, organizimi i zgjedhjeve të lira ka funksion thelbësor. Në fakt, një sistem politik vlerësohet demokratik apo jo demokratik, varësisht se sa i përmbush kriteret për zgjedhje të lira, të drejtpërdrejta dhe të përgjithshme. Ato (zgjedhjet) duhet të jenë në përputhje me standardet demokratike apo parimet bazë të trashëgimisë elektorale evropiane që janë: *votimi i përgjithshëm, i barabartë, i lirë, i fshehtë dhe i drejtpërdrejtë..... dhe duhet të zhvillohen në intervale të rregullta kohe* (Komisioni i Venecias, Nr.190/2002) si dhe në përputhje me legjislacionin e miratuar nga forcat politike që duhet të pranojnë legjitimitetin e sistemit dhe për të qenë në gjendje të përmbushin detyrën e tyre për të siguruar legjitimitet, stabilitet dhe funksionalitet të shtetit në Kosovë. Gjithashtu, ato duhet

të arrijnë pranimin e gjerë nga të gjithë pjesëmarrësit në proces zgjedhor. Përndryshe, një vend pa zhvilluar zgjedhje periodike dhe pa respektuar të drejtën universale të votimit, ai nuk do të konsiderohet sistem demokratik, sepse, zgjedhje organizojnë edhe vendet jodemokratike për të formalizuar pushtetin totalitar. Për këtë arsye, nëse demokracia është vendosur në përgjithësi si forma e vetme e pranueshme e qeverisjes e dalë nga zgjedhjet e lira apo sipas Richard Katz *"bëhet një argument i përgjithshëm për legjitimitetin e një sistemi politik, i cili është legjitim, sepse është demokratik dhe demokratik sepse mban zgjedhje"* (Katz, R. 1997:101-102). Mirëpo sipas Norris-it "zgjedhjet nuk janë të mjaftueshme vetvetiu për demokracinë përfaqësuese, por është një kusht i domosdoshëm pa të cilën nuk mund të ketë demokraci dhe konsiderohet si e tillë" (Norris, P. 2004:4; LeDuc, L.&Niemi, R& Pippa Norris:2002:1). Madje "legjitimitetin procesit zgjedhor" sipas prof. Fehmi Aganit ia jep kryesisht "pjesëmarrja masive e qytetarëve dhe deklarimi i lirë i zgjedhësve në votime" (Agani, F. 1999:306). Pa dyshim se kësaj i kontribuon edhe leximi i drejtë i votës së qytetarëve dhe përkthimi i saj në mandate në Kuvend dhe reflektimi në stabilitet dhe funksionalitet të qeverisjes. Ndërkaq, një pjesëmarrje shumë e ulët ose një përqindje shumë e lartë e votave të humbura mund të shërbejnë si tregues relevantë apo mund të vënë në pikëpyetje legjitimitetin e sistemit. Natyrisht se përveç zgjedhjeve është i domosdoshëm edhe përfaqësimi i drejtë i shoqërisë në organet përfaqësuese dhe qeverisëse sipas përbërjes së shoqërisë në vend. E megjithatë, në lehtësimin e përfaqësimit të të gjitha grupeve politike dhe etnike në të gjitha vendet determinohet gjithmonë nga modeli zgjedhor dhe sistemi juridik dhe politik.

Në përgjithësi sistemet zgjedhore përcaktohen si instrumente, metoda apo mënyra me të cilën votat e hedhura në kutinë e votimit gjatë zgjedhjeve përkthehen në vende në Parlament. Së këndejmi ato përkufizohen si: *“një tërësi të rregullave thelbësisht të pandryshueshme në bazë të të cilave një ose më shumë procese zgjedhore organizohen në një vend demokratik* (Lijphart, A. 1994:13); *“sistemi zgjedhor përfshin rregullat ligjore zgjedhore që determinojnë përbërjen e parlamentit”* (M. Gallagher&P. Mitchell 2005:3); *"instrumenti më manipulues i politikës"* (Sartori, G.1994: ix). Madje sistemet zgjedhore janë mjetet me të cilat votat përkthehen në vende në legjislaturë (Douglas J. Amy 2000:1); apo Sistemet zgjedhore sipas Devid M Farrell janë si *"vidat që ia mundësojnë rrotave të demokracisë të funksionojë siç duhet"*, (Devid M Farrell, 2001:2).

Edhe Kosova, si çdo shtet demokratik për zgjedhjen e institucioneve përfaqësuese aplikon një sistem të caktuar zgjedhor. Mënyra se si përkthehet vota e qytetarëve në mandate parlamentare përcaktohet nga faktorë të ndryshëm të cilët ndërlidhen me specifikat e vendit, siç janë rregullimi dhe përbërja e shtetit, traditat, struktura demografike, ndarjet etnike dhe ideologjike. Në dizajnimin e sistemeve zgjedhore, faktor vendimtar në përzgjedhjen e tij është ai sistem që favorizon partitë që kanë ndikim më të madh. Sistemet zgjedhore konsiderohen të kenë efekte "mekanike" dhe "psikologjike" (IDEA 2005:6). Në votim, ndikojnë, sidomos, efektet psikologjike ndërsa efektet mekanike ndikojnë në rezultatin e votimit (Blais, A.& L. Massicotte 1996:67).

Një nga argumentet kryesorë në debatin rreth sistemeve zgjedhore është ajo rreth avantazheve dhe disavantazheve të sistemeve mazhoritar dhe proporcional (Schmidt, G. M, 2012:306-337).

Një ndër avantazhet e modelit mazhoritar është se ai determinon qeveri të shumicës njëpartiake, sistem dypartiak në Kuvende, ndërsa përkrahësit e sistemit proporcional e favorizojnë këtë formulë për përfaqësimin e saj të gjerë dhe të drejtë, për grupet politike, etnike dhe gjinore. Mirëpo përveç stabilitetit, llogaridhënia është një avantazh tjetër i qeverive me shumicë njëpartiake. Madje, sipas Lijphart zgjedhja midis sistemeve proporcionale dhe mazhoritar varet nga theksi i vënë në vlera të tilla si proporcionaliteti dhe përfaqësimi i pakicave nga njëra anë ose përgjegjësia e qeverisë nga ana tjetër (Lijphart, A. 1994 :57-78). Gjithashtu, Duverger thekson faktorët teknikë të sistemit zgjedhor sipas formulës: *"votimi me një shumicë të thjeshtë favorizon sistemin dypartiak"*, në krahasim me *"sistemet mixt dhe përfaqësimi proporcional të cilat favorizojnë sistemin shumëpartiak"* (Duverger, M. 1972: 23-32). Në këtë kontekst edhe Sartori e favorizon formën e sistemit të votimit të dyfishtë dhe mbi të gjitha sistemet e tjera, veçanërisht kur ato prodhojnë një sistem dypartiak, i cili rezulton në një qeveri të përgjegjshme e përbërë prej një partie të vetme. Ai i jep sistemit mazhoritar aftësinë për të mbajtur të ulët fragmentimin e partisë, dhe në këtë mënyrë për të nxitur qeverisjen efektive. Përgjegjësia e qeverisë dhe vendosmëria e votës janë vlerat e favorizuara të mbështetësve të sistemit mazhoritar. Për këtë, ai kritikon pikëpamjen se sistemet proporcionale janë në thelb superior ndaj sistemeve mazhoritare dhe prandaj ato gjithmonë duhej të preferoheshin në veçanti, Gjithashtu, Sartori kundërshton argumentin se *"kërkesa më e madhe e demokracisë përfaqësuese është përfaqësimi i drejtë dhe se përfaqësimi është i drejtë vetëm kur është proporcional"* (Sartori, G. 1994:69). Sipas tij sistemi proporcional nuk ka nevojë për ndonjë teori të madhe dhe se ajo mund të jetë e mbyllur në mënyrë të thjeshtë

dhe të drejtpërdrejtë me argumentin se krijon qeveri përfaqësuese, e cila është thelbi i politikës demokratike.

Një këndvështrim tjetër kanë mbështetësit e sistemit proporcional, që preferojnë këtë sistem për “drejtësinë dhe përgjegjshmërinë” e tij (Blais, A.&L. Massicotte, 1996:49- 81). Madje, sistemi i përfaqësimit proporcional konsiderohet i drejtë, sepse ai synon që t’i ndajë secilës parti politike aq numër të mandateve ekuivalent me fuqinë e votave të saj. Ato vlerësohen se japin një përfaqësim më të drejtë se sa familja e sistemeve mazhoritare. Kjo çon në një diversitet më të madh të pikëpamjeve të shprehura në parlament, sepse përfaqësohen më shumë parti politike. Dhe për këtë arsye përkrahësit e proporcionalit e konsiderojnë atë veçanërisht të përshtatshme për shoqëritë e polarizuara dhe me ndarje të thella, etnike, ideologjike, për shkak të aftësisë së saj për të përfaqësuar grupet minoritare dhe partitë politike në Parlament. Në lidhje me këtë, Arend Lijphart në studimin e tij për sistemet zgjedhore dhe sistemet partiake në 27 demokraci nga viti 1945-1990, tregon se shkalla e proporcionalitetit dhe e shpërpjesëtimit zgjedhor përgjigjet shumë me ndjeshmëri ndaj rregullave të sistemit zgjedhor, aq sa dy të tretat e ndryshimit në disproporcionalitet mund të shpjegohen vetëm nga sistemi zgjedhor. Mandej, sipas tij ekziston "një marrëveshje universale që proporcionaliteti zgjedhor është një qëllim i madh i sistemeve zgjedhore", si dhe një kriter kryesor me të cilin duhet të gjykohet duke përshkruar proporcionalitetin si një qëllim në vetvete, sinonim me drejtësinë zgjedhore, si dhe një mjet i rëndësishëm për përfaqësimin e minoriteteve (Lijphart, A. 1994: 139-140).

Përveç të tjerash ndikimi i sistemit zgjedhor është përcaktues për sistemin politik dhe partiak, përfaqësimin e grave, grupeve etnike dhe politike në Kuvend. Në lidhje me këtë,

përveç, Duverger, i cili thekson se sistemi mazhoritar një "*sistem votimi me një shumicë të thjeshtë*" favorizon "sistemin dypartiak", në krahasim me dy format e tjera "sistemet mixt dhe përfaqësimi proporcional të cilat favorizojnë sistem shumëpartiak" (Duverger, M, 1954: 217, 239). Gjithashtu, edhe Lijphart thekson lidhjen e fortë midis "sistemit zgjedhor dhe numrit efektiv të partive në Parlament" (Lijphart, A. 1994:41). Sipas tij, në përgjithësi pragu efektiv dhe sistemi mazhoritar në veçanti konsiderohen si instrumentet më të forta të eksperimenteve elektorale për të ndikuar në sistemin e partive politike. Përveç këtyre, sistemi i kuotave ose vendeve të rezervuara/garantuara për minoritetet mund të konsiderohet po aq i rëndësishëm për sistemin partiak dhe numrit të partive politike në Kuvend, siç është rasti i Kosovës.

Për ta bërë procesin më të lehtë analitik, këto sisteme zgjedhore ndahen në tri grupe, mazhoritar, proporcional dhe i kombinuar. Të tri modelet zgjedhore janë të ndryshme me specifika dhe metoda të veçanta, që synojnë arritjen e një objektiv të njëjtë. E përbashkëta e tyre është përfaqësimi si çështje qendrore e tyre. Rrjedhimisht, sistemet proporcionale zgjedhore i referohen përbërjes së parlamentit, ndërsa sistemet mazhoritare i referohen raportit, votues me përfaqësuesin dhe llogaridhënien. Modeli i sistemeve të përfaqësimit proporcional - me lista të mbyllura e bëjnë më të mundshme zgjedhjen e përfaqësuesve të grupeve të pakicave, grave dhe partive të vogla (IDEA: 2005:60). Gjithashtu, partitë politike mund të inkurajohen nga sistemet e përfaqësimit proporcional për të vendosur listat e balancuara të kandidatëve që mbulojnë të gjithë spektrin e interesave në shoqëri. Në këtë mënyrë, sipas Lijphart, sistemi proporcional i jep avantazhin më të madh dhe i mundëson çdo pakicë të përfaqësohet në parlament për sa kohë që ato arrijnë një nivel minimal të

mbështetjes zgjedhore (Lijphart, A. 1994:140). Njëkohësisht, e rrit probabilitetin e grave për t'u zgjedhur përfaqësuese në Parlament.

Rrjedhimisht, partitë politike do të rekomandoheshin të përdorin lista për të mbështetur avancimin dhe fuqizimin e politikaneve gra, sidomos duke i orientuar votuesit të zgjedhin kandidatet gra për t'i votuar. Në përgjithësi, përfaqësimi i gruas është më i suksesshëm në sistemet proporcionale, e në veçanti në lista të mbyllura se sa me zonat një anëtarëshe, nga ana tjetër, sepse shumica e partive inkurajohen që të paraqesin një kandidat që është "më i pranueshëm gjerësisht" dhe ai person është rrallë një grua (IDEA 2005:61). Këtë fakt, e argumenton edhe rasti i Kosovës ku partitë politike shumë rrallë e propozojnë një kandidate për Kryetare të Komunës e cila "zgjidhet drejtpërdrejtë" nga qytetarët (Ligji Nr. 03/L-072 , Neni 9). Megjithatë, në tri zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2009, 2013 dhe 2017 ka pasur disa raste që në mesin e konkurrentëve, janë gra kandidate për Kryetar të Komunës (KQZ/QNR: 2009-2013-2017). Mirëpo, rasti i Komunës së Gjakovës është një argumentim i hipotezës se kur partitë politike e kanë vullnetin politik për të mbështetur plotësisht një kandidate ajo mund të ketë sukses në garën zgjedhore edhe në zonat një kandidatëshe apo sistemin mazhoritar. Ky argument mbështetet në zgjedhjet e vitit 2013, kur kandidatja e AKR-së, Mimoza Kusari Lila, i fiton zgjedhjet në balotazh dhe zgjidhet Kryetare e Komunës së Gjakovës, gruaja e parë kryetare në nivelin lokal nga 38 komunat e Kosovës (KQZ/QNR: 2013). Ndërsa kur mungon mbështetja politike ashtu sikurse në zgjedhjet e fundit lokale për Kryetar të Komunës (2017), edhe pse ishin dy kandidate në balotazh nuk arriti asnjëra prej tyre sukses për t'u zgjedhur Kryetare e Komunës së Gjakovës dhe Mitrovicës (KQZ/QNR 2017).

Për më tepër, siç thekson Norris, sistemet zgjedhore me zona të mëdha, inkurajojnë partitë që të krijojnë listë të balancuar të kandidatëve me një prag të ulët ose kuotat dhe vendet e garantuara e rrisin më tej mundësinë që gratë, pakicat të përfaqësohen në parlament, edhe në një sistem mazhoritar me njohje të qëllimshme të grupeve të paracaktuara të pakicave (Norris, P. 2004: 228), ashtu siç janë vendet e rezervuara apo të garantuara për komunitete minoritare në Kosovë. Kjo reflektohet edhe te përfaqësimi i grave dhe minoriteteve në institucionet e përkohshme dhe ato të Republikës së Kosovës nga ndikimi i sistemit zgjedhor dhe mundësitë që ato të zgjidhen në pozita përfaqësuese dhe vendimmarrëse (ABGj/ZKM 2014).

Çështja se cili sistem zgjedhor arrin një përfaqësim ideal ose më i miri, konsideroj që varet kryesisht nga zhvillimi i demokracisë, modeli i qeverisjes që do të përdoret në vend. Përveç kësaj, sistemi a është gjithëpërfshirës dhe sa përfaqësohen strukturat e popullsisë në institucionet përfaqësuese, dhe sa është e zhvilluar toleranca dhe integritet ndëretnike, kultura politike dhe demokratike në një shoqëri, reflektohet në Kuvend. Ndërsa institucioni përfaqësues apo siç thotë Edmund Burke “... *parlamenti nuk është kongres i ambasadorëve nga interesa të ndryshme dhe armiqësore, por një kuvend diskutues i një kombi, me një interes dhe ajo e përgjithshmja, që drejtohet jo nga qëllimet dhe paragjykimet lokale por nga e mira e përgjithshme, që rrjedh nga arsyeja e përgjithshme*” (E. Burke, 1949:116). Me fjale të tjera përfaqësimi në Kuvend duhet të jetë pasqyrë e shoqërisë së një vendi dhe të reflektojë shpirtin e tij. Në këtë mënyrë siç thotë John Adams, në Letrën dërguar John Penn, “*Parlamenti duhet të jetë një portret i saktë në miniaturë, i njerëzve në përgjithësi, duhet të mendojnë, të ndiejnë, të arsyetojnë dhe të veprojnë ashtu si ata.*” (Adams, J. 1852-1865:205).

Rrjedhimisht, Kuvendi e merr kuptimin e plotë të fjalës “sovrani” vetëm atëherë kur përfaqësohet në mënyrë të drejtë vullneti i popullit dhe vendos interesat e përgjithshme të tij.

Historia e demokracisë elektorale në Kosovë është e lidhur drejtpërsëdrejti me lirinë, demokracinë, pluralizmin dhe formimin e institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) të krijuara sipas bazës ligjore të aprovuar nga institucionet ndërkombëtare apo UNMIK-u, pas vitit 1999 deri 2008 si dhe legjislacionit të miratuar nga institucionet e Republikës së Kosovës pas qershorit të vitit 2008. Korniza ligjore bazike në të dy periudhat, si para pavarësisë së Kosovës dhe pas saj është fokusuar në krijimin e mundësisë për pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve në ndërtimin e institucioneve demokratike (KS, 1999 Rezoluta 1244, UNMIK 2001: Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të Kosovës; Kuvendi i Kosovës 2008: Kushtetuta e Republikës së Kosovës). Sipas Kornizës normative, sistemit politik dhe qeverisjes në Kosovë është vendosur modeli parlamentar, shumëpartiak dhe demokratik me ndarje të pushteteve (Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të Kosovës, Kreu 9; Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 4).

Demokracia elektorale dhe Parlamentarizmi në Kosovë është zhvilluar për afër dy dekada. Në kuadër të kësaj periudhe (2000-2017) janë mbajtur dymbëdhjetë (12) procese zgjedhore për dy nivelet e përfaqësimit, atij qendror dhe lokal (KQZ, 2017:14-15; KQZ/QNR: 2017). Prej tyre gjashtë janë procese zgjedhore për Kuvendin e Kosovës dhe gjashtë për nivelin lokal, duke përfshirë edhe katër cikle nga viti 2007-2017, për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave. Në përgjithësi, të gjitha proceset zgjedhore të organizuara për

të dy nivelet e pushtetit, përveç zgjedhjes së Kryetarëve të Komunave janë të mbajtura sipas sistemit të përfaqësimit proporcional me lista të hapura dhe preferencial me tri përjashtime të zgjedhjeve të vitit 2001, 2002 dhe 2004 (shih: Tabelat nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4) që janë organizuar me lista të mbyllura si dhe me një zonë të vetme zgjedhore (UNMIK/REG.2001/33, Neni 4.3, UNMIK/REG. 2001/9: 9.1.3; UNMIK/REG/2004/12, Neni 5; UNMIK/REG/2007/27; Neni 5; UNMIK/REG. Nr.. 2007/26 për ndryshimin e Rregullores Nr.2004/12, Neni 5.3-4-5; Ligji Nr. 03/L-073, Neni 110). Gjithashtu, të gjitha proceset zgjedhore, e në veçanti ato pas pavarësisë së Republikës së Kosovës kanë rezultuar me “vlerësime pozitive dhe negative” nga vëzhgues të ndryshëm, aktorët pjesëmarrës në zgjedhje dhe shoqëria civile për zgjedhjet dhe sistemin zgjedhor (EU EOM 2014:4; EU EOM 2017; Komisioni Evropian, Raport i progresit për Kosovën për vitet *KE 2010:7; KE 2011:6; KE-2012:7;... KE 2013:8;..KE 2014:6; KE 2016:6 KIPRED 2011/7;4-5; IPOL 2012:8-9*).

Formimi i institucioneve dhe gjashtë legjislatrave në përgjithësi është strukturuar sipas efektit të sistemit proporcional dhe konform dispozitave të Kornizës normative të UNMIK-ut si dhe Kushtetutës së Republikës që përcakton kuotën etnike apo vendet e rezervuara/garantuara për minoritetet si dhe kuotën gjinore për përfaqësimin e gruas. Vendorsja e kuotës etnike në Kuvend së pari është vendosur me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të Kosovës dhe pastaj Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar në mënyrë të njëjtë kuotën etnike prej 20 vendeve. Sipas dispozitave të këtyre dy akteve, është vendosur që në kuadër të Kuvendit, kuota etnike për përfaqësuesit e komuniteteve pakicë nga njëqind e njëzet vende, “njëzet prej tyre janë të (rezervuara)

garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë” (Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të Kosovës, Kreu 9.1.3, b; Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 64.2). Gjithashtu kuota gjinore është vendosur në fokus të legjislacionit për zgjedhjet dhe formimin e institucioneve të Kosovës në dy periudhat e qeverisjes si atë nën administrimin ndërkombëtar (UNMIK-ut) po edhe pas saj. Legjislacioni zgjedhor ka përcaktuar “kuotën gjinore prej 30% për gratë” për të gjitha institucionet përfaqësuese (UNMIK/REG Nr. 2000/39, Neni 4.2; UNMIK/ REG.2001/33; Neni 4 UNMIK/REG/2002/11: neni 5.5; UNMIK/REG/2004/12, Neni 21; UNMIK/REG /2007/26, Neni 6.6. UNMIK/RREG. Nr. 2007/27, Neni 6.4; Ligji Nr. 03/L-256, Neni 8.2, Ligji Nr. 03/L-072, Neni 8.4).

Ky punim është dizajnuar për të pasqyruar efektet e sistemit proporcional në procesin e ndërtimit dhe funksionimit të institucioneve dhe sistemit politik si dhe reformës së sistemit zgjedhor në Kosovë. Kjo më ndihmoi për të vlerësuar sistemin zgjedhor aktual dhe ta krahasoj atë me sistemet e tjera, me opsionet e ndryshme në dispozicion nga familja e sistemeve zgjedhore. Vendosja për sistemin zgjedhor është një vendim që kërkon kompromis politik dhe për këtë është e domosdoshme arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse nga të gjitha forcat politike në vend. Për faktin se, ashtu siç thotë Douglas, *“një nga arsyet kryesore me interes në rritje për reformën e sistemit zgjedhor, është rritja e perceptimit të lidhjes midis rregullave të votimit dhe nga problemet e shumta që po shfaqen në proceset zgjedhore”* (Douglas, J.A, 2000:2). Arsyeja më e qartë se sistemet zgjedhore janë të rëndësishme është që ato përcaktojnë se kush zgjidhet përfaqësues, dhe në fund të fundit ai vendos se cili person drejton institucionet shtetërore. Ai zgjidhet drejtpërdrejtë dhe ndikon në llojin e qeverisjes dhe politikave që do të miratohen dhe kush përfiton apo humb

nga këto politika. Prandaj ka shumë rëndësi se kush fiton zgjedhjet. Në fund të fundit, zgjedhja e sistemit zgjedhor ka një efekt të thellë jo vetëm për procesin e zgjedhjeve, por edhe për shkallën në të cilën një sistem politik është i drejtë, përfaqësues dhe demokratik. Në këtë kontest ashtu siç thekson Sartori, në veprën “Ç’është demokracia”: *“Sistemi elektoral që i intereson më shumë demokracisë është, para se gjithash, ai që i përgatit më mirë ato zgjedhje cilësore, prej së cilës varet rezultati pozitiv i eksperimenteve demokratike. Nëse zgjedhjet bëhen për të përcaktuar kush do të komandojë, mënyra më e mirë është ajo që e për zgjedh një lidhship të mirë”* (Sartori, G 1998 :99).

Në këtë punim, kemi përfshirë pikëpamjet e autorëve eminent të bëra në lidhje me çdo sistem zgjedhor. Një sistem zgjedhor është instrumenti i procedurave që përcaktojnë mënyrën se si njerëzit zgjidhen në postet politike dhe publike. Sidoqoftë, në Kosovë, reforma e sistemit zgjedhor nuk është një ide e re, por, diskutimi shpeshherë pengohet nga mungesa e vullnetit politik, frika dhe mungesa e informacionit të duhur. Është e vështirë që të ketë suksese një reformë zgjedhore apo institucionale, kur mungon konsensusi në mes të pozitës e opozitës, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë për optionet e reformës zgjedhore, dhe nëse shumica e aktorëve që vendosin nuk janë të gatshëm t’i pranojnë efektet e tyre. Në anën tjetër, duhet zgjedhur një sistem i përshtatshëm i cili e lehtëson shprehjen e vullnetit të qytetarëve përmes votimit dhe leximit të drejtë të votës së tyre.

Megjithatë, për të pasur një pasqyrë më të mirë dhe informata më shumë se si vepron sistemi zgjedhor proporcional dhe disa dispozita normative në krijimin e institucioneve, kemi analizuar efektin e tyre në sistemin politik dhe atë qeverisës si dhe konsolidimin e

demokracisë përfaqësuese në Kosovë, më tej, analizojmë efektin i cili promovon një përfaqësim të drejtë për të gjitha subjektet politike e sidomos për gratë dhe minoritetet në institucionet e Kosovës. Për t'iu përgjigjur këtyre çështjeve, çdo kapitull i veçantë në këtë punim përmban një përshkrim dhe analizë për avantazhet dhe disavantazhet e saj në proceset politike dhe institucionale. Për fat të mirë, nuk kemi speculuar në lidhje me këto efekte politike përveç interpretimit të fakteve dhe proceseve që kanë ndodhur realisht dhe propozimeve për të ndryshuar për të ardhmen. Ekzistenca e dëshmive dhe një literaturë shkencore mbi këtë problematikë do të thotë që mund të parashikoj me një bindje të thellë avantazhet dhe disavantazhet politike të prodhuara nga sistemi zgjedhor në Kosovë. Mirëpo një favorizim apo kritikë në lidhje me një sistem të caktuar nuk do të thotë domosdoshmërisht se është i vlefshëm për vendet apo rrethanat e tjera, pasi është shumë e vështirë të jepet një propozim kategorik për sistemin zgjedhor ideal për të gjitha rrethanat. Kjo argumentohet ashtu siç thotë David Farrell dhe Roger Scully *"për arsye të ndryshimeve të shumta që mund të ndodhin në hartimin e sistemit zgjedhor dhe gamës së gjerë të pasojave që rrjedhin nga këto ndryshime, qoftë në përbërjen partizane, etnike apo socio-ekonomike të parlamentit, përbërjes së qeverisë, stabilitetin e përgjithshëm të sistemit, angazhimin e votuesve ... etj."* (Farrell, D.&R. Scully, 2007:205).

Edhe në mesin e studiuesve ka nga ata që favorizojnë një sistem të veçantë zgjedhor nga modelet e tjera zgjedhore. Megjithatë shumica prej tyre janë të gatshëm të pranojnë se vendimi për një "model ideal" varet kryesisht nga vizioni i tyre për "demokracinë" (Schmidt, G. M, 2012).

Ky punim ofron analizë teorike dhe empirike të normave dhe proceseve zgjedhore, politike dhe efektin e tyre në krijimin dhe funksionimin e institucioneve politike dhe publike. Në mënyrë analitike është ndjekur procesi duke ardhur në përfundim me një propozim për formën e një modeli zgjedhor të përshtatshëm për Kosovën. Ky hulumtim iu ofron vendimmarrësve dhe studiuesve të fushës një model zgjedhor për rrethanat e Kosovës për të siguruar legjitimitetin demokratik, stabilitetin institucional dhe gjithëpërfshirje në përfaqësim. Në ndërtimin e një sistemi ideal të zgjedhjeve, kombinimi i mazhoritarit dhe proporcionalit me një kontakt të ngushtë e të mundshëm ndërmjet votuesve dhe kandidatëve në zonat zgjedhore, do të jepte rezultate më gjithëpërfshirëse.

Studimi ofron një hulumtim dhe analizë teorike dhe empirike të sistemeve zgjedhore në përgjithësi dhe legjislacionit e proceseve zgjedhore në veçanti si dhe efektin e tyre te sistemi politik, krijimin e institucioneve përfaqësuese e qeverisë dhe përfaqësimin gjinor dhe etnik në Kosovë. Ky studim përforcon argumentin që reformat e pakta elektorale kanë dhënë rezultate në aspektin e tranzicionit demokratik që nga vitet e para të pasluftës. Megjithatë, korniza ligjore dhe sistemi proporcional me variantet e saj me lista të hapura e preferenciale, me një zonë të vetme zgjedhore dhe pragu prej 5 përqind është pothuajse i pamjaftueshëm dhe jo adekuat për rrethanat e krijuara politike nga vetë ata në proceset politike që determinon pasiguri për avancimin demokratik dhe stabilitetin politik dhe institucional në Kosovë. Studimi ofron një pasqyrë të qartë dhe sistematike të zhvillimit të demokracisë elektorale dhe ndikimit të sistemit zgjedhor të sistemi politik, partiak e institucional dhe propozimet për ndryshimet e nevojshme.

1.2.Qëllimi i punimit

Kosova është një shtet i ri dhe në tranzicion me diversitet të shoqërisë shumëetnike dhe me një demokraci konsensuale, pluraliste dhe sistem parlamentar. Si në çdo demokraci tjetër edhe në Kosovë, institucionet burojnë, përveç kornizës normative, nga zgjedhjet, dhe përmes votës sigurojnë legjitimitetin e tyre. Historia e proceseve elektorale, pluralizmit politik dhe përfaqësimi i tyre në Kuvend dhe qeverisje e pasqyron mozaikun e shoqërisë dhe rregullimin e sistemit politik dhe juridik të Kosovës.

Hulumtimi ka pasur për qëllim të shtjellojë ndikimin e sistemit zgjedhor në sistemin politik dhe formimit të institucioneve në Kosovë, përfaqësimit të drejtë të shoqërisë kosovare në përgjithësi si dhe përfaqësimit të gruas e komuniteteve minoritare në veçanti. Gjithashtu, propozimi i një modeli më të përshtatshëm për Kosovën. Pastaj, krahasimi i proceseve zgjedhore, dispozitave normative dhe efektit të tyre në sistemin politik, partiak si dhe formimi i institucioneve politike dhe publike në bazë të rezultateve zgjedhore duke respektuar kuotën gjinore dhe etnike në veçanti. Përveç impaktit të tyre në sistemin politik, partiak dhe institucional, kemi tentuar të gjemë disa nga faktorët e tjerë kryesorë që ndikojnë në raportin votues-përfaqësues, vota si kontroll politik i qeverisjes; pjesëmarrja e qytetarëve në miratimin e politikave dhe zgjedhjen e liderëve të partive politike; përvojat e krijuara dhe zhvillimet e proceseve politike gjatë formimit të institucioneve, funksionimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të tyre si dhe për pjesëmarrjen e votueseve në procesin zgjedhor, votave të humbura, përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për zgjedhje të lira si dhe reformimin apo depolitizimin e administrimit të procesit zgjedhor.

Ndër rezultatet e dala nga trajtimi i këtij punimi:

- është pasqyruar roli i sistemit proporcional dhe sistemit kushtetues për integrimin dhe përfaqësimin e ideologjive politike, etnike të shoqërisë në institucione;
- është pasqyruar historia e demokracisë elektorale, parlamentarizmit dhe qeverisje konsensuale (kohabitacioneve), jo stabilitetit, krizat dhe bllokadat institucionale gjatë procesit zgjedhor dhe pas tij si dhe janë identifikuar masat të cilat konsiderohen si domosdoshmëri të ndërmerren për evitimin e tyre;
- është identifikuar dhe është e nevojshme të reformohet mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit të presidentit për të evituar krizat institucionale;
- është pasqyruar zhvillimi i pluralizmit dhe efektit të sistemit zgjedhor dhe ligjor, ajo e kuotës etnike të sistemit partiak në Kosovë dhe nevojat për reformë ligjore dhe institucionale për regjistrimin, veprimtarinë dhe funksionimin e partive politike. Mandej për masat që duhen të ndërmerren nga partitë politike për avancimin e barazisë gjinore në strukturat partiake dhe institucionet publike;
- është identifikuar se përmes kuotës gjinore është siguruar përfaqësimi i gruas në Parlament, mirëpo, mungon mbështetja politike nga partitë dhe kërkohet fuqizimi politik i saj;
- është identifikuar se përmes kuotës etnike është vendosur dhe siguruar (mbi)përfaqësimi etnik, megjithatë - kërkohet integrimi i tyre në shoqëri. Praktikrat e mira të modelit kosovar për vendet e garantuara për minoritetet mund të rekomandohet edhe për vendet e rajonit;
- është identifikuar dhe është e nevojshme depolitizimi i administrimit të procesit zgjedhor, reformimi i KQZ-së dhe PZAP-it apo drejtësisë zgjedhore si mekanizmat

kryesorë për organizimin, administrimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor për të garantuar realizimin e të drejtës së votës nga qytetarët dhe leximin, reflektimin e drejtë të vullnetit të zgjedhësve nga kutitë e votimit si dhe nevoja për nxjerrjen e një Kodi Zgjedhor që përmbledh të gjithë legjislacionin për zgjedhjet.

Nëpërmjet këtij punimi së pari, synohet të jepet një kontribut në literaturë mbi efektin e sistemit zgjedhor proporcional me veçoritë e tij të sistemi politik dhe formimi institucional të determinuara së pari nga rezultati i procesit zgjedhor, së dyti nga korniza normative dhe së treti, ai i kuotës gjinore dhe etnike apo vendeve të garantuara për komunitetet minoritare si masat më afirmative në rajon për garantimin dhe përfaqësimin e tyre në institucionet e Kosovës. Edhe pse në demokracitë e zhvilluara ekziston një literaturë apo pasqyrë e gjerë për efektet e sistemit zgjedhor në shumë sfera, në Kosovë, demokracia elektorale është e re dhe si fushë studimi është pak e eksploruar.

Së dyti, ka për qëllim të jepet një kontribut modest për çështjet që janë të diskutueshme në opinionin akademik dhe atë politik që kanë të bëjnë me reformën e sistemit zgjedhor dhe kushtetues si dhe ndikimin e tyre të sistemi politik, partiak, formimi dhe funksionimi institucional në Kosovë.

Së treti, punimi synon të ndihmojë zgjerimin e njohurive për faktorët kryesorë të cilët ndikojnë për formimin dhe funksionimin e një sistemi politik demokratik të qëndrueshëm, me institucione legjitime dhe gjithëpërfshirëse, stabile dhe llogaridhënëse në Kosovë.

Së katërti, ky punim ka për qëllim të pasqyrojë një sërë masash të cilat kanë dalë si rezultat i hulumtimit dhe konsiderohen si domosdoshmëri të ndërmerren për të siguruar stabilitet dhe funksionalitet të sistemit politik dhe demokratik në Kosovë. Mandej punimi ka rëndësi praktike, duke prezantuar të dhëna teorike, analizë të kornizës normative dhe rezultateve

empirike mbi proceset zgjedhore, politike dhe juridike që mund të merren në konsideratë gjatë reformës zgjedhore, asaj normative dhe institucionale si dhe gjatë hartimit të politikave strategjike shtetërore dhe partiake për përmbushjen e rekomandimeve dhe standardeve për të siguruar zgjedhje të lira si dhe krijimit të institucioneve funksionale, stabile dhe demokratike në Kosovë.

Së pesti, punimi shërben si pikënisje për studime më të thelluara për mënyrën e organizimit, funksionimit, orientimet programore, vendimmarrjen si dhe financimin dhe auditimin e financave të partive politike në Kosovë, inkurajon studiuesit për të pasuruar më tej literaturën për ndikimin e sistemit zgjedhor dhe kornizës normative, të analizojnë problematikën dhe të sugjerojnë domosdoshmërinë e reformave të veçanta ligjore dhe institucionale në Republikën e Kosovës.

1.3.Pyetjet kërkimore dhe hipoteza

Referuar qëllimit kryesor të këtij punimi dhe çështjeve të ngritura për trajtim, autori ka ngritur disa pyetje, të cilave i jep përgjigje gjatë studimit dhe në përfundim të tij.

1. Si ndikon sistemi zgjedhor në sistemin partiak dhe sistemin qeverisës në Kosovë?
2. Çfarë efektsh ka patur sistemi zgjedhor në formimin institucional?
3. A garanton ky sistem përfaqësimin politik në përgjithësi dhe të shtresave shoqërore të veçanta?

Hipoteza : Referuar pyetjeve të ngritura në seksionin pararendës, ky punim synon të provojë vërtetësinë e hipotezave të mëposhtme:

1. Hipoteza e parë: Sistemi zgjedhor në Kosovë ka krijuar një sistem partiak të fragmentizuar dhe një qeverisje jo të qëndrueshme.
2. Hipoteza e dytë: Fragmentizimi politik ka krijuar vështirësi në formimin e institucioneve shtetformuese.
3. Hipoteza e tretë: Sistemi zgjedhor ka garantuar përfaqësimin politik të të gjitha shtresave shoqërore në përgjithësi, për grat dhe komunitetet minoritare në veçanti.

1.4. Metodat dhe Metodologjia e Kërkimit

Në këtë punim ka një gërshetim metodash të instrumenteve kërkimore duke i dhënë atyre rëndësinë që bartin, si mjet për të realizuar punimin. Metodologjia e përdorur është metoda cilësore dhe sasiore, metoda e përshkrimit, krahasimit, analizës ligjore dhe analizës së të dhënave dhe informacionit të mbledhur nga procesi i hulumtimit.

Metodologjia e shkrimit të punimit fokusohet nga këndvështrimi juridik dhe politik në këtë mënyrë: Analizën ligjore të legjislacionit të fushës, Metoda krahasuese është përdorur për t'i krahasuar rezultatet në periudha të ndryshme zgjedhore dhe proceset politike; Metoda përshkruese është përdorur duke cituar autorët e fushës dhe akteve juridike.

Gjatë punimit është përdorur dhe metoda cilësore, pyetësor për anëtarë të kryesisë të partive politike, deputetëve dhe ekspertëve të fushës, si dhe pyetësor me qytetar (votues) për të hedhur dritë mbi nevojat për ndryshime dhe plotësim ligjor dhe institucional sa i përket sistemit zgjedhor, nevojës për reformë të sistemit zgjedhor dhe nevojës për reformë

institucionale. Mostra e hulumtimit ka qenë 715 respondentë, sipas strukturës së moshës, gjinisë, vendbanimit dhe përgatitjes shkollore e profesionale si dhe funksionin dhe përgjegjësinë e tyre politike janë paraqitur në figurat 20-29, të cilat janë bashkëngjitur në shtojcën e punimit. Pyetësi i është ofruar 1000 personave, nga të cilët 715, gjegjësisht 71.5 përqind e tyre u janë përgjigjur pyetjeve të shtruar. Targeti është i ndarë në dy grupe: në target grupi qytetar dhe target grupi me funksion politik. Në kuadër të target grupit të respondentëve qytetarë, është planifikuar të anketohen 800 qytetarë, prej tyre 607, gjegjësisht 75.8 përqind i janë përgjigjur pyetjeve. Ndërsa nga target grupi politik është planifikuar të anketohen 200 persona, që kanë funksione partiake (Kryetar, nënkryetar dhe anëtar të kryesisë të partisë: LDK, PDK, LVV, AAK, AKR, Nisma për Kosovën, Alternativa, Partia e Drejtësisë, Lëvizja për Bashkim, Partia Demokratike Turke e Kosovës, Partia e Aksionit Demokratik e Boshnjakëve të Kosovës, kryetar dhe anëtarë të degëve të tyre) dhe funksione publike (deputet, zëvendësministra, këshilltar politikë, anëtar të bordeve dhe komisioneve të pavarura) ku prej tyre 108 gjegjësisht 54 përqind i janë përgjigjur pyetjeve.

Intervistat janë realizuar në mënyre të drejtpërdrejtë, me pyetësorë të (hard copy) printuar si dhe në mënyre elektronike. Qëllimi i intervistimit dhe përdorimi i pyetësorëve gjatë hulumtimit ishte nxjerrja e rezultateve dhe krahasimi i gjetjeve individuale me mendimet e anëtarëve drejtues të partive politike dhe votuesve kosovarë. Pasqyrimi statistikor e ndihmoi analizën e rezultateve në ndriçimin e përmbajtjes së problemit, lidhjeve kauzale /shkak-pasojë/ në proceset para dhe pasgjedhore, para dhe pas krijimit të institucioneve dhe

qeverisë. Natyrisht qasja e studimit është krahasimore dhe metoda krahasuese është dominante në hulumtimin e kësaj materie.

1.4.1. Burimet e studimit

Gjatë hartimit të kësaj teze të disertacionit, hulumtimit rreth demokracisë elektorale, të drejtës së votës, zgjedhjet si një mjet për të përzgjedhur përfaqësuesit dhe politikat sipas modeleve zgjedhore, janë shërbyer me burime primare: legjislacioni përkatës zgjedhor dhe burime të tjera teorike dhe empirike. Punimi bazohet në një analizë të detajuar të burimeve primare dhe burimeve sekondare. Në kuadër të burimeve primare janë analizuar aktet bazike, siç janë: Aktet ndërkombëtare Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Rregulloret e UNMIK-ut, pastaj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008) disa nga aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës dhe akte nënligjore të KQZ, raporte të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe hulumtimi me anë të pyetësorit për interes të kësaj teme. Mandej, Udhëzuesit për rishikimin e një kuadri ligjor për zgjedhjet (OSBE/ODIHR 2005), Kodi i praktikës së mirë në çështjet zgjedhore-udhëzime dhe raporti shpjegues, nga Komisioni i Venecias, Manual për Vëzhgimin e Zgjedhjeve nga OSBE-së; Raportet për zgjedhjet nga: OSBE/CEC/UNMIK, 2001-2004, OSBE:2012,, ENEMO 2010; 2013; EU EOM 2014, 2017; i Komisionit Evropian (KE-së) KE 2011, 2013; 2014; 2015; 2017 dhe shoqëria civile DnV (2011; 2013); KIPRED 2013; Forum 2015; IKD 2014; 2017; si dhe Rezultatet e KQZ/QNR-s për zgjedhjet 2007- 2017.

Burime dytësore: Burime dytësore: artikuj shkencorë, botime nga autorë të huaj dhe vendas, gazeta, web faqe etj. Literaturë të studiuesve eminentë ndërkombëtarë të sistemeve

elektorale: Arend Lijphart, (1994; 1999); Duverger, M, (1954); Gallagher M&P. Mitchell, (2005), Norris, Pippa (1997, 2004); Sartori, G. (1994; 1998); Siaroff, A. (2000); Ezrow, L. (2010); Bajrami, A. (1997; 2002; 2010); Haxhiu, S. (2013) dhe autorë të tjerë. Mandej, manualët e IDEA, OSBE-së dhe artikuj të tjerë të prezantuar në bibliografi.

1.5.Objektivat e punimit

Studimi mendojmë që përmbush objektivat e mëposhtme:

- Të bëjë një analizë krahasimore të varësisë së përfaqësimit, krijimit institucional dhe stabilitetit politik nga lloji i sistemeve zgjedhore. Nëpërmjet kësaj analize të konkludohet mbi modelin më favorizues të sistemit zgjedhor, sigurisht me përpjekjen për ta zhveshur në masën më të madhe të mundshme nga ndikimi i faktorëve të tjerë;
- Të japë një tablo krahasimore të nivelit të përfaqësimit të subjekteve politike në Kuvend, duke synuar evidentimin e nivelit aktual dhe reflektimin mbi nevojën e ndryshimit të situatës;
- Të bëjë një analizë krahasimore të varësisë së përfaqësimit gjinor dhe etnik në vendimmarrjen e pushtetit qendror dhe lokal nga lloji i sistemeve të kuotës gjinore dhe etnike. Nëpërmjet kësaj analize do të konkludohet mbi modelin më favorizues të përfaqësimit gjinor dhe etnik sigurisht lidhur ngushtë me llojin e sistemit zgjedhor, pasi kuota gjinore dhe etnike gjithmonë ekziston në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve të caktuara;
- Të rekomandohet formula më e mirë, në varësi të kushteve konkrete, për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje dhe përfaqësimit më të drejtë të tyre, si dhe

në këndvështrimin e raportit me sistemet zgjedhore dhe kuotën gjinore dhe etnike si kategori kushtetuese dhe ligjore;

- Të bëjë një analizë krahasimore të menaxhimit të procesit zgjedhor dhe drejtësisë zgjedhore për të siguruar përmbushjen e standardeve për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Nëpërmjet kësaj analize do të konkludohet mbi modelin zgjedhor më favorizues të menaxhimit dhe drejtësisë, sigurisht me përpjekjen për ta zhveshur në masën më të madhe të mundshme nga ndikimi i faktorëve të politikës në procesin zgjedhor;
- Të bëjë një analizë krahasimore bazuar në rezultatet zgjedhore dhe krijimit të institucioneve përfaqësuese dhe qeverisjes stabile, funksionale dhe llogaridhënese para qytetarëve të saj. Nëpërmjet analizës kushtetuese, ligjore dhe zhvillimit të proceseve politike (krizave parlamentare dhe qeveritare) si dhe rezultatit të hulumtimit mund të konkludojmë për mënyrat me të mira për krijimin e institucioneve demokratike, funksionale, stabile dhe llogaridhënese duke evituar krizat e krijimit të institucioneve dhe bllokimit të tyre.

1.6.Shtrimi i problemit

Ndryshimet politike në Kosovë janë vazhdimisht në proces të zhvillimit prandaj edhe kërkesat për reforma ligjore (elektorale) dhe institucionale janë të domosdoshme për t'iu përshtatur rrethanave politike dhe juridike. Megjithatë, historia e krijimit të institucioneve demokratike, të bazuar te fuqia e votës së lirë dhe sipas konkurrencës politike është

përballur me vështirësi dhe kriza politike pas çdo procesi zgjedhor. Ato janë rezultat i një procesi kompleks për shkak të organizimit të sistemit juridik dhe politik të Kosovës. Edhe pse përvoja disavjeçare e demokracisë elektorale dhe institucionale në Kosovë është e re, ajo ka rezultuar me vlerësime pozitive dhe negative nga vëzhgues ndërkombëtar (ENEMO 2010; 2013; EU EOM 2014, 2017; OSBE-2012 e KE 2011, 2013; 2014; 2015; 2017) si dhe shoqëria civile (DnV (2011; 2013); KIPRED 2013; Forum 2015; IKD 2014; 2017), për proceset zgjedhore dhe sistemin zgjedhor. Janë dhënë vlerësime pro dhe kundër për sistemin zgjedhor të aplikuar me një zonë të vetme zgjedhore, prag prej 5 përqind dhe çështjen e listave të mbyllura apo të hapura dhe votës preferenciale. Madje, reformat elektorale dhe institucionale zakonisht janë bërë pas mbajtjeve të zgjedhjeve si formë e kompromisit për të fituar në kohë.

Reformimi i sistemit proporcional me lista të mbyllura dhe kalimi me lista të hapura dhe preferenciale kanë nxjerrë në shesh sfida të tjera siç janë: organizimi, menaxhimi i zgjedhjeve dhe problemet pas zgjedhore që ndërlidhen me devijimin e votës, si dhe votat e pavlefshme dhe ato të humbura. Kështu që përcaktimi për një sistem zgjedhor ka rëndësi të veçantë në proceset demokratike, politike dhe institucionale, sepse, ashtu siç thekson Goowin Gill *“sado të rregullta e të drejta të jenë zgjedhjet në një vend, rezultati i tyre politik është dukshëm i përcaktuar nga sistemi zgjedhor që është aplikuar, ose është zbatuar në atë vend”* (Goowin-Gill; 1998:34). Kosova përmes ndryshimeve të vogla apo teknike ka bërë përpjekje për gjetjen e modelit të përshtatshëm të sistemit zgjedhor. Mirëpo me gjithë ndryshimet e bëra, ajo nuk ka reflektuar për lehtësimin e shprehjes së vullnetit të qytetarëve

dhe përfaqësimit të tyre. Roli i sistemit zgjedhor është “të lehtësojë shprehjen e vullnetit të qytetarëve nëpërmjet zgjedhjeve” (Goodwin-Gill; 1994:37).

Duke u bazuar në përvojat e gjertanishme, Kosovës i duhet një reformë e mirëfilltë e sistemit zgjedhor. Dhe ajo duke filluar nga ndryshimi i sistemit, pragut zgjedhor, menaxhimit dhe administrimit të zgjedhjeve, kalimi në sistemin kombinuar sipas modelit 50% mazhoritar dhe 50% proporcional e zgjedhjes së deputetëve të Kuvendit. Ky model do të lehtësojë krijimin e një shumice parlamentare dhe stabilitet në qeverisje, përfaqësues të përgjegjshëm dhe llogaridhënës, mundëson lidhjen e përfaqësuesit dhe zgjedhësit si dhe ruan kuotën gjinore dhe etnike sipas kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. Me reformimin kushtetues, të kalimit në zgjedhjen e Presidentit nga populli, domosdoshmërisht kërkohet të aplikohet sistemi mazhoritar dy raundesh. Një model i tillë është duke u aplikuar në zgjedhjet lokale për zgjedhjen e Kryetarëve të Komunave.

Kështu që, në finalizimin e këtij punimi jam qasur në katër hapa:

- Hapi i parë: analiza teorike e literaturës nga autorë të ndryshëm për konceptin dhe efektet e sistemit zgjedhor dhe pasojat e tyre;
- Hapi i dytë: analiza e akteve kushtetuese dhe ligjore përkatëse për formimin e institucioneve që sigurojnë pjesëmarrje të barabartë të të gjithë qytetarëve në institucionet publike dhe mënyra e zgjedhjes së tyre si dhe menaxhimi i procesit zgjedhor. Analiza e akteve që promovojnë kuotat gjinore dhe etnike si dhe atyre që rregullojnë krijimin dhe funksionimin e pluralizmit dhe sistemit partiak;

- Hapi i tretë: analiza empirike e të dhënave nga rezultatet e zgjedhjeve si dhe të hulumtimit të opinionit publik duke dhënë alternativat për modelin më të përshtatshëm pas identifikimit të disavantazheve të sistemit aktual si dhe avantazhit të modelit gjysmëproporcional dhe efektet politike e përfaqësuese.
- Hapi i katërt: dhënia e konkluzioneve dhe rekomandimeve për proceset zgjedhore, sistemin partiak, politik e përfaqësues si dhe duke propozuar sistem zgjedhor të kombinuar si më i përshtatshmi për rrethanat aktuale në Kosovë dhe që i plotëson kriteret për të vendosur një demokraci të stabilizuar në Kosovë.

1.7.Struktura e punimit

Punimi është i strukturuar në njëmbëdhjetë kapituj. Në kapitullin e parë, trajtohet: hyrja dhe bazimi teorik, qëllimi dhe objektivat, pyetjet kërkimore dhe hipotezat, metodat e përdorura, rëndësia, shtrimi i problemit dhe struktura e punimit.

Në kapitullin e dytë, është trajtuar aspekti teorik mbi konceptet për modelet e sistemit zgjedhor me format e saj mazhoritare, proporcionale dhe të kombinuar.

Në kapitullin e tretë, trajtohet analiza ligjore për sistemin zgjedhor në Kosovë. Këtu analizohet korniza normative për të drejtën zgjedhore dhe për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale si dhe listat zgjedhore, pragu zgjedhor dhe kuotat gjinore. Pastaj, analizë dispozitave ligjore për menaxhimin e procesit zgjedhor dhe drejtësia zgjedhore në Kosovë, si dhe gjetjet nga hulumtimi për domosdorshmërinë e reformës si dhe opinionin e respondentëve për sistemin zgjedhor.

Në kapitullin e katërt, trajtohet pjesëmarrja e votuesve në zgjedhje dhe trendi i tyre për nivelin qendror dhe lokal, Zgjedhjet dhe pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhjet nacional, lokale dhe zgjedhjet për Kryetar të Komunës. Pastaj votat e mbetur apo humbura dhe abstenimi si reflektim për votën e humbur si dhe gjetjet nga hulumtimi për ndikimin e faktorëve që po ndikojnë në rënien e pjesëmarrjes në zgjedhje.

Në kapitullin e pestë, trajtohet efekti i sistemit zgjedhor të sistemi partiak në Kosovë. Këtu shtjellohet fillet e pluralizmit, analizë e kornizës ligjore për regjistrimin dhe veprimtarinë e partive politike si dhe sistemit partiak në Kosovë. Në fund trajtohen gjetjet nga hulumtimi për masat dhe aktivitetet që kërkohet të ndërmerren nga partitë politike.

Në kuadër të kapitullit të gjashtë është shtjelluar Sistemi politik dhe Kushtetues i Kosovës, historiku dhe sistemi politik dhe Kushtetues i Republikës së Kosovës. Analizë kornizës normative dhe rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nacionale në Kosovë (2001-2017) si dhe formimit të institucioneve përfaqësuese dhe ekzekutive. Ketu është trajtuar korniza normative për formimin e institucioneve dhe janë analizuar rezultatet e gjashtë legjislaturave dhe përbërja e tyre, format e qeverisjes dhe koalicionet. Gjetjet për mungesë të relacionit votues-përfaqësues dhe të përfaqësimit jo të drejtë të vullnetit të tyre në Kuvend.

Në kapitullin e shtatë, trajtohet analiza e kornizës normative dhe efekti i sistemit zgjedhor proporcional në zgjedhjen e Presidentit nga Kuvendi, krizat politike dhe evitimi i tyre si dhe mënyra e zgjedhjes së tij për të ardhmen. Në fund prezentohen të gjeturat e hulumtimit emirik për zgjedhjen e Presidentit drejtpërsëdrejti nga populli.

Kapitulli i tetë, trajton analizën e kornizës normative mbi kontrollin politik të qeverisë dhe Presidentit nga Kuvendi (2001-2017) si dhe shqyrtohet mocioni i votëbesimit dhe shkarkimi

i qeverisë dhe procedura e impeachmentit ndaj Presidentit të Kosovës është pjesë e këtij kapitulli.

Në kapitullin e nëntë, trajtohet përfaqësimi i grave në institucione sipas kornizës normative për kuotën gjinore dhe rezultatit zgjedhor. Barazia gjinore si vlerë kushtetuese, analizë kornizës legislative për kuotat gjinore që promovojnë përfaqësim të grave në institucione. Ketu është trajtuar përfaqësimi i grave në institucione si dhe të gjeturat për mënyrat se si të vepohet në të ardhmen për avancimin e gruas në pozitat vendimmarrëse.

Kapitulli i dhjetë, trajton përfaqësimin e minoriteteve sipas kornizës normative për kuotat etnike dhe rezultatit zgjedhor. Ketu është analizuar korniza normative që sigurojnë përfaqësim të minoriteteve në Kosovë, pastaj, përfaqësimi i minoriteteve në institucionet përfaqësuese, Kuvend, qeveri dhe përfaqësimi i tyre në drejtimin e pushtetit lokal.

Në kuadër të kapitullit të njëmbëdhjetë janë trajtuar përmbledhtazi përfundimet e nxjerra nga hulumtimi si dhe propozimet për të ardhmen. Në kuadër të punimit janë të përfshira edhe Bibliografia e ndarë sipas burimeve primare dhe sekondare si dhe në fund është Shtojca në të cilën janë prezantuar disa të dhëna nga hulumtimi në terren si dhe pyetësori.

KAPITULLI II: ASPEKTI TEORIK PËR MODELET E SISTEMEVE ZGJEDHORE

2.1. Koncepti për sistemet zgjedhore

Ky kapitull fokusohet në konceptet kryesore të modeleve zgjedhore, përshkruan grupet e sistemeve zgjedhore dhe pasojat e tyre politike dhe institucionale. Analiza do të sigurojë bazat për ndërtimin e tipit të përshtatshëm zgjedhor për Kosovën, si dhe për vlerësimin e sistemeve aktuale në përdorim për zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme. Sistemet zgjedhore janë instrumente, metoda apo mënyra në të cilën votat e hedhura në kutinë e votimit gjatë zgjedhjeve përkthehen në vende në Parlament. Më pas kjo reflektohet drejtpërdrejt në përbërjen, zgjedhjen dhe drejtimin e institucioneve të vendit si dhe ndikojnë në dinamikën dhe dimensionet kyçe të qeverisjes dhe funksionimit të demokracisë. Megjithatë, para se të shpjegojmë për rëndësinë e sistemeve zgjedhore, është e nevojshme të përcaktohet koncepti i sistemit zgjedhor që respektivisht do të thotë *“përkthimi i votave në mandate”*. Kur organizohen zgjedhjet lokale apo të përgjithshme sistemi zgjedhor konverton votat e hedhura në vende apo mandate. Ndër përkufizimet e shumta për sistemin zgjedhor sipas Arend Lijphartit përfaqëson *“një tërësi të rregullave thelbësisht të pandryshueshme në bazë të të cilave një ose më shumë procese zgjedhore organizohen në një vend demokratik”* (Lijphart, A. 1994:13). Me fjalë të tjera, *“sistemi zgjedhor përfshin rregullat ligjore zgjedhore që determinojnë përbërjen e parlamentit”* (M. Gallagher&P.Mitchell 2005:3). Pastaj, sistemet zgjedhore sipas Devid M Farrell, (2001:2) janë si *“vidat që ia mundësojnë rrotave të demokracisë të funksionojë siç duhet”*, ndërsa për Sartorin sistemi zgjedhor është *“instrumenti më manipulues i politikës”* (Sartori, G. 1994: ix).

Në përkufizimin e sistemit zgjedhor, elementi i përbashkët për të gjithë studiuesit është konvertimi i votës në mandate ose vende në parlament. Nëse i referohemi përkufizimeve që i bëhen sistemeve elektorale, ato janë: mënyra që i shndërrojnë votat e hedhura (në kuti) gjatë zgjedhjeve, në vende të fituara në parlament nga partitë dhe kandidatet e tyre (IDEA 2000: 6), apo rruga më e thjeshtë për t'i shqyrtuar sistemet elektorale është klasifikimi i tyre në bazë të shkallës së shndërrimit të votës së fituar të popullit në vende deputetësh në parlament; ajo pjesë e rregullave elektorale që e përcaktojnë rezultatin zgjedhor, kryesisht, formulën elektorale, strukturën e fletëvotimit dhe madhësinë e zonës elektorale (IDEA2000: 150). Ndërkaq, sipas Luan Omarit & Aurela Anastasi, Pipa Norris-it, sistemi zgjedhore kuptohet “tërësia e normave juridike që rregullojnë procesin zgjedhor të zgjedhjeve të përgjithshme apo lokale” duke përcaktuar “shpalljen e zgjedhjeve, procedurën për nominimin e kandidatëve, të drejtën e votës, dispozitat për votimin me kushte, procedurat për shqyrtim të ankesave dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve, dispozitat për votimin e detyrueshëm, kushtet, zonat dhe procedurat zgjedhore që rregullojnë financimin e fushatës dhe transmetimin zgjedhor” (Omari, L., & Anastasi A., 2010:271-2; Norris, P. 2004:39). Megjithatë, sistemet zgjedhore ofrojnë lloje dhe mënyra për të ndikuar ndaj votuesve në mënyrë që të japë rezultate të ndryshme elektorale. Sidomos në zgjedhjet nacionale ku votuesit do të votojnë për lista të mbyllura partiake, liderët e partive kanë fuqi të konsiderueshme, sepse ata përcaktojnë renditjen e secilit prej kandidatëve në këtë listë. Në këtë model zgjedhor, deputetët janë më llogaridhënës ndaj lidershipit të partisë se sa të votuesve, duke pasur parasysh se karriera politike varet nga relacioni me shefin e partisë se me elektoratin (e Kosovës). Mirëpo, sistemi mazhoritar, bazohet në parimin e shumicës që

determinojnë llojin e kundërt të shtytjes nga sistemi proporcional me lista të mbyllura, pasi ato janë shumë më të fokusuar në kandidat individual dhe më pak në partinë që ata i përkasin. Sistemet zgjedhore i ndihmojnë në mënyra të ndryshme llogaritjet e politikanëve në lidhje me zgjedhjet politike, dhe ata ofrojnë stimuj të ndryshëm për të bërë ankesa të ngushta ose më shumë në bazë të gjerë të popullsisë, në varësi ndër të tjera nëse sistemi zgjedhor inkurajon përhapjen e partive politike apo jo. Prandaj është e rëndësishme për të kuptuar se si rregullat e lojës politike ndërveprojnë me grupet e interesit ose të kërkesës në njërën anë, si dhe të ofertës në anën e tjetër. Sipas Sartorit *“populli që vendos sipas kriterit mazhoritar absolut është në shumicën e rasteve një trupë që përfaqëson popullin dhe që pasqyron si shumicë, shumicën popullore që e zgjedh”* (Sartori, G. 1998:25) Gjithsesi, është e vërtetë se populli, i llogaritur sipas kriterit mazhoritar absolut, ndahet në një shumicë që fiton gjithçka dhe në një pakicë që humb të gjitha, gjë që nuk duhet të lejohet. Për Ylli Bufin (ish kryetari i Kuvendit të Shqipërisë) *“Demokracia, krahas vullnetit të shumicës, duhet të krijojë hapësirë politike edhe për artikullimin politik të pakicës dhe ta përfshijë atë në jetën politike”* (Bufi, Y.2010: 82). Në këtë kontekst zhvillohet demokracia parlamentare dhe koncepti i qeverisjes së shumicës realizohet në atë mënyrë që subjekti politik, që i ka fituar zgjedhjet e krijon qeverinë dhe realizon programin e saj politik. Ndërsa, pakica parlamentare është opozita që ka rolin e kontrolluesit dhe kritikuesit të qeverisjes së shumicës. Vetëm marrëdhëniet korrekte midis pozitës dhe opozitës, respektimi dhe bashkëpunimi i tyre reciprok, sipas Bufit, mundësojnë zhvillimin e marrëdhënieve demokratike në shoqëri. Këto marrëdhënie në shoqëri mund të realizohen vetëm me respektimin e pluralizmit politik dhe shtetit të së drejtës (Bufi, Y. 2010: 82).

Kjo tezë ka të bëjë kryesisht me efektin e sistemit zgjedhor të përdorur në Kosovë dhe rëndësinë e tyre në demokratizimin e jetës politike dhe institucionale. Në lidhje me rëndësinë e sistemit zgjedhor në jetën politike dhe institucionale sipas këndvështrimit të David Farrel është se: “ato përcaktojnë se si do të funksionojë sistemi politik, ... zgjedhjet dhe përfaqësimi i partive politike dhe sistemeve partiake, formimi i qeverisë dhe koalicioneve politike”. Mandej ai thekson se, “sistemet zgjedhore janë të dizajnuara për të përmbushur një gamë të gjerë funksionesh dhe për të *“reflektuar vullnetin e votuesve në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, si dhe duke prodhuar qeveri të qëndrueshme”* ...etj. (Farrel, D. 2001:1). Në varësi të theksit të studiuesit dhe qasjes në aspekte të caktuara të sistemit zgjedhor ato ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Rrjedhimisht, asnjë shtet nuk ka saktësisht të njëjtin sistem zgjedhor për faktin e specifikave të veçanta të përbërjes etnike, nivelin e zhvillimit të demokracisë dhe organizimit të sistemit juridik e politik. Për më tepër, sipas Harrop&Miller, sistemi zgjedhor dhe sjellja zgjedhore, *“zbulon se si shoqëria e një shteti, është e hapur për njerëzit e rinj dhe idetë e reja dhe sa është e gatshme ajo, të tolerojë mosmarrëveshjet dhe mospajtimet”* (Harrop&W.Miller, 1987: 9-10). Prandaj, sistemet zgjedhore japin efekte politike për institucione stabile, të qëndrueshme dhe (jo) demokratike, sepse ato përcaktojnë rregullat e lojës në formimin e tyre.

Megjithatë, diskutimet mbi efektet e sistemeve zgjedhore në përfaqësimin politik, partiak dhe institucional janë vazhdimisht në proces zhvillimi. Fillimisht, studimet për sistemet zgjedhore janë në fokus nga studiuesit të tjerë si: Maurice Duverger (1954), Douglas Rae (1967) Lijphart, A. (1994; 1999), Sartori, G. (1998), Norris, P. (2000), Douglas J. AMY (2000), Bajrami, A. (2005; 2010) dhe S. Haxhiu (2013), etj. Përveç numrit të madh të punimeve për efektin e sistemeve zgjedhore, proporcionalitetin e tyre dhe numrin e

subjekteve politike në një sistem partiak, ka bërë që studiues të ndryshëm të flasin për një fushë të gjerë studimi. Kjo fushë në Kosovë është më pak e studiuar. Por, për të kuptuar efektet e një sistemi zgjedhor, është e nevojshme të paraqesim modelet e ndryshme të sistemeve zgjedhore që ekzistojnë në përdorim.

2.2.MODELET E SISTEMEVE ZGJEDHORE

Në literaturën për demokracinë elektorale gjejmë klasifikime të ndryshme të sistemeve zgjedhore si dhe shumë forma të rregullave zgjedhore që japin rezultate proporcionale dhe joproportionale në ndarjen e mandateve në organin përfaqësues. Në kuadër të klasifikimit të sistemeve zgjedhore dhe llojet e tyre, janë studiuesit Duverger, M. (1954); Douglas Rae (1967), Lijphart, A. (1994); Norris, P. (1997), Omari, L. & Anastasi, A. (2010) e të tjerë, të cilët me veprat e tyre kanë bërë klasifikimet lidhur me tipat e modeleve zgjedhore. Megjithatë, ekzistojnë mënyra të shumta për “kategorizimin e sistemeve zgjedhore”, por variablat kyç janë “formulat elektorale që përdoren për të kalkuluar ndarjen e vendeve, madhësisë së zonës që i referohet numrit të deputetëve që zgjedh ajo zonë, strukturën e votimit”, i cili përcakton se si votuesit shprehin vullnetin e tyre dhe aspekte të tjera (Omari, L. & Anastasi, A. 2010:272; IDEA 2000: 6-7; IDEA 2005 :5-28).


Kjo tezë përmbledh modelet e sistemeve zgjedhore me formulën zgjedhore në tri familje kryesore të njohura për ndarjen e mandateve parlamentare:

1. Modeli mazhoritar
2. Modeli i përfaqësimit proporcional

3. Modeli mixt - kombinuar – i njohur si sistem gjysmëproporcional ose gjysmëmazhoritar (A. Lijphart 1994:1-10; Lijphart 1999: 144-5; Pippa Norris P., 1997: 299; Norris, P. 2004: 41; Bajrami A, 1997:164; Haxhiu, S. 2013:179-181; Omari,L &Anastasi, A. 2010:272; IDEA 2000 :18 & IDEA 2005: 28)

Modelet e sistemeve zgjedhore pasqyrohen në Tabelën 1.

Tabela 1 Modelet e sistemeve zgjedhore



Burimi: IDEA (2005 :28)

Në kuadër të secilit model zgjedhor ka disa nënsisteme të cilat do të paraqiten me radhë.

Pjesë e modelit mazhoritar janë:

1. I pari i listës merr postin (IPLMP);
2. Vota bllok (VB);
3. Vota bllok partiake (VBP);
4. Vota alternative (VA);
5. Sistemi dy raundesh (SDR).

Në sistemin gjysmëproporcional bëjnë pjesë dy forma:

1. Sistemi paralel dhe
2. Vota e vetme e patransferueshme (VVPT).

Ndërkaq, në grupin e tretë të sistemeve elektorale, sistemi proporcional zgjedhor ka tri forma, të cilat janë:

1. Lista e përfaqësimit proporcional (LPP);
2. Proporcionaliteti mikst (PM) dhe
3. Vota e transferueshme (VT).

Në sistemet e tjera bëjnë pjesë dy forma:

1. Vota e Kufizuar (VK) dhe
2. Borda Count (BC)

Ky trung familjar i merr parasysh ose i inkorporon në vetvete të gjitha sistemet zgjedhore që përdoren sot në botë (Norris P, 1997: 300; IDEA 2005: 28) të cilat do të elaborohen në vazhdim.

2.2.1. MODELI MAZHORITAR

Dallimi midis modelit të demokracisë mazhoritare prej formave të demokracisë konsensuale është shumë i thjeshtë. Demokracia mazhoritare apo “filozofia e shumicës” sipas Lijphartit “është përdorimi i shumë zonave me një anëtar dhe fiton kandidati i mbështetur nga numri më i madh i votuesve të zonës” ... (Lijphart, A. 1999:163). Sipas kësaj metode në çdo zonë fiton ai kandidat, ose lista e kandidatëve, që siguron “shumicën relative apo absolute” të votave në një njësi zgjedhore. Në bazë të këtij sistemi “vendi ndahet në shumë zona zgjedhore” dhe brenda çdo zone elektorale votuesit mund të votojnë “vetëm për një kandidat” (Norris, P. 1997:301; Norris, P. 2004:42; IDEA 2005:29). Në bazë të kësaj formule mazhoritare, i pari i listës merr postin (IPLMP) apo edhe sipas Sistemit të proporcionalitetit Mikst (SPM) të njohur si sistemi shumëzonësh me një anëtar, do të fitojë garën zgjedhore ai kandidat i cili ka marrë një votë më shumë se kandidatët e tjerë dhe që nuk kërkohet domosdoshmërisht një shumicë absolute të votave.

Lidhur me këtë Profesor Arsim Bajrami, sqaron se sipas variantit të “shumicës relative” nënkuptohet se “fitues i zonës” është “ai kandidat”, i cili ka fituar më së “shumti vota në raport me kandidatët e tjerë të së njëjtës njësi elektorale”. Ndërsa sipas variantit të “shumicës absolute”, nënkuptohet ndarja e mandateve parlamentare sipas “shumicës absolute të votave të trupit elektorale”, që kanë fituar kandidatët e caktuar në njësinë elektorale. Fitues i garës është “ai kandidat, i cili në njësinë elektorale ka fituar më tepër së 50+1% të votave, qoftë të votave të qytetarëve që kanë dalë në zgjedhje, qoftë të numrit të përgjithshëm të trupit elektorale” (Bajrami A, 1997:165). E sipas profesor Kurtesh Salihut pothuajse gjithmonë

aplikohet “shumica relative” pasi në një njësi zgjedhore mund të votohet për më shumë se dy kandidatë (Salihu, K. 2004:172). Po ashtu edhe sipas Gallagher dhe Mitchell, fitues i mandatit është secili kandidat që merr “shumicën e votave në njësinë zgjedhore, pavarësisht nëse ajo përbën shumicën absolute të votave apo jo, është e parëndësishme” (Gallagher M & P. Mitchell, 2005:579). Sipas kësaj metode për kandidatët nuk është e nevojshme të kalojnë pragun minimal të votave.

Ky sistem është i thjeshtë, i drejtpërdrejtë dhe është i destinuar të çojë në zgjedhjen e kandidatëve që nuk e kanë mbështetjen e shumicës si dhe “krijon parlamente në të cilat shpërndarja e vendeve nuk mund të reflektojë në mënyrë të veçantë shpërndarjen e votave në zgjedhje” (Gallagher&Mitchell, 2005:579). Megjithatë, sistemi mazhoritar determinon një qeveri njëpartiake ose një qeveri stabile parlamentare, në krahasim me sistemet proporcionale që çojnë drejt qeverive më gjithëpërfshirëse apo të koalicioneve si dhe parlamenteve shumëpartiake. Ky model aplikohet në forma të ndryshme të cilat ne do t’i analizojmë në vazhdim.

2.2.1.1.I Pari i listës merr postin (IPLMP)

Sipas këtij modeli, i njohur si sistem mazhoritar i zonës njëkandidatëshe, fitues është ai kandidat që ka më së “shumti vota, por jo domosdoshmërisht shumicën absolute të votave”. (IDEA 2000:27). Mandej, kandidati duhet të ketë më së shumti vota, në raport me konkurrentët e tjerë në atë zonë elektorale, në qoftë që nuk është përcaktuar limiti sipas të cilës përqindje fitohet mandati: p.sh; 25%, 35%, 45% apo 50+1% të votave të fituara. Sipas

kësaj metode, teorikisht mandati mund të fitohet automatikisht me dy vota, nëse kandidatët e tjerë në garë në atë zonë zgjedhore i kanë fituar vetëm nga një votë.

IPLMP dhe Sistemi proporcionalitetit Mikst (SPM) ka një tendencë drejt prodhimit të qeverive njëpartiake, ku llogaridhënia e qeverisë dhe vendimmarrja e saj është një avantazh i këtij sistemi. Pastaj, votuesit kanë një zgjedhje të qartë mes qeverisë dhe partive të opozitës. Për më tepër partitë e vogla “mund të arrijnë të fitojnë ndonjë vend nën IPLMP, veçanërisht ato rajonale ose partive etnike, komuniteteve me mbështetje të përqendruar në nivel lokal dhe zonave të vogla zgjedhore” (Norris, P. 2004:9).

Megjithatë, disproporcionaliteti është një disavantazh i modelit IPLMP dhe SPM. Në këtë mënyrë, kandidati kërkon një shumicë të thjeshtë, një votë më shumë se rivalët më të afërt, është e mjaftueshme. Për më tepër, sistemi prodhon parlamente në të cilat shpërndarja e vendeve nuk pasqyron nga afër shpërndarjen e votave gjatë zgjedhjeve. Përveç kësaj, disa votues mund të konkludojnë se nuk ka asnjë dobi të votimit për kandidatin e tyre më të preferuar, pasi kjo do të rezultojë me një votë të humbur pasi kandidati i preferuar nuk ka shanse për zgjedhje dhe se ka më shumë kuptim të votojë "pa dëshirë" për “një kandidat më pak i favorizuar për të cilin votimi i tyre mund të bëjë ndryshime” (Gallagher & Mitchell: 2005: 580). Sipas këtij sistemi zgjedhor, vendimtare për një parti politike për formimin e qeverisë, është numri i vendeve parlamentare, dhe jo i votës popullore. “Një qeveri përderisa ka shumicën e mandateve në parlament mund të jetë pa shumicën e votave popullore” (Norris, P. 2004: 43). Këtë e argumenton përvoja elektorale angleze dhe amerikane. Në Angli si argument është rasti i Margaret Thatcher në vitin 1983, e cila u kthye në qeveri me një shumicë parlamentare prej 177 vendeve por mbështetja ishte më pak se një e treta e

elektoratit të përgjithshëm- 30.8 përqind (Norris, P. 2004:44). Ndërsa në SHBA, gjatë zgjedhjeve presidenciale (kur vota popullore është më e madhe se sa vota e anëtarëve të Kolegjit të Elektorëve) të vitit 1996, Presidenti Bill Clinton u zgjodh President me 70.4 përqind të votave të Kolegjit Zgjedhor, por votat e tij të fituara ishin në një epërsi prej vetëm 50.1 përqind të votës popullore. Ndërsa, në zgjedhjet presidenciale të vitit 2000, rezultati zgjedhor i votës popullore ishte në favor të kandidatit demokrat Al Gor, megjithatë kandidati republikan Xhorxh Bush e fitoi garën presidenciale ndaj kundërkandidatit Al Gor me 271 vota kundrejt 267 votave të Kolegjit Zgjedhor (Norris, P. 2004:44; US Electoral College 2000, Presidential Election Results). Gjithashtu, kjo është përsëritur edhe në zgjedhjet e vitit 2016 midis kandidatëve Clinton dhe Trump. Hillary Clinton ka fituar më shumë vota popullore ose 65.794.399 votë popullore. Megjithatë Donald J. Trump me 62.955.202 votë popullor, mori shumicën e votave elektorale dhe u zgjodh President me 304 vota të Kolegjit Zgjedhor kundrejt 227 vota që ishin për Hillary Clintonit (U.S. Electoral College, 2016 Results). Sipas kushtetutës të SHBA-së, President zgjidhet ai kandidat që merr shumicën e votave të elektorëve ose prej 538 anëtarëve siguron 270 vota elektorësh (Schroeder C. R, & Glick, N. 1989:43; Halili, Z, 2006:87).

Përveç rezultateve pozitive modeli IPLMP kritikohet për përjashtimin e partive më të vogla nga përfaqësimi "i drejtë" në parlament (IDEA 2005 :37). Sipas Duverger, "*sistemi mazhoritar favorizon sistemin dypartiak*", ndërsa "*sistemet mixt dhe përfaqësimi proporcional favorizojnë sistemin shumëpartiak*" (Duverger, M.1954:217,239). Megjithatë, IPLMP prodhon një bonus për subjektin "fitues", duke ekzagjeruar përqindjen e vendeve të fituara nga partia në vendin e parë krahasuar me përqindjen e votave në realitet (Norris, P.

2004:45). Gjithashtu, sipas Norris-it IPLMP është “sistemi më i vjetër elektoral, që daton që nga shekulli i dymbëdhjetë” (Norris, P.:2004:42). Mandej, njëri prej sistemeve të para, është përdorur në praktikën parlamentare "*kudo në shekullin XIX*" (Omari, L. 1994:154). Është karakteristike që ky sistem funksionon në vendet anglosaksone, dhe ato shtete që janë ndikuar historikisht nga Britania, SHBA dhe shumë shtete të Commonwealth (Lijphart, A.1999: 10-30). Element kryesor që e dallon këtë sistem prej sistemeve të tjera, është se sistemi mazhoritar përdor zona të vogla zgjedhore, pra zona më të vogla zgjedhore, në krahasim me sistemin proporcional, ku zakonisht përdoret një zonë e vetme apo disa zona me shumë anëtarë siç është rasti i Kosovës që “konsiderohet një zonë zgjedhore me shumë kandidatë” (Ligji Nr.03/L-073, Neni 110.1); pastaj, Maqedonia që “ndahet në gjashtë njësi zgjedhore” (Maqedoni: Kodi zgjedhor, Neni 4, 2) si dhe Shqipëria që në bazë të Kodit Zgjedhor është ndarë në 12 zona (Shqipëri: LIGJ Nr. 115/2014, Neni 1.b dhe Kodi Zgjedhor, Neni 74).

Sot në botë janë në përdorim të gjitha modelet e sistemit zgjedhor. Sa u përket shifrave, ato dallojnë për nga numri i vendeve që e kanë në zbatim sistemin e tyre. Një studim i bërë nga Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore (IDEA) në vitin 2004, rezulton se nga 199 shtete, 47 raste ose 24 përqind e shteteve dhe territoreve përdorin IPLMP për zgjedhjet legjislativ kombëtare dhe Dhomave të Ulëta (IDEA,2005:31) ndërsa 91 vende ose 46 për qind e shteteve të botës që kanë zgjedhje të drejtpërdrejta në legjislaturë, përdorin sistemet mazhoritare (IDEA, 2000: 29-35).

Sistemi mazhoritar u përshtatet atyre vendeve ku demokracia është e fortë dhe me traditë të gjatë. Në këto vende, procesi i vendimmarrjes politike është i shpërndarë nëpër shumë aktorë

të shoqërisë, që janë jashtë politikës, por që në një formë ose në një mënyrë tjetër, kryejnë funksione politike (Çili, H. 2002: 10.).

2.2.1.2.Vota Bllok dhe Vota e Bllokut Partiak

Një sistem mazhoritar i formës IPLMP i përdorur në zona me shumë anëtarë quhet Votimi i Bllokut. Votuesit kanë po aq vota sa edhe vende të lira. Kandidatët janë në qendër të votimit. Kandidatët me pjesëmarrjen më të lartë të votave fitojnë të gjitha vendet në zonën zgjedhore, pavarësisht nga përqindja e votave që fitojnë. Ky sistem (VB) funksionon kryesisht në shtete dhe territore me parti politike të dobëta ose joekzistuese (IDEA, 2005:44). Për dallim nga VB, sistemi i Votimit të Bllokut Partiak (VBP) është se votuesit votojnë për listat e partive në vend të kandidatëve individualë (IDEA, 2005:28). Partia që fiton numrin më të madh të votave në një shtet merr të gjitha votat e atij shteti në Kolegjin e elektorëve (A.Blais&L.Massicotte, 1996:52). Kjo pastaj reflekton divergjencën e votës popullore me atë të anëtarëve të Kolegjit të Elektorëve. Një gjë e tillë është paraqitur dhe përsëritur në zgjedhjet presidenciale të vitit 1996. Presidenti Clinton u zgjodh President me 70.4 përqind të votave të Kolegjit Zgjedhor, por votat e tij të fituara ishin në një epërsi prej vetëm 50.1 për qind të votës popullore në të gjithë SHBA. Ndërsa, në zgjedhjet presidenciale të vitit 2000, rezultati zgjedhor i votës popullore ishte në favor të kandidatit demokrat Al Gor. Megjithatë kandidati republikan Xhorxh Bushi e fitoi garën presidenciale ndaj kundërkandidatit Al Gor (Norris 2004:44; US Electoral College 2000, Presidential Election Results). Kjo situatë e njëjtë është përsëritur edhe në zgjedhjet e vitit 2016.

2.2.1.3.Vota alternative (VA)

Modeli Vota Alternative është i njëjtë sikurse sistemet e tjera elektorale mazhoritare. Zgjedhjet, sipas modelit VA, zhvillohen zakonisht në zona njëkandidatëshe. Mirëpo, dallimi nga sistemet e tjera është se ky sistem, gjatë shënimit të fletëvotimeve, u ofron zgjedhësve shumë më tepër mundësi sesa format IPLMP, SDR, ku zgjedhësit, në vend që të rrethojnë kandidatin e tyre të preferuar, sipas sistemit VA, ata i radhisin kandidatët sipas preferencës, duke shënuar me “një” kandidatin më të preferuar, “dy” të dytin, “tre”, të tretin e kështu me radhë (IDEA 2000: 37). Kandidati për të fituar mandatin ka nevojë të arrijë një shumicë absolute të votave (d.m.th. 50+1 për qind). Në parim dy modelet përdorin preferencën e dytë të votuesve për të krijuar një fitues me shumicë absolute nëse nuk del nga raundi i parë i votimit (IDEA2000: 29). Procesi i numërimit të votave mund të marrë disa faza dhe vazhdon derisa një kandidat të ketë një shumicë absolute të votave. Në rast se asnjë kandidat nuk merr shumicën absolute të zgjedhjeve të para të votuesve, numërimi vazhdon duke eliminuar kandidatin me më pak vota dhe votat e tij i transferohen kandidatëve në përputhje me preferencën e dytë të shënuar në secilën fletë votimi, (Gallagher, M.&P. Mitchell, 2005: 580). Kështu që, procesi vazhdon derisa të sigurohet një shumicë absolute. Numri i votave sistematikisht diskriminon ato parti dhe kandidatë në fund të sondazhit për të promovuar një qeveri të një partie për fituesin (Norris P, 2004;50).

2.2.1.4.Sistemi dy raundesh (SDR)

Ky sistem është model mazhoritar, i cili ka një përdorim mjaft të gjerë në zgjedhjet parlamentare, presidenciale (IDEA 2000:43) dhe lokale për Kryetar të Komunave në

Kosovë (Ligji Nr. 03/L-072, Neni 9. 6) dhe vendet e tjera. Gjithashtu, neni 9 i ligjit për zgjedhjet lokale në Kosovë përcakton se Kryetar i Komunës “zgjidhet ai kandidat që fiton më shumë se 50%, plus një votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në kuti për atë komunë”. Megjithatë, nëse asnjëri nga kandidatët nuk fiton më shumë se 50%, plus një votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në kuti, organizohet raundi i dytë i zgjedhjeve (balotazhi) në mes të dy kandidatëve të cilët kanë fituar më së shumti vota të vlefshme. Ky model është i njohur edhe si sistem i eliminimit, ose sistem i votimit të dyfishtë. Nga njëra anë, ky sistem mund të konsiderohet si një përmirësim i “legjitimitetit të fituesit”, pasi kandidatët kanë nevojë për mbështetjen e së paku gjysmës së votuesve, por nga ana tjetër ndëshkohen partitë më të vogla dhe nevoja që qytetarët të dalin në votime dy herë brenda një periudhe kohore të shkurtër mund të pengojë entuziazmin e votuesve dhe rrjedhimisht “pjesëmarrje e ulët në zgjedhje” (Norris, P. 2004:49). Gjithashtu, ky model krijon mundësinë që në raundin e dytë të krijohen aleanca të reja si dhe kohabitacione (koalicion të partive rivale) në qeverisje.

2.2.2. MODELI PROPORCIONAL

2.2.2.1. Lista e përfaqësimit proporcional (LPP)

Parimi i përbashkët i modelit të Përfaqësimit proporcional është zvogëlimi i pabarazisë midis një pjese të votës kombëtare dhe pjesës së saj në vendet e parlamentit (IDEA 2005:29). Përderisa sistemet mazhoritare kanë tendencë dhe efekt kufizues të numrit të partive, sistemet proporcionale priren të jenë më të pranueshme, duke rezultuar në një

kolorit më të madh të partive politike në kuvend (Lijphart, A. 1999:27). Mandej, nëse një parti politike fiton 30 përqind të votës popullore, kjo do të duhej të korrespondojë me fitimin e së paku 30 përqind apo më shumë të vendeve/ mandate në parlament. Vendet që pretendojnë së kanë vendosur sistem demokratik të qeverisjes, këtë mund ta shohin në vendimmarrje, sepse vetë “demokracia është kompromis” (Hagua, R. et al 1998:30). Ndërsa kundërshtarët e demokracisë në mazhoritar theksojnë kontrollin popullor nga partia në qeveri sipas parimit të sundimit të shumicës. Kjo është e “rrezikshme për demokracinë” sepse “pakicat” politike dhe etnike të cilave në vazhdimësi i mohohet qasja në pushtet do të ndjehen të përjashtuara dhe të diskriminuara nga qeverisja dhe mund të humbasin besimin ndaj saj. Kështu që demokracitë e konsensusit dhe sistemet zgjedhore të PR, përqendrohen në përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në shoqëri, duke theksuar nevojën për negociata dhe kompromise brenda parlamentit, qeverisë dhe procesit të bërjes së politikave në vend (Lijphart, A. 1999:31-47; Norris, P. 2004:50).

Vendosja e modelit zgjedhor të sistemit PR përfshin marrjen e së paku katër vendimeve kryesore: “formulën zgjedhore” për përkthimin e votave në mandate/vende, nivelin e “pragut zgjedhor”, “madhësinë e zonës” zgjedhore dhe mundësinë e preferencave për kandidatët (A. Blais&L.Massicotte, 1996:54). Mirëpo, formula zgjedhore ndryshon në mesin e sistemeve proporcionale, megjithatë janë dy opsionet themelore të këtij sistemi që përdorin metodat mesatare më të larta, një ndarës (pjesëtues) dhe metodat më të mëdha të mbetjeve, të cilat përdorin kuota (A. Blais&L. Massicotte, 1996: 57). Sipas metodës mesatare më të lartë, i cili përdoret edhe në Kosovë, i bie që numri i votave për secilën parti të ndahet në mënyrë të suksesshme nga një proces ndarje (Ligji Nr. 03/L-072, Neni

8). Mandej, mandatet ndahen për partitë që sigurojnë koeficientin më të lartë që rezulton, deri në numrin e përgjithshëm të vendeve në dispozicion (Norris, P. 2004: 51). Me fjalë të tjera, procesi i ndarjes së vendeve mund të konsiderohet si një proces i dhënies së çdo mandati partisë që paraqet mesataren më të lartë. Kjo mesatare tregon numrin e votave të fituara nga partia dhe fuqisë së saj që pasqyron numrin e vendeve që i janë dhënë në Kuvend (Gallagher&Mitchell, 2005: 584). Ndërkohë që vendi i parë shkon për partinë më të madhe, mesatarja e tij zvogëlohet për këtë shkak kur vjen puna për të konkurruar për vendin e dytë. Rezultatet e sakta të metodës mesatare më të lartë varen nga sekuenca e numrave të përdorur si ndarës. Sekuenca më e përdorur gjerësisht është formula d'Hondt, duke përdorur pjesëtues të tillë si 1, 2, 3, 4, 5, dhe kështu me radhë në ndarjen e mandateve (Salihu, K. 2004: 255). Metoda tjetër kryesore është formula Sainte-Laguë (e përdorur në Kosovë nga 2000-2017, shih tabelat Nr. 2) e cila pjesëton votën me numra të rastësishëm (1, 3, 5, 7, 9 ...). Kjo formulë vështirë të përdoret në formën e saj të pastër, por formula e modifikuar e Sainte-Laguë, e cila zëvendëson pjesëtuesin e parë me 1.4, është më e zakonshme. Nga këto tri metoda më të larta mesatare, formula e d'Hondt është prirur të favorizojë partitë më të mëdha dhe formula e pastër Saint-Laguë është metoda më e paanshme që prodhon rezultatet më proporcionale (Blais, A.&Massicotte, L. 1996: 59). Metodat më të mëdha të mbetura përdorin një kuotë minimale, e cila bazohet në numrin e votave të hedhura në kuti dhe numrin e vendeve që do të ndahen. Secilës parti i ndahen aq vende sa ka kuota të plota, dhe nëse kjo i lë disa vende të paplotësuara, ato vende të mbetura u shpërndahen partive me më shumë vota të mbetura (Gallagher&Mitchell, 2005: 586), apo me mesatare më të lartë se sa listat e tjera (Salihu, K. 2004: 225). Metoda më e zakonshme e përdorur është kuota Hersit (Hare), në Gjermani e njohur edhe si kuota

Hare/Niemeyer. Kuota Hare llogaritet duke e ndarë numrin e votave me numrin e vendeve. Kuota Hare konsiderohet e paanshme midis partive më të vogla dhe më të mëdha, duke prodhuar rezultate të njëjta si Saint-Laguë (Gallagher&Mitchell, 2005:584). Në shumicën e sistemeve të PR, caktohet censusi zgjedhor në mënyrë që numri i votave që ka fituar një listë zgjedhore të pjesëtohet me numrin e mandateve (Bajrami, A. 2010:240). Kështu që pragjet zgjedhore variojnë nga 0.67 për qind në Holandë, në Kosovë 5% , në 7 për qind në Poloni dhe 10 për qind në Turqi. Partitë që fitojnë më pak se kjo përqindje (pragu) nuk do të përfitojnë asnjë vend në parlament. Ekzistenca e pragjeve tenton të rrisë nivelin e shpërpjesëtimit, sepse mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në mundësitë për partitë më të vogla. Gjithashtu, madhësia e zonës mund të ndryshojë ndjeshëm në mes të sistemeve PR. Në përgjithësi, sa më e madhe është zona zgjedhore, aq më proporcional është rezultati. Ai ofron shanse më të mira për partitë e vogla si dhe zvogëlon presionin e votuesve për të votuar në mënyrë strategjike (IDEA 2005: 7). Aktualisht, modeli LPP përdoret në 70 vende nga 199 shtete, duke u dhënë atyre 35 përqind të totalit (IDEA 2005: 31). Ky model aplikohet me lista të hapura të mbyllura dhe lista të lira. Në Kosovë është aplikuar PP me lista të mbyllura dhe lista të hapura (për më shumë shih kapitullin III).

2.2.2.2.Vota e vetme e transferueshme (VVT)

Në kuadër të këtij modeli është proporcionaliteti që konsiderohet se arrihet më së miri me përdorimin e listave të partive politike dhe sipas votimit preferencial duke qenë pjesë e modelit të sistemit zgjedhor proporcional (IDEA 2000:29). Në bazë të këtij sistemi (VVT), votuesit bëjnë renditjen e kandidatëve në zonat zgjedhore me shumë anëtarë. Votuesit janë të lirë t'i shprehin preferencat e tyre. Në shumicën e rasteve vendosja e preferencës është

fakultative dhe zgjedhësve nuk u kërkohet që t'i radhisin të gjithë kandidatët, po që se ata dëshirojnë të votojnë vetëm një kandidat. Përkrahësit e këtij sistemi argumentojnë se duke i lejuar qytetarët të shënojnë preferencat e tyre në listat e partive, ose me ndarjen e votave të tyre nëpër parti të ndryshme në një sistem me lista të hapura, ofrohen zgjidhje më të mëdha se sistemet e tjera (Norris, P. 2004:55).

2.2.2.3. *Sistemet e përziera (PM)*

Ky model përdor elementë të proporcionalitetit dhe veçori mazhoritare si dhe funksionon në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra (IDEA 2005: 29). Në kuadër të Sistemit Paralel, bëhet zgjedhja e disa deputetëve ose mandateve parlamentare sipas Sistemit Mixt (PM) /IPLMP në zonat e caktuara dhe pjesa tjetër e mandateve zgjidhet nga Lista PR, në nivelin kombëtar dhe në këtë rast sistemet proporcionale të përfaqësimit, kompensojnë çdo disproporcionalitet që del në sistemin mazhoritar. Kështu që zonat njëanëtarëshe janë të kombinuara me një sistem proporcional me lista mbarëkombëtare. Ky sistem përdoret në zonat elektorale të listës së përfaqësimit proporcional (LPP) si dhe “fituesi merr të gjitha”, ndryshe nga Sistemi Proporcionaliteti Mikst (SPM), ku një pjesë e madhe e parlamentit, zakonisht gjysma, zgjidhet nga zonat mazhoritare, ndërsa pjesa tjetër zgjidhet me listat e PP. Në sistemet PM vendet nga lista PP kompensojnë disproporcionalitetin e krijuar nga rezultatet e vendeve nga zonat ku dalin (IDEA2000: 55).

2.2.3. MODELI GJYSMËPROPORCIONAL

Këto modele janë ato sisteme që i shndërrojnë votat e fituara në një mënyrë të tillë që bie në mes të sistemeve proporcionale (PP) dhe sistemeve mazhoritare (IDEA 2000: 51). Nga sistemi mazhoritar ai përvetëson parimin e shumicës, për të fituar mandate, ndërsa nga sistemi proporcional merr metodën e fitimit të vendeve për në parlament, në proporcion me numrin e votave të hedhura në kutitë e votimit. Ndarja e mandateve parlamentare në bazë të këtij sistemi bëhet me aplikimin e kombinuar të sistemit mazhoritar dhe të sistemit proporcional. Procesi i kombinimit të këtyre dy modeleve bën që “kandidatët” të zgjidhen për në parlament sipas dy mënyrave: në bazë të votave që kanë fituar kandidatët individualisht në zgjedhje dhe numrit të votave që ka fituar partia politike. Ky proces mikst i kandidatëve që i kanë humbur zgjedhjet sipas parimit të shumicës mundëson që përsëri të fitojnë mandate parlamentare, në qofte se lista zgjedhore e partisë së tyre politike ka fituar përqindje të caktuar të votave të trupit elektoral, që do të thotë se jo më pak se 5% (Bajrami, A.1996: 168). Gjithashtu, ky sistem është aplikuar në zgjedhjet e vitit 1992 dhe 1998, për Parlamentin e Republikës së Kosovës. Ekzistojnë dy forma kryesore të sistemit zgjedhor gjysmëproporcional, e ato janë: vota e vetme e patransferueshme dhe sistemi paralel (IDEA 2000 :51).

2.2.3.1. Vota e vetme e patransferueshme (VVPT)

Njëri prej modeleve më të rralla që përdoret në zgjedhjet parlamentare, është sistemi VVPT. Sipas këtij sistemi, ku zonat elektorale janë shumëkandidatëshe, secili zgjedhës ka një votë për të dhënë (votuar). Kandidati me numrin më të madh të votave, konsiderohet i zgjedhur,

ngjashëm me sistemin IPLMP. Në qoftë se bëhet fjalë për një zonë katëranëtarëshe, për shembull, kandidatit i nevojiten diçka pak më shumë se 20% të votave për të siguruar zgjedhjet. Prandaj, mund të thuhet se VVPT-ja është një sistem gjysmëproporcional, që i kombinon zonat shumëkandidatëshe me metodën e numërimit të IPLMP (IDEA 2000:152). Dallimi më i rëndësishëm midis VVPT dhe IPLMP qëndron në faktin se VVPT-ja ka më shumë mundësi të lehtësojë përfaqësimin e partive të vogla, për t'u përfaqësuar në parlament. Andaj, sa më e madhe të jetë një zonë elektorale, aq më proporcional bëhet sistemi (IDEA 2000: 51). Ky sistem ka një aplikim shumë të rrallë në praktikën parlamentare. Aplikimi i tij nuk mund të garantojë që rezultatet e përgjithshme të jenë proporcionale, edhe pse partitë e vogla janë mjaft të favorizuara në bazë të këtij sistemi, që aplikon zona shumëkandidatëshe, por në qoftë se ato nuk i udhëzojnë zgjedhësit se si dhe cili kandidat duhet votuar, mund të mos e fitojë mandatin asnjë kandidat. Kjo do të thotë se partitë e vogla, me një përkrahje, të themi rreth 10%, por që i kanë votat e shpërndara gjithandej vendit, mund të mos fitojnë asnjë vend në parlament (IDEA 2000: :51). Ndër përparësitë që ka ky sistem është fakti se bën seleksionimin e kandidatëve në kuadër të partisë, sepse votuesi ka vetëm një votë dhe zona është shumëkandidatëshe. Kjo është mënyra më e mirë e reformës brendapërbrenda partisë drejt demokratizimit të saj.

2.2.3.2.Sistemet paralele - të përziera

Është një prej formave të sistemit gjysmëproporcional, është ky një kombinim i sistemit mazhoritar dhe sistemit proporcional. Ajo që e dallon këtë sistem nga sistemet e tjera zgjedhore, është ajo, se këtu votuesit kanë në dispozicion dy lista, nëpërmjet të cilave duhet të votojnë. Njëra listë është ku votuesi duhet të hedhë votën e tij, sipas IPLMP, kurse lista

tjetër është ku votuesi hedh votën sipas sistemit proporcional. Ky sistem përdoret në zonat elektorale të LPP si dhe “fituesi merr të gjitha”, ndryshe nga Sistemi Proporcionaliteti Mikst (SPM), ku një pjesë e madhe e parlamentit, zakonisht gjysma, zgjidhet nga zonat mazhoritare, ndërsa pjesa tjetër zgjidhet me LPP. Në sistemet PM vendet nga lista PP kompensojnë disproporcionalitetin e krijuar nga rezultatet e vendeve nga zonat zgjedhore (IDEA 2000: 55). Ato shtete që e aplikojnë këtë sistem, e bëjnë këtë në forma të ndryshme rreth përqindjes së ndarjes së mandateve, sipas listave që votohen. Në disa shtete përdorin dizajne të ndryshme, por edhe në mënyrë të barabartë sikurse Gjermani ku sistemin e votimit - 50% të deputetëve i zgjedhin sipas sistemit mazhoritar dhe 50% sipas sistemit proporcional (Norris, P. 1997:304) .

Në Kosovë ky model është aplikuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 1992 dhe 1998. Ndërsa, në Shqipëri ky sistem është ndryshuar në vitin 2009 duke kaluar në modelin PP rajonal, që u aplikua për herë të parë në zgjedhjet parlamentare të 2009-ës dhe zëvendësoi sistemin PM, që ishte aplikuar nga zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri.

Sistemet paralele japin rezultate që bien diku midis sistemeve mazhoritare dhe sistemeve PP, por në të shumtën e herëve i japin zgjedhësit mundësinë e përzgjedhjes në nivel zone elektorale dhe parti në rrafshin kombëtar, meqenëse këto sisteme kërkojnë dy fletëvotime (IDEA, 2000:56). Sipas këtij sistemi zgjedhor, për në parlament zgjidhen dy kategori deputetësh. Kategoria e parë e deputetëve zgjidhen nëpër zonat elektorale, ndërsa, kategoria tjetër e deputetëve zgjidhen sipas listës partiake të dominuar në zgjedhje. Deputetët që zgjidhen nga zona elektorale i përgjigjen zonës së tyre prej nga janë zgjedhur, kurse ata që zgjidhen nga listat partiake, që nuk i detyrohen zonës elektorale, shtrëngohen t’u përgjigjen

liderëve partiakë, të cilët i kanë radhitur në listat partiake për kandidatë të mundshëm për në parlament. Megjithatë, ky sistem determinon një parlament përfaqësues gjithëpërfshirës, politik dhe gjeografik.

2.2.4. Votimi i Kufizuar dhe Borda Count

Për më tepër, këto sisteme nuk bien nën asnjë prej tre nëngrupeve të mësipërme. Votimi i Kufizuar është shumë i ngjashëm me Vota e vetme e patransferushme (VVPT) por dallimi mes tyre qëndron se ky model i jep votuesve më shumë se një votë. Megjithatë, për ndryshim nga Vota Bllok, ku secili zgjedhës ka aq vota, sa ka vende për t'u plotësuar dhe zakonisht zgjedhësit janë të lirë të votojnë për kandidatët individualë, pavarësisht nga anëtarësia partiake (IDEA 2000:36), duke shprehur preferencat për kandidatët sipas dëshirës së tyre, Vota e Kufizuar nuk i jep zgjedhësve aq vota sa ka vende për t'u plotësuar. Ndërsa, Borda Count është një sistem preferencial në zona me një ose më shumë anëtarë (IDEA 2005:29). Kjo është një metodë, sipas së cilës, votuesit i rankojnë kandidatët sipas preferencave.

Pas dhënies së kësaj pasqyre për sistemet zgjedhore, nënseksioni në vijim shqyrton efektet e sistemit zgjedhor në Kosovë.

KAPITULLI III: ANALIZË KORNIZËS LIGJORE PËR SISTEMIN ZGJEDHOR NË KOSOVË

3.1. Analizë kornizës normative për të drejtën zgjedhore në Kosovë

Historia e demokracisë elektorale në Kosovë është e lidhur drejtpërsëdrejti me lirinë, demokracinë, pluralizmin dhe formimin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) të krijuar sipas bazës ligjore të aprovuar nga institucionet ndërkombëtare apo UNMIK-u pas vitit 1999 deri 2008 si dhe legjislacionit të miratuar nga institucionet e Republikës së Kosovës pas qershorit të vitit 2008. Korniza ligjore në të dy periudhat si para pavarësisë së Kosovës dhe pas saj është fokusuar në krijimin dhe lehtësimin e mundësisë për pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve në ndërtimin e institucioneve demokratike (KS,1999, Rezoluta 1244, UNMIK 2001: Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të Kosovës; Kuvendi i Kosovës 2008: Kushtetuta e Republikës së Kosovës). Gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar ose UNMIK-ut, e “drejta e votës” është garantuar përmes Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme të Kosovës (me tutje Korniza Kushtetuese) si dhe me dispozitat e rregulloreve mbi zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme në Kosovë.

E drejta e votës sipas dispozitave të Kreu 9.1-3.c i Kornizës Kushtetuese; Neni 7 i UNMIK/REG/2000/21; Neni 7 i UNMIK/REG/2000/65; Neni 8 i UNMIK/REG/2002/11; Neni 10 i UNMIK/REG/2004/9; Neni 7 i UNMIK /REG/ 2004/12 dhe Neni 10 i UNMIK/REG/2007/27 të rregullave zgjedhore, i takon “të gjithë personave të cilët i kanë mbushur 18 vjeç në ditën e votimit”. Në fakt: “Çdo person që ka mbushur moshën 18-

vjeçare në ditën e zgjedhjeve dhe që i plotëson kriteret e tjera për të drejtën e votimit, ka të drejtën e votës” (Korniza Kushtetuese: Kreu 9.1-3.c; UNMIK/REG/2000/21, Neni 7; UNMIK/REG/2000/65, Neni 7; UNMIK/REG/2002/11, Neni 8; UNMIK/REG/2004/9, Neni 10; UNMIK /REG/ 2004/12, Neni 7; UNMIK/REG/2007/27 Neni 10).

Me Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe miratimit të Kushtetutës së Republikës të Kosovës (me tutje Kushtetuta) nga Kuvendi më 9 prill 2008 dhe hyrjes në fuqi të saj më 15 qershor 2008, e drejta e votës është garantuar në kuadër të dispozitës së Nenit 45, që përcakton se kjo i takon: *“çdo shtetasi që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, të gëzoj të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet ne institucionet përfaqësuese”* (Kushtetuta, Neni 45.1). Përveç Kushtetutës dhe përmes dy ligjeve zgjedhore: Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (me tutje Ligji Nr. .), është e garantuar e “drejta e votës” si dhe drejta e votimit “brenda dhe jashtë” Kosovës. Në kuadër të Nenit 5 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme është sanksionuar e drejta për të votuar dhe ajo i garantohet të gjithë banorëve të Kosovës që kanë jetuar aty, para dhe pas janarit 1998. Sipas ligjit:

“Çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje në përputhje me këtë ligj nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjeç në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kriterëve vijuese: a) është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil; b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t’i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës; apo c) ka fituar statusin e refugjatit ,.... dhe ka të drejtë për t’u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës”(Ligji Nr. 03/L-073 neni 5; Ligji Nr. 03/L-072 Neni 12.1-2).

Gjithashtu, e drejta për votim brenda dhe jashtë Kosovës, është sanksionuar në kuadër të Nenit 6 të këtij ligji (Nr. 03/L-073 dhe kjo e drejtë i takon çdo shtetasi me të drejtë vote

që është i regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si dhe figuron në listën e votuesve të KQZ-së:

Sipas kësaj dispozite:

“Çdo person me të drejtë vote ka të drejtë të votojë në Kosovë në ditën e zgjedhjeve dhe në zonën zgjedhore ku ai apo ajo është i regjistruar, me kusht që emri i tij apo saj paraqitet në Regjistrin Qendror Civil ose është regjistruar si qytetar i Kosovës në një datë të caktuar nga KQZ-ja”... “Votuesi me të drejtë vote i cili përkohësisht banon jashtë, ose është zhvendosur nga Kosova ka të drejtë të votojë në zgjedhje sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj”...(Ligji Nr. 03/L-073, Neni 6.1-6.2)

Në kuadër të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme gjithashtu është garantuar votimi jashtë Kosovës si dhe votimi i personave me nevoja të veçanta dhe mundësohet sipas procedurave të veçanta . Sipas Nenit 96 votimi jashtë Kosovës realizohet atëherë “kur votuesi ka aplikuar për votim dhe ajo është pranuar” nga KQZ-ja. Sipas ligjit:

“Votuesi me të drejtë vote i cili përkohësisht mungon në Kosovë mund të votojë për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës nëse ai ose ajo ka aplikuar suksesshëm për Votim Jashtë Kosovës”... “Vota përmes Votimit Jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ- së” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 96.1-2; KQZ 2013 Rregulla Nr.03/2013, Neni 3).

Ndërsa për votimin e personave me nevoja të veçanta, Ligji Zgjedhor përmes Nenit 99 i jep mandat KQZ-së që të përcaktojë rregullat për votimin e personave me nevoja dhe rrethana të veçanta. Për këtë, KQZ përmes Rregullores Nr.04/2013 për votimin e personave me nevoja dhe rrethana të veçanta ka përcaktuar mënyrat për të ofruar mundësinë për: “Votuesit e ngjuar në shtëpi”; “Votuesit me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion si dhe votuesit në rrethana të veçanta” përmes “Kutisë lëvizëse të votimit” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 99; KQZ 2013, Rregulla Nr. 04/2013, Neni 2-7).

E drejta zgjedhore apo e drejta e votës në Kosovë trajtohet si në shumicën e shteteve dhe “konsiderohet e drejte personale, do të thotë autorizim juridik të cilin qytetarët mundën, por nuk janë të obliguar ta shfrytëzojnë” (Hasani, E.& Çukalović I, 2013:161-2) .

Në përgjithësi legjislacioni i Kosovës i garanton çdo qytetari të drejtën për të votuar dhe për t’u zgjedhur në institucionet qendrore dhe lokale pa diskriminim në bazë të etnisë, gjuhës, gjinisë, bindjes politike besimit apo përkatësisë sociale. Në veçanti, legjislacioni zgjedhor promovon dhe siguron përfaqësimin gjinor dhe etnik në institucionet përfaqësuese. Ndërsa, legjislacioni penal parasheh, masa dhe ndjekjen penale ndaj personave të cilët ndërmarrin veprime abuzive kundër të drejtave të votimit siç janë votimi i shumëfishtë; shkelja e fshehtësisë së votimit; kryerja e mashtrimit gjatë votimit, numërimit, regjistrimit apo publikimit të votave dhe asgjësimi në çfarëdo mënyre i dokumenteve të votimit. Në kapitullin XVIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është përcaktuar “përgjegjësia penale”, si të “votuesve” ashtu edhe të “zyrtarëve zgjedhorë” me dënime që fillojnë nga ai me gjobë e deri në pesë vjet burgim¹ (KODI PENAL, Nr. 04/L-082, Neni 210-220). Legjislacioni i siguron qytetarëve që përmes votës të shprehin vullnetin e tyre, qoftë duke i zgjedhur përfaqësuesit e vet apo duke i kontrolluar ata përmes mjeteve demokratike ose

¹ Shënim: Kodi Penal i Republikës së Kosovës veprat kundër të drejtave të votimit gjatë procesit zgjedhor i ka kategorizuar si krime të rënda. Ndjekja e veprave penale të lidhura me zgjedhjet është rregulluar nga neni 210 deri 220 i Kodit. Këto vepra kundër të drejtave të votimit mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, duke përfshirë veprimet penale paraelektorale, elektorale dhe paselektorale. Veprat penale që mund të kryhen në periudhën paraelektorale sanksionohen në Nenet 210: “Cenimi i së drejtës për të kandiduar” dhe 211 “Kanosja e kandidatit”. Veprat penale që mund të kryhen në periudhën elektorale sanksionohen në nenet 212 “Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar”; Neni 214 “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve”; Neni 215 “Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin”; Neni 213 “Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve”; Neni 216 “Keqpërdorimi i të drejtës së votimit”; Neni 217 “Pengimi i procesit të votimit” dhe Neni 218 “Cenimi i fshehtësisë së votimit” dhe veprat penale që mund të kryhen në periudhën paselektorale sanksionohen në Nenet 219 “Falsifikimi i rezultateve të votimit” dhe 220 “Asgjësimi i dokumenteve të votimit” (KODI NR. 04/L-082, Neni 210-220).

edhe duke marrë pjesë drejtpërdrejtë për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve qeverisëse. Gjithashtu, përveç dhënies së legjitimitetit të pushtetit demokratik, është e drejtë e qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur ta monitorojnë qeverisjen sipas procedurave demokratike të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Pas analizës dhe krahasimit të legjislacionit zgjedhor të periudhës së administrimit ndërkombëtar të UNMIK-ut dhe legjislacionit pozitiv në Kosovë, arrijmë në përfundimin se pothuajse ato janë të njëjta, si dhe ndryshimet e bëra janë evidente por jo të plota. Megjithatë, një reformë elektorale konform “rekomandimeve” të Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM) mbi Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë (EU EOM 2014:26; EU EOM 2017: 35) dhe Komisioni Evropian (K-E) të prezantuar në raportet e progresit për Kosovën, “korniza ligjore” është e domosdoshme (KE 2010:7; KE 2011:6; KE-2012:7;... KE 2013:8;...KE 2015:6; KE 2016:6).

Kosova sipas këtyre rekomandimeve:

... duhet të sigurohet që korniza ligjore përmirësohet që të pasqyroj praktikat dhe standardet më të mira të BE-së që dalin nga një marrëveshje e tillë”(KE-2012:7;.... “Kuvendi dhe institucionet e tij duhet të fokusohen në prioritetet e identifikuara në studimin e fizibilitetit, posaçërisht sa i përket reformës zgjedhore”(KE 2013:8;....) Kosova ende ka nevojë për një reformë të plotë zgjedhore për të adresuar rekomandimet nga misionet dhe ekspertët për vëzhgimin e zgjedhjeve ... Kuvendi i Kosovës mbetet të miratojë reformën zgjedhore e cila është vonuar (KE 2015:6);... Kuadri zgjedhor i Kosovës është në përputhje me standardet ndërkombëtare, megjithatë reforma zgjedhore, e udhëhequr nga Komisioni i Venecias, mbetet e nevojshme (KE 2016:6).

Në përgjithësi, rekomandimet për reformën e kornizës ligjore janë emërues i përbashkët dhe kërkesë prioritare për Kosovën. Në përfundim mund të themi se është e domosdoshme që Kosova sa më parë të finalizojë procesin e reformës zgjedhore. Në kuadër të kësaj reforme duhet të përfshihet korniza ligjore dhe dispozitat kushtetuese për zgjedhjet dhe përmbledhja e tyre në një kod të veçantë zgjedhor i cili do të rregullonte proceset zgjedhore në nivel lokal dhe të përgjithshëm dhe i cili do të pasqyronte praktikat më të mira ndërkombëtare

si dhe përmbushjen e rekomandimeve dhe standardeve ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe demokratike.

3.2. Analizë kornizës ligjore për zgjedhjet e përgjithshme: Sistemi zgjedhor, Listat, Preferencat, Kuota gjinore dhe pragu zgjedhor

Në hulumtimin e kornizës ligjore zgjedhore, analizohen dispozitat zgjedhore (në UNMIK: RREG.2001/33 Mbi zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës; UNMIK/REG/2004/12 Mbi zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës; UNMIK/REG. Nr.. 2007/26 për ndryshimin e Rregullores Nr.2004/12 Mbi zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës; Ligjin Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligji nr. 03L-256 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës) që përcaktojnë: sistemin zgjedhor, listat zgjedhore, votat preferenciale, prapun zgjedhor si dhe kuotën gjinore dhe etnike për zgjedhjet e përgjithshme në dy periudhat, para dhe pas pavarësisë së Kosovës. Përmes analizës ligjore dhe procesit zgjedhor janë nxjerr në pah disa karakteristika të përbashkëta si dhe ndryshimet në mes tyre.

Historia e demokracisë elektorale dhe përfaqësuese në Kosovë² është zhvilluar sipas dy sistemeve ligjore për afër dy dekada. Gjatë të kësaj periudhe (2000-2017) janë mbajtur dymbëdhjetë cikle zgjedhore për dy nivelet e përfaqësimit, atij qendror dhe lokal (KQZ 2017:14-15). Prej tyre tri nga gjashtë proceset zgjedhore për nivelin qendror janë organizuar sipas kornizës ligjore të UNMIK-ut: UNMIK:RREG.2001/33; UNMIK/REG/2004/12;

² Për sqarim: Zgjedhjet e para pluraliste për Kuvendin e Kosovës janë organizuar më 24 maj 1992 sipas Kushtetutës të Republikës së Kosovës, apo Kushtetuta e Kaçanikut 1990. Në këtë punim i referohemi zgjedhjeve që janë mbajtur pas lufte (1998-1999) dhe pas vendosjes së Kosovës nën administrimin ndërkombëtar (UNMIK 1999-2008) dhe pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, 17 shkurt 2008 dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi.

UNMIK/REG/2007/27; UNMIK/REG. Nr.. 2007/26 për ndryshimin e Rregullores Nr.2004/12 dhe tri cikle zgjedhore sipas ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Po ashtu, tri nga gjashtë proceset zgjedhore për nivelin lokal janë organizuar sipas kornizës ligjore të UNMIK-ut: UNMIK/REG Nr.2000/39; UNMIK/REG/2002/11; UNMIK/RREG. Nr. 2007/27 dhe tri sipas Ligji Nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, duke përfshirë edhe tri nga katër cikle zgjedhore për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të kryetarëve të Komunave, përveç zgjedhjeve të vitit 2007 që janë organizuar sipas kornizës ligjore të UNMIK-ut: UNMIK/RREG. Nr. 2007/27.

Korniza ligjore zgjedhore në përgjithësi, për të gjitha këto procese zgjedhore të organizuara për të dy nivelet e pushtetit, përveç zgjedhjes së “Kryetarëve të Komunave” janë të organizuar sipas rregullave të “sistemit të përfaqësimit proporcional” me “lista të hapura” me tri përjashtime të zgjedhjeve të vitit 2001, 2002 dhe 2004 (shih: tabelat nr. 2, nr.3 dhe nr.4) që janë organizuar me “lista të mbyllura” si dhe me “një zonë të vetme zgjedhore” (UNMIK: RREG.2001/33, Neni 4.3, UNMIK/Rreg. 2001/9: 9.1.3; UNMIK/REG/2004/12, Neni 5; UNMIK/REG/2007/27; neni 5; UNMIK/REG. Nr.. 2007/26 për ndryshimin e Rregullores Nr.2004/12 , Neni 5.3-4-5; Ligji Nr. 03/L-073, Neni 110).

Megjithatë, legjislacioni i dy periudhave, para dhe pas Pavarësisë së Kosovës përcakton Kosovën si një zonë të vetme zgjedhore. Sipas dispozitave të kreu 9.1.3 të Kornizës Kushtetuese “*Kosova konsiderohet një zonë e vetme elektorale shume anëtarëshe për qëllimet e zgjedhjes së Kuvendit*” (Korniza Kushtetuese apo UNMIK/Rreg. 2001/9: 9.1.3) apo sipas Nenit 110 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme “*Kosova konsiderohet një zonë zgjedhore me shumë kandidatë*” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 110).

Gjithashtu legjislacioni zgjedhore trajton në mënyrë të njëjtë “kuotën gjinore” dhe “etnike”. Sa i përket kuotës etnike ose vendet e rezervuara dhe pastaj të garantuara për komunitetet pakicë është normuar së pari me dispozitën kushtetuese të kreu 9.1.3 të Kornizës Kushtetuese dhe vazhdon të Neni 64.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kuota të njëjta prej njëzet vendeve. Aty përcaktojnë së: *“njëzet prej njëqind e njëzet vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë”* (Korniza Kushtetuese 9.1.3; Kushtetuta, Neni 64.2). Kurse lidhur me kuotën gjinore legjislacioni zgjedhor në vazhdimësi përmes dispozitave: Neni 5.5 i UNMIK/REG/2002/11; Neni 21 i UNMIK/REG/2004/12; Neni 6 i UNMIK/REG/2007/26; Neni 6.4 i UNMIK/REG/2007/27; Neni 27 dhe Neni 111.6 i Ligjit Nr. 03/L-073 dhe Neni 8.4 i Ligjit Nr. 03/L-072, ka sanksionuar “kuotën prej së paku 30% në listat e kandidatëve të subjekteve politike” si dhe në ndarjen e vendeve në institucionet përfaqësuese (UNMIK/REG/2002/11, Neni 5.5; UNMIK/REG/2004/12, Neni 21; UNMIK/REG/2007/26, Neni 6; UNMIK/REG/2007/27, Neni 6.4; Ligji Nr. 03/L-073 Neni 27 dhe Neni 111.6; Ligji Nr. 03/L-072, Neni 8.4). Këto dy kritere të veçanta të sistemit zgjedhor (kuotën gjinore dhe etnike) janë trajtuar më gjerësisht në kapitullin IX dhe X të këtij punimi.

Mirëpo “Sistemi zgjedhor” në zgjedhjet e para për Kuvend (të mbajtura në vitin 2001) janë organizuar³ sipas rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/33 për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës me sistemin proporcional me “lista të mbyllura”. Sipas dispozitës së Nenit 4.1 të kësaj kornize ligjore është përcaktuar se: *“Një votues mund të votojë vetëm për*

³ Shënim: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSCE) ka organizuar katër palë zgjedhje nga viti 2000 deri në vitin 2004 dhe ka ndihmuar në themelimin e dy institucioneve zgjedhore – Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Sekretariatin e tij. <http://www.osce.org/sq/kosovo/118214> (qasur 19.09.2015)

një subjekt politik në fletëvotim” (UNMIK/ REG. Nr. 2001/33, Neni 4.1), ndërsa vendet në Kuvend, ndahen sipas “fuqisë së votës” dhe “vendeve të rezervuara” për subjektet politike.

Sipas Nenit 4.3 i rregullores:

“...Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme të fituara nga çdo subjekt politik që konkurron për një numër vendesh, sipas mënyrës së përcaktuar në paragrafin 9.1.3(a)-(b) të Kornizës Kushtetuese, pjesëtohet me 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, e kështu me radhë derisa numri i pjesëtuesve të përdorur të korrespondojë me numrin e përgjithshëm të vendeve që do të jepen për atë grup vendesh” (UNMIK: RREG.2001/33, Neni 4.3).

Duke analizuar këtë dispozitë, vërejmë se subjektet politike dhe kandidatët e tyre sigurojnë vende në Kuvend në përpjesëtim me fuqinë e votës për subjektin dhe radhitjen e tyre brenda listës partiake.

Sistemi zgjedhor proporcional me “lista të mbyllura” është normuar sipas Nenit 5 i Rregulles UNMIK/REG/2004/12 dhe është zbatuar në zgjedhjet e dyta të vitit 2004 për Kuvendin e Kosovës (UNMIK/REG/2004/12, Neni 5).

Në kuadër të reformës së parë elektorale ose reformës ligjore përmes Rregullores Nr. 2007/26 UNMIK/ REG. për ndryshimin e UNMIK/REG. Nr. 2004/12 dhe Rregullores UNMIK/REG Nr.2007/28 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2007/26 është normuar ndryshimi i tri çështjeve me rëndësi për proceset zgjedhore siç janë:

- a. listat e hapura;
- b. vota preferenciale dhe
- c. vendosja e pragut zgjedhor.

Në dispozitat e nenit 5 dhe Neni 6 të Rregullorës Nr. 2007/26 UNMIK/ REG. për ndryshimin e UNMIK/REG. Nr. 2004/12 dhe Neni 1 të Rregullores UNMIK/REG Nr.2007/28 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2007/26 (janë organizuar zgjedhjet nacionale të vitit 2007) është përcaktuar sistem proporcional me “lista të hapura”,

me mundësi votimi deri në “dhjetë preferenca brenda listës” si dhe “pragu zgjedhor prej pesë përqind”. Sipas Nenit 5 të Rregullores UNMIK/ REG. Nr. 2007/26 për ndryshimin e UNMIK/REG. Nr. 2004/12, përcaktohet që subjekti politik pjesëmarrës në zgjedhje paraqitet me “listë të hapur” për votim dhe votuesit kanë mundësi të votojnë brenda listës deri në “dhjetë kandidatë”. Në bazë të kësaj dispozite:

...“Votuesi voton vetëm për kandidatët e një (1) subjekti politik të certifikuar që janë në listën zyrtare të kandidatëve. ...Votuesit mund të votojnë deri dhjetë (10) kandidatë brenda listës së njëjtit të kandidatëve të subjektit politik. Nëse në fletëvotim shënohen më shumë se dhjetë (10) kandidatë, do të numërohen vetëm dhjetë (10) kandidatët e parë. Votat e hedhura për kandidatët e listës nga i njëjti subjekt politik një fletëvotim konsiderohen se përbëjnë një (1) votë për subjektin politik të cilit i përket lista e kandidatëve, pavarësisht nga numri i kandidatëve të shënuar” (UNMIK/REG. Nr. 2007/26, Neni 5.3-4-5).

Gjatë analizës së kësaj rregulloreje rezultonte se përveç votës preferenciale, gjithashtu, në kuadër të dispozitave të Nenit 6, të Rregullores UNMIK/REG. Nr. 2007/26 dhe Nenit 1 të Rregullores UNMIK/REG Nr.2007/28 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2007/26 “Mbi Zgjedhjet për Kuvendin” më 2007 në Kosovë, është vendosur pragu zgjedhor prej 5%. Në bazë të kësaj dispozite ndarja e vendeve në Kuvend realizohet sipas “sistemit të përfaqësimit proporcional” për subjektet që kanë arritur të sigurojnë së paku 5 përqind të votës së përgjithshme të dala nga zgjedhjet dhe duke respektuar vendet e rezervuara.

Sipas kësaj dispozite vendet ndahen:

“në mesin e subjekteve politike që paraqesin komunitetin shumicë në Kosovë që kanë marrë së paku pesë përqind (5%) të votave të përgjithshme të vlefshme në zgjedhjet për Kuvend dhe subjektet politike që paraqesin komunitetin jo shumicë në Kosovë. Vendet që do t'u ndaheshin subjekteve politike të cilët nuk e plotësojnë kushtin prej pesë përqind (5%) do t'u ndahen subjekteve politike që paraqesin komunitetin shumicë në Kosovë ...” (UNMIK: Rreg. NR. 2007/28: Neni 1).

Në interpretimin logjik të dispozitës së përmendur më sipër, vijmë në përfundim se, për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetin shumicë (shqiptarët) është e domosdoshme që së pari të sigurojnë votat e nevojshme që të kalojnë pragu zgjedhor për të participuar në kuvend dhe e dyta, për të marrë pjesë në pjesëtimin e votave të mbetura nga subjektet e tjera

politike shqiptare të cilat nuk kanë kaluar pragun zgjedhor. Ky rregull (pragu zgjedhor) nuk vlen për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet minoritare për shkak të vendeve të rezervuara të përcaktuar sipas kreut 9.1.3, të Kornizës Kushtetuese.

Vota preferenciale ka pësuar ndryshime pas ndryshimit të statusit politik dhe Juridik të Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës në qershor të vitit 2008. Në kuadër të reformës elektorale me Ligjin Nr. 03/L-073, është hequr “vota preferenciale. Largimi i votës preferenciale është normuar me nenin 110.4 të Ligjit Nr. 03/L-073, duke përcaktuar se qytetarët gjatë ushtrimit të së drejtës së votës mund të votojnë vetëm për “një kandidat” brenda listës. Sipas Neni 110.4 i ligjit:

...”votuesi voton për një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votoj për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik. Nëse në fletëvotim janë shënuar më shumë se një (1) kandidat, vetëm vota për subjektin politik llogaritet” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 110.4).

Mirëpo kjo dispozitë ligjore (neni 110.4) nuk është zbatuar ndonjëherë pasi Kuvendi e ndryshoi atë disa ditë para shpërndarjes si pasojë e “mocionit të votëbesimit ndaj qeverisë” të mbajtur më 2 nëntor 2010 (Kuvendi, 2010, Transkript i 2 nëntor 2010:2-46). Megjithatë, gjatë analizimit të transkriptit të seancës së Kuvendit të mbajtur më 29 tetor 2010, vërejmë se gjatë “Shqyrtimit të dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës”, rezultonte se në kuader të amendamenteve, dy prej tyre kanë ngjallur debat parlamentar. Ato kanë të bëjnë me “pragun zgjedhor” (ulja e pragut nga 5% në 3% dhe , ku propozohet që “pragu zgjedhor të jetë 3% për subjektet politike” dhe “1% për kandidatët e pavarur”) dhe “votimin preferencial” (votimi preferencial brenda listës deri “për 10 kandidatë” siq ka qenë në rregulloren e UNMIK

2007/26 apo në zgjedhjet e vitit 2007). Megjithatë, propozimi për “uljen e pragut nga 5% në 3%” është çështja me e diskutuar në seancën e Kuvendit. Ky amandament nuk është përkrahur nga shumica e deputetëve (prej 82 votave që votuan amandamentin 61 vota ishin “kundër”, 14 vota “për” dhe 7 abstenime). Sidoqoftë, Kuvendi pas debatit “pro dhe kundër uljes së pragut dhe vendosjes së numrit të preferencës”, e miratoi me 81 vota “për”, 1 abstenim, 2 “kundër”, Ligjin Nr. 03/L-256 për “Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës” (Kuvendi, 2010, Transkript i 29 tetorit 2010: 11-23).

Në ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-073, është ndryshuar neni 110.4 i cili ndalon që votuesit të votojnë më shumë se “një kandidat” nga lista e kandidatëve është zëvendësuar me dispozitat e Neni 7 të Ligji nr. 03/L-256, që lejon mundësinë e votuesit “të shënojë atë me vota për deri në pesë kandidatë nga lista e subjektit politik për të cilin ka votuar”... Më fjalë të tjera, me ndryshimin e ligjit është rikthyer preferenca në listat e votimit ose lënien e mundësisë që votuesi të votojë deri në “5 preferenca brenda listës” në zgjedhjet nacionale. Dispoza e neni 7 të ligjit të ndryshuar përcakton se :

“Votuesi pajiset me një fletëvotim të vetëm për zgjedhje dhe e shënjon atë me votën për një (1) subjekt politik, dhe mund që po ashtu të shënojë atë me vota për deri në pesë (5) kandidatë nga lista e subjektit politik për të cilin ka votuar votuesi” ... (Ligji nr. 03/L-256, Neni 7).

Megjithëse Kuvendi, përveç këtij ndryshimi të votës preferenciale, me këtë ligj, ka vazhduar me pragun zgjedhor të njëjtë prej 5 përqind. Në bazë të neni 111, të ligjit zgjedhor është specifikuar se kjo vlen vetëm për subjektet që përfaqësojnë komunitetin shumicë. Sipas ligjit ndarja e mandateve do të bëhet:

.. “në mesin e subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet e tjera joshumicë dhe në mesin e subjekteve politike të cilat nuk përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet joshumicë të cilat kanë fituar së paku pesë përqind (5%) nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme në zgjedhjet për Kuvend” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 111.2.a).

Të gjitha dispozitat e mësipërme të kornizës normativ për sistemin zgjedhor dhe specifikat e tij i kemi përmbledhur dhe prezantuar në tabelën e mëposhtme. Në fakt në kuadër të Tabelës 2 pasqyrohet sistemi zgjedhor në Kosovë i aplikuar nga viti 2001 deri në vitin 2017, me një përmbledhje të specifikave të sistemit, listat, votat për partinë, formula dhe pragu zgjedhore si dhe kuota etnike e gjinore dhe numri i mandateve në Kuvendin e Kosovës.

Tabela 2. Sistemi zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme (2001-2017)

Viti	Sistemi	Lista	Zonat	Vota	Formula	Pragu	Mandat	Kuota	
								Etnik	gjinor
2001	LPP	Mbyllur	Një	Partine	Sainte- Laguë	N-0	120	20	30%
2004	LPP	Mbyllur	Një	Partine	Sainte- Laguë	N-0	120	20	33%
2007	LPP	Hapur	Një	10 kand.	Sainte- Laguë	5%	120	20	30%
2010	LPP	Hapur	Një	5 kand.	Sainte- Laguë	5%	120	20	30%
2014	LPP	Hapur	Një	5 kand.	Sainte- Laguë	5%	120	20	30%
2017	LPP	Hapur	Një	5.kand	Sainte- Laguë	5%	120	20	30%

Burimi: UNMIK/ REG.2001/33; UNMIK/REG 2001/9; UNMIK/REG/2004/12; UNMIK/REG/2007/26; UNMIK: REG. NR. 2007/28, Ligji Nr. 03/L-073; Ligji nr. 03/l-256; Kushtetuta Neni 64 ,

Kur analizohet Tabela 2, vërejmë se aty është pasqyruar në mënyrë kronologjike sistemi zgjedhor i vendosur për zgjedhjet nacionale si dhe reformat⁴ elektorale dhe ligjore që janë bërë gjer më tani në Kosovë. Pastaj legjislacioni zgjedhor për zgjedhjet nacionale (UNMIK: REG.2001/33; UNMIK/Rreg. 2001/9; UNMIK/REG/2004/12; UNMIK/REG, Nr. 2007/26 për ndryshimin e Rreg. NR. 2004/12; UNMIK/REG/2007/28, Ligji Nr. 03/L-073, Ligji nr. 03/l-256) me dispozitat e saj ka normuar sistemin zgjedhor të përfaqësimit proporcional në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe krahas votimit për subjektin politik, votuesve iu është ofruar mundësia të votojnë kandidatin apo kandidatët e tyre të preferuar në fletëvotim

⁴ Shënim: Pjesë e veçantë për reformën zgjedhore është trajtuar nga autori Xhavit Shala “The challenges of reforming the electoral system in Kosovo” in “The Sixth International Congress on Social Sciences and Humanities” 2nd December, 2015 “Science of law” PP 227-235.

me listën e hapur, me tre përjashtime në zgjedhjet e vitit 2001, 2002 dhe 2004 që ishin me lista të mbyllura (shih: Tabelën 2 dhe 3). Ndërsa renditja përfundimtare e kandidatëve fitues është realizuar në bazë të renditjes nga shumësi i votave preferenciale për kandidatët, por gjithmonë duke e marrë parasysh përmbushjen e kuotës gjinore.

Në përgjithësi legjislacioni zgjedhor ka qenë gjithëpërfshirës për sa i përket ushtrimit të së drejtës së votës dhe mundësisë të votimit preferencial për subjektin dhe kandidatin e preferuar me përjashtim të zgjedhjeve nacionale të mbajtura në vitin 2001 dhe 2004.

Reformat elektorale në Kosovë zakonisht janë iniciuar pas mbajtjeve të zgjedhjeve për të evituar ndonjë krizë institucionale, për të përfituar kohë dhe ndryshimet në legjislacionin zgjedhor janë bërë “ditët e fundit para zgjedhjeve” të reja (Kuvendi 2010, Transkripti i dt.29 tetor :11-23) ose ka dështuar procesi reformues. Mirëpo, praktikat e mira për hartimin e legjislacionit kërkojnë që legjislacioni zgjedhor të miratohet përpara zgjedhjeve në mënyrë që pjesëmarrësit politikë dhe zgjedhësit të kenë kohë të mjaftueshme për t’u informuar rreth rregullave të proceseve zgjedhore. “Legjislacioni zgjedhor i miratuar minutën e fundit minon legjitimitetin e legjislacionit dhe pengon pjesëmarrësit politikë dhe zgjedhësit që të informohen në kohën e duhur për rregullat e proceseve zgjedhore (OSBE-ODIHR 2005:13), sepse zgjedhja e sistemit zgjedhor duhet të sigurojë standardet minimale për zgjedhje demokratike (OSBE-ODIHR 2005:17). Dhe kjo në fakt, një nga arsyt kryesore me interes në rritje për reformën e sistemit zgjedhor, siç thotë Douglas, “është rritja e perceptimit të lidhjes midis rregullave të votimit dhe nga problemet e shumta që po shfaqen në proceset zgjedhore” (Douglas, J.A, 2000:2).

Një iniciativë serioze për reformë është paraqitur në vitin 2011 duke shprehur në Memorandum Marrëveshjen midis Bexhet Pacollit, Isa Mustafës dhe Hashim Thaçit e kthyer në Rezolutë të Kuvendit të Kosovës të miratuar në mbledhjen e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 7 prill 2011, për reformë kushtetuese dhe zgjedhore. Në pikën tre të Rezolutës përcaktohet se Kuvendi: *“mbështet zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amendamentin e Kushtetutës..., Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe legjislacionit të ndërlidhur, që mes tjerash do të përkrahin krijimin e më shumë distrikteve zgjedhore në Kosovë”*... (Kuvendi 2011 Rezoluta Nr. 04 - R-02, pika 3).

Megjithatë ky konsensus, nuk dha ndonjë rezultat pozitiv për shkak të “mungesës së vullnetit politik” në veçanti për të bërë një reformë të plotë zgjedhore (Kuvendi 2014, Transkripti 30-31 janar, 138-157) dhe përfundon me ndryshime teknike. Megjithatë, është e domosdoshme të gjendet modeli më i përshtatshëm i sistemit zgjedhor në Kosovë, sepse ky sistem aktual edhe pas ndryshimit nga sistemi proporcional me lista të mbyllura në sistemin proporcional me lista të hapura kanë dalë në shesh sfida të tjera siç janë: menaxhimi i zgjedhjeve, numri i preferencave dhe përfaqësimi gjeografik si dhe shfaqja e abuzimeve gjatë procesit zgjedhor. Ndër kritikatat më të shpeshta që janë bërë ndaj procesit zgjedhor në përgjithësi dhe sistemit zgjedhor në veçanti janë: manipulimi i votës ose preferencës, votimi disa herë i një votuesi dhe ai familjar, listat e votuesve dhe mashtrimeve të raportuara në zgjedhje nga administruesit zgjedhor etj. (OSBE 2012: 4-8; Forumi 2015:7-25; IKD 2014: 8-30; DnV 2011: 12-33 & DnV2014:13-39).

Lidhur me këto çështje ka propozime për të ndryshuar sistemin zgjedhor, uljen e preferencave në një votë për partinë dhe kandidatin, ndryshimin nga “një zonë në atë me

shumë zona si prag më të ulët zgjedhor nga 5 përqind në 3 përqind” (Kuvendi, 2010, Transkript i 29 tetorit 2010: 11-23; INDEP 2012/02;8; IPOL 2012; 23-24 Shala, Xh. 2011). Gjate analizës krahasimore të legjislacionit zgjedhor të periudhës së administrimit ndërkombëtar të UNMIK-ut (UNMIK: REG.2001/33; UNMIK/Rreg. 2001/9; UNMIK/REG/2004/12; UNMIK/REG, Nr. 2007/26 për ndryshimin e Rreg. NR. 2004/12; UNMIK/REG/2007/28) dhe legjislacionit të ri zgjedhor të miratuar nga Kuvendi i Republikës (Ligji Nr. 03/L-073 dhe Ligji nr. 03/L-256 për ndryshimin e Ligji Nr. 03/L-073) për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës gjejmë ngjashmëritë dhe ndryshimet sa i përket “sistemit zgjedhor”, “zonës zgjedhore”, “kuotës gjinore dhe etnike” dhe vijmë në përfundim se legjislacioni zgjedhor gjatë kësaj periudhe ka pësuar ndryshime në vendosjen e “votës preferenciale” dhe uljes së ‘numrit të saj’ si dhe “pragut zgjedhor”.

3.3. Analizë kornizës ligjore për zgjedhjet lokale: Sistemi zgjedhor, listat dhe preferencat

Korniza ligjore që ka rregulluar organizimin e zgjedhjeve për institucionet e nivelit lokal janë rregullat ligjore të UNMIK-ut Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë dhe Ligjit Nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës e në mënyrë të veçantë dispozitat e rregulloreve UNMIK/REG Nr.2000/39; UNMIK/ REG/2002/11; UNMIK/RREG. Nr. 2007/27 Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë si dhe të Ligjit Nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës. Në bazë të këtyre akteve ligjore është zhvilluar demokracia elektorale për zgjedhjen e përfaqësuesve lokal dhe organeve të qeverisjes lokale. Që nga

zgjedhjet e para lokale (2000) e gjer më tani (2017) janë organizuar gjashtë palë zgjedhje për kuvendet komunale, duke përfshirë edhe katër cikle zgjedhore për zgjedhjen drejtpërdrejt të kryetarëve të komunave (KQZ 2017:11; KQZ/QNR 2017).

Në këto akte, përmes dispozitave të Neni 4 dhe 5 i UNMIK/REG Nr.2000/39; Neni 6.1-2 i UNMIK/ REG. Nr.2002/11; të Neni 5.4-5, Neni 6.4-5 dhe 7 i UNMIK/RREG. Nr. 2007/27 si dhe Neni 7.4-5 dhe neni 9.5 i Ligjit Nr. 03/L-072, është përcaktuar mënyra e zgjedhjes të organeve Komunale dhe “sistemi i përfaqësimit proporcional” me dy variantet e saj: të “përfaqësimit proporcional” me lista të “hapura” dhe të “mbyllura” për zgjedhjen e “asambleistëve” të Kuvendeve Komunale si dhe “sistemi mazhoritar dy raundesh” për zgjedhjen e drejteperdrejte të “Kryetarëve të Komunave” nga populli (UNMIK/REG Nr.2000/39, Neni 4.10; UNMIK/ REG/2002/11: Neni 6.1-2; UNMIK/RREG. Nr. 2007/27, Neni 5, 6 dhe 7; Ligji Nr. 03/L-072, Neni 7.4-5 dhe neni 9.5).

Zgjedhjet e para lokale janë organizuar (në vitin 2000), sipas rregullores UNMIK/REG. Nr. 2000/39 me të cilën është përcaktuar “sistemi zgjedhor” dhe “mënyra e zgjedhjes së përfaqësuesve komunalë”. Në fakt, neni 4 dhe 5 i kësaj rregulloreje ka normuar “sistemin e përfaqësimit proporcional”. Sipas kësaj rregulloreje: *“Zgjedhjet për kuvendet komunale do të zhvillohen sipas sistemit të përfaqësimit proporcional të bazuar në listat e kandidatëve të partive politike, iniciativave qytetare dhe koalicioneve dhe kandidatëve të pavarur të emëruar në fletëvotim”...* (UNMIK/REG.Nr.2000/39:Neni 4.10). Ndërsa “listat e hapura” për votim dhe mënyra e “ndarjes së vendeve për Kuvendet Komunale” është përcaktuar në Nenin 5 të rregullores së lartpërmendur.

Sipas këtij neni, qytetarët kanë mundësi të votojnë për subjektin politik dhe një kandidat brenda listës si vijon:

..Kandidatin e veçantë në kuadër të listës së kandidatëve të partisë politike, të koalicionit apo të iniciativës qytetare. Kur votuesi e ka shënuar në mënyrë të vlefshme një kandidat në listën e kandidatëve, konsiderohet se ajo listë ka marrë një votë të vlefshme për qëllim të ndarjes së vendeve.... Ndarja e vendeve ndërmjet kandidatëve nga lista e njëjtë do të bëhet së pari ndërmjet kandidatëve të asaj liste, të cilët individualisht kanë fituar vota të vlefshme, me ç'rast këto vende do t'iu jepen sipas radhës prej numrit më të madh të votave deri te numri më i vogël i votave. Nëse mbesin ende vende për t'u ndarë sipas listës dhe kandidatët që kanë mbetur janë kandidatë që nuk kanë fituar asnjë votë të vlefshme, atëherë ndarja e vendeve në mes të kandidatëve që kanë mbetur nga ajo listë do të bëhet sipas radhitjes së tyre në kuadër të saj.... (UNMIK/REG/Nr.2000/39:Neni 5.1.c).

Në bazë të interpretimit logjik të kësaj dispozite, vijmë në përfundim se qytetarët kanë pasur të drejtë të votojnë për subjektin politik dhe një kandidat brenda listës dhe vendet në Kuvend janë ndarë sipas fuqisë së votës për partinë politike dhe votës brenda listës partiake që ka siguruar kandidati në mënyrë të veçantë si dhe duke respektuar kuotën gjinore. Sipas këtij modeli zgjedhor janë organizuar edhe zgjedhjet e dyta lokale (në vitin 2002) por me një ndryshim tek lista e votimit. Ky ndryshim është normuar me Nenin 6 të rregullores së UNMIK/REG/nr. 2002/11 mbi zgjedhjet Komunale në Kosovë duke vendosur që mbyllja e listave dhe mënyra e votimit të realizohet vetëm për njërën nga subjektet politike. Në bazë të kësaj dispozite qytetarëve me të drejtë vote u sigurohet mundësia që të votojnë njërën nga subjektet e certifikuar në procesin zgjedhor.

Sipas këtij rregulli ata mund:

....“të votojnë për njërën nga subjektet e certifikuar politike”... Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme të fituara nga çdo subjekt i certifikuar politik duhet të pjesëtohet me 1, 3, 5, 7, 9, 11 dhe të tjerët që pasojnë, derisa numri i votave të pjesëtuar në këtë mënyrë të japë koeficientët e kualifikuar që korrespondojnë me numrin e përgjithshëm të vendeve në kuvendin komunal” UNMIK/REG/2002/11: neni 6.1-2)

Në bazë të kësaj dispozite ndarja e vendeve në kuvendin komunal korrespondon me fuqinë e votës politike që kanë siguruar subjektet në garën zgjedhore dhe radhitjes së kandidatëve brenda listës partiake.

Në kuadër të reformës elektorale të vitit 2007, përveç sistemit elektoral u përfshi edhe qeverisja lokale. Në kuadër të reformës elektorale është rivendosur votimi preferencial me “listë të hapur” si dhe është vendosur modeli mazhoritar dy raundesh për zgjedhjen e kryetarit të Komunës. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores Nr. 2007/27 “Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë” është përcaktuar se votuesit kanë të drejtë të votojnë një subjekt politik si dhe dhjetë kandidatë brenda listës së kandidatëve. Në bazë të kësaj rregulloreje:

“Votuesi voton vetëm për kandidatët e një (1) subjekti politik të certifikuar që janë në listën zyrtare të kandidatëve.”... “Votuesit mund të votojnë deri dhjetë (10) kandidatë brenda listës së njëjtë të kandidatëve të subjektit politik. Nëse në fletëvotim shënohen më shumë se dhjetë (10) kandidatë, do të numërohen vetëm dhjetë (10) kandidatët e parë. Votat e hedhura për kandidatët e listës nga i njëjti subjekt politik një fletëvotim konsiderohet se përbën një (1) votë për subjektin politik të cilit i përket lista e kandidatëve, pavarësisht nga numri i kandidatëve të shënuar”. ... (UNMIK/RREG. Nr. 2007/27, neni 5.4-5)

Megjithatë Kuvendi i Kosovës me miratimin e Ligjit “Për Zgjedhjet Lokale në Kosovë” ka shfuqizuar Rregulloren Nr. 2007/ 27 dhe njëkohësisht ka hequr mundësinë e votimit me preferenca brenda listës si dhe është pamundësuar votimi për të parin e listës ose bartësin e saj. Sipas dispozitave të këtij ligji të gjitha votat për listën e caktuar i faturohen automatikisht bartësit të listës. Qytetari konform dispozitës Neni 7 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, ka mundësi që të votojë subjektin dhe një kandidat të preferuar nga lista partiake.

Sipas kësaj dispozite ligjore :

“...votuesi voton një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votoj për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik, Nëse në fletëvotim janë shënuar më shumë se një (1) kandidat, vetëm vota për subjektin politik llogaritet”... Vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të subjektit politik. KQZ-ja siguron që fletëvotimi nuk e lejon votuesin të votojë njëkohësisht për subjektin politik dhe për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të këtij subjekti politik (Ligji Nr. 03/L-072, Neni 7.4-5)

Sipas interpretimit logjik kjo dispozitë ligjore e fuqizon parimin një qytetar një votë, por njëkohësisht e diskriminon pozitivisht kandidatin e parë apo bartësin e listës të subjektit politik në krahasim me kandidatët e tjerë brendapartiakë. Përveç privilegjit si kandidat i parë apo bartës i listës, ai konsideron në mënyrë automatike të gjitha votat e subjektit politik si votë të tij. Për të rivendosur parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në garën elektorale, rekomandohet që të ndryshohet kjo dispozitë ligjore Neni 7.5 (Ligji Nr. 03/L-072) dhe propozohet të vendoset si vijon: votuesi voton një subjekt politik dhe mund të votojë për një kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik. KQZ-ja siguron që fletëvotimi i lejon votuesin të votojë njëkohësisht për subjektin politik dhe për kandidatin në listën e kandidatëve të këtij subjekti politik. Nëse në fletëvotim është shënuar vetëm votë për partinë apo janë shënuar më shumë se një kandidat, llogaritet vetëm vota për subjektin politik. Vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatet gra në listën e kandidatëve të subjektit politik.

Në kuadër të analizës së legjislacionit zgjedhor të periudhës së administrimit ndërkombëtar të UNMIK-ut (UNMIK/REG/2000/39; UNMIK/REG/2002/11; UNMIK/ RREG. Nr. 2007/27); si dhe legjislacionin e ri zgjedhor të miratuar nga Kuvendi i Republikës (Ligji Nr. 03/L-072) për Zgjedhjet Lokale në Kosovë dhe kur i krahasojmë ato, gjejmë ngjashmëritë dhe ndryshimet sa i përket sistemit zgjedhor, zonës zgjedhore, kuotës gjinore dhe etnike dhe vijmë në përfundim se legjislacioni zgjedhor gjatë kësaj periudhe ka pësuar ndryshime në vendosjen e votës preferenciale si dhe uljes së numrit të saj. Ndërsa, çështjet e tjera si sistemi zgjedhor (LPP) me lista të hapura dhe me një zonë zgjedhore ka mbetur i njëjtë. Ky model zgjedhor vazhdon të jetë në fuqi. Në Tabelën 3 është pasqyruar Sistemi

Zgjedhor i aplikuar në zgjedhjet lokale për pushtetin lokal ose për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendeve të Komunave. Aty janë përfshirë formula zgjedhore, zonat, listat zgjedhore, vota për kandidatin apo partinë si dhe pragun zgjedhor dhe kuotën gjinore.

Tabela 3. Sistemi zgjedhor për zgjedhjet lokale (2000-2017)

Viti	Sistemi	Formula e nd. Mandateve	Zonat ⁵	Lista e kand.	Vota për	Pragu	Kuotat gjinor
2000	LPP	Koefic. më i lartë (Sainte- Laguë)	30	Hapur	1 kand	N-0	30%
2002	LPP	Sainte- Laguë	30	Mbyllur	Partine	N-0	30%
2007	LPP	Sainte- Laguë	30	Hapur	1 kand.	N-0	30%
2009	LPP	Sainte- Laguë	36	Hapur	1 kand.	N-0	30%
2013	LPP	Sainte- Laguë	38	Hapur	1 kand.	N-0	30%
2017	LPP	Sainte-Lague	38	Hapur	1 kand	N-0	30%

Burimi UNMIK/REG Nr. 2000/39 Neni 4.2; UNMIK/REG/2002/11: neni 6.1-2; UNMIK/RREG. Nr. 2007/27, neni 5.4-5; Ligji Nr. 03/L-072, Neni 7.4-5, Neni 8.4 KQZ 2015:17-18 dhe KQZ/QNR 2017

Gjithashtu, reformat elektorale për pushtetin lokal dhe qeverisjes lokale⁶ në Kosovë është paraqitur në Tabelën 3. Ajo pasqyron ndryshimet e bëra në sistemin për zgjedhjet lokale që ndërlidhet me listat zgjedhore, duke bërë eksperimente nga listat e hapura dhe të mbyllura dhe anasjelltas si dhe me zgjedhjen e kryetarit të Komunës. Reforma e legjislacionit zgjedhor së pari është ndryshuar me rregulloren e UNMIK-ut, nr.2007/27 dhe Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, duke përcaktuar sistemin zgjedhor dhe procedurat për zgjedhjet lokale dhe të kryetarëve të komunave drejtpërsëdrejti nga populli. Në bazë të nenit 9 të këtij legjislacioni është përcaktuar që kandidatët për kryetarë të

⁵ Shënim: Zona zgjedhore në zgjedhjet lokale janë komunat e Kosovës.

⁶ Shënim: UNMIK përmes RREGULLORES NR. 2006/54 ka shtyrë zgjedhjet lokale të cilat është dashur të mbahen në vitin 2006. Kjo Rregullore ka përcaktuar se “Mandati i parë i delegatëve të kuvendeve komunale do të jetë dy vjet. Mandej çdo mandat i delegatëve të kuvendeve komunale do të jetë katër vjet, i cili përjashtimisht mund të vazhdohet nga PSSP-ja për shkak të arsyeve mbizotëruese politike, pas konsultimeve me udhëheqësit e IPVQ-ve dhe subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës”. (UNMIK/REG/2006/54, Neni 1)

komunës të zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Konsiderohet që një kandidat ka fituar zgjedhjet nëse ai siguron mbi 50% të votave të përgjithshme që janë hedhur në kuti.

Sipas Ligjit:

...”Kandidati zgjidhet kryetar i komunës nëse ai fiton mbi 50% dhe një nga votat e përgjithshme valide të hedhura në atë komunë. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk fiton mbi 50% dhe një nga numri i përgjithshëm i votave valide të hedhura në atë komunë, organizohen zgjedhjet e dyta nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmjet dy kandidatëve të parë të cilët kanë fituar më së shumti vota valide” (UNMIK/REG. Nr. 2007/27neni 7.4; Ligji Nr. 03/L-072, neni 9.5)

Sipas dispozitave të legjislacionit zgjedhor në fuqi, në veçanti Neni 9 i Ligji Nr. 03/L-072 që rregullon mënyrën e zgjedhjes të kryetarëve të komunave është vendosur “sistemi mazhoritar dy raundesh”. Proceset elektorale sipas këtij modeli janë prezantuar nëpërmes Tabelës 4, duke paraqitur sistemin zgjedhor mazhoritar dy raundesh i zbatuar që nga viti 2007 gjer më sot (2017) për zgjedhjen e kryetarit të komunës në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët e saj.

Tabela 4. Sistemi zgjedhor për zgjedhjen e Kryetarit të Komunës (2007-2017)

Viti	Sistemi	Formula	Zona ⁷	Vota
2007	Mazhoritar	Dy raundesh	30	Një kandidate
2009	Mazhoritar	Dy raundesh	37	Një kandidate
2013	Mazhoritar	Dy raundesh	38	Një kandidate
2017	Mazhoritar	Dy raundesh	38	Një kandidate

Burimi: UNMIK/REG. Nr. 2007/27neni 7.4; Ligji Nr. 03/L-072, neni 9.5; KQZ/QNR2007- 2017

Gjithashtu në kuadër të Tabelës 4 është prezantuar kalendari zgjedhor për zgjedhjet e Kryetarit të Komunave, formulën dhe zonat zgjedhore si dhe votën për një kandidat. Për më tepër ky model zgjedhor, tashmë ka krijuar një traditë elektorale dhjetë vjeçar dhe kjo formulë nuk është e panjohur për qytetarët e Kosovës. Në veçanti, sistemi mazhoritar dy

⁷ Shënim: Komunat e reja Partesh dhe Mitrovica e Veriut, ose / Zona 37 dhe 38 zgjedhore në zgjedhjet komunale për kryetar komune, u formuan pas zgjedhjeve të vitit 2009.

raundesh ka mundësuar menaxhimin e votës në balotazh dhe ka dhënë efektet e saj në disa raste për kandidat për Kryetar Komune të cilët në raundin e parë nuk kanë siguruar një shumicë absolute të votave. Në fakt, në zgjedhjet për kryetar të Prishtinës në vitin 2013, asnjeri kandidat nuk i mori 51% e votave. P.sh. kandidati A ka marr 42.75% të votave, kandidati B 31.89%, kandidati C 10.91% , kandidati D 6.26% dhe kandidati E 4.38%. Por, sipas ligjit për zgjedhjet lokale, kërkohet një shumicë absolute për të fituar postin e Kryetarit, dhe kur nuk sigurohen këto rezultate, është e domosdoshme të organizohet balotazhi ndërmjet dy kandidatëve me vota më të larta në mënyrë që të nxjerrin një fitues. Në rezultatin e mësipërm, shumica e mbështetësve të kandidatit C, D, votuan për kandidatin B në balotazhin e zgjedhjeve, atëherë B ishte fituesi e jo kandidati A. Sipas rregullave ligjore, kandidati fitues është kandidati me më shumë vota (KQZ- QNR 2013). Ky rast është përsëritur edhe në zgjedhjet e vitit 2017 në Komunën e Prizrenit (KQZ/QNR 2017). Kjo në një mënyrë ia mundëson qytetarit të reflektojë në raundin e dytë në rast se gjatë raundit të parë ka votuar në presion ose hamendje.

Në përgjithësi, të gjitha proceset zgjedhore për dy nivelet e pushtetit, e në veçanti ato pas pavarësisë (2009-2017) kanë rezultuar me “vlerësime pozitive dhe negative” nga vëzhgues të ndryshëm, aktorët pjesëmarrës në zgjedhje dhe shoqëria civile për zgjedhjet dhe sistemin zgjedhor (EU EOM 2014:4; EU EOM 2017; Komisioni Evropian, Raport i progresit për Kosovën për vitet *KE 2010:7; KE 2011:6; KE-2012:7;... KE 2013:8;...KE 2014:6; KE 2016:6 KIPRED 2011/7;4-5; IPOL 2012:8-9*).

Përveç vlerësimeve për procesin dhe sistemin zgjedhor janë dhënë edhe rekomandime për Kosovën për “reformë të kornizës ligjore zgjedhore” për t’i përmbushur standardet demokratike për zgjedhje të lira. Reforma e kornizës ligjore është emëruesi i përbashkët

Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM), mbi Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë (EU EOM 2014:26; EU EOM 2017: 35) dhe Komisionit Evropian (K-E) të prezantuara në raportet e progresit (KE 2010:7; KE 2011:6); KE-2012:7;... KE 2013:8;..KE 2015:6; KE 2016:6) ku rekomandohet që:

... “Të metat e sistemit zgjedhor duhet të adresohen dhe duhet të forcohet roli i Kuvendit në shqyrtimin e legjislacionit për të siguruar cilësi” (KE 2010:7) ... “Ka pasur mangësi serioze në procesin e zgjedhjeve të përgjithshme. Kosova duhet të bëjë hapa urgjentë për adresimin e këtyre, duke thjeshtuar sistemin, duke e bërë më transparent, si dhe duke hetuar e përndjekur rastet e mashtrimeve zgjedhore (KE 2011:6)...”; Zgjedhjet e fundit të përgjithshme të mbajtura më 2010/2011 janë karakterizuar me mangësi serioze dhe vështirësi teknike. Kosova duhet të sigurohet që korniza ligjore përmirësohet që të pasqyrojë praktikën dhe standardet më të mira të BE-së që dalin nga një marrëveshje e tillë”(KE-2012:7;... “Kuvendi dhe institucionet e tij duhet të fokusohen në prioritetet e identifikuara në studimin e fizibilitetit, posaçërisht sa i përket reformës zgjedhore”(KE 2013:8);... Kosova organizoi zgjedhje të suksesshme të përgjithshme dhe lokale. Procesi zgjedhor në të dy rastet është përmirësuar në krahasim me zgjedhjet e mëparshme. Kosova ende ka nevojë për një reformë të plotë zgjedhore për të adresuar rekomandimet nga misionet dhe ekspertët për vëzhgimin e zgjedhjeve ... Kuvendi i Kosovës mbetet të miratojë reformën zgjedhore e cila është vonuar (KE 2014-2015:6);... Kuadri zgjedhor i Kosovës është në përputhje me standardet ndërkombëtare, megjithatë reforma zgjedhor e udhëhequr nga Komisioni i Venecias, mbetet e nevojshme (KE 2016:6).

Në përmbushjen e këtyre rekomandimeve është e domosdoshme arritja e një konsensusi politik të të gjitha forcave politike qofshin ato në pozitë apo opozitë parlamentare jo parlamentare, shoqërisë civile si dhe mekanizmave të tjerë institucionale.

3.4. ANALIZË DISPOZITAVE LIGJORE PËR MENAXHIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR DHE DREJTËSISË ZGJEDHORE NË KOSOVË

3.4.1. Menaxhimi i Procesit Zgjedhor në Kosovë

Qeverisja dhe administrimi i procesit zgjedhor⁸ ka të bëjë me infrastrukturën administrative që kërkohet për të mbështetur procesin demokratik të zgjedhjeve. Zgjedhjet e suksesshme nuk realizohen pa përgatitje dhe organizim të tyre. Menaxhimi i zgjedhjeve ka të bëjë me përzgjedhjen e sistemit të duhur për rrethana të caktuara politike, ekonomike, kulturore dhe demokratike të shoqërisë. Pas “dekretimit të shpalljes së zgjedhjeve” lokale apo nacionale nga Presidenti i Republikës konform Nenit 84 i Kushtetutës dhe Neni 4 i Ligjit Nr. 03/L-256, i gjithë procesi i menaxhimit të zgjedhjeve apo administrimi i procesit zgjedhor fokusohet tek Komisioni Qendror i zgjedhjeve. Gjatë procesit zgjedhor, KQZ-ja vendoset në epiqendër të vëmendjes publike në periudhën paraelektorale, elektorale dhe pas elektorale. Ndërsa pas përfundimit të procesit zgjedhor, ajo mbetet jashtë vëmendjes, derisa nuk flitet për zgjedhje të reja. Mirëpo, gjatë kohës kur debati publik për zgjedhje është më i ulët, aktorët përgjegjës (Kuvendi, KQZ, etj.) duhen të koordinohen për ta përmirësuar procesin e ri zgjedhor dhe për të siguruar që administrata zgjedhore të jetë e aftë kurdoherë që është e nevojshme për zgjedhje të reja. Lidhur me këtë Guy Goodwin-Gill argumenton se për zgjedhje të drejta dhe të lira administrimi i një procesi elektoral të pavarur dhe të paanshëm është esencial (Guy Goodwin-Gill 1994:46).

⁸ Shënim: Pjesë të veçanta të menaxhimit të procesit zgjedhor janë trajtuar nga autori Xhavit Shala (2015) “Electoral Process Management In Kosovo” in the “International Journal of Academic Research and Reflection” Vol. 3, No. 7, 2015, PP 29-34.

Sa i përket menaxhimit dhe administrimit të procesit zgjedhor, ekzistojnë tri modele të vendosjes institucionale në komisionet më të larta zgjedhore: Komisioni i pavarur; qeveritar; dhe i kombinuar (IDEA 2014:6). Kosova bën pjesë në grupin e vendeve që kanë të aplikuar një model të institucionit të pavarur për organizimin dhe menaxhimin e procesit zgjedhor. Ky model për herë të parë në Kosovë është vendosur me Rregulloren e UNMIK-ut, Nr. 2000/21 për Themelimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si organ i “pavarur, i paanshëm” dhe “përgjegjës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë”. (UNMIK/RREG/2000/21, Neni 1, Neni 4; UNMIK/REG/2000/65 Neni 1, Neni 4).

Pas Pavaresisë së Kosovës përveç Kushtetutës, e cila të Neni 139 i saj përcakton se *“Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, referendumet dhe shpall rezultatet e tyre”*. Edhe ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Nenin 64 përcakton *“përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ-së”*, të cilat janë:

“përgatit dhe shpall rregullat, format dhe procedurat zgjedhore dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencës së saj; publikon të gjitha rregullat e miratuara, rregullat, udhëzimet dhe procedurat zgjedhore; krijon dhe mban listën e personave që kanë të drejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta; mban Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikimin e Partive Politike; përpilon dhe miraton fletëvotimet dhe materialet e tjera zgjedhore; akrediton vëzhguesit zyrtarë të zgjedhjeve; certifikon listën votuese lidhur me zgjedhjet; certifikon rezultatet e zgjedhjeve; publikon rezultatet e zgjedhjeve; themelon komisionet komunale të zgjedhjeve dhe këshillat e vendvotimeve; cakton ekipet e numërimit për çdo këshill të vendvotimit për aq sa garantojnë rrethanat (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 64).

Gjithashtu, sipas Neni 59 është në mandatin e KQZ-ës, *“vetëdijësimi”* i qytetarëve për pjesëmarrjen në zgjedhje si dhe rekomandimi për avancimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 59). Në kuadër të vetëdijësimit apo edukimit dhe informimit zgjedhor të qytetarëve KQZ-ja përmes materialeve reklamuese të veçanta: si spote e reklama në media të shkruara dhe elektronike, fletëpalosje dhe postera,

paraqet të gjitha hapat që duhet të ndiqen nga votuesit, në veçanti votuesit e ri për mënyrën e votimit dhe që mbarëvajtja e procesit zgjedhor të jetë sa më e qartë dhe e lehtë, dhe që vota e tyre të konsiderohet e vlefshme.

Neni 139 i Kushtetutës dhe Neni 64 i ligji zgjedhor (Ligji Nr. 03/L-073), ia njeh Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të drejtën ekskluzive të administrimit, mbikëqyrjes për të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve si dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve në Kosovë. Përveç menaxhimit, KQZ njëkohësisht kontrollon procesin zgjedhor dhe para zgjedhor duke siguruar mbarëvajtjen e plotë të tyre në përputhje me ligjin dhe rregullat e saj zgjedhore. Është në mandatin e saj ligjor detyrimi për realizimin e zgjedhjeve të drejta, të lira dhe demokratike, si dhe për sigurimin dhe mbrojtjen e fshehtësisë së votës.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore në përgjithësi, dhe në veçanti të Neni 139 i Kushtetutës dhe Neni 61, Neni 67 dhe Neni 74 i Ligjit Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të themi se administrimi zgjedhor në Kosovë kalon nëpër tre-nivele: “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”, “Komisionet komunale të zgjedhjeve” si dhe “Këshillat e vendvotimeve” (Kushtetuta, Neni 139; Ligji Nr. 03/L-073, Neni 61, Neni 67; Neni 74).

3.4.1.1. Përbërja e strukturave të administrimit të procesit zgjedhor

Institucioni kryesor i cili menaxhon të gjithë procesin zgjedhor në Republikën e Kosovës është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). KQZ është “organi i pavarur, i përhershëm” dhe me mandat Kushtetues për “administrimin e zgjedhjeve” në përputhje me rregullat e

përcaktuara në Ligjin Zgjedhor (Kushtetuta, Neni 139; Ligji Nr. 03/L-073, Neni 59 dhe Neni 64). Në administrimin e zgjedhjeve përfshihen struktura dhe përbërja e administratës zgjedhore dhe organizimi i zgjedhjeve në Kosovë. Në kuadër të Nenit 139 të Kushtetutës është përcaktuar “struktura dhe mandati i KQZ-së”.

Në analizën e kësaj dispozite vijmë në konkludim së Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Republikën e Kosovës përbëhet nga dy lloj anëtarësh:

- a. anëtarët politik që propozohen nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvend dhe të dekretuar nga Presidenti i Kosovës si dhe
- b. anëtari jo politik apo drejtuesi i KQZ-së që vjen nga sistemi i drejtësisë apo Gjykata Supreme i përzgjedhur dhe dekretuar nga Presidenti i Kosovës.

Në bazë të dispozitës të nenit 139 të Kushtetutës, Komisioni *“përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë”* (Kushtetuta, Neni 139), “dhjetë” nga “njëmbëdhjetë anëtarët”, propozohen nga “subjektet politike” të përfaqësuara në Kuvend si dhe Kryetari i saj që vjen nga “sistemi i drejtësisë”. Prej tyre, “gjashtë anëtarë” propozohen nga “gjashtë grupe më të mëdha parlamentare” në Kuvend të përfaqësuara nga shqiptarët. Kur në Kuvend janë më pak se gjashtë grupe parlamentare, një anëtar shtesë i takon grupit më të madh. Ndërsa “katër anëtarë” propozohen nga “përfaqësuesit e pakicave”. “Një anëtar” propozohet nga deputetët e “komunitetit serb” dhe “tre anëtarë” nga deputetët të cilët mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera. “Kryetarin e Komisionit” e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës konform Nenit 84.26 dhe Nenit 139.3 i Kushtetutës “nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme” (Kushtetuta, Neni 84.26 dhe Neni 139). Përveç kryetarit edhe “anëtarët” e

Komisionit emërohen nga Presidenti sipas Nenit 139.2-3 i Kushtetutës pas nominimit nga grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarit(ve) të tyre në Komision. Ndërsa mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të KQZ-së është i përcaktuar me ligj. Sipas Nenit 61 i ligjit zgjedhor “mandati i Kryetarit” të KQZ-së është “shtatë vjet” duke filluar nga data e emërimit nga Presidenti i Kosovës. Ndërsa, “mandati i anëtarëve” të KQZ-së sipas Nenit 61 i Ligjit Nr. 03/L-073, fillon jo më vonë se “gjashtëdhjetë ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 61).

Gjithashtu, përmes Nenit 68 të këtij Ligji janë përcaktuar “përgjegjësitë”, “përbërja” dhe “mënyra e zgjedhjes” së “Komisionit Komunal të Zgjedhjeve” (KKZ). Ata janë trupa që themelohen nga KQZ-ja nëpër komuna për të ndihmuar organizimin e procesit zgjedhor. Është nën “përgjegjësinë” e KKZ të “administrojnë zgjedhjet përbrenda komunës” së tyre, gjithmonë të “mbikëqyrura” nga KQZ-ja për “të garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet gjatë procesit zgjedhor” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 68). Sipas ligjit, çdo KKZ kryesohet nga “Zyrtari Ekzekutiv” (shërbyes civil i KQZ-s) dhe nga “një anëtar i nominuar nga subjektet politike” që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse ato i nënshtrohen pragut zgjedhor. Në përgjithësi ligji me dispozitën e Nenit 67, ka përcaktuar se KKZ-t të “përbëhen nga shtatë anëtarë”, dhe ky numër mund të “rritet” vetëm nëse “numri i subjekteve politike” që kanë kaluar “pragun” “kualifikohen” për të qenë “pjesë e komisionit”, atëherë ky numër është më i madh (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 67).

Procesi i konsolidimit të strukturave për administrimin e procesit zgjedhor shkon më tutje deri me emërimet e Këshillave të Vendvotimeve (KKV). Ato reflektojnë strukturën e anëtarëve të KKZ-së. Megjithatë, është në përgjegjësinë e KKZ-së që në raste të veçanta, ta

shtojë numrin e anëtarëve KKV dhe për këtë duhet të njoftojë KQZ-në. Kjo sipas Nenit 74 dhe 76 i ligjit, çdo KVV miratohet nga KQZ-ja dhe udhëhiqet nga Kryesuesi i saj (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 74; Neni 76). Gjithashtu, në bazë të nenit 74 pika 10 i ligjit, KVV është “përgjegjëse” për “sigurimin e integritetit”, në procesin e votimit dhe “numërimit në Vendvotim” nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga KQZ-ja (Ligji Nr. 03/L-073, neni 74, pika 10).

Megjithatë menaxhimi i procesit zgjedhor në Kosovë sipas Ligjit Zgjedhor udhëhiqet nga KQZ dhe strukturat e saj siç është SKQZ. Sekretariati është një trupë teknike, themeluar nga KQZ-ja për të ndihmuar atë në kryerjen e përgjegjësiave dhe funksioneve të saj. Në dispozitat e Nenit 65, Neni 66 të Ligjit Zgjedhor, përcaktohet se Sekretariati “drejtohet” nga “Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zëvendësi” i tij të cilët i përgjigjen drejtpërdrejt themeluesit të saj. Në kuadër të strukturave të Sekretariatit funksionin “Qendra e Numërimit dhe Rezultateve” e cila sipas Nenit 2 i Rreg/ Nr. 06/2013 të KQZ-së “pranon të gjitha rezultatet dhe materialet e tjera zgjedhore për t’u verifikuar, hetuar dhe audituar” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 65-66; KQZ: Rreg/ Nr. 06/2013, Neni 2). Ndërsa për punën dhe veprimtarinë e saj, KQZ sipas Nenit 63.10 i ligjit është e obliguar që në “baza vjetore të raportoje në Kuvendin e Kosovës” (Ligji Nr. 03/L073, Neni 63.10). Për periudhën dhjetëvjeçare, KQZ-ja ka raportuar para Kuvendit, 8 herë, nga viti 2009 deri 2016 (KQZ 2009-2016).

Gjatë kohës së administrimit ndërkombëtar të UNMIK-ut nga viti 2000-2008, zgjedhjet prej vitit 2000-2004 janë organizuar dhe mbikëqyrur nga OSBE-ja, Misioni në Kosovë⁹

⁹ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSCE) ka organizuar katër herë zgjedhje nga viti 2000 deri në vitin 2004 dhe ka ndihmuar në themelimin e dy institucioneve zgjedhore – Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Sekretariatin e tij. <http://www.osce.org/sq/kosovo/118214> (klikuar më 19.09.2015)

(OSBE 2008), ndërsa ato të vitit 2007 si dhe ato pas Pavarësisë (deri 2017), janë organizuar dhe menaxhuar nga KQZ dhe janë vëzhguar nga mekanizmat ndërkombëtare (ambasadat) prezentë në Kosovë si dhe organizata të specializuara vendore dhe ndërkombëtare (OSBE, ENEMO, EU EOM), si vëzhgues gjatë procesit zgjedhor.

Në raportet vlerësues të ENEMO-thuhet se:

“Në përgjithësi administrimi i zgjedhjeve, është vlerësuar nga vëzhgues të ndryshëm. Sipas ENEMO zgjedhjet janë .. menaxhuar në mënyrë të kënaqshme në të gjitha aspektet teknike të procesit zgjedhor me materialet e rëndësishme dhe të ndjeshme, në kohën e duhur. Por, puna e KQZ-së është ndikuar nga përkatësia partiake e anëtarëve të Komisionit” (ENEMO 2011:1)

Gjithashtu sipas vlerësimeve të ENEMO-s, “KQZ e ka kryer punën në mënyrë profesionale në pjesën më të madhe të aktiviteteve zgjedhore” (ENEMO 2013:2), ndërsa për Misionin e Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM) Parlamentare të mbajtura më 8 qershor 2014 në Kosovë vlerëson se: ... *“Të gjitha nivelet e administratës së zgjedhjeve kanë kryer punën e tyre në mënyrë transparente... Sidoqoftë, disa nga vonesat në marrjen e vendimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve nga KQZ nuk kanë rritur besimin e publikut në punën e saj” (EU EOM 2014:8-9.).*

Si përfundim, për të siguruar zgjedhje të lira dhe të ndershme sipas standardeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare është e domosdoshme të rishqyrtohet mënyra e propozimit, zgjedhjes dhe përbërjes së anëtarëve¹⁰ të KQZ-së si dhe të ulet numri i anëtarëve nga 11 në

¹⁰ Shenim: Edhe një argument shtesë për domosdoshmërinë e reformimit të KQZ-së, janë edhe zhvillimet politike pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017, konfigurimit politik të grupeve parlamentare në Kuvend. Në fillim të legjislaturës ishin tri grupime parlamentare si PAN-i, LAA dhe LVV duke u bazuar në rezultatit zgjedhor (KQZ/QNR 2017). Pas formimit të institucioneve, nga PAN-i krijohen tri grup parlamentare, më pas nga LVV krijohen dy grupe parlamentare. Si pasojë e kësaj ndarje dhe krijimit të grupeve të reja parlamentare, Presidentin e Republikës e kanë vënë në dilemë se a duhet emëruar nga dy përfaqësues nga tri grupet apo nga një anëtar nga të gjitha grupimet parlamentare. Megjithatë, për ti zgjidhur këto dilema, Presidenti i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për sqarim dhe për të shmangur çdo dilemë se nga “cilat grupe parlamentare duhet të emërohen anëtarët e KQZ-së” (Gjykata Kushtetuese 2018: rasti Nr.K079/18) . E sipas Neni 61 i ligjit zgjedhor që përcakton afatin prej 60 ditëve pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve dhe me nominim

9 anëtarë. Nga nëntë anëtarët e saj gjashtë të vijnë nga komuniteti shumicë dhe, tre të zgjidhen nga komunitetet minoritare në Kosovë. Kryetarin e KQZ e zgjedh Kuvendi me mandat shtatëvjeçar ndërsa mandati i anëtarëve është gjashtëvjeçar. Zgjedhja e tyre të bëhet pas shpalljes publike, të zgjidhen nga Kuvendi dhe të dekretohen nga Presidenti i Kosovës. Zgjedhja e anëtarëve të KQZ të bëhet me 2/3 e votave të deputetëve prezentë në seancë si dhe 2/3 e deputetëve të komuniteteve minoritare në Kuvend (në mënyrë të njëjtë sikurse anëtarët e Gjykatës Kushtetuese). Anëtarët e KQZ duhen të jenë profesional e jo zyrtarë drejtues (politik) të partive politike. Kjo kontribuon në ngritjen dhe forcimin e integritetit të KQZ-së në të gjitha proceset si dhe në vendimmarrjen përmes largimit të ndikimit të partive politike mbi punën e saj. Gjithashtu, edhe anëtarët e KKZ dhe KVV të jenë profesional dhe jo politik apo partiak. Mandati i tyre përfundon me përmbylljen e procesit zgjedhor. KQZ përzgjedh kandidatët sa më profesional për administrimin e procesit zgjedhor. Ata zgjidhen përmes shpalljes publike nga KQZ-ja e jo përmes propozimeve të subjekteve për personat që ata dëshirojnë t'i emërojnë anëtarë të KVV-ve. Ndërsa përfaqësuesit e subjekteve politike rekomandohen të jenë vetëm vëzhgues në procesin zgjedhor. Kjo është mënyra më e mirë për të depolitizuar procesin zgjedhor në Kosovë. Pas reformimit të KQZ dhe depolitizimit apo departiakizimit të saj dhe rritjes së integritetit dhe besimit ndaj KQZ, ajo mund të jetë shkalla e parë e vlerësimit të shkeljes ose abuzimit të procesit zgjedhor dhe më pastaj, palët e pakënaqura ndaj vendimit të KQZ i drejtohen

anëtarëve nga partitë politike, Presidenti i Kosovës duhet të emërojë anëtarët e rinj. Për momentin konsiderohet se KQZ është “jo funksionale” më mos emërimin e anëtarëve të rinj nga presidenti i vendit (Telegrafi.com, 2018; Zëri info, 2018; Gazeta Tribuna, 2018). Kjo pengon në kryerjen e funksionit kushtetues dhe ligjor që ka KQZ-ja dhe institucionet e tjera që varen nga vendimarrja e saj.

Gjykatës Elektorale apo PZAP-it si shkallë e dytë. Për realizimin e kësaj reforme, rekomandohet që të ndryshohen Neni 139 i Kushtetutës dhe Neni 59, Neni 60, Neni 61, Neni 67, Neni 74, Neni 75 dhe Neni 76 dhe Kreu XX i Ligjit Nr. 03/L-073 si dhe Neni 4, Neni 6, Neni 9; Neni 10 dhe 12 i Ligji Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për “Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës”, dispozita këto që kanë të bëjnë me përgjegjësitë, strukturën, zgjedhjen dhe mandatin e anëtarëve të KQZ, KKZ dhe KVV si dhe të PZAP-it.

3.4.2. Drejtësia Zgjedhore: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Procesi i ankesave dhe parashtresave gjatë procesit zgjedhor dhe zgjidhja e tyre është i rregulluar përmes ligjit zgjedhor dhe Rregullores për procedurat në PZAP-it (Ligji Nr. 03/L-073; 117; Ligji Nr. 03/L-256 Neni 4, PZAP 2015 Rreg. Nr. 02/15, Neni 5-15). Me qëllim të trajtimit të ankesave që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, është themeluar Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i cili sipas Neni 115.1 i Ligji Nr. 03/L-073 është “organ i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor” (Ligji Nr. 03/L-073; Neni 115.1). Paneli është i përbërë nga gjyqtarë të emëruar nga sistemi i drejtësisë. Anëtarët e tij sipas Neni 9 i Ligji Nr. 03/L-256 janë nga radhët e “gjykatësve të Gjykatës Supreme, Apelit dhe gjykatave themelore” (Ligji Nr. 03/L-256, Neni 9). Ndryshe PZAP-i mund të quhet edhe si gjykatë elektorale por që nuk bën pjesë në sistemin e drejtësisë, por që përbëhet nga strukturat e saj. Sipas reformës zgjedhore të vitit 2010 i normuar të Ligji nr. 03l-256 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03l-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, me

Nenin 9 dhe 11 i është dhënë kompetencë Kryetarit të Gjykatës Supreme për “emërimin e dhjetë anëtarëve” si dhe “kryetarit” të PZAP-it. “Mandati” i tyre sipas nenit 115.3 i Ligjit Nr. 03/L-073 është “katër vite dhe i ripërtërishëm” (Ligji Nr. 03/L-256, Neni 9-11; Ligji Nr. 03/L-073; Neni 115.3). Përveç kësaj, reforma ligjore përmes Nenit 12.1-2 ka përfshirë “ndryshimin e periudhën kohore” brenda së cilës vendoset mbi ankesat dhe afatit për “dorëzimin e ankesave të palëve” të PZAP-i apo të Gjykata Supreme si dhe për “vendimet” e tyre (Ligji (Nr. 03/L-256, Neni 12.1-2).

3.2.1. Procedura për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore në procesin zgjedhor

Procedura për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore në periudhat paraelektorale, elektorale dhe paselektorale bëhet së pari nga PZAP-i. PZAP-i sipas Nenit 13 i ligjit Nr.03/L-256, trajton çdo ankesë që vjen nga personi fizik apo juridik, i cili ka “interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të tij ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas rregullave zgjedhore”. Pala e cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-i sipas kësaj dispozite mund të paraqesin “ankesë pranë PZAP-it, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”. Ndërsa PZAP-i obligohet që të “vendosë për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa” (Ligji Nr.03/L-256, Neni 13). Gjithashtu, PZAP-i përmes Rregullës Nr. 02/15 “Rregullorat dhe Procedurat’ ka rregulluar procedurat dhe stadardet lidhur me ankesat e palëve. Ajo pranon t’i shqyrtojë “ankesat e bazuara në fakte” dhe “refuzon ankesat” të cilat nuk përmbushin standardet e përcaktuara të Neni 5, Neni 6 dhe Neni 7 i rregullores për procedurat (PZAP 2015: Rreg. Nr. 02/15, Neni 5, Neni 6 dhe Neni 7).

Drejtësinë elektorale mund ta kërkojnë të gjithë personat fizikë apo juridikë, që pretendojnë se të drejtat ligjore i janë cenuar nga vendimi i KQZ-së për “refuzim të aplikacionit për certifikim të subjektit politik”; “të certifikimit të listës së kandidatëve të subjektit politik”; “të akreditimit të ndonjë personi apo organizate si vëzhgues në zgjedhje apo refuzimit për të marrë pjesë si votues jashtë Kosovës, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda 24 orëve pasi vendimi i apeluar është shpallur nga KQZ-ja”. Dispozitat e ligjit e obligon PZAP-in të “vendos lidhur me apelin brenda 72 dy orëve nga momenti i parashtimit të ankesës” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 16.6; Neni 26.6, Neni 54.7; Neni 64.2,f,g; Ligji Nr. 03/L-256 Neni 12).

Gjithashtu para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it i përcaktuar të Neni 15-16, që në raste të jashtëzakonshme të “anulojë rezultatet” në “një vendvotim” apo “qendër votimi”, dhe ta “urdhërojë KQZ-ën të “përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale” (Ligji Nr. 03/L-256, Neni 15-16). Gjithashtu, Ligji Zgjedhor ka përcaktuar kompetencat e këtij organi duke i dhënë të drejtë që “vendimet” e tij të jenë të “detyrueshme për KQZ-n” nëse nuk janë “apeluar” paraprakisht në Gjykatën Supreme. Në kuadër të Nenit 12 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme shprehimisht përcaktohet se Vendimi i PZAP-it është detyrues për KQZ, vetëm nëse Gjykata Supreme ka vendosur ndryshe. Në bazë të Nenit 12.3 i ligjit: “Vendimi i PZAP-it është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe Gjykata Supreme përcakton ndryshe” (Ligji Nr. 03/L-256, Neni 12.3).

Sipas kësaj dispozite ligjore Gjykata Supreme na paraqitet si organ i shkallës së dytë për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore. Pas verdiktit të Gjykatës Supreme, KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve. Me certifikimin e rezultateve përmbyllet procesi zgjedhor dhe i gjithë fokusi kalon në ndërtimin e institucioneve qofshin ato nacionale që bëhet me dekretin e presidentit për mbledhjen konstituive apo ato lokale që bëhet me pranimin e detyrës dhe dhënies së betimit para institucioneve kompetente. Me këtë përfundon procesi postelektoral në Kosovë.

Mirëpo, pas verdiktit të Gjykatës Supreme dhe certifikimit të rezultateve prej KQZ-së, procesi i drejtësisë zgjedhore vazhdon të Gjykata Kushtetuese që sipas Nenit 112 i kushtetutës është “autoriteti përfundimtar për interpretimin e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën” (Kushtetuta, Neni 112). Ndërsa sipas Nenit 113.3.5 i Kushtetutës “Palët e Autorizuara” (Kuvendi, Presidenti dhe Qeveria) janë të autorizuar të ngrenë çështjet: ...*“nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit”*. Kjo dispozite sipas Enver Hasanit “përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës”. Në këtë rast “Gjykata Kushtetuese” është institucioni që “vlerëson” dhe “garanton” që zgjedhjet janë “zhvilluar sipas Kushtetutës” dhe janë respektuar “standardet kushtetuese mbi zgjedhjet në zgjedhjet për Kuvend” (Hasani, E. Çukalovic, I. 2013:583). Megjithatë, kur flitet për rastet individuale të ankesave për zgjedhjet, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë kushtetuese, përveç Nenit 113.7 i Kushtetutës, për vlerësim të kushtetutshmërisë së procesit elektoral, qoftë në nivel qendror apo lokal. Në mungesë të këtyre normave, kandidatët duke u bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për ndonjë shkelje nga autoriteti

publik vetëm pasi të jenë konsumuar të gjitha mjetet juridike. Sipas kësaj dispozite Kushtetuese: *”Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”* (Kushtetuta 2008, Neni 113.7).

Faktikisht, bazuar në dispozitat e mësipërme, tre kandidatet për Kryetar Komune i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e ligjshmërisë të procesit zgjedhore. E para, është Kandidatja për Kryetare të Komunës së Gjakovës në zgjedhjet e vitit 2009, Mimoza Kusari-Lila, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për “Vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Vendimit të KQZ-së”, për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve lokale, të cilat u mbajtën më 15 nëntor 2009, pa marrë në konsideratë rezultatet e të gjitha ankesave dhe parashtresave që janë paraqitur”. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese në aktvendimin e saj për Rastin Nr. KI 73/09, vendosi që ta shpallë kërkesën si të “*papranueshme për shkak të mos shterjes së mjeteve juridike*” (Gjykata Kushtetuese 2010: Rasti Nr. KI 73/09). Një proces i ngjashëm vazhdon të jetë në procedurë pranë Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e vendimit të (PZAP-it) Gjykatës Supreme për balotazhin në Zgjedhjet Lokale të vitit 2017 në komunën e Prishtinës dhe Istogut (Indeksonline.net 2018; Gazeta Express 2018).

Me qëllim të realizimit të procesit në mënyrë sa më efikase dhe zvogëlimin e mundësive për vonesa në certifikimin përfundimtar të rezultateve të zgjedhjeve, rekomandohet të reformohet institucioni për trajtimin e ankesave në proceset zgjedhore dhe propozohet që: Ankesat për shkeljet e supozuara nga KKZ dhe KVV si dhe ato lidhur me administrimin e numërimit në QNR, nga palët e pakënaqura dorëzohen për shqyrtim pranë KQZ-së. Ajo i

trajton këto ankesa si shkallë e parë. Nëse palët e pakënaqura ndaj vendimit të KQZ e apelojnë në Kolegjin Elektoral (apo PZAP-i) si shkallë e dytë. Gjithashtu, të ndryshohet mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Kolegjit Elektoral apo Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, nga Kryetari i Gjykatës Supreme të kalojë propozimi i tyre të Këshilli Gjyqësor i Kosovës¹¹ dhe emërimi nga Presidenti i Republikës.

Në realizimin e kësaj reforme, propozohet që të ndryshohen dhe plotësohen Neni 59 dhe Neni 64 “Mbi Përgjegjësitë dhe Funkcionet e KQZ-së” si dhe Kreu XX i Ligjit Nr. 03/L-073; si dhe Neni 4, Neni 6, Neni 9; Neni 10 dhe Neni 12 i Ligji Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme me të cilat funksionon PZAP-i.

3.5.Gjetjet nga hulumtimi për domosdoshmerinë e reformës ligjore, administrimin zgjedhor dhe opinionin e respondentëve për sistemin zgjedhor

Në kuadër të analizës së kornizës ligjore zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale janë nxjerrë në pah nevojat e domosdoshme për ndryshimin dhe plotësimin e tyre. Në mënyrë të përmbledhur Ligji (Nr. 03/L-073) për Zgjedhjet e Përgjithshme, njëkohësisht Ligji Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme

¹¹ Shënim: Këshilli Gjyqësor i Kosovës në bazë të Nenit 108 të Kushtetutës së Kosovës, siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor. Ai është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është po ashtu përgjegjës për transferimin dhe për procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve (Kushtetuta 2008: Neni 108).

në Republikën e Kosovës si dhe Ligjit Nr. 03/L-072) për Zgjedhjet Lokale në Kosovë kanë për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, organizimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe për organet e qeverisjes lokale (zgjedhjet për Kuvendin Komunal dhe ato për Kryetar të Komunës). Në këtë legjislacion zgjedhor janë objekt i rregullimit: a) e drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur; b) caktimi i sistemit zgjedhore dhe pragut zgjedhore; c) caktimi i kuotës gjinore dhe etnike; ç) afatet, procedura dhe kompetenca për regjistrimin e subjekteve zgjedhore; d) organizimi dhe funksionimi i administratës zgjedhore; dh) afatet, procedura dhe kompetencat për përgatitjen e listës së zgjedhjeve si dhe certifikimi i kandidatëve; e) financimi i zgjedhjeve dhe financimi i subjekteve politike si dhe auditimi i tyre; ë) zhvillimi i fushatës zgjedhore; f) rolin e medieve dhe vëzhguesve të zgjedhjeve; g) procedura e votimit dhe shpalljes së rezultateve; gj) drejtësia zgjedhore apo shqyrtimi i ankimeve dhe vendosja e sanksioneve administrative dhe penale; h) rregulla të tjera në lidhje me zgjedhjet dhe proceset zgjedhor (Ligji Nr. 03/L-073 dhe Ligji Nr. 03/L-256, Neni 1-16).

Në hulumtimin e raportëve të publikuara mbi “Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë” nga Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM), (EU EOM 2014:26; EU EOM 2017: 35) si dhe në “raportet e progresit të Komisionit Evropian (KE) (KE 2010:7; KE 2011:6); KE-2012:7;... KE 2013:8;...KE 2015:6; KE 2016:6) vërejmë se rekomandimi i përbashkët në përgjithësi është “reforma e kornizës ligjore zgjedhore” në Kosovë.

Disa nga vlerësimet apo rekomandimet e dhëna:

... “Të metat e sistemit zgjedhor duhet të adresohen dhe duhet të forcohet roli i Kuvendit në shqyrtimin e legjislacionit për të siguruar cilësi” (KE 2010:7) ... “Ka pasur mangësi serioze në procesin e zgjedhjeve të përgjithshme. Kosova duhet të bëjë hapa urgjentë për adresimin e këtyre, duke thjeshtuar sistemin, duke e bërë më transparent, si dhe duke hetuar e përndjekur rastet e mashtrimeve zgjedhore (KE 2011:6)...”; Zgjedhjet e fundit të përgjithshme të mbajtura më 2010/2011 janë karakterizuar

me mangësi serioze dhe vështirësi teknike. Kosova duhet të sigurohet që korniza ligjore përmirësohet që të pasqyrojë praktikën dhe standardet më të mira të BE-së që dalin nga një marrëveshje e tillë”(KE-2012:7);... “Kuvendi dhe institucionet e tij duhet të fokusohen në prioritetet e identifikuara në studimin e fizibilitetit, posaçërisht sa i përket reformës zgjedhore”(KE 2013:8);... Kosova organizoi zgjedhje të suksesshme të përgjithshme dhe lokale. Procesi zgjedhor në të dy rastet është përmirësuar në krahasim me zgjedhjet e mëparshme. Kosova ende ka nevojë për një reformë të plotë zgjedhore për të adresuar rekomandimet nga misionet dhe ekspertët për vëzhgimin e zgjedhjeve ... Kuvendi i Kosovës mbetet të miratojë reformën zgjedhore e cila është vonuar (KE 2014-2015:6);... Kuadri zgjedhor i Kosovës është në përputhje me standardet ndërkombëtare, megjithatë reforma zgjedhor e udhëhequr nga Komisioni i Venecias, mbetet e nevojshme (KE 2016:6).

Në kuader të analizës të kornizës ligjore në përgjithësi, gjejmë ngjashmëritë dhe ndryshimet sa i përket sistemit zgjedhor, zonës dhe pragut zgjedhor, kuotës gjinore dhe etnike për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe vejmë në pah se legjislacioni zgjedhor në fuqi gjatë kësaj periudhe (2008-2017) ka pësuar këto ndryshime:

- a. në vendosjen e votës preferenciale deri në pesë (5) vota brenda listës për zgjedhjet për Kuvendin e Kosoves;
- b. në rritjen e numrit nga pesë (5) në dhjetë (10) antëarëve të PZAP-it për rritjen e efikasitetit për drejtësinë zgjedhore dhe procedurave për shqyrtimin e ankesave në lidhje me shkeljet në procesin zgjedhor,
- c. në rritjen e afatit prej dy (2) ditëve në shtatëdhjetë e dy (72) orëve që PZAP-i duhet të ofron kopjet e vendimeve, palëve të përfshira, nga momenti i lëshimit të vendimit, në rast se ai ndikon në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve;’
- d. Në uljen e gjobës nga dyqindmijë euro (€200,000) në vlerë deri në pesëdhjetëmijë euro(50,000) Euro ndaj një subjekti politik;

- e. Organizatat vëzhguese në zgjedhje përjashtohen nga mundësia e vendosës së gjobës në vlerë deri në dyqindmijë euro (€200,000) siq ishte vendosur me ligjin paraprak; dhe
- f. Afatet e fushatës zgjedhore për Partitë Politike rregullohen përmes rregulloreve të KQZ-se.

Në këtë veshtrim, gjate analizës se dispozitave të Nenit 4 i ligjit zgjedhor që rregullon mënyrën e “shpalljes së zgjedhjeve të rregullta, të zgjedhjeve të parakohshme” vërejmë se kjo dispozite nuk i ka të normuara “zgjedhjet e jashtëzakonshme”. Sipas dispozitave të 4.5 i ligjit Nr. 03/L-073, “Zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas shpërndarjes” së Kuvendit. Zgjedhjet e parakohshme rregullohen nga ligjet dhe rregullat e njëjta të KQZ-së sikurse edhe zgjedhjet e tjera, përveç se KQZ-ja mund të ndryshojë “afatet kohore sipas nevojës në pajtim me rrethanat” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 4.5). Në këtë rast KQZ-ja përmes dispozitave nga Neni 1-15 i Rregullës Zgjedhore Nr.15/2010 për “Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme” përcakton afatet dhe kushtet e tjera për proceset zgjedhore në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme të Përgjithshme dhe Lokale nga zgjedhjet e rregullta (KQZ 2010, Rregulla Nr. 15/2010, Neni 1-15). Sipas Nenit 7 të kësaj Rregullore “fushata zgjedhore” për zgjedhjet e jashtëzakonshme ose të parakohshme “zgjat dhjetë ditë” dhe përfundon “një ditë” para ditës së zgjedhjeve, e njohur si heshtja zgjedhore (KQZ: Rregulla 15/ 2010, Neni 7). Ndërsa periudha e fushatës zgjedhore në zgjedhjet e rregullta sipas Nenit 2.1 i Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2013 Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike “nënkuptohet periudha prej tridhjetë ditëve për fushatën


zgjedhore të subjekteve politike e cila përfundon një ditë para ditës së zgjedhjeve” (KQZ 2013 Rregulla nr.13/2013, Neni 2).

Në lidhje me këtë, të dhënat e hulumtimit empirike që pasqyrohet në Figurën 3 për shkaqet e daljes së ulet të qytetarëve në zgjedhje ka rezultuar se “koha e shkurtër e fushatës zgjedhore prej dhjetë ditëve” është konsideruar si një ndër pengesat kryesore për mos daljen e qytetarëve në votime. Për ndryshimin e kësaj gjendje paraprakisht duhet të ndryshohen dispozitat normative të Nenit 86 pika 6 dhe Nenit 95 pika 4 e Kushtetutës që përcaktojnë afatet kohore për zgjedhje të reja (parakohshme apo jashtëzakonshme), që për organizimin e tyre kërkohet të bëhet “brenda 45 ditëve” të ndryshohet më së paku në 60 ditë dhe kjo e rrit automatikisht “kohën për fushatë zgjedhore” sipas Nenit 7 i Rregulles Nr. 15/2010 të KQZ-se.

Megjithatë sipas këtyre rregullave ligjore janë zhvilluar të gjitha proceset zgjedhore për dy nivelet e pushtetit, pas vitit 2010 deri 2017, të cilat kanë rezultuar me “vlerësime pozitive dhe negative” nga raportimet e vëzhguesve të ndryshëm, aktorët pjesëmarrës në zgjedhje dhe shoqëria civile për “zgjedhjet dhe sistemin zgjedhor” (EU EOM 2014:4; EU EOM 2017; Komisioni Evropian, Raport i progresit për Kosovën për vitet *KE 2010:7; KE 2011:6; KE-2012:7;... KE 2013:8;..KE 2014:6; KE 2016:6* KIPRED 2011/7;4-5; IPOL 2012:8-9). Ndër kritikrat më të shpeshta që janë bërë ndaj procesit zgjedhor në përgjithësi dhe “sistemit zgjedhor” në veçanti është “manipulimi i votës ose preferencës”, votimi disa herë i një votuesi si dhe ai familjar, “listat e votuesve” dhe “mashttimeve të raportuara në zgjedhje nga administruesit zgjedhorë”, etj. (OSBE 2012: 4-8; IKD 2014: 8-30; DnV 2011: 12-33 & DnV2014:13-39; Forumi 2015:25).

Në kuadër të hulumtimit të realizuar me përfaqësues të partive politike, deputetë të Kuvendit, drejtues të institucioneve zgjedhore dhe ekspertë të fushës si dhe me qytetarët si votues kemi nxjerrë vlerësime sa i përket sistemit zgjedhor dhe nevojës për reformë të sistemit zgjedhor. Në bazë të rezultatit të hulumtimit për modelin zgjedhor më të përshtatshëm dhe më të pëlqyer për qytetarët të dy target grupet e përfshira në hulumtim kanë vlerësime të përafërta, po me një nuancë më të theksuar nga respondentët politikë që i bëjnë modelit aktual zgjedhor. Kjo është paraqitur nga Figura 1 për opinionet e qytetarëve dhe Figura 2, e cila prezanton vlerësimet e respondentëve me funksione politike. Në pyetjen: *Si qytetar dhe pjesëmarrës në zgjedhje, Ju me dëshirë në të ardhmen do të votoni për kandidatin, partinë dhe një kandidat apo disa kandidatë apo vetëm për partinë?* Lidhur me këtë pyetje kemi një përgjigjeje të ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë për dy opsionet: e para, respondentët e kanë preferencë për të votuar për partinë dhe një kandidat me 39% e tyre, dhe opsioni i dytë, është votë për partinë dhe disa kandidatë i mbështetur nga 38.5% e respondentëve. Ndërsa opsioni votë për një kandidat është mbështetur nga 15.6% e respondentëve si dhe votë vetëm për partinë është mbështetur nga 6.9% e respondentëve. Opinioni i respondentëve pasqyrohet në mënyrë figurative në Figurën 1.


Figura 1. Preferenca e qytetarëve për mënyrën e votimit.



Burimi : Autori bazuar në hulumtimin 2017

Në bazë të rezultatit dhe sipas interpretimit logjik të të dhënave mund të konkludojmë se qytetarët e preferojnë sistemin i cili ia mundëson të votojnë partinë dhe një kandidat. Ndërsa opinioni i respondentëve me funksion politik dhe publik në lidhje me pyetjen për mënyrën e votimit në të ardhmen është i ndryshëm nga ai qytetar. Grupi politik mbështet modelin aktual të sistemit zgjedhor të përfaqësimit proporcional që mundëson votim për partinë dhe disa kandidatë. Kjo alternativë është mbështetur nga 49.4% e respondentëve (LPP me disa kandidatë), ndërsa, për alternativën për të votuar partinë dhe një kandidat është mbështetur me 28.6% prej tyre; alternativa e tretë, votë për një kandidat është mbështetur me 18.2% dhe 4.8% janë deklaruar për opsionin për të votuar vetëm për partinë (Lista të mbyllura). Opinionet lidhur me preferencat e respondentëve dhe rezultati i tyre është pasqyruar në Tabelën 2.

Figura . 2 . Preferenca e përfaqësuesve politikë për mënyrën e votimit.



Burimi: Autori bazuar në hulumtimin (2017)

Në bazë të analizës së rezultatit dhe interpretimit logjik të tyre arrijmë në përfundimin se alternative mbështetëse është sistemi proporcional e në veçanti opsioni me lista të hapura dhe me një votë brenda listës partiake. Ky model ka marrë një mbështetje më të madhe në krahasim me të gjitha opsionet e tjera. Edhe pse opsioni, vota për partinë dhe disa kandidatë, d.m.th. sistemi aktual, është më i preferuar për përfaqësuesit politik. Gjithashtu ky grup i ka dhënë një mbështetje edhe opsionit votë për kandidatin ose sistemin mazhoritar. Ndërsa opsioni i mbylljes së listave në përgjithësi ka marrë një mbështetje të vogël. Përveç kësaj duhet theksuar se “mbyllja e listave” imponon ndryshimin e nenit 64.1 të kushtetutës e cila përcakton se deputetët e Kuvendit janë “të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura”. Mirëpo ndryshimi i saj është një proces që sipas Nenit 65.2 i Kushtetutës “kërkon 2/3 e shumicës së deputetëve që përfaqësojnë shqiptarët si dhe 2/3 e deputetëve që përfaqësojnë minoritetet”. Ky proces është i komplikuar dhe kërkon një konsensus me të gjerë politik të të gjithë subjekteve, qofshin ato subjekte politike që përfaqësojnë shumicën

shqiptare, po edhe të subjekteve që përfaqësojnë komunitetet pakicë në Kuvendin e Kosovës për të arritur “dy të tretat e votave të shumicës dhe dy të tretat e votave të pakicës” (Kushtetuta, Neni 64.1 dhe 65:2). Megjithatë, kjo nuk është pengesë për ndryshimin e ligjit që përcakton sistemin zgjedhor, zonën dhe pragun zgjedhor, votën preferenciale apo edhe vendosjen e sistemit të kombinuar zgjedhor.

Për të ngritur dhe siguruar integritetin në një proces zgjedhor prej manipulimeve të votës preferenciale e përcaktuar sipas Nenit 7 i Ligji nr. 03/l-256 se një ..” *votues mund të votoj deri në pesë kandidatë nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik*”. Në kuader të këtij hulumtimi rekomandohet që kjo dispozite të ndryshohet dhe të vendoset parimi një qytetar një votë. Në dispozitën e re propozohet që “votuesi voton për një subjekt politik të certifikuar dhe mund të votoj për një kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik. Nëse në fletëvotim janë shënuar më shumë se një kandidat, të llogaritet vetëm vota për subjektin politik. Ky propozim mbështetet edhe të rezultati i hulumtimit empirik i pasqyruar në figuren 1.

Kosova duhet vendosmërisht të bëjë një reformë të mirëfilltë zgjedhore. Kjo mund të fillojë me nxjerrjen e një Kodi zgjedhor i cili do të rregullon në tërësi të gjitha procedurat për proceset zgjedhore për organet e nivelit qendror dhe lokal. Gjatë hartimit të Kodit zgjedhor duhet të hapet debati politik dhe shoqëror për reformën e sistemit zgjedhor, ndarjen e Kosovës në shumë zona zgjedhore, uljen e pragut zgjedhor në 3 përqind për subjektet politike dhe 1 përqind për kandidatët e pavarur si dhe reformimin e “menaxhimit të procesit zgjedhor dhe drejtësisë zgjedhore” (për më shumë shih pikat 3.2.1.1 dhe 3.2.1 dhe 6.3.4-6.3.7). Në lidhje me ndryshimin nga një zonë e vetme zgjedhore në më shumë zona zgjedhore në Kosovë ka

një marrëveshje politike e vitit 2011 e kthyer në Rezolutë në Kuvendin e Kosovës. Në piken e tretë të Rezolutës thuhet: ...*“që mes tjerash do të përkrahin krijimin e më shumë distrikteve zgjedhore në Kosovë”* (Kuvendi i Kosovës 2011, Rezoluta Nr. 04 - R -02, pika 3). Një ndryshim nga një zonë në më shumë zona kërkon ndryshimin e Nenit 110 të Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme.

Me qëllim të përfaqësimit më të drejtë të qytetarëve në institucionet përfaqësuese në Kosovë rekomandohet kalimi nga sistemi proporcional me një zonë zgjedhore me shumë kandidatë i normuar sipas Nenit 110 të Ligjit Nr. 03/L-073 në sistemin e kombinuar ku 50% e deputetëve ose 60 prej tyre të zgjedhen sipas sistemin mazhoritar, i pari i listës merr postin dhe 50% e deputetëve ose 60 prej tyre zgjedhen sipas sistemit proporcional me lista të hapur. Kjo nënkupton që Kosova nga një zonë e vetme (unike) zgjedhore e përcaktuar sipas Nenit 110.1 të Ligjit Nr. 03/L-073, rekomandohet të ndahet në 60 zona zgjedhore me një kandidat dhe plus një zonë zgjedhore me shumë kandidatë. Të gjithë, 120 deputetët zgjidhen drejtpërdrejt nga populli. Në mesin e tyre 60 deputetë do të zgjidhen sipas sistemit mazhoritar të IPLMP në 60 zona njëanëtarëshe si dhe 60 deputetë të tjerë do të zgjidhen sipas sistemit proporcional me lista të hapura në një zonë të vetme zgjedhore.

Ky sistem do t'i mundësonte votuesit që gjatë procesit zgjedhor të votojnë për dy fletëvotime, në njërin për deputetin e zonës së tyre si dhe fletëvotimin tjetër për subjektin politik dhe kandidatin e preferuar brenda listës. Ky model zgjedhor është gjithëpërfshirës dhe integrues për të gjitha komunitetet pa dallime etnie, gjuhe, kulture apo prejardhje sociale. Njëkohësisht ky model zgjedhor mundëson më lehtë zbatimin e kuotës kushtetuese për minoritetet dhe integrimin e tyre në dallim nga çdo variant tjetër zgjedhor

me 5, 7, 10 apo 38 zona zgjedhore, apo me ndonjë zonë të veçantë për minoritetet për faktin se në çdo variant tjetër do të jetë izolues apo dezintegruues për komunitetet si dhe më i vështirë për ta realizuar kuotën etnike në veçanti dhe përfaqësimin gjeografik në përgjithësi. Gjithashtu efektet e këtij sistemi do të reflektohen së pari në krijimin e institucioneve përfaqësuese gjithëpërfshirëse, të përgjegjshëm dhe llogaridhënës, stabilitet në qeverisje dhe krijon hapësirë për kontroll politik të institucioneve. Përveç aplikimit të instrumenteve të kontrollit politik të qeverisë, ky model e rrit fuqizimin e votës së qytetarit dhe njëkohësisht forcimin e demokracisë. Ata përmes këtij sistemi, do të kenë relacione dhe mundësi më të mëdha me deputetët e tyre të zonës dhe njëkohësisht llogaridhënia dhe përfaqësimi do të rritet. Po ashtu, ky model, e lehtëson apo mundëson që në kuvend të përfaqësohen edhe deputetë të pavarur nga 60 deputetët të cilët zgjidhen duke u bazuar në votat e zonës apo në nivel vendi, që ka siguruar kalimin e pragut zgjedhor prej 1 përqind. Në veçanti, një sistem i tillë e mundëson integrimin e subjekteve politike që përfaqësojnë minoritetet në koalicionet parazgjedhore me subjektet politike që përfaqësojnë shumicën shqiptare si dhe në menaxhimin e votës së përbashkët të votuesit e pakicave minoritare dhe atyre të shumicës për zonat e caktuara në nivel vendi. Në këtë mënyrë do të mund të inkurajohen votuesit e komuniteteve pakicë në zonat e veçanta për të votuar kandidatin e përkatësisë tjetër. Gjithashtu ky model krijon mundësinë që 60 deputetët e tjerë të zgjidhen duke u bazuar në votat e zonës shumëemërore apo zonës në nivel vendi, do të sigurohet ruajtja e kuotës etnike, gjinore si dhe proporcionalitetit në ndarjen e vendeve për subjektet politike në nivel vendi. Për më tepër ky opsion do të inkorporojë, në vetë preferencat e partive politike për një sistem të veçantë zgjedhor,

sipas rregullës: “partitë e vogla preferojnë zona të mëdha, ndërsa partitë e mëdha preferojnë zona të vogla” (Colomer, Jacobo 2004:3).

Përveç efekteve pozitive ky model zgjedhor ka vështirësitë e tij siç është ndarja në gjashtëdhjetë zona njëemërore dhe me numër të votuesve të përafërt në mes tyre. Një vështirësi tjetër është administrimi i procesit të numërimit si dhe rritja e dizbalancuar e votave në mes deputetëve të zonave dhe atyre që zgjidhen në nivel vendi. Megjithatë, ky model zgjedhor do të reflektojë më mirë mozaikun e diversitetit të shoqërisë shumetnike në Kosovë si dhe integrimin e plotë të tyre në institucione dhe në shoqëri.

Ndërsa gjatë analizës së dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-072) për Zgjedhjet Lokale në Kosovë dhe duke bërë krahasim me dispozitat e Ligjit për zgjedhjet e Pergjithshme vërejmë dallime thelbësore gjatë votimit të kandidatëve për Kuvend të Komunës dhe atyre për Kuvend të Kosovës. Dy karakteristikat dalluese të përcaktuar të Neni 7 të ligjit për Zgjedhjet Lokale në Kosovë janë:

- a. Votuesi nuk ka votë preferenciale por voton një (1) kandidat në listëm e kandidatëve dhe
- b. bartësi i listës nuk i nënshtrohet votimit, por, vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatin e parë në listë.

Në bazë të interpretimit logjik të kësaj norme vërejmë se promovohet parimi demokratik “një qytetar një votë” i sanksionuar sipas Nenit 7.4 të këtij ligji. Mirëpo, dispozita e Nenit 7.5 e favorizon kandidatin e parë në raport me kandidatët e tjerë në listën zgjedhore. Ai duke qenë bartës i listës, përfiton nga votat e partisë, pothuajse pa qenë

kandidat në garë. Kjo krijon pabarazi në garën zgjedhore brenda listës dhe së dyti e ngulfatë konkurrencën e brendshme partiake sepse diskriminon pozitivisht bartësin e listës me kandidatët e tjerë të listës. Për këtë rekomandohet: që të vazhdohet sistemi i përfaqësimit proporcional me lista të hapura sipas parimit një qytetar një votë, duke përjashtuar mundësinë që të përfitojë prijësi i listës; të ndryshohet dispozita e nenit 7.5 e ligjit për zgjedhjet lokale (Ligji Nr. 03/L-072) i cili favorizon bartësin e listës në krahasim me kandidatët e tjerë në listë pasi në mënyrë automatike ai siguron të gjitha votat të cilat i takojnë subjektit të tij. Propozohet që me dispozitën e re të vendoset që edhe bartësi i listës të i nënshtrohet garës zgjedhore si pjesëmarrës i barabartë me kandidatët e tjerë brenda listës. Mirëpo, nëse në fletëvotim është shënuar vetëm vota për partinë apo janë shënuar më shumë se një kandidat, llogaritet vetëm vota për subjektin politik. Vota e hedhur për subjektin politik të konsiderohet si votë për kandidatet gra në listën e kandidatëve të subjektit politik.

KAPITULLI IV: ZGJEDHJET DHE PJESËMARRJA E ULËT E QYTETARËVE NË ZGJEDHJE: Një Trend në Rritje

4.1.Zgjedhjet dhe pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhjet nacionale

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje analizohen nga dimensionet e shprehjes të sovranitetit popullor, i demokracisë elektorale dhe përfaqësues dhe rolit të tyre në krijimin e institucioneve dhe kontrollin politik të tyre. Kështu që zgjedhjet mund të interpretohen si një pajisje me atribut për “vendimarrje” ose “vendimin e duhur”; si një “ushtrim i vetëqeverisjes” si dhe një “mundësi për pjesëmarrje në diskutim” (Jos´ e Mar´ia Maravall & Ignacio S´anchez-Cuenca 2008:13-17). Në kuadër të ndërtimit të sistemit demokratik, organizimi i zgjedhjeve të lira ka funksion thelbësor. Ato janë “thelbi i demokracisë” thotë Prof. Arsim Bajrami apo “mekanizmi me të cilën funksionon demokracia” (Bajrami, A. 2010:207). Ndërsa sipas Prof. Kurtesh Salihi “sa me demokratik të jetë sistemi i zgjedhjeve aq me demokratik është sistemi, përkatësisht rregullimi shtetëror e shoqëror i atij vendi” (Salihi. K. 2004:245).

Në sistemet demokratike, populli përmes zgjedhjeve të lira e shpreh sovranitetin e vet dhe merr pjesë në vendimarrjen politike në krijimin e institucioneve dhe kontrollin politik të tyre. Në fakt, një sistem politik vlerësohet demokratik apo jo demokratik, varësisht se sa i përmbush kriteret për zgjedhje të lira, të drejtpërdrejta dhe të përgjithshme. Ato (zgjedhjet) duhet të jenë në përputhje me standardet demokratike apo parimet bazë të trashëgimisë elektorale evropiane të paraqitura të Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore Nr.190/2002 nga Komisioni i Venecias që janë: *votimi i përgjithshëm, i barabartë, i lirë, i fshehtë dhe i drejtpërdrejtë..... dhe duhet të zhvillohen në intervale të rregullta kohe*

(Komisioni i Venecias, Nr.190/2002) si dhe në përputhje me legjislacionin e miratuar nga forcat politike që duhet të pranojnë legjitimitetin e sistemit dhe për të qenë në gjendje të përmbushin detyrën e tyre për të siguruar legjitimitet, stabilitet dhe funksionalitet të shtetit në Kosovë. Gjithashtu, ato duhet të arrijnë pranimin e gjerë nga të gjithë pjesëmarrësit në proces zgjedhor. Përndryshe, një vend pa zhvilluar zgjedhje periodike dhe pa respektuar të drejtën universale të votimit (Katz, R. 1997:101-2), ai nuk do të konsiderohet sistem demokratik, sepse, zgjedhje organizojnë edhe vendet jodemokratike për të formalizuar pushtetin totalitar.

Zgjedhjet në demokraci në përgjithësi sipas Timothy D. Sisk, “shërbejnë për katër funksione kryesore”, përmes të cilave realizohet: “Legjitimimi i qeverisjes, Ushtrimi i llogaridhënies, Zgjedhja e përfaqësuesve dhe Ushtrimi i zërit, preferencat popullore” (Timothy D. Sisk. 2017:5). Sipas tij “referencat ndaj vullnetit të popullit janë bërë thelbësore për të përpunuar ligjshmërinë ose për të justifikuar autoritetin qeveritar”.

Për këtë arsye, nëse “demokracia” është vendosur në përgjithësi si “forma e vetme e pranueshme e qeverisjes” e dalë nga zgjedhjet e lira apo sipas Richard Katz *"bëhet një argument i përgjithshëm për legjitimitetin e një sistemi politik, i cili është legjitim, sepse është demokratik dhe demokratik sepse mban zgjedhje"* (Katz, R. 1997:101-102). Mirëpo sipas Norris-it “zgjedhjet nuk janë të mjaftueshme vetvetiu për demokracinë përfaqësuese, por është një kusht i domosdoshëm pa të cilën nuk mund të ketë demokraci dhe konsiderohet si e tillë” (Norris, P. 2004:4; LeDuc, L.&Niemi, R& Pippa Norris:2002:1). Për Sartorin “në demokraci, si sistem i qeverisjes me zgjedhje”..., askush nuk mund të vendosë vet se është me i mirë, duhen të jene të tjerët ata që do ta vlerësojnë si të tillë ..., dhe të veshin me pushtet.

Dhe metoda e percaktimit të atyre që janë me të vlerësuarit është pikerisht metoda e zgjedhjes se tyre, instrumenti elektoral” (Sartori, G..1998 : 92-98).

Një kuptim më gjithëpërfshirës i sistemit demokratik dhe burimit të pushtetit në demokraci është përkufizimi i demokracisë nga Abraham Lincoln (1809-1865), Presidenti i XVI i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (1861–65). Sipas tij demokracia është: “qeverisje e popullit, nga populli, për popullin” (Bajrami A 2010:27). Në mënyrë gati identike edhe Kushtetuta e Kosovës ia atribuon popullit sovranitetin e Republikës dhe ky sovranitet i takon popullit dhe ushtrohet, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në pajtim me mandatin që ia jep Kushtetuta. Në fakt, Neni 2.1 i Kushtetutës përcakton se: “*Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute*” (Kushtetuta, Neni 2.1).

Në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe kornizës ligjore për zgjedhjet, Populli i Kosovës ka realizuar të drejtën e tij sovranë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre. Kjo histori e demokracisë elektorale në Kosovë është zhvilluar për afër dy dekada. Në kuadër të kësaj periudhe (2000-2017) janë mbajtur dymbëdhjetë cikle zgjedhore për dy nivelet e përfaqësimit, atij qendror dhe lokal (KQZ 2017:14-15). Prej tyre gjashtë procese zgjedhore për nivelin qendror dhe gjashtë për nivelin lokal, duke përfshirë edhe katër cikle nga viti 2007, për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave (KQZ/QNR :2017).

Në përgjithësi, të gjitha proceset zgjedhore për dy nivelet e pushtetit, e në veçanti ato pas pavarësisë (2009-2017) kanë rezultuar me “vlerësime pozitive dhe negative” nga vëzhgues të ndryshëm, aktorët pjesëmarrës në zgjedhje dhe shoqëria civile për zgjedhjet, proceset zgjedhore dhe sistemin zgjedhor (EU EOM 2014:4; EU EOM 2017; Komisioni Evropian,

Raport i progresit për Kosovën për vitet *KE 2010:7; KE 2011:6; KE-2012:7;... KE 2013:8;..KE 2014:6; KE 2016:6 KIPRED 2011/7;4-5; IPOL 2012:8-9*).

Fokusi këtu është pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje dhe në veçanti pjesëmarrja në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale. Ndërsa proceset zgjedhor dhe ndikimi i rezultateve të tyre në formimin e institucioneve do të trajtohen në Kapitullin VI. Mirëpo, në përgjithësi, procesi zgjedhor në Kosovë vazhdimisht është duke u shoqëruar me një pjesëmarrje të ulët të qytetarëve në votime. Kjo ndikon edhe në uljen e legjitimitetit demokratik të institucioneve përfaqësuese, mbështetur në faktin se kemi më pak se gjysmën e votuesve që marrin pjesë në procesin zgjedhor, përveç zgjedhjeve të para lokale dhe nacionale. Një proces i tillë është shqetësues kur pjesëmarrja në zgjedhjet nacionale bie nën 50 për qind e trupit elektoral (KQZ 2017:45-47). Një pjesëmarrje shumë e ulët ose një përqindje shumë e lartë e votave të humbura mund të shërbejnë si tregues relevantë apo mund të vënë në pikëpyetje legjitimitetin e sistemit. Madje, “legjitimitetin e procesit zgjedhor” sipas prof. Fehmi Aganit ia jep kryesisht “pjesëmarrja masive e qytetarëve dhe deklarimi i lirë i zgjedhësve në votime” (Agani, F.1999:306).

Të dhënat statistikore të nxjerrura nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga OSBE/CEC/UNMIK dhe KQZ-ja (OSBE/CEC/UNMIK: 2001-2004& KQZ/QNR 2007-2017) për zgjedhjet e përgjithshme nga viti 2001-2017 pasqyrojnë trendin në rritje e pjesëmarrjes së ulët në daljen e qytetarëve në zgjedhje. Kjo mund të vihet në dukje më një krahasim të përqindjes së daljes të qytetarëve në tri zgjedhjet e fundit që është prezentuar në kuadër të Tabelës 5. Aty pasqyrohet pjesëmarrja në zgjedhje për legjislaturën e parë deri tek e fundit duke pasqyruar numrin e votuesve të regjistruar në listat zgjedhore, përqindjes së daljes në zgjedhje, votave të vlefshme dhe atyre të humbura apo të pavlefshme.

Tabela 5. Elektorati dhe pjesëmarrja në zgjedhjet e përgjithshme (2001-2017)


Viti	Elektorati	Dalja në zgjedhje	Fletëvotimet			
			Kuti	vlefshme	pavlefshme	zbrazëta
2001	1,249,987	64.30%	803,796	788,303	11,975	3,518
2004	1,412,680	49.52%	699,519	690,089	6,704	2,726
2007	1,567,690	40.09%	628,630	571,767	34,883	21,980
2010	1,632,276	45.29%	739,439	698,751	29,226	4,780
2014	1,799,023	42.63%	766,847	731,248	30,725	4,842
2017	1,888,059	41.30%	747,228	727,986	42,554	6,553

Burimi: Autori bazuar në rezultatet e OSBE/CEC/UNMIK: 2001-2004& KQZ/QNR 2007- 2017

Pjesëmarrja në zgjedhjet e para të përgjithshme ka qenë afër 65 për qind ndërsa, në zgjedhjet e tjera, paraqitet trendi i rënies së vazhdueshme të numrit të votuesve aktivë në procesin zgjedhor si dhe rritjes së natyrshme të trupit elektor. Në zgjedhjet e fundit nacionale, Kosova ka pasur një trup elektor prej 1,888,059 votues (shih Tabela 5). Megjithatë, Kosova sipas Agjencisë Statistikor të Kosovës, popullsi të regjistruar në vitin 2011, ka 1.783.531 banorë. Kështu që, “numri i votuesve të regjistruar” është më i madh se “numri i popullsisë në përgjithësi të regjistruar” në Kosovë (KZQ/QNR: 2017; ASK 2017:27). Kjo ndodh për shkak se shumë votues të regjistruar jetojnë jashtë Kosovës si dhe mospastrimit të listave nga personat e vdekur e që figurojnë në listat e votuesve. Megjithatë ndër faktorët që po ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e qytetarëve në zgjedhje sipas rezultatit të hulumtimit empirik të pasqyruar të figura 3 janë: “mosbesimi te partitë politike dhe institucione politike” si dhe “mosbesimi te vota për ndryshime” etj.

Përveç pjesëmarrjes së ulët në zgjedhje, gjithashtu, kemi një “trend të rritjes së votave të humbura ose të pavlefshme në proceset zgjedhore” (KQZ 2015:4). Megjithatë kjo pasqyrohet në Tabelën 5 si dhe trendi i daljes në zgjedhjet e përgjithshme nga viti 2001-2017 pasqyrohet në Grafikon 1.

Grafiku 1. Trendi i daljes së qytetarëve në zgjedhjet e përgjithshme (2001-2017)



Burimi: Autori bazuar në rezultatet e publikuara nga OSBE/CEC:/UNMIK: 2001-2004, KQZ/QNR:2007- 2017

Kjo rënie e numrit të votuesve në zgjedhje mund të lidhet me problemet social-ekonomike dhe politike në vend. Mirëpo ato mund të jenë edhe më të shumta. Sipas rezultatit të këtij hulumtimi ndër shkaqet kryesore që janë listuar në Figurën 3 është “mosbesimi te partitë politike dhe institucionet”. E sipas Anthony Downs, “kur diferenciali i partive është zero, zgjedhësi është indiferent” (Cituar nga Schmidt, G. M, 2012:201). Gjithashtu, dalja e ulët në zgjedhje mund të shihet si zhgënjim i qytetarëve dhe pamundësi për të ndikuar në agjendat politike apo jetën publike në përgjithësi. Kjo reflektohet në përqindjen e ulët të pjesëmarrjes në zgjedhje për të dy nivelet e përfaqësimit.

4.2.Zgjedhjet dhe pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhjet lokale

Një trend i njëjtë i pjesëmarrjes së ulët të qytetarëve është edhe për zgjedhjet lokale qoftë për Asamblenë apo Kryetarët e Komunave. Përveç zgjedhjeve të para për pushtetin lokal të vitit 2000, ku pjesëmarrja në zgjedhje ka qenë afro 80% e votueseve të regjistruar, në të gjitha ciklet zgjedhore ka rënie të vazhdueshme të pjesëmarrjes në procesin zgjedhor (KQZ 2017:45-47). Lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhjet për Kuvendet Komunale në periudhën e viteve 2000 -2013 në mënyrë të përmbledhur prezantohet në Tabelën 6. Gjithashtu, në kuadër të saj është pasqyruar edhe numri i votuesve, përqindja e rezultatit në zgjedhje si dhe votat e vlefshme dhe atyre të humbura ose të pavlefshme.

Tabela .6. Elektorati dhe pjesëmarrja në zgjedhjet lokale (2000-2013)

Viti	Elektorati	Përqindja	Fletëvotimet			
			F. në Kuti	F. vlefshme	F. pavlefshme	F. zbrazëta
2000	913,179	79,00%	721,260	68,733	24,171	9,757
2002	1,320,481	53,86%	711,205	699,399	8,620	3,186
2007	1,567,690	39,44%	618,230	565,919	29,102	23,209
2009	1,563,741	44,7%	698,073	631,000	54,084	12,751
2013	1,792,913	46,31%	830,325	746,729	70,782	12,775

Burimi: Rezultatet e publikuara nga OSBE/CEC/UNMIK 2000-2002,KQZ/QNR:2007-2013

Të dhënat statistikore të prezantuara në kuadër të Tabelës 6, tregojnë rritjen e dyfishtë të trupës elektorale në zgjedhjet e fundit në krahasim nga zgjedhjet e para, ka rënie të pjesëmarrjes në zgjedhje si dhe rritje të votave të pavlefshme në zgjedhjet lokale të mbajtura në Kosovë (OSBE/CEC/UNMIK 2000-2002,KQZ/QNR:2007-2013). Kështu që, rekomandohen subjektet politike që të hartojnë politika për nxitjen e anëtarësisë dhe votuesve në tërësi, për të dalë në zgjedhje. Të koordinohen me strukturat-anëtarësinë për te

zgjedhur dhe vendosur në listat zgjedhore kandidatët e preferuar. Kjo mund të konsiderohet një motiv që votuesit të dalin për të mbështetur të propozuarin e tyre.

4.3.Zgjedhjet dhe pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhjet për Kryetar të Komunave

Në kuadër të reformave të qeverisjes lokale në vitin 2007 është bërë ndryshimi i mënyrës se “zgjedhjes së Kryetarit të Komunës nga kuvendi”, tek “zgjedhja e drejtpërdrejtë nga populli” (UNMIK/REG. Nr. 2007/27 neni 7.4; Ligji Nr. 03/L-072, neni 9.5). Po në këto vite janë mbajtur në të njëjtën kohë zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, Kuvendet Komunale si dhe zgjedhjet për Kryetarin e Komunës (KQZ 2017:14). Sipas të dhënave nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor, pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje në përgjithësi, po edhe për “zgjedhjen e kryetarit të komunave” në veçanti ka qenë e ulët” (KQZ/QNR 2007- 2017).

Në kuadër të kornizës ligjor për zgjedhjet lokale vetmja dispozitë që detyron arritjen e kuotës “mbi 50% plus një votë” është Neni 9.5 i Ligjit Nr. 03/L-072 që përcakton se “Kandidati për Kryetar të Komunës” për ta fituar mandatin e Kryetarit duhet të sigurojë “shumicën absolute të votave të përgjithshme dhe valide të hedhura në kuti”. Ndërsa për raundin e dytë, “Kandidati” i cili fiton shumicën e votave zgjidhet Kryetar i Komunës” (Ligji Nr. 03/L-072, neni 9.5-7).

Kjo në realitet bëhet edhe më shqetësuese kur pjesëmarrja në zgjedhje gjë më tani nuk e ka kaluar pjesëmarrjen mbi 50% të elektoratit përveç zgjedhjeve të para historike lokale dhe nacionale (OSBE/CEC/UNMIK 2000 dhe 2001). Ndërsa rezultat në raundin e dytë pasqyrojnë një pjesëmarrje shumë më e ulët në zgjedhjet, siç është rasti i raundit të dytë të

zgjedhjeve të vitit 2007 (KQZ/QNR 2007). Përveç zgjedhjeve të vitit 2013 që ka pasur rritje të pjesëmarrjes, këtë e ka shoqëruar edhe “trendi i votave të pavlefshme” (KQZ 2014:3; DnV 2017:29-30). Kjo mund të shihet në Tabelën 7, që pasqyron ciklet zgjedhore, trupën elektorale, përqindjen e daljes në zgjedhje, vota të vlefshme dhe të pavlefshme si dhe të zbrazëta.

Tabela 7. Elektorati dhe pjesëmarrja në Zgjedhjet për Kryetar të Komunave (2007-2017)

Viti	Elektorati	Përqindja	Fletëvotimet			
			F. në Kuti	F vlefshme	F. pavlefshme	F. zbrazëta
2007	1,567,690	39,07%	612,513	589,050	12,699	10,764
R-2	1,432,249	29,37%	420,660	414,025	4,118	2,513
2009	1,563,741	44,67%	698,671	681,531	10,990	4,923
R-2	993,791	38,50%	381,604	377,602	3745	257
2013	1,792,913	46,34%	825,792	801,792	15,512	8,248
R-2	1,383,198	39,86%	539,038	541,163	7,144	288
2017	1,890,952	44.10%	811,650	80,7552	13,814	7,899

Burimi: KQZ/QNR 2007- 2017

Duke u bazuar në të dhënat statistikore të pasqyruara në Tabelën 7 si dhe atyre empirike të nxjerra nga intervistat me qytetarë dhe interpretimit logjik të tyre kemi arritur në përfundim se subjektet politike dhe kandidatët konkurrues nuk po tregohen atraktivë për nxitjen e qytetarëve për pjesëmarrje në vendimmarrje apo votim. Gjithashtu, subjektet politike dhe liderët e tyre nuk po hulumtojnë disponimin e anëtarësisë dhe potencialisht votuesve të ardhshëm për kandidatët e mundshëm për t’u propozuar. Gjithashtu, problemet e shfaqura në proceset zgjedhore lokale mund të konsiderohen si një nga pengesat për refuzim dhe për pjesëmarrje në zgjedhje.

4.4.Votat e mbetura apo të humbura

Votat e vlefshme janë ato që në të vërtetë përcaktojnë në rezultatin e zgjedhjeve për një subjekt politik si dhe një kandidati brenda listës së tyre. Ndërsa votat e humbura apo të mbetura janë ato vota që prej tyre nuk fiton asnkush prej subjekteve politike apo kandidatëve në procesin zgjedhor. Në përgjithësi, një “sistem i mirë votimi maksimizon votat efektive dhe minimizon votat e humbura” thot Douglas J. Amy. Sipas tij vota e “humbur” konsiderohet e padëshirueshme për disa arsye: e para, “vota e humbur mund të jetë shumë dekurajuese për votuesit dhe kontribuon në apatinë e votuesve” për të dalur në zgjedhje; kur subjektet politike apo “kandidatët e tyre gjithmonë humbin”, votuesit nuk “shqetësohen për të votuar” dhe më e rëndësishmja, “vota e tretur” apo të humbura “nënkupton që njerëzit dalin nga kabina e votimit pa asnjë përfaqësim”. Në këtë mënyrë, thot ai, “numri i votave efektive apo të rregullta “lidhet drejtpërdrejt me cilësinë dhe sasinë e përfaqësimit në një sistem politik”(Douglas J. Amy, 2000:17).

Një pjesëmarrje shumë e ulët ose një përqindje shumë e lartë e votave të humbura mund të shërbejnë si tregues relevantë apo mund të vënë në pikëpyetje legjitimitetin e sistemit politik dhe institucional në Kosovë. Megjithatë dukuria e “votave të pavlefshme dhe të humbura” është shfaqur në të gjitha proceset zgjedhore në Kosovë. Nga hulumtimet e rezultateve përfundimtare të publikuara nga KQZ/QNR-ja të prezentuar në kuadër të Tabelës 5, Tabelës 6 dhe Tabela 7, të cilat pasqyrojnë të dhënat statistikore për numrin e fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet nacionale dhe ato lokale për Kryetar të Komunave (2009-2017) dhe sipas një studimi i bërë nga KQZ-ja ose “Hulumtimi dhe Analizimi i Fletëvotimeve të Pavlefshme për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës ”tregon


se ka një “rritje dukshëm më të madhe të fletëvotimeve të pavlefshme nga zgjedhjet paraprake”(OSBE/CEC/UNMIK:2001-2004;KQZ/QNR 2007- 2017;OSBE/CEC/UNMIK 2000-2002,KQZ/QNR:2007-2013; KQZ/QNR 2009-2017’ KQZ 2015:4).

Mirëpo numri i “fletëvotimeve të pavlefshme” në dy ciklet e fundit zgjedhore (2014, 2017) është dukshëm më i vogël në krahasim me fletëvotimet e pavlefshme në zgjedhjet lokale. Mirëpo, ka një rritje të “fletëvotimeve të pavlefshme”, krahasuar me zgjedhjet e vitit 2010 (KQZ 2015:4).

Duke u bazuar në të dhënat e prezentuar me lartë vijmë në përfundim se numri i votave të pavlefshme në tri zgjedhjet e fundit është rritur në krahasim me zgjedhjet paraprake. Gjithashtu, pas vendosjes së pragut zgjedhor prej 5 përqind në vitin 2007 që është ende në fuqi, paraqitet problemi i “votave të mbetura nga subjektet politike të cilat nuk e kanë kaluar pragun zgjedhor”. Kjo kategori e votave sipas Sartori “nuk e zgjedhin askënd” apo “votuesit e hubin votën e vet” (Sartori, G. 1998:93). Nga kjo përfitojnë subjektet politike të cilat sipas Nenit 111 pika 2.a i Ligji Nr. 03/L-073, “kanë fituar së paku pesë përqind (5%) nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme në zgjedhjet për Kuvend” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 111.2.a). Megjithatë, ky numër votash të mbetura në zgjedhjet e fundit (2017), për Kuvendin e Kosovës sipas rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ/QNR-ja për zgjedhjet 2010-2017, ka shënuar “ulje të theksuar në krahasim me zgjedhjet paraprake” (KQZ/QNR: Zgjedhjet 2010- 2017). Duhet potencuar se ndikimi kryesor për këtë ulje mund të konsiderohet “formimi i koalicioneve parazgjedhore” i subjekteve politike dhe krijimi i grupeve të mëdha siç ishte “PAN”-i, “LAA”- dhe “LVV” dhe dalja në zgjedhje me një list zgjedhore të perbashket [(KQZ/QNR 2017). Rezultatet zgjedhor dhe efektet e

tyre janë elaboruar në kapitullin VI, pika 6.3.7.]. Ky ishte një lehtësim për votuesit që të pozicionohet për njërin nga këto subjekte dhe që vota e tyre mos të humbet. Në kuadër të grafikut 2, pasqyrohen votat e mbetura për tri ciklet zgjedhore për Kuvendin e Kosovës.

Grafiku 2. Votat e mbetura në tri palë zgjedhje të përgjithshme (2010-2017)



Burimi: Autori bazuar në rezultatet e KQZ/QNR, 2010- 2017

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitur në grafikun e mësipërm arrijmë në përfundimin se dy faktorët kryesorë që kanë dhënë efekte pozitive në uljen e votave të mbetura janë: a. krijimi i koalicioneve të mëdha parazgjedhore dhe vetëdijesimi i qytetarëve për rëndësinë e votës së tyre. Ata këtë fuqi të demokracisë, kanë filluar ta përdorin për të penalizuar subjekte e kandidatë brenda saj të cilët nuk e kanë mbajtur premtimin në të kaluarën.

4.5. Abstenimi si reflektim për votën e humbur

Në analizën e kornizës ligjor për zgjedhjet apo sistemit juridik të Kosovës në përgjithësi nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë që detyron apo penalizon¹² qytetarin për mosdalje në zgjedhje ose abstenim në procesin zgjedhor. Një ndër faktorët që shtyjnë qytetarin për të abstenuar në një proces zgjedhor janë alternativat e partive politike që për ata zgjedhës janë vlerësuar si të njëjta, e siç thotë Anthony Downs *“kur çdo gjë tjetër është njësoj, zgjedhësi abstenon”* (cituar nga Schmidt, G. M, 2012:201). Ndërsa, sipas rezultatit të hulumtimit që prezanton figura 3 (dhe elaboruar të pika 4.6 gjetjet e hulumtimit) për faktorët që ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin zgjedhor janë radhitur si me kryesorët mosbesimi te partitë politike dhe institucione politike si dhe “mosbesimi të vota për ndryshim.

Duke u bazuar në të dhënat e prezantuara më lart , pjesëmarrja e votuesve në të gjitha ciklet zgjedhore ka qenë e ulët përveç zgjedhjeve të para lokale dhe të përgjithshme. Megjithatë, gatishmëria e qytetarëve për të qenë “kandidatë” për garën elektorale është shumë i madh (KZQ: 2017:38).

Kjo mund të shihet edhe në kuadër të Tabelës 8, e cila në përgjithësi pasqyron numrin e kandidatëve pretendent në garën zgjedhore për Kuvendin e Kosovës i ndarë edhe sipas gjinisë së tyre.

¹² Shenim:,Në disa shtete (Belgjik,Greqi..etj) “votimi është I obligim qytetar”, do të thotë ” është i kushtezuar ky detyrim”, me çrast , shkelja e detyrimit të votimit apo abstenimit zgjedhor, më së shpeshti, përcillet me saksionim në formë të denimit me të holla” (Hasani, E.& Çukalloviç I, 2013:161-2) .

Tabela 8. Numri i kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhjet e përgjithshme (2001-2014)

Kandidat	Zgjedhjet 2001	Zgjedhjet 2004	Zgjedhjet 2007	Zgjedhjet 2010	Zgjedhjet 2014	Zgjedhjet 2017
Burra	959	934	5,458	839	833	644
Gra	374	381	2,465	427	402	327
Total	1,333	1315	7,923	1266	1235	971

Burimi: KQZ 2017: 38; KQZ/QNR 2017

Mirëpo, rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ/QNR prej vitet 2010-2017, për opinion publik në përgjithësi dhe për disa kandidatë pjesëmarrës në garën zgjedhore në veçanti ishte befasi jo e pritshme sepse, pretendentët për të qenë përfaqësues të popullit në Asamblетë komunale apo Parlament të Kosovës nuk kanë siguruar as edhe një votë të vetme. Logjikisht kjo mund të konsiderohet se ata nuk kanë votuar për veten e tyre, por, ndoshta votën ia kanë dhënë ndonjë kandidati tjetër ose liderit të partisë.

Një veçanti tjetër është se shumë kandidatë kanë marrë shumë pak vota ose “vetëm nga një, dy ose tri vota” (KQZ/QNR: 2010; 2013; 2014- 2017). Përderisa pritjet e tyre kanë qenë të larta, ata nuk janë mbështetur as nga rrethi familjar apo shoqëror i tyre. Edhe pse shoqëria kosovare karakterizohet për familje të mëdha, kjo nuk ka reflektuar pozitivisht në vota për disa kandidatë. Parë nga një këndvështrim tjetër, ndoshta vota e tyre është “devijuar gjatë procesit të numërimit nga administrata zgjedhore” (Shala, Xh./2014/22: 275). Kjo reflektohet negativisht në pjesëmarrjen në zgjedhje si dhe në përfaqësimin e drejtë dhe gjeografik në Kuvend. Këtë më së miri e tregojnë të dhënat e prezantuara në Tabelën 9, e cila pasqyron përfaqësimin e deputetëve sipas komunave në Kuvendin e Kosovës.

Tabela 9. Numri i Përfaqësuesve nga Komunitat në Parlament (2001-2014)

Nr.	Komuna	2001	2004	2007	2010	2014
1	Deçan	3	3	4	3	3
2	Dragash	1	3	2	1	1
3	Drenas	2		2	3	2
4	Ferizaj	3	4	9	3	6
5	Fushë Kosovë	2	1	1	1	1
6	Gjakovë	5	6	2	5	3
7	Gjilan	8	5	4	4	7
8	Graçanicë				4	3
9	Hani Elezit					
10	Istog			1	1	1
11	Junik					
12	Kamenic	3	2			
13	Kaçanik		1		1	
14	Kline		1	1		
15	Klokot					
16	Leposaviq	3	2			4
17	Lipjan	1	1	5	5	3
18	Malishevë		1		3	2
19	Mamushe					
20	Mitrovica e Veriut					
21	Mitrovica	9	5	7	6	1
22	Novobërd				1	
23	Obiliq	2	2	1		
24	Partesh				1	
25	Pejë	10	9	7	6	8
26	Podujevë	2	2	1	1	1
27	Prizren	3	14	13	12	12
28	Prishtinë	54	50	52	45	51
29	Rahovec		2		2	
30	Ranillugu				1	
31	Shterpcë		1	1	2	3
32	Shtime	1		1	1	
33	Skënderaj	2	1	2	1	4
34	Suharekë	2	1	1	6	1
35	Viti		1			1
36	Vushtri	1	2	3	1	2
37	Zubinpotok	1				
38	Zveqan	2				
	Totali	120	120	120	120	120

Burimi: KQZ 2017:49-57

Pas analizës së të dhënave të prezantuar më lart si dhe interpretimit logjik të fakteve arrijmë në përfundimin se ka një kontrast të madh midis numrit të deputetëve dhe votuesve të një komune. Për shembull: disa komuna edhe pse me numër të madh të votuesve nuk kanë arritur të kenë ndonjë përfaqësues të tyre në Kuvend. Ndërsa komuna të tjera japin një numër shumë më të madh të përfaqësuesve në Kuvend në disproporcion me numrin e votuesve (për më shumë shih: Elektorati sipas komunave 2000-2014 të botimi i KQZ 2017:32-34). Ky trend ka vazhduar edhe në zgjedhjet e fundit parlamentare të 11 qershorit 2017, ku komunat Dragashi, Fushë Kosova, Lipjani, Obiliqi, Juniku dhe Hani i Elezit me shumicë shqiptare kanë mbetur pa asnjë përfaqësues në Kuvendin e Kosovës (Lajmi 2017). Kjo ndodh për arsye se Kosova është një Zonë e vetme dhe vota preferencial deri në pesë vota brenda listës partiake mundëson në disbalancim në përfaqësimin e drejtë dhe gjeografik. Edhe pse përfaqësuesit duhet të ndjekin interesin e përgjithshëm të zgjedhësve në Kuvend e Kosovës, nëse dëshirojnë, siç thotë Pippa Norris, “të pasqyrojnë shoqërinë nga e cila ata janë zgjedhur duke mos përjashtuar ndonjë komunitet etnik, gjuhësor apo ideologjik” (Norris, P. 2004:4). Në këtë kontekst përfaqësim i drejtë sipas James Madisoni në “Letrat e Federalistit”, është:.. ..*“vetëm nëse secili përfaqësues e ndjek interesin faktik të elektoratit të tij, sepse, interesat e ndryshme në vend mund të balancojnë njëri-tjetrin në qeveri”* (Medison, J. 1787, Nr. 10). Megjithatë votuesit e këtyre komunave të Kosovës duan që dikush të përfaqësojë zonën e tyre gjeografike apo qytetin e tyre në Kuvend. E kjo siç thot Douglas J. Amy“ *“është e dëshirueshme, sepse shqetësimet politike ndonjëherë janë specifike për rajonet gjeografike të veçanta”* (Douglas J. Amy, 2000:13)

Duke u bazuar në të dhënat e prezantuara më lart dhe në veqanti ato në Tabelën 9 arrijmë në konkludimin: se sistemi zgjedhor aktual me një zonë të vetme zgjedhore dhe me votë preferenciale nuk po e reflekton drejt shprehjen e vullnetit të popullit përmes zgjedhjeve në Kuvend. Gjithashtu, ky sistem nuk po krijon dhe reflekton lidhjen komunikuese mes përfaqësuesve të zgjedhur në Kuvend dhe votuesve në rajone gjeografike të ndryshme në Kosovë. Kjo argumentohet nga të dhënat statistikore të pasqyruara në tabelën 9 dhe rezultati i hulumtimit empirik i paraqitur Figura 8 dhe Fig. 9 që tregojnë: se mungon kontakti apo bashkëveprimi në mes të zgjedhurve dhe qytetarëve.


Gjithashtu, kjo argumenton Hipotezën se është e domosdoshme reforma e sistemit zgjedhor aktual dhe kalimi në sistemin mixt (mazhoritar &proporcional) i cili do të krijonte një përfaqësim më të drejtë dhe përfaqësim të çdo komune me votat e tyre më së paku nga një përfaqësues në Kuvend. Po ashtu, kjo do të mundësonte lidhjen e përfaqësuesit me zonën dhe qytetarët e saj si dhe kandidatët dhe deputetët e zonës e kanë më të lehtë të komunikojnë me votuesit e tyre drejtpërdrejtë. Ky sistem do të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm në konfigurimin e strukturave partiake brenda partive politike. Mandej, ia lehtëson qytetarit përzgjedhjen e kandidatit të zonës si dhe atë brenda listës partiake në nivelin qendror dhe nëpërmes votës, fuqizohet partia politike dhe kandidati si përfaqësues i tyre në parlament, por edhe brenda strukturave të partisë (Sarah Birch 2003:99). Në këtë mënyrë mund të hapet konkurrenca për menaxhimin e partisë. Kuptohet liderët politikë, janë të prirur çdo herë për të pasur një sistem ndryshe, i cili në fund të fundit do t'u përshtatej atyre dhe rregullave që krijojnë për të qëndruar sa më gjatë në

pushtet (PIPS, 2012:3) apo thënë ndryshe ata përqendrohen vetëm në zgjidhjet sistematike të cilat u shërbejnë atyre për ta maksimalizuar fitoren politike (Forum 2015; 2013:5).

4.6.Gjetjet nga hulumtimi për faktorët që po ndikojnë në rënien e pjesëmarrjes në zgjedhje

Me qëllim të gjetjes së faktorëve që ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin zgjedhor, është realizuar hulumtimi empirik në terren me dy fokus grupet: fokus grupi me funksion politik dhe ai qytetar. Në kuadër të gjetjeve nga hulumtimi, rezulton se (për opinionet e respondentëve të sferës politike), ndër faktorët që po ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e qytetarëve në zgjedhje janë: mosbesimi te partitë politike dhe institucione politike si dhe mosbesimi te vota për ndryshime. Këta faktorë janë vlerësuar dhe radhitur si më kryesorët. Në vendin e parë është mosbesimi te partitë politike dhe institucionet politike dhe për të janë deklaruar 72.7% e respondentëve; ndërsa, faktor i dytë është mosbesimi te vota për ndryshime, i deklaruar nga 59.7% e respondentëve; ndërsa mentaliteti është radhitur i treti me 26%. Anëtarësimi i ulët i grave dhe rinisë në partitë politike me 22.1%; lufta e ashpër politike edhe brenda llojit me 19.5% si dhe e fundit është radhitur, me 15.6%, koha e pakët në dispozicion për fushatën elektorale. Këto vlerësime pasqyrohet në Figurën 3.

Figura 3. Faktorët që ndikojnë negativisht në pjesëmarrje të ulët në zgjedhje




Burimi: Autori bazuar në rezultatet e hulumtimit 2017

Bazuar në të dhënat e prezantuara më lart (Figura 3), mund të konkludojmë se faktori kryesor për pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve në votime ose zgjedhje është mosbesimi i qytetarëve ndaj partive politike dhe institucioneve për mënyrën e veprimit të tyre.

Përveç faktorëve që ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve në zgjedhje kemi kërkuar të gjejmë mënyrat dhe masat që duhen të ndërmerren për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në zgjedhje. Në bazë të hulumtimit janë radhitur sipas rëndësisë këto veprime që duhen të ndërmerren: e para, llogaridhënia politike, transparencë dhe sundimi i ligjit me 77.9%; veprimi i dytë, rritja e besimit tek partitë politike dhe në vendimmarrjen politike me 50.6%; e treta, ngritja e mirëqenies sociale në vend me 46.8%; e katërta: futja e sistemit të votës së obliguar me 35.1%; e pesta, rritja e numrit të grave dhe rinisë në forumet drejtuese të partive me 27.3% dhe gjashtë, rritja e anëtarësisë në partitë politike me 9.1%. E gjithë kjo është pasqyruar në mënyrë të përmblodhur në Figurën 4.

Figura . 4. Mënyrat më efektive për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje



Burimi: Autori bazuar në rezultatin e hulumtimit 2017


Këto janë disa nga veprimet që konsiderohen se do të ndikonin në mënyrë efektive në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje. Rrjedhimisht, sipas interpretimit logjik të rezultateve nga hulumtimi për mënyrat e nxitjes dhe rritjes së votuesve në zgjedhje është potencuar elementi kryesor i demokracisë dhe shtetit të së drejtës që është llogaridhënia politike dhe sundimi i ligjit. Kjo mund të reflektojë pozitivisht në nxitjen e qytetarëve për pjesëmarrje në votime. Për këtë rekomandohen subjektet politike dhe aktorët përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe organizimin e zgjedhjeve të ndërmarrin masat për të promovuar llogaridhënien në përgjithësi dhe sundimin e ligjit në veçanti .

Në fund, është hulumtuar se cilat janë aktivitetet që do të duhej të ndërmerren për të rritur pjesëmarrjen në zgjedhje. Dhe për këtë është shtruar pyetja se: *Çfarë lloje të aktiviteteve të fushatës duhet të bëjnë kandidatët apo partitë në të ardhmen?* Nga të dhënat empirike të nxjerra nga hulumtimi tregohet se cilat veprime duhet të merren parasysh gjatë fushatës nga subjektet politike. Këto veprime janë radhitur si vijon: veprimi i parë, është

organizimi i takimeve, mbledhjeve dhe tubimeve me qytetarë i mbështetur nga 71.1%; i dyti, kontaktimi me votuesit drejtpërdrejtë ose dorë më dorë është i mbështetur nga 59.2% ; i treti, shpërndarja e programit në çdo hyrje-shtëpi i mbështetur nga 34.2%; i katërti, bisedat me miq familjen dhe fqinjët për të dalë në zgjedhje dhe për të votuar partinë, është mbështetur me 30.3% si dhe kontakti i votuesve me telefon është veprimi me më pak mbështetje me 3.9%.

Në kuadër të Figurës 5 pasqyrohen veprimet që duhet të merren nga subjektet politike për të rritur pjesëmarrjen në zgjedhje.

Figura 5. Llojet e aktiviteteve të fushatës që duhet të bëjnë kandidatët apo partitë për të rritur pjesëmarrjen në zgjedhje.



Burimi: autori bazuar në rezultatin e hulumtimit 2017

Duke u bazuar në të dhënat e prezantuara më lart (Figura 5), arrijmë në konkluzionin se kjo reflekton situatën aktuale si dhe na mundëson që të japim propozimin për subjektet politike për veprimet dhe aktivitetet që duhen të ndërmerren nga subjektet politike për të nxitur daljen e qytetarëve në zgjedhje. Nisur nga këto të dhëna mund të vijmë në përfundimin se duhet të ndryshohen dispozitat normative që përcaktojnë shkurtimin e afateve të fushatës

zgjedhore në zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtëzakonshme. Një ndryshim i tillë do t'i mundësojë subjektet politike dhe qytetarët të kenë kohë të mjaftueshme për fushatat gjithëpërfshirëse dhe përmbajtësore. Përndryshe, nëse subjektet politike vazhdojnë të përkrahin që fushata të mbetet dhjetë ditë për zgjedhjet e parakohshme apo të jashtëzakonshme, trendi i daljes në zgjedhje do të jetë i njëjtë, sepse qytetari nuk ka kohën e duhur që t'i kërkojë llogari përfaqësuesit të tyre. Andaj rekomandohet që të bëhet ndryshimi i dispozitave të Nenit 86.6 dhe Nenit 95.4 i kushtetutes, të rritet afati për organizimin e “zgjedhjeve që kërkohet të bëhet brenda 45 ditëve” dhe të kalohet më së paku në 60 ditë (Kushtetuta Neni 86.6 dhe Neni 95.4). Kjo mundëson rritjen automatike të “kohës për fushatë nga 10 ditë” në së paku 20 ditë fushatë për zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe për ato të parakohshme i përcaktuar sipas Nenit 7 i Rregulles Nr. 15/2010 të KQZ-se (KQZ: Rregulla Nr.15/ 2010, Neni 7) .

Si përfundim i këtij hulumtimi mund të konkludojmë se disa nga arsyet për rënie të pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje është mosbesimi tek vota për ndryshim si dhe për faktin se listat zgjedhore nuk pastrohen (qytetarët e vdekur dhe ata që humbin shtetësinë) si dhe regjistrimi i atyre që jetojnë jashtë Kosovës. Një numër i madh i tyre e mbajnë shtetësinë e Kosovës dhe kjo e bën automatikisht me të drejta të plota për pjesëmarrje në votime. Ndërsa lidhur me trendin e rritjes së votave të humbura sipas analizës dhe interpretimit logjik të saj vijmë në përfundim se gjatë organizimit të zgjedhjeve të parakohshme dhe të jashtëzakonshme, votuesit nuk i ofrohet kohë e mjaftueshme për të vetëdijesuar për mënyrën e votimit dhe trajnimit të administratorëve në procesin zgjedhor. Ky është edhe një argument për reformë zgjedhore kushtetuese dhe ligjore për krijimin e kohës së mjaftueshme për pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Gjithashtu, rekomandohet që qytetarëve me të drejtë

vote me banim jashtë Kosovës, t'i mundësohet që të votojnë në zyrat e ambasadës apo konsullatat e Kosovës dhe Shqipërisë ose me postë kur, nuk ka përfaqësi aty. Një rekomandim tjetër po ashtu, është se kërkohet një angazhim më i fuqishëm i të gjithë aktorëve relevantë si dhe shoqërisë civile për ngritjen e vetëdijes qytetare për fuqinë dhe rëndësinë e votës, dhe pjesëmarrjes në procesin zgjedhor si dhe mënyrës së votimit.

KAPITULLI V: EFEKTI I SISTEMIT ZGJEDHOR TE SISTEMI PARTIAK NË KOSOVË

5.1.Fillimet e pluralizmit në Kosovë

Historia e pluralizmit dhe krijimit të Partive Politike në Kosovë fillon në fund të viteve 80-të (Ismaili, O. 2001). Ndonëse sistemi shumëpartiak është instaluar në të njëjtën kohë kur pluralizmi politik është përhapur në tërë Evropën Juglindore, kushtet në të cilën gjendej Kosova pas okupimit nga Serbia më 1989, nuk lejuan hapësirë për zhvillim të mirëfilltë politik e pluralist sikurse në vendet e tjera. Zhvillimi i sistemit pluralist në Kosovë, mund të ndahet në tri periudha: e para, lindja e pluralizmit, okupimi i Kosovës dhe fillimi i shpërbërjes së Federatës Jugosllave nga viti 1989 deri në vitin 1999 me çlirimin e Kosovës; e dyta, periudha pas luftës dhe vendosja e Prezencës Ushtarake dhe Civile Ndërkombëtare në qershor të vitit 1999 deri te Shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, dhe periudha e tretë, vitit prej shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe deri më sot.

Lindja e pluralizmit politik në Kosovë, fillon si një lëvizje gjithëpopullore. Një grup i Intelektualëve të Kosovës më 23 dhjetor 1989 formojnë subjektin e parë politik, *Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)*. Partitë e tjera të themeluara në atë kohë ishin Partia Social-Demokrate e Kosovës (PSDK), Partia Parlamentare e Kosovës (PPK), Partia Shqiptare Demokristiane (PSHDK) , Partia Fshatare (PF), Partia Liberale e Kosovës (PLK), Lëvizja e Bashkuar Demokratike e Kosovës (LBD); Partia Demokratike Turke e Kosovës (PDTK) dhe Partia e Aksionit Demokratik e Boshnjakëve të Kosovës (PAD), që ndërtuan institucionet e para të Republikës së Kosovës. Baza ligjore ishte Kushtetuta e vitit 1990, një sistem paralel të vetorganizimit politik, jashtë sistemit okupues serb (Ismaili, O. 2001: 57-81;119). Kjo

lëvizje dhe disa parti të tjera në kushte të okupimit siç nënvizon profesor Arsim Bajrami, “provuan të ndërtojnë jetë plurale politike” (Bajrami, A. 2010:380). Kjo periudhë e *Republikës së Kosovës*, e cila ishte e njohur si shtet paralel ose “organizim i institucioneve paralele ”... “një tentativë për ndërtimin e pavarur të strukturave shtetërore” (Bajrami, A. 2010:380-81). Një tranzicion i vonuar për më shumë se një dekadë. Me vendosjen e Administrimit Ndërkombëtar dhe civil të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB, (KS 1999: Rezoluta 1244) u krijua hapësirë e re për zhvillimin e pluralizmit politik dhe ndërtimin e institucioneve demokratike, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror. Shumë nga partitë e vjetra vazhduan të vepronin, ndërkohë që u themeluan edhe parti të reja nga ish komandantët (drejtuesit) e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), pastaj Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Partia Ora, Lidhja Demokratike Dardanisë (LDD), Aleanca e Kosovës së Re (AKR), Nisma dhe Lëvizja Alternativa (AL) (OSBE/KODI 2004;5-37). Kështu që, tranzicioni i mirëfilltë politik nga sistemi monist në sistemin pluralist në Kosovë filloi të ndjehej vetëm pas lirisë së Kosovës. Faza e tretë e zhvillimit të sistemit shumëpartiak filloi me pavarësinë e Kosovës më 17 shkurt 2008. Pasi çështja e pavarësisë u realizua, fillon mundësia për partitë politike për t’u profilizuar dhe për të pasur ideologji të ndryshme. Kjo është një rast për partitë që të ofrojnë programe dhe alternativa për anëtarësinë dhe votuesit e tyre.

5.2. Analizë kornizës ligjore për Regjistrimin dhe Veprimtarinë e Partive Politike në Kosovë

Në kuadër të legjislacionit primar dhe sekondar për regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Kosovë trajtohet themelimi i partive politike dhe organizatave që dëshirojnë të veprojnë si subjekte politike. Kjo kornizë normative i takon dy periudhave kohore. Në periudhën e administrimit të UNMIK-ut ose ndërmjet vitit 2000 dhe 2008, regjistrimi dhe veprimtaria e partive politike është bërë sipas dispozitave të Nenit 2 i Rregullores Nr. 2000/16; Nenit 2 i Rregullorja Nr. 2001/16 “Për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2000/16”, si dhe Nenit 2 i Rregullores Nr. 2002/8 për ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-UT mbi regjistrimin dhe veprimin e Partive Politike në Kosovë (UNMIK/REG/2000/16, Neni 2; UNMIK/REG/2001/16, Neni 2; UNMIK/REG/2002/8, Neni 2). Periudha pas vitit 2008, funksionimi dhe veprimtaria e subjekteve politike në Kosovë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullorja e KQZ-së Nr. 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike. Kushtetuta në kuadër të dispozitave të të drejtave dhe lirive themelore, konkretisht Neni 44.1, “garantohet liria e asociimit” që përfshin edhe të drejtën e çdo qytetari për të themeluar organizata politike. Për më tepër sipas Nenit 45.1 të Kushtetutës, “*çdo shtetas kosovar, që ka arritur moshën 18 vjeç e gëzon të drejtën për të zgjedhë dhe për t’u zgjedhur*” (Kushtetuta 2008, Neni 44-45). Ndërsa, Ligji për zgjedhjet në kuadër të Nenit 12, ka përcaktuar procedurat për “regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e subjekteve politike” (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 12). Përmes këtyre akteve ligjore rregullohet “organizmi i zgjedhjeve dhe

veprimtaria e subjekteve politike”, përveç financimit të tyre që rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-174 “Për Financimin e Subjekteve Politike” (Ligji Nr. 03/L-174, Neni 4-Neni 8).

Në mungesë të një ligji të veçantë për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, kjo çështje është rregulluar me aktet nënligjore nga KZQ-ja, e cila ka nxjerrë rregulla zgjedhore: Rregulla Nr. 01/2013 dhe Rregulla NR. 15/2010, ku përmes të cilave rregullohen procedurat për “regjistrimin e partive politike dhe raportimit të tyre” si dhe procedura për “zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtëzakonshme” (KQZ: Rregulla Nr. 01/2013; Rregulla NR. 15/2010). Megjithatë, Rregulla Nr. 01/2013 për “Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike”, në kuadër të Nenit 3, ka përcaktuar të gjitha “kushtet dhe procedurat për regjistrimin e një partie politike” (KQZ, 2013: Rregulla Nr. 01/2013, Neni 3). Gjithashtu në bazë të Nenit 15, janë përcaktuar “detyrimet për subjektet e themeluara” kur kërkohet që çdo “parti politike, pas regjistrimit është e obliguar të mbajë Kuvendin e saj zgjedhor, të zgjedhë udhëheqësin e partisë dhe organin më të lartë ekzekutiv të saj brenda gjashtë muajsh” nga data e regjistrimit. Këtë proces zgjedhor të subjekteve politike e “monitoron” KQZ-ja (KQZ 2013: Rregulla Nr.01/2013, Neni 15.6). Sipas kësaj baze normative ajo vëzhgon procesin zgjedhor të subjektit të ri i cili duhet të zhvillohet sipas parimit të “demokracisë kushtetuese” apo statutit në bazë të të cilit partitë politike regjistrohen dhe funksionojnë.

Statuti sipas Nenit 14. i Rregullës Nr.01/2013, është dokumenti bazë për çdo subjekt politik përmes të cilit përcaktohen “parimet, rregullat e organizimit të brendshëm të partive politike, struktura, mandati, roli dhe funksioni i të gjitha njësive të saj”. Aty, gjithashtu, përcaktohen : “kriteret për anëtarësim; klasifikohen pozicionet e drejtuesve dhe shpjegohet mënyra e

përzgjedhjes së tyre; përshkruhet roli dhe marrëdhëniet hierarkike të njësive të ndryshme në nivel qendror apo lokal; struktura e organizimit të administratës dhe financat e subjektit politik; komisionet në fusha të rëndësishme si politika, zhvillimi, financa, etj. Përveç këtyre në statut rregullohen procedurat për zgjedhjen e strukturave drejtuese të partisë politike dhe veçanërisht të liderit të saj” (KQZ 2013, Rregulla Nr.01/2013, Neni 14).

Kur flitet për zgjedhjen e liderit të partive politike në Kosovë aplikohen mënyra të ndryshme të zgjedhjeve brenda forcës politike. Kështu që, zgjedhja e liderit bëhet në dy mënyra: direkte nga anëtarët ose indirekte nga Kuvendi. Zgjedhja e “drejtpërdrejtë e liderit”, realizohet përmes pjesëmarrjes së anëtarëve të partisë që votojnë për zgjedhjen e kryetarit të tyre. Në këtë mënyrë zgjidhet “Kryetari” apo “presidenti” i partisë LVV dhe AKR (LVV-Statuti 2012: Neni 28; AKR-Statuti 2017; Neni 33) ndërsa, në rastin e zgjedhjes së kryetarit në mënyrën “indirekte nëpërmjet përfaqësuesve” (delegatë) të degëve të zgjedhur nga anëtarësia e saj në Këshill të Përgjithshëm, Konventa ose Kongrese kombëtare, që votojnë për zgjedhjen e Kryetarit të Partisë funksionon te LDK, PDK, AAK, Nisma për Kosovën, Alternativa (LDK Statuti 2012 Neni19; PDK-Statuti 2010, Neni 34; AAK-Statuti 2016, Neni 13; Nisma për Kosovën - Statuti 2015, Neni 16; Alternativa 2017, Neni 13). Megjithatë, disa subjekte politike që nga themelimi i tyre drejtohen nga liderët e njëjtë apo thënë ndryshe nga themeluesit e partisë. PDK-ja është drejtuar prej vitit 1999-2016 nga Kryetari Hashim Thaçi; AAK-ja nga viti 2000-2018 udhëhiqet nga themeluesi Ramush Haradinaj si dhe, AKR nga viti 2007-2018 prej themeluesit Bexhet Pacolli (PDK 2017, AAK 2018, AKR 2018).

Megjithatë në demokracinë elektorale për periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2014 në Kosovë janë regjistruar 84 parti politike, shtatëmbëdhjetë (17) janë çregjistruar si dhe dy prej tyre janë shkrirë (KQZ 2017:37). Ky zhvillim i pluralizmit politik nga zgjedhjet e para lokale të vitit 2000, deri ato nacionale të vitit 2014 pasqyrohet në Tabelën 10. Aty pasqyrohet numri i partive politike që janë regjistruar si dhe atyre të çregjistruara në Kosovë.

Tabela 10. Partitë politike të regjistruara dhe të çregjistruara 2000-2014

Viti	Të regjistruara	Të çregjistruara	Të shkrira/ Shuara
2000	17		
2001	4		
2002	6		
2003	0		
2004	3		
2005	1		
2006	5		
2007	7		
2008	1		
2009	5	6	
2010	14	0	1
2011	0	7	1
2012	4	0	
2013	8	1	
2014	9	3	
Total	84	17	2

Burimi: KQZ: 2017:37

Kur analizojmë Tabelën 10, vërejmë se pas vitit 2008 ka pasur një lëvizje në rritje të regjistrimit dhe çregjistrimit të partive politike. Kjo reflekton zhvillimin e proceseve politike para dhe pas zgjedhjeve brenda subjekteve politike, lindjen e fraksioneve dhe ndarjes së tyre nga partia si dhe pjesëmarrja në zgjedhje dhe integrimi i plotë i komunitetit serb në institucione.

Në çdo proces zgjedhor numri i subjekteve politike që janë certifikuar vazhdimisht ka ndryshuar, përveç asaj të vitit 2001 dhe 2007 të cilat janë të njëjta. Kjo pasqyrohet në Tabelën 11. Ndërsa, subjektet politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë dhe numri i subjekteve që kanë hyrë në Kuvend e kanë marrë mandate parlamentare pasqyrohen në Tabelën 14 (më gjerësisht trajtohen në Kapitullin e VI).

Tabela 11. Subjektet Politike të certifikuara për zgjedhjet e përgjithshme (2001 –2017)

Viti	Parti	Koalicion	Inic. Qytetare	K/ të pavarur	Totali
2001	19	2	2	3	26
2004	22	1	5	5	33
2007	19	2	2	3	26
2010	24	2	3	0	29
2014	18	4	7	1	30
2017	15	5	6	0	26

Burimi: KQZ:2017:38 dhe KQZ//QNR 2007 -2017

Gjithashtu, nga statistikat e paraqitura në Tabelën 11, vërejmë se ka lëvizje në rritje nga zgjedhjet e para të vitit 2001 deri te ato të fundit të vitit 2017. Me vendosjen e pragut zgjedhor prej 5% i përcaktuar sipas Nenit 111.2 i Ligjit zgjedhor (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 111.2.a) fillon gradualisht ulja e pjesëmarrjes së partive politike si të vetme në procesin zgjedhor si dhe ka rritje të koalicioneve parazgjedhore. Efektin e pragut të lartë e vërejmë nga zgjedhjet e viteve 2007 deri 2017. Ky impakt i rritjes së koalicioneve parazgjedhore si dhe ulja e numrit të partive politike për të garuar të vetme në zgjedhje nacionale për subjektet politike shqiptare është rezultat i pragut prej pesë përqind (5%). Lidhur me pjesëmarrjen e subjekteve politike të certifikuar në zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme pasqyrohet në Tabelën 12 dhe 13 (KQZ 2017:38 & KQZ/QNR 2007&2017). Aty paraqiten në mënyrë specifike statistikat mbi pjesëmarrjen e subjekteve politike, në veçanti, partitë politike, koalicionet parazgjedhore, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur në zgjedhjet

lokale dhe të përgjithshme. Gjithashtu, në Tabelën 12, janë pasqyruar statistika sipas përkatësisë etnike të tyre.

Tabela 12. Numri i Subjekteve Politike të certifikuara për zgjedhjet lokale dhe përkatësia e tyre etnike (2000-2013)

Vitet	P. polit	Koalic	IQ	Kand P.	Komunitet/Etnia							
					Total	Alb	Serb	Bosh/ Gor	RAI	Turq	Malazez	Kroat
2000	19	2	3	15	39	29	-	4	4	2	-	-
2002	28	1	28	11	68	25	30	6	5	1	-	1
2007	25	2	36	33	96	51	33	6	3	3	-	-
2009	37	2	19	16	74	34	22	7	5	4	2	-
2013	33	2	52	16	103	50	31	10	5	3	3	1

Burimi: Autori bazuar në të dhënat e KQZ: 2017:38

Sipas Nenit 3.1 të Kushtetutës, Kosova përcaktohet “shoqëri shumëetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike” (Kushtetuta, Neni 3.1). Megjithatë, Tabela 12 reflekton diversitetin politik, ideologjik dhe etnik të shoqërisë kosovare si dhe pluralitetin politik të strukturuar në subjektet politike. Për më tepër, ajo (Tabela 12) pasqyron pluralitetin e proceseve zgjedhore dhe subjektet politike të certifikuara për zgjedhjet lokale sipas përkatësisë etnike dhe pjesëmarrjen e subjekteve politike në garën zgjedhore për Kuvendin e Komunës si dhe zgjedhjet për kryetarin e Komunës për vitet 2001-2013 (KQZ 2017:38). Në dy ciklet zgjedhore ato të vitit 2007 dhe 2009, numri i subjekteve është më i madh për dy arsye, e para në vitin 2007 janë mbajtur njëkohësisht zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme. Shumë kandidatë për kryetar të komunave kane qenë edhe kandidat për deputet, dhe e dyta në zgjedhjet e vitit 2013 janë regjistruar për certifikim edhe subjektet politike që përfaqësojnë komunitetin serb që jeton në veri të vendit apo në komunat Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Zubin Potok (KQZ 2017:38).

Përveç Tabelës 11, e cila pasqyron numrin e subjekteve politike të certifikuara në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës edhe përmes Tabelës 13, krahasohet dhe pasqyrohet numri i subjekteve politike sipas përkatësisë etnike pjesëmarrëse në proceset zgjedhore nacionale nga viti 2001-2014.

Tabela 13. Numri i partive Politike të certifikuara për zgjedhjet nacionale dhe përkatësia e tyre etnike (2001-2014)

Komuniteti	Zgjedhjet 2001	Zgjedhjet 2004	Zgjedhjet 2007	Zgjedhjet 2010	Zgjedhjet 2014
Shqiptar	19	21	10	7	9
Serb	1	2	8	9	5
Boshnjak/goran	2	5	3	5	8
Turq	1	1	2	2	2
RAI	3	4	3	6	6
Malazez	0	0	0	1	0
Kroat	0	0	0	0	0
Gjithsej	26	33	26	29	30

Burimi: KQZ 2017:38,& KQZ/QNR 2007

Sipas të dhënave statistikore që pasqyron Tabela 13 dhe duke i krahasuar ato, vërejmë se numri i subjekteve politike të certifikuara dhe që përfaqësojnë shqiptarët nga zgjedhjet e para, e më vonë ka rënie të numrit si dhe ka një rritje të komuniteteve të tjera. Gjithashtu, në zgjedhjet e qershorit të vitit 2017, janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje 26 subjekte politike (KQZ:QNR 2017). Megjithatë, numri i tyre do të ishte shumë më i madh, sepse për herë të parë në këto zgjedhje janë bërë grupime apo blloqe të partive të mëdha ose koalicione të subjekteve parlamentare dhe jo parlamentare. Në kuadër të dy koalicioneve më të mëdha të PAN¹³ dhe LAA¹⁴ janë bërë pjesë e tyre edhe dhjetëra parti politike të tjera

¹³ Sqarim: Koalicioni PAN është i përbërë nga PDK; AAK; NISMA; PD; LB; PSHDK; PK; PLK; ADK; - REK; -PB; PSD; BKK

¹⁴ Sqarim: Koalicioni LAA është i përbërë nga LDK, AKR, AL, LD.

(KQZ/QNR 2017). Qëllimi i krijimit të këtyre koalicioneve të mëdha ka qenë për të dalë subjekti i parë në procesin zgjedhor dhe njëkohësisht për ta marrë primatin për ndërtimin e institucioneve qeverisëse. Kjo është vendosur me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për procedurën e formimit të Qeverisë (Gjykata Kushtetuese 2014, Rasti Nr. KO103/14 dhe Rasti Nr. KO119/14) e cila përcakton, se i takon vetëm subjektit të parë të dalë nga zgjedhjet të ndërmarrë iniciativën për formimin e institucioneve.

Sidoqoftë veprimtaria e subjekteve politike duhet të jetë konform normativës me të cilën janë themeluar (KQZ: Rregulla Nr. 01/2013). Si dhe sa zbatohet kjo normativë është përgjegjësi e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike, si mekanizëm kontrollues dhe sanksionues, për t'i monitoruar. Sipas shoqërisë civile ajo nuk ka mundur që të “monitorojë me efikasitet veprimtarinë e partive politike dhe t'i sanksionojnë ato kur shkelin legjislacionin në fuqi”, dhe kjo rrjedhimisht ka reflektuar edhe “praktikat jodemokratike brenda partive politike” (IDK 2014:23). Për të evituar këto dukuri është e domosdoshme të ndryshohet dhe plotësohet legjislacioni në fuqi për zgjedhjet si dhe aktet për regjistrimin dhe veprimtarinë e subjekteve politike. Me këtë do të mënjanohej praktikat e rregullimit me akte nënligjore të çështjeve shumë të rëndësishme siç janë: zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtëzakonshme apo edhe regjistrimi dhe funksionimi i partive politike të cilat në mungesë të vakuumit ligjor janë të rregulluara me akte nënligjore (KQZ 2013. Rregulla nr. 15/2013&Rregulla Nr. 01/2013).

Në përfundim mund të konkludojmë se është e domosdoshme reforma ligjore dhe institucionale me qëllim të avancimit të sistemit të pluralizmit demokratik. Konkretisht, rekomandohet që të hartohet ligji për regjistrimin, funksionimin e partive politike. Në

kuadër të këtij ligji të parashihet kalimi i përgjegjësisë nga KQZ-ja te Gjykata e Apelit në Prishtinë: Regjistrimi i Partive politike; interpretimi i statutit dhe zgjidhjen e kontesteve statutore të partive politike pasi ato të jenë shteruar para organeve të partisë; të formohet një zyrë për auditim të financave të partive politike e cila duhet të funksionojë pranë Auditorit Gjeneral.

Këto ndryshime ligjore dhe mekanizmeve institucionale mund të garantojnë respektimin e normativës ligjore dhe standardet për proceset zgjedhore, regjistrimin, veprimtarinë dhe kontrollin e financave të partive politike.

5.3.Sistemi partiak në Kosovë

Mbi studimet për lidhjen ndërmjet sistemeve partiake me sistemet zgjedhore ka një traditë të konsiderueshme në literaturën e shkencave politike. Janë të shumtë autorët që studiojnë “sistemet zgjedhore dhe efektet e tyre politike” në përgjithësi si dhe të “sistemit partiak¹⁵ në veçanti” (Maurice Duverger (1954:217-239), Rea, D. (1967:47), Sartori, G. (1976:53-4), Arend Lijphart (1994:41), Alan Siaroff (2000:69-80), Lawrence Ezrow (2010:68-74). Të gjithë theksojnë se sistemet zgjedhore ndikojnë te numri i partive politike në Parlament ose te sistemi partiak në një sistem politik. Në këtë kontest edhe sistemi partiak në Kosovë është i determinuar përveç sistemit proporcional, me një zonë të vetme dhe pragut zgjedhor prej 5 përqind edhe nga faktorë të tjerë të rëndësishëm siç janë sistemi i kuotës etnike dhe

¹⁵ Përkufizimi i sistemit partiak sipas Daniel-Louis Seiler, “si bashkësi e strukturuar e përbërë nga marrëdhënie herë bashkëpunimi herë kundërvënie që ekziston midis partive politike që veprojnë në skenën politike të një shoqërie” (Seiler, L. D. 2000:146)

legjislacioni përkatës për regjistrimin dhe veprimtarinë e partive politike. Në veçanti sistemi elektoral me një zonë dhe ai i kuotës etnike janë ndër faktorët kryesorë që kanë determinuar sistemin shumëpartiak në Kuvend. Përveç, këtyre faktorëve edhe “legjislacioni për regjistrimin, veprimtarinë dhe financimin e partive politike” e ka lehtësuar këtë proces (Kushtetuta, Ligji Nr.03/L-073; Ligji Nr.03/L-174; KQZ: Rregulla Nr. 01/2013). Mandej pragu prej pesë përqind (5%) mund të konsiderohet që ka ndikuar në sistemin e partive politike në Kosovë. Megjithatë, ndikimi i tij ka reflektuar vetëm tek “partitë politike që përfaqësojnë komunitetin shumicë” në vend (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 111.2.a), e në veçanti, partitë e vogla, ashtu siç thotë Norris “ndëshkohen” rëndë për shkak të “pragut të lartë zgjedhor” (Norris P.2004:9). Impakti i këtyre faktorëve pasqyrohet në dy Tabelat 10 dhe 11, Partitë politike të regjistruara dhe të çregjistruara, dhe Tabela 11, Subjektet Politike të certifikuara në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës nga viti 2001 - 2017. Për më tepër, kur analizohet aspekti statistikor i subjekteve të certifikuara për pjesëmarrje në zgjedhje dhe atyre që kanë mundur të kalojnë prapun zgjedhor dhe duke i krahasuar ato rezulton me një ndryshim shumë të madh midis tyre.

Një argument të tillë e mbështesim duke u bazuar në të dhënat që prezantohen në Tabelën 14, apo grafiku 3 që pasqyron numrin e subjekteve elektorale dhe atyre të përfaqësuar në Kuvend, si dhe Tabelën 15 mbi pjesëmarrjen e partive politike, koalicioneve, iniciativa, kandidatëve të pavarur në zgjedhjet për Kuvendin.

Tabela 14. Numri i subjekteve politike elektorale dhe Parlamentare (2001-2017)


Subjektet	2001	2004	2007	2010	2014	2017
Elektorale	26	33	26	29	30	26
Parlamentare	15	19	17	17	15	13

Burimi: OSBE/CEC/UNMIK:2001-2004 & KQZ/QNR 2007-2017

Të dhënat statistikore të paraqitura në Tabelën 14, kur krahasohen, tregojnë diferencën midis subjekteve konkurruese dhe atyre parlamentare. Kjo diferencë do të ishte shumë më e lartë midis subjekteve konkurruese elektorale dhe atyre fituese parlamentare nëse nuk do të kishte koalicione parazgjedhore si dhe kuotë etnike për përfaqësimin e etnive (për më shumë shih Kapitullin e Gjashtë).

Gjithashtu, sistemi partiak në Kosovë në mënyrën grafike paraqet diferencat në mes subjekteve konkurruese në zgjedhje dhe atyre që kanë arritur të bëhen subjekte parlamentare që nga zgjedhjet e para parlamentare të vitit 2001 dhe deri te ato të fundit në vitin 2017.

Grafiku 3. Subjektet e certifikuara elektorale dhe parlamentare (2001-2017)



Burimi: OSBE/CEC/UNMIK: 2001-2004, KQZ/QNR 2007-2017:

Në përgjithësi siç e vërejmë në grafikun nr. 3, certifikimi i subjekteve politike për pjesëmarrje në një garë zgjedhore është i përafërt në çdo raund zgjedhje me një ndryshim në numër të vogël.

Një pasqyrim i krahasuar dhe më përmbajtësor lidhur me pjesëmarrjen e subjekteve të certifikuara si parti politike, koalicione, iniciativa qytetare apo si kandidatë të pavarur në zgjedhjet parlamentare (2001-2017) paraqitet në Tabelën 15.

Tabela 15. Pjesëmarrja e partive, koalicioneve, iniciativa, kandidatë të pavarur në zgjedhjet e përgjithshme (2001-2017)


Viti	Parti	Koalicion	Iniciativa Qytetare	K/ të pavarur	Gjithsej
2001	19	2	2	3	26
2004	22	1	5	5	33
2007	19	2	2	3	26
2010	24	2	3	0	29
2014	18	4	7	1	30
2017	15	5	6	0	26

Burimi: KQZ 2017:39& KQZ/,QNR 2007- 2017

Efekti i vendosjes së pragut zgjedhor prej 5% nga zgjedhjet e vitit 2007 e më pas reflektohet në çdo proces zgjedhor. Efektet e para të pragut (të lartë) reflektohen në zgjedhjet e vitit 2007, e në veçanti zgjedhjet e fundit. Kjo paraqitet në dy drejtime: rritje të koalicioneve parazgjedhore, iniciativave qytetare dhe ulje të numrit të partive politike që marrin pjesë si subjekte të vetme në zgjedhje (shih Kapitullin VI). Si pasojë, kemi zvogëlime apo ulje të numrit të subjekteve politike apo sistemit partiak në Kuvend. Kjo pasqyrohet në kuadër të Tabelës 15.

Ndërsa lidhur me pjesëmarrjen e partive politike, koalicioneve, iniciativa qytetare dhe kandidatëve të pavarur në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës nga viti 2001 - 2017 është pasqyruar edhe në grafikun 4.

Grafiku 4. Pjesëmarrja e partive politike, koalicioneve, iniciativa qytetare dhe kandidatët e pavarur në zgjedhjet e përgjithshme (2001 - 2017)



Burimi: KQZ 2017:38 & KZQ/QNR 2017

Si përfundim, aplikimi i sistemit LPP me një zonë të vetme dhe pragut me 5% ka ndikuar në zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit të pluralizmit partiak në Kosovë. Megjithatë, sistemi LPP me një zonë të vetme zgjedhore në Kosovë ka prodhuar “parti elektorale” më shumë se sa “parti politike përfaqësuese” (KQZ 2017:38 & KZQ/QNR 2017). Kjo ka bërë që shumë subjekte politike të shfaqen disa ditë para zgjedhjeve ndërsa, pas përfundimit të ciklit zgjedhor nuk shfaqen me ndonjë aktivitet për të treguar ekzistencën e tyre si parti jashtëparlamentare. Pragu i lartë zgjedhor i ka defaktorizuar shumë partitë e vogla politike. Duke ndikuar që partitë e vogla politike (dhe parti liderësh ku vetëm lideri njihet në publik) të strukturuar dhe me anëtarësi të shpërndarë për të ruajtur subjektivitetin e tyre politik dhe përfaqësues, detyrohen të hyjnë në koalicione me partitë e mëdha si shans i vetëm për të hyrë në Kuvend. Në këtë mënyrë ato më shumë kanë kontribuar në rritjen e numrit të votuesve

për koalicionin, se sa për subjektin e tyre, sepse çdo votë për koalicionin automatikisht e rrit proporcionalitetin e votës e cila është e disfavorshme për kandidatët e tyre brenda listës zgjedhore të koalicionit. Këtë hipotezë e argumenton edhe rezultatet zgjedhore të zgjedhjeve të fundit (2014 dhe 2017) ku në kuadër të koalicioneve (p.sh. PAN-it) ishin edhe shumë parti, por në fund nuk rezultuan me asnjë vend në Kuvend (KQZ/QRN: rezultati zgjedhor 2014 - 2017). Për të krijuar një qëndrueshmëri të sistemit partiak (elektoral dhe postelektoral) rekomandohet të ulet pragu zgjedhor nga 5% në 3% për subjektet politike, dhe të caktohet pragu një përqind (1%) për kandidatët e pavarur. Për këtë përsëritet rekomandimi për ndryshimin e dispozitës të Neni 111.2.a i Ligji Nr. 03/L-073. Gjithashtu, të rriten kriteret që lidhen me numrin e mbështetësve për të krijuar një parti politike nga 500 në 1000 anëtarë me të drejtë vote dhe të nënshkruar në listë si dhe të rritet eficensa në mbikëqyrjen e respektimit të rregullave statutoire gjatë funksionimit të tyre. Në përfundim, mund të konkludojmë se sistemi partiak në Kosovë është sistem i konsoliduar dhe i qëndrueshëm shumëpartiak dhe me orientime të ndryshme programore.

5.4.Gjetjet e hulumtimi për masat dhe aktivitetet që kërkohet të ndërmerren nga partitë politike

Ndikimi i sistemit zgjedhor në demokracinë e brendshme të partive politike në Kosovë është i madh në mënyrën e zgjedhjes dhe ndërrimit të elitave drejtuese dhe përfaqësuese. Zgjedhja e lidershit, përzgjedhja e listës së kandidatëve për deputet dhe pjesëmarrjes së anëtarësisë në këtë proces, janë pothuajse sfida të njëjta për të gjitha subjektet politike. Përveç zgjedhjes së liderit të subjekteve politike, statutet e tyre kanë përcaktuar edhe

mënyrën e propozimit, zgjedhjes së kandidatëve për poste politike nga strukturat e Partisë dhe që miratohet në organet më të larta vendimmarrëse partiake. Sipas Nenit 24 të statutit të LDK-së propozimet për deputet dhe postet publike pas propozimit të Kryesisë, aprovohen nga Këshilli i Përgjithshëm (LDK 2012, Statuti, Neni 24.1).

Në mënyrë të njëjtë edhe PDK, sipas Nenit 50 të statutit ka përcaktuar se propozimi për postet publike bëhet nga Komisioni për Burime Njerëzore ndërsa verdiktin përfundimtar e jep Kryesia e Partisë (PDK 2010, Statuti Neni 46.11; Neni 50). Edhe LVV përfaqësimin në institucione e ka përcaktuar përmes Neneve 82-88 të statutit dhe është Këshilli i Përgjithshëm i LVV që jep miratimin përfundimtar (LVV 2012 Statuti, Neni 82-88). Ndërsa në AAK, sipas Nenit 18 të statutit propozimet bëhen nga Kryetari i partisë dhe verdiktin përfundimtar e jep Këshilli Drejtues (AAK 2016, Statuti, Neni 18.6). Kurse AKR përmes Nenit 34 të statutit i jep të drejtë presidentit të partisë të vendosë për postet publike (AKR 2017, Statuti Neni 34.6).

Përveç ndikimit që kanë normat statutore, pjesëmarrja e anëtarësisë në zgjedhjet partiake është shumë e rëndësishme. Veçanërisht këto reflektojnë në zgjedhjet dhe funksionimin e brendshëm të partive, gjatë proceseve zgjedhore për pozitat udhëheqëse partiake¹⁶ dhe institucionale që shpeshherë, sjellin pasoja negative për ruajtjen e kohezionit dhe unitetin e partisë, e më tej suksesin në zgjedhjet nacionale apo lokale. Kështu që, zgjedhja e kandidatëve është një proces i rëndësishëm në ruajtjen e relacionit të një partie politike me


¹⁶ Shënim: Mospajtimet rreth menaxhimit dhe zgjedhjes së kryetarit të partisë ka prodhuar subjekte të reja në Kosovë: nga LDK-ja është krijuar LDD 2006, nga PDK-ja është krijuar Nisma për Kosovën 2013, nga PD-ja është krijuar Lëvizja për Drejtësi 2017, nga AKR është krijuar Alternativa 2017 si dhe nga LVV-ja është krijuar Grupi i pavarur, 2018.

anëtarësinë e saj dhe elektoratin e tyre. Përveç aspektit elektoral është i rëndësishëm, qasja normative e respektimit të dispozitave statutores që përcaktojnë mënyrat e propozimeve dhe përzgjedhjes së anëtarëve të saj në të gjitha nivelet strukturore.

Lidhur me këtë, është realizuar hulumtimi empirik dhe është marrë opinionimi nga përfaqësuesit e subjekteve politike dhe drejtuesit e saj, për sa i përket cilësive të rëndësishme të kandidatit për t'u zgjedhur lider në parti; kushtet që kërkohet të plotësojë një kandidat i pavarur para se të hyjë në listën garuese të partisë si dhe nga kush duhet të bëhen këto propozime dhe sa janë të hapura partitë politike për anëtarë të rinj. Për të gjitha këto çështje, janë nxjerrë të dhëna të dorës së parë nga hulumtimi.

Në pyetjen se *Cilat cilësi janë me të rëndësishme në zgjedhjen e liderit të partisë?* Rezultatet nga përgjigjet janë radhitur sipas mbështetjes së opinionit në këtë mënyrë: E para, si cilësi më e rëndësishme sipas opinionit të 50% të deklaruarve është se “*kandidati duhet të jetë menaxher (intelektual) i mire*”; e dyta, elementi i “*karizmës së liderit*” është i rëndësishëm për 26.9% të respondentëve për të zgjedhur liderin e tyre; “*besnikëria ideologjike ndaj partisë*” është radhitur e treta e mbështetur prej 17.9%, si dhe cilësia e fundit e liderit që është mbështetur nga 5.2% prej tyre thonë se do t’ia japin mbështetjen një kandidati “*biznesmen*”, që ka aftësi për të kontribuar financiarisht për partinë. Këto opinione pasqyrohen në Figurën 6.

Figura 6. Cilat cilësi janë më të rëndësishme për zgjedhjen e liderit të partisë




Burimi: Autori bazuar në rezultatin e hulumtimit, 2017

Në përgjithësi opinioni është mbështetur te kualifikimi akademik i kandidatit për lider dhe është e preferuar që ai paraprakisht të jetë i dëshmuar si një menaxher apo intelektual i mirë. Bazuar në rezultatin e pasqyruar me lart arrijmë në përfundimin se, qytetarët për udhëheqës të partisë së tyre, gradualisht po ndryshojnë mbështetjen nga ajo për lider karizmatik ose lider mitik, në lider pragmatik.

Ndërsa, lidhur me kushtet që duhet të përmbushin kandidatët potencialë për të hyrë në listën partiake për garën zgjedhore për deputet, respondentët janë pyetur: *Për kandidatët potencialë për deputet, a duhen të jenë anëtarë të partisë para se të bëhen pjesë të listës së partisë?* Rezultati i hulumtimit na jep këtë pasqyrë të të dhënave: për opsionin se një kandidat që është jashtë partisë, së pari duhet të bashkohet me partinë, të anëtarësohet aty e më pastaj të bëhet pjesë e listës është mbështetur nga 42.1% e të anketuarve. Alternativa e dytë e mbështetur prej 34.2% është opsioni se kandidatët e përshtatshëm nuk kanë nevojë të jenë anëtar të partisë, pastaj, opsioni i tretë i mbështetur prej 13.2% deklarojnë se

kandidatët para se të hyjnë në listën e partisë për deputet duhet të jenë se paku tri vite më parë të anëtarësuar në parti, ndërsa, dy opsionet me më pak mbështetje është se kandidati duhet të jetë anëtar paraprakisht për një vit, ka marrë mbështetje prej 6.4% kurse, kandidati duhet të jetë paraprakisht disa muaj përpara anëtar i partisë është mbështetur vetëm nga 5% e respondentëve. Ky rezultat pasqyrohet në Figurën 7.

Figura 7. Kushtet për kandidatët për deputet dhe a duhet të jetë anëtar i partisë para se të behet pjesë e listës së partisë




Burimi: Autori bazuar në të dhënat nga hulumtimi 2017

Bazuar në rezultatin e hulumtimit mund konkludojmë se për anëtarësinë e subjekteve politike është më e pëlqyeshme që paraprakisht kandidatët të anëtarësohen në parti dhe pastaj të hyjnë në listën zgjedhore, në mënyrë që së pari, ai të marrë mbështetjen e strukturave dhe anëtarësisë së saj dhe pastaj nga përkrahësit e tjerë. Edhe pse një përqindje e madhe i kushtojnë rëndësi begraundit të kandidatit më shumë se sa të qenit anëtar apo jo i partisë. Megjithatë, për të pasur suksese në garën zgjedhore duhet të identifikohesh me subjektin të cilën e përfaqëson ose do të përfaqësohet në të ardhmen në Kuvend.

Një çështje tjetër e hulumtuar është raporti i kandidatit dhe partisë politike me mbështetësit ose votuesit e tyre. Në pyetjen: *Sa bashkëveprojnë partitë politike apo kandidatët me përkrahësit/votuesit e tyre?* Lidhur me koordinimin midis partisë, kandidatit dhe raportin me votuesit e tyre kanë dalë këto rezultate: për alternativën e parë, ka pak koordinim në mes përfaqësuesve dhe zgjedhësve me votuesit e tyre, janë deklaruar 59.2%; e dyta, ka koordinim të mirë në mes të përfaqësuesve dhe votuesve janë deklaruar 25%; e treta, ka koordinim shumë të mirë deklarojnë vetëm 4% si dhe alternativa s'ka fare koordinim në mes partisë, kandidatit dhe votuesve janë deklaruar 11.8% e respondentëve. Ky rezultat pasqyrohet në Figurën 8.

Figura 8. Sa bashkëveprojnë partitë politike apo kandidatët me përkrahësit/votuesit e tyre




Burimi: Autori bazuar në të dhënat e hulumtimit 2017

Duke u bazuar në rezultatin e pasqyruar më lart (Figura 8), arrijmë në përfundimin se partitë politike dhe kandidatët e tyre pas procesit zgjedhor e humbin kontaktin me mbështetësit e tyre, andaj ata rekomandohen që të vazhdojnë të komunikojnë dhe të ruajnë bashkëpunimin me bazën e tyre zgjedhore gjatë gjithë kohës së veprimit e jo vetëm në kohë parazgjedhore.

Gjithashtu, një çështje me interes që është hulumtuar ka qenë sa partitë politike janë të hapura të rekrutojnë anëtarësi të reja. Për më tepër, respondentët janë pyetur: *Nëse partia është e hapur të rekrutojë më shumë anëtarë dhe çfarë aktiviteteve ndërmerr?* Lidhur me këtë kemi nxjerrë këtë rezultat: Opsioni i parë më i mbështetur nga respondentët është se Partia për të anëtarësuar më shumë anëtarë të rinj, ndërmerr veprime duke i dhënë hapësirë përkatësisht atyre. Për këtë janë deklaruar 58.7%; alternativa e dytë, se Partia duhet të organizojë më shumë ngjarje shoqërore dhe politike për të tërhequr anëtar të rinj janë deklaruar 17.3%; e treta, deklarojnë se zgjedhja e liderit karizmatik është hapi më i duhur për prurje të reja deklarojnë 12%; partia krijon më shumë mundësi për karrierë janë deklaruar 5.5% si dhe partia nuk është e hapur deklarohen 4.4%; nuk më intereson 1.1% apo nuk e di janë deklaruar 1%. Kjo pasqyrohet në figurën 9.

Figura 9. Sa partia është e hapur të rekrutojë anëtarë apo jo.




Burimi : Autori bazuar në rezultatin e hulumtimit 2017

Bazuar në rezultatin e hulumtimit dhe pas analizës dhe interpretimit logjik të saj dalim me rekomandim për partitë politike. Ato duhet të bëjnë reforma që krijojnë hapësirë më të madhe për anëtarët e rinj, apo prurjet e reja. Kjo të shikohet si mundësi e mirë për të rritur dhe zhvilluar kapacitetet humane në Parti. Integrimi i tyre në strukturat partiake,

përveç që e lehtëson ndërrimin e elitave drejtuese por reflektohet edhe në ruajtjen e anëtarësisë, njëkohësisht siguron mbështetjen politike të saj në shoqëri .

Një çështje tjetër e hulumtuar është edhe procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për postet publike. Ky proces është po aq i rëndësishëm sa edhe vetë profili i kandidatëve të përzgjedhur. Lidhur me këtë, kemi shtruar pyetjen se: *kush duhet të bëjë nominimin e kandidatëve për garën zgjedhore?* Rezultati i nxjerrë pasqyron se një shumicë prej 78.4%, kanë mbështetur opsionin se anëtarësia së bashku me forumet e partisë duhet të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve për deputet. Mundësia që lideri i partisë të bëjë nominimin e kandidatëve është mbështetur vetëm nga 12.9% e respondentëve. Ndërsa, opsioni i përzgjedhjes së kandidatëve nga një grup brenda partisë është mbështetur prej 7.9% si dhe opsioni më pak i mbështetur prej 0.8% është ai i përzgjedhjes se kandidatëve nga miqësitë politike apo grupet klanore që është refuzuar. Këto rezultate janë pasqyruar në Figurën 10.

Figura 10. Kush duhet të vendosë për listën zgjedhore për kandidat për deputet



Burimi : Autori bazuar në rezultatin e hulumtimit 2017

Në bazë të rezultatit të pasqyruar në Figurën 10 dhe interpretimit logjik të saj arrijmë në përfundimin se partitë politike për të pasur suksese në garën zgjedhore, duhet që paraprakisht

të hapin diskutimin dhe debatin në strukturat për përzgjedhjen e kandidatëve të pranueshëm nga anëtarësia e saj dhe pastaj të vendosin listën e partisë për pjesëmarrje në garën zgjedhore, sepse përvoja zgjedhore ka treguar se kandidati i nominuar nga partia ose lideri i saj pa marrë pëlqimin e strukturave të degës dhe nëndegëve, nuk ka pasur suksese në garën zgjedhore, për faktin e mosmbështetjes nga strukturat e partisë. Si shembull marrim zgjedhjet lokale të vitit 2009, kandidati për kryetar të Prishtinës nga PDK ose i caktuar pa koordinim me strukturat e degës, nuk e mori mbështetjen apo votat e anëtarësisë së saj. Ky ishte një rast ndër shumë të tjerë që sa herë që është përsëritur në zgjedhjet lokale apo edhe nacionale, kandidati nuk ka marrë mbështetjen e strukturave partiake.

Duke u bazuar në të dhënat e pasqyruara më lart mund të konkludojmë se anëtarësia e partive politike si dhe qytetarët e kanë më të preferuar që kandidati së pari të jetë i pranueshëm për të gjitha strukturat për të marrë mbështetjen maksimale në procesin zgjedhor. Kështu që, partitë politike rekomandohen që gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve, listës për garën zgjedhore, paraprakisht të hapin debatin me strukturat e tyre dhe të respektojnë propozimet që vijnë nga strukturat e saj.

KAPITULLI VI: SISTEMI POLITIK DHE KUSHTETUES NË KOSOVË

6.1.Konteksti dhe historiku

Historia e shtetndërtimit të Kosovës sipas Marc Weller (2009), kaloi nëpër “sisteme të ndryshme politike dhe të qeverisjes”. Lëvizjet për liri dhe shtetin e Kosovës kanë vepruar gjatë gjithë historisë së saj. Zhvillimet e këtyre proceseve sipas Ukshin Hotit kishin për qëllim “realizimin e aspiratave të kosovarëve për të qenë të barabartë” si çdo popull tjetër i Evropës apo “të drejtës së Kosovës në vetëvendosje” (Hoti, U 1997: 95). Ai argumenton kërkesën e kohës për demokraci, sepse “me demokraci mendohet të arrihet në Evropë, ndërsa me Evropë mendohet të kihet demokraci” (Ukshin Hoti, 1997:94). Ndërsa sipas prof. Gani Bobit, dy qëllimet kryesore të njëkohësishme që sot ia kanë vënë vetes shqiptarët: “ndërtimi i një shoqërie demokratike e pluraliste dhe pavarësimi nga sundimi serb, kërkojnë identifikimin veprues mbi baza dhe parime të ndryshme me vlerat e reciprocitetit dhe të participimit. Pa një identifikim racional me të parin, më kot të flasim për demokratizimin dhe pluralizmin dhe pa një identifikim të vërtetë me të dytat, më kot të synohet pavarësia” (Bobi, G. 1994:148-49).

Proceset drejt lirisë, pavarësisë dhe demokratizimit në Kosovë, filluan me Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut 1990, me miratimin e Kushtetutës të Republikës më 7 shtator 1990 (që njihet si Kushtetuta e Kaçanikut), me organizimin dhe mbajtjen e Referendumit më 27-30 shtator të vitit 1991. Duke u bazuar në rezultatin e referendumit, 99.87% të qytetarëve pjesëmarrës në referendum që u deklaruan për Pavarësi, “deputetët e Kuvendit të Kosovës më 18 tetor 1991, shpallin Rezolutën për Republikën e Kosovës shtet sovran dhe i pavarur”

(Bajrami, A.1996:72-88, Bajrami, A. 2005:291; Weller, M. 2009:69-89). Organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve të lira për "institucionet e shtetit të Kosovës" u mbajtën më 24 maj 1992 (Bajrami, A.1996:82). Këto zgjedhje ishin shumëpartiake, "legjitime dhe demokratike" (Agani, F. 1999: 306). Në këto zgjedhje të lira, qytetarët kosovarë i "zgjodhën përfaqësuesit e tyre në Parlament dhe Presidentin e Kosovës" (Ismaili, O. 2001: 107-113). Këto ishin zgjedhjet e para pluraliste dhe fillimi i tranzicionit "demokratik" pas rënies së sistemit monist.

Në Kosovë, procesi i tranzicionit, ka zgjatur më shumë se në vendet e tjera për shkak të apartheidit dhe mbajtjes së okupuar për një kohë të gjatë të saj nga ish - Jugosllavia.

Liria e Kosovës i hapi rrugë zhvillimit të proceseve të mirëfillta demokratike. Vendosja e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar civil dhe ushtarak të UNMIK-ut; KFOR-it dhe strukturat e tjera (OSBE, UNHCR) sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, krijoi një ambient të sigurt për zhvillimin e proceseve politike dhe institucionale (KS,1999 Rezoluta 1244). Rrjedhimisht, ndërtimi i institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse ka qenë *sui generis*. Krijimi i institucioneve të përkohshme ishte "sfiduese për të gjithë aktorët pjesëmarrës në proces, qofshin ata ndërkombëtarë apo vendorë" (Bajrami, A. 2002).

Në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të gjitha "kompetencat dhe përgjegjësitë për administrimin e pushtetit qendror dhe lokal" ishin të koncentruara te Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) ose UNMIK-u, (KS 1999:Rezoluta1244:10; UNMIK/REG/Nr. 2001/9:8). Forma e qeverisjes parlamentare, ndarja e pushteteve dhe kompetencat e kufizuara të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes për periudhën 2001-2008 është përcaktuar në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë apo Rregullores Nr. 2001/9, Për Kornizën

Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë (UNMIK/REG/Nr. 2001/9:9). Me Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe krijimin e shtetit të pavarur si dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës më 15 qershor 2008, është ndryshuar sistemi juridik dhe politik.

6.2.Sistemi Politik dhe Kushtetues i Republikës së Kosovës

Forma e qeverisjes dhe sistemit politik i Republikës së Kosovës është demokratike, përfaqësuese dhe shumëpartiake. Megjithatë, dispozita e Nenit 4 i Kushtetutës ka përcaktuar në këtë mënyrë formën e qeverisjes: *“Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre”*...(Kushtetuta, Neni 4.1). Sipas Nenit 4 i Kushtetutes, institucionet kryesore të pushtetit në kuadër të sistemit politik të Kosovës janë: Kuvendi, Presidenti dhe Qeveria. “Pushteti legjislativ është në mandatin e Kuvendit”. ‘Presidenti është kreu i shtetit dhe garanton funksionimin demokratik të shtetit’, ndërsa “qeveria e ushtron autoritetin ekzekutiv në Republikën e Kosovës” (Kushtetuta:Neni 4,2-4).

Në kuadër të sistemit politik dhe kushtetues janë të normuara kuotat për përfaqësimin etnik dhe gjinor për të gjitha institucione në Kosovë. Në këtë kontekst, Kuvendi në bazë të Nenit 64.1 është i përbërë nga “120 deputetë, të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli me votim të fshehtë”, në bazë të “listave të hapura” dhe për një “mandat katërvjeçar” sipas Neni 66.1 i Kushtetutës. Mirëpo dispozita e Nenit 64.2 percakton se “prej 120 mandateve “20 janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë” (Kushtetuta, Neni 64.1-2 dhe Neni 66.1).

Sipas legjislacionit zgjedhor gjatë ndarjes së vendeve, përveç kuotës etnike përfaqësimi gjinor në Kuvend kërkohej të jetë së paku 30%. *për gjininë pakicë*. Në dispozitën e Nenit 8.2 të Ligjit Nr. 03/L-256 përcaktohet se:

“Nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara për kandidatët në listën e një subjekti politik, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të ndarë për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidati i radhës i gjinisë pakicë në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30% (Ligji Nr. 03/L-256, Neni 8.2).

Kuvendi në kuadër të kompetencave të përcaktuar sipas Nenit 65- 67, Neni 70 dhe Neni 100 i Kushtetues, përveç miratimit të ligjeve “ndryshon Kushtetutën” (me 2/3 e të gjithë deputetëve të tij, duke përfshirë 2/3 e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e garantuara), “ratifikon traktatet ndërkombëtare”, “zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Kosovës me 2/3 e të gjithë deputetëve”; “zgjedh qeverinë dhe shpreh mosbesimin” mbi të, “propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese” dhe jep “pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme” (Kushtetuta: Neni 65- 67, Neni 70 dhe Neni 100).

Presidenti i Republikës së Kosovës sipas dispozitave të Nenit 4.3, Nenit 83 dhe 84 i Kushtetutës: “është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit”; ‘garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës në pajtim me Kushtetutën’. Ai zgjidhet nga “Kuvendi, me 2/3 e shumicës së të gjithë deputetëve në raundin e parë dhe të dytë, ose duhet të marrë në votimin e tretë, shumicën e thjeshtë të të gjithë deputetëve”. Në rast se Presidenti “nuk zgjidhet në votimin e tretë, Kuvendi shpërbëhet dhe shpallen zgjedhjet e jashtëzakonshme që duhet të mbahen brenda 45 ditëve”. Në kuadër të kompetencave kushtetuese ai “përfaqëson” Republikën “brenda dhe jashtë”, “shpall zgjedhjet” dhe, pas tyre, “thërret mbledhjen konstituive të Kuvendit”, “shpall ligjet” dhe ka të drejtën e “kthimit të ligjeve të miratuara” (një herë për ligj) në Kuvend; “nënshkruan

marrëveshjet ndërkombëtare”; “udhëheq politikën e jashtme të vendit”; është “Komandanti Suprem i Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK). Ai emëron: “Komandantin e FSK-së”, “kandidatin për Kryeministër”; emëron dhe shkarkon “Kryetarin dhe gjyqtarët” e Gjykatës Supreme dhe Gjykatave të tjera, me “propozime të Këshillit Gjyqësor”, “emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin dhe prokurorët e Shtetit me propozim të Këshillit Prokurorial”, emëron “Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese pas propozimit të Kuvendit dhe i shkarkon ata me propozim të 2/3 e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese”, vendos për “shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme”, si dhe emëron “Komisionin Qendror të Zgjedhjeve” etj. (Kushtetuta: Neni 4.3, Neni 83-84, Neni 86; Gjykata Kushtetuese 2011, AKTGJYKIMI në Rastin Nr.KO 29/11&AKTGJYKIM në Rastin Nr. K0103/14).

Qeveria e Kosovës sipas Neneve 92-97 të Kushtetutës “ushtron pushtetin ekzekutiv dhe përbëhet nga “Kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministrat dhe zëvendësministrat”. Në varësi të madhësisë së numrit të kabinetit qeveritar rriten vendet e “garantuara për minoritetet” në qeveri. Në kuadër të mandatit të saj, ajo zbaton ligjet, propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme, promovon zhvillimin ekonomik, propozon projektligje në Kuvend dhe nxjerr akte juridike të nevojshme për zbatimin e ligjeve etj... Fuqia politike dhe kushtetuese e Kryeministrit është e madhe. Ai përveç që përfaqëson dhe udhëheq qeverinë; emëron dhe shkarkon ministrat pa pëlqimin e Kuvendit; drejton Këshillin e Sigurisë së Kosovës, emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe në bashkëpunim me Presidentin emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës etj. (Kushtetuta: Nenet 92-97).

Vetëqeverisja lokale sipas Nenit 123 i Kushtetutes, ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në votime të drejtpërdrejta. Veprimtaria e pushtetit lokal bazohet

në Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës, në veçanti, rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-040 “Për Vetëqeverisjen Lokale dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale (Kushtetuta Neni 123; Ligji Nr. 03/L-040, Neni 4-86).

Në përgjithësi formimi dhe funksionimi i institucioneve politike si në nivelin qendror apo lokal përbëhet nga sistemi shumëpartiak dhe shumetnik si dhe qeveriset me koalicione sepse asnjëri prej tyre nuk ka arritur ta marrë pushtetin i vetëm. Që nga zgjedhjet e para nuk ka pasur fitues të garës zgjedhore, në të cilën ndonjë parti të këtë fituar më shumë se gjysmën e votave që të mundësojë krijimin e institucioneve. Megjithatë, ky model elektoral dhe sistemi politik kosovar është i favorshëm për demokracinë konsensuale, pasi asnjë parti nuk është aq e fuqishme të fitojë e vetme shumicën në Kuvend. Kjo në vazhdimësi po krijon kriza në formimin e institucioneve dhe funksionimin e tyre.

6.3.ANALIZË KORNIZËS NORMATIVE DHE REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE NACIONALE NË KOSOVË (2001- 2017) SI DHE FORMIMIT TË INSTITUCIONEVE PËRFAQËSUESE DHE EKZEKUTIVE

6.3.1. Analizë kornizës normative për formimin e institucioneve

Korniza Kushtetuese dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës janë dy aktet që kanë përcaktuar strukturën, mandatin dhe mënyrën e zgjedhjes dhe formimit të institucioneve në Kosovë nga viti 2001-2017 (Korniza Kushtetuese, Kreu 9; Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli IV-VI).

Korniza Kushtetuese e miratuar më 15 maj 2001, e njohur si regullorja e UNMIK-ut 2001/9, është vlerësuar nga nënshkruesi i saj Hans Haekkerup Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) si:

“regullorja më e rëndësishme e lëshuar në dy vitet e fundit, që nga ardhja e UNMIK-ut dhe KFOR-it në Kosovë, sepse kjo krijon një kornizë kushtetuese gjithpërfshirëse për vetëqeverisje në Kosovë. Korniza Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë përshkruan institucionet, të cilat do të lihen në duar të liderëve kosovarë dhe nëpunësve publik pas zgjedhjeve, më 17 nëntor 2001. Ky është vërtetë një dokument historik: Ai do të drejtojë popullin e Kosovës drejt themelimit të strukturave demokratike dhe implementimi i tij i suksesshëm do të ndihmojë në masë të madhe procesin e përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës” (Korniza Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë 2002:2).

Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes nga vitit 2001-2008 janë formuar sipas Kreu -t 9 të Kornizës Kushtetuese, që është e strukturuar në tri pjese: Kuvendi, Kryetari i Kosovës dhe Qeveria (Korniza Kushtetuese Kreu 9.1.-9.3). Ndërsa pas qershorit të vitit 2008, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës të Republikës së Kosovës formimi dhe funksionimi i institucioneve të shtetit të Kosovës buron nga dispozitat kushtetuese në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në veqanti, dispozitat të Kapitulli IV, V dhe VI i

Kushtetutës rregullojnë strukturën, mënyrën e zgjedhjes, mandatin dhe kompetencat e Kuvendit, të Presidentit dhe Qeverisë së Republikës të Kosovës.

Gjatë analizës dhe krahimit të këtyre dy akteve dhe dispozitave të veçanta sipas të cilave zgjidhen dhe formohen institucionet si parlamenti, presidenti dhe qeveria kemi nxjerr në pah disa vakuume ligjore që i ka zgjidhur Kushtetuta: moszgjedhjes të Presidentit në raundin e tretë, moszgjedhjes së qeverisë në raundin e dytë dhe pas shkarkimit të saj nga Kuvendi. Duhet theksuar se Kreu 9 i Konizës Kushtetuese nuk ka pasur ndonjë dispozitë që përcakton pasojat e Kuvendit për moszgjedhjen e Kryetarit të Kosovës në raundin e tretë, si dhe dështimit të votëbesimit të qeverisë pas herës së dytë. Ndërsa, Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka të sanksionuar sipas dispozitave të Neni 82; Neni 86.6; Neni 95.4 dhe Neni 100.4 të Kushtetutës, pasojat e Kuvendit: për “mos zgjedhjen e Presidentit të Republikës në raundin e tretë”, “dështimit të votëbesimit të qeverisë në herën e dytë” dhe “pas mocionit të suksesshëm të votëbesimit të saj”, vjen të “shpërndarja e Kuvendit” (Kushtetuta, Neni 82; Neni 86.6; Neni 95.4 dhe Neni 100.4).

Në vazhdim trajtohen në mënyrë krahasimore dhe më të zgjeruar historia e formimit të institucioneve sipas dispozitave të Kornizës Kushtetuese (2001-2008) dhe Kushtetutës së Republikës të Kosovës (2008-2017) si dhe rezultatet zgjedhore nga zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.

6.3.2. Formimi i institucioneve sipas Kornizës Kushtetuese dhe rezultatit zgjedhor për Legjislaturën e Parë (2001-2004)

Vendosja e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar të UNMIK-ut sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, krijoi një ambienti të sigurt për zhvillimin e proceseve politike dhe institucionale (KS,1999 Rezoluta 1244). Në fillim, para organizimit të zgjedhjeve lokale dhe të përgjithshme administrata e UNMIK-ut ndërtoj një infrastrukturë ligjore dhe institucionale. Në kuadër të kompetencave të saj, UNMIK-u përmes rregulloreve të veçanta si: UNMIK/RREG Nr.2001/9 apo Kornizës Kushtetuese; Rregullorja UNMIK/REG Nr. 2001/16 Për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2000/16 për regjistrimin dhe vepriminë e partive politike në Kosovës; Rregullorja Nr.2000/65 Ndryshimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/21 për themelimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe rregullorja UNMIK: RREG.2001/33, Mbi Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës ka krijuar bazën ligjore të domosdoshme për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës.

Institucionet e para demokratike të dala nga zgjedhjet janë ndërtuar sipas Kreu 9.1.1-3 i Kornizës Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës (*Korniza Kushtetuese*, Kreu 9). Në bazë të kësaj dispozite, “Institucioni më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës” i vetëqeverisjes së përkohshme të Kosovës është “Kuvendi, i cili përbëhet prej 120 deputetëve të zgjedhur me votim të fshehtë dhe me një mandat trevjeçar”. Mënyra e zgjedhjes së tyre bëhet përmes “votës së lirë” si dhe përmes “vendeve të rezervuara” për komunitetet minoritare. Në fakt, njëqind (100) mandate në Kuvend zgjidhen përmes votës së lirë dhe shpërndahen midis të gjitha subjekteve politike (partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur) në proporcion me numrin e votave të vlefshme që i kanë fituar në procesin zgjedhor. Ndërsa, “njëzet (20) vende janë të rezervuara për


përfaqësim plotësues për të gjitha minoritetet e tjera joshumicë”. Rrjedhimisht, ata përveç vendeve që fitojnë në procesin zgjedhor, përfitojnë edhe nga kuota e rezervuar, dhjetë vende iu ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur që kanë deklaruar se përfaqësojnë për komunitetin atë serb, si dhe dhjetë vende ndahen për komunitetet e tjera si vijon: katër prej tyre për komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptian, tre për komunitetin boshnjak, dy për komunitetin turk dhe një për atë goran.

Sipas Kornizës Kushtetuese: *“Njëzet (20) prej 120 vendeve rezervohen për përfaqësim plotësues të komuniteteve joshqiptare të Kosovës....* (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.1.3 b).

Zgjedhjet e para dhe “historike” për Kuvendin e Kosovës, janë organizuar më 17 nëntor të vitit 2001 (European Parlament, No 3/2002:1-15; KQZ 2017:14’ ISG 2001: Nr120) konform dispozitës të Nenit 4 pika 3 i Rregulles UNMIK: RREG.2001/33 dhe Kreu 9.1.3 i Kornizës Kushtetuese që përcaktojnë “sistemin PP me lista të mbyllura” si dhe “Kosovën si një zonë të vetme elektorale shumanëtarëshe” (UNMIK: RREG.2001/33, Neni 4.3, Korniza Kushtetuese, Kreu 9.1.3). Kur analizohen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve i publikuar nga OSBE/CEC/UNMIK:2001, vërehet “efekti i sistemit zgjedhor” dhe “vendeve të rezervuara” të cilat ndikuan në konfigurimin e parlamentit të parë pluralist të njohur ndërkombëtarisht (OSBE/CEC/UNMIK:2001).

Në kuadër të figurës 11 pasqyrohet rrezultati i zgjedhjeve dhe përqindja e votave të fituara nga subjektet politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës (OSBE/CEC/UNMIK:2001). Ndërsa, Grafiku 5 pasqyron konfigurimin politike sipas vendet e fituara dhe të rezervuara sipas subjekteve politike që janë përfaqësuar në Kuvend.

Figura 11. Përqindja e votave sipas subjekteve politike në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001




Burimi: OSCE/CEC/UNMIK: Rezultatet e vërtetuara të Zgjedhjeve 2001

Në bazë të rezultatit përfundimtar të publikuar nga OSBE/CEC/UNMIK vërejmë se në këto zgjedhje LDK, ka fituar 45.65 për qind të votave, ose 359.851 vota, dhe ka siguruar gjithsej 47 deputetë; e dyta, PDK ka fituar 25.70 për qind, ose 202.622 vota me 26 deputetë; e treta, Koalicioni serb Povratak 11.34 për qind ose 89.388 vota dhe 22 deputetë; dhe e katërta AAK me 7.83 për qind ose 61.688 mijë vota dhe 8 deputetë e kështu me radhë (OSBE/CEC/UNMIK: 2001). Në mënyrë të përmblodhur rezultatin zgjedhor dhe përqindjen e votave të fituara nga partitë dhe subjektet politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e para për Kuvendin e Kosovës e pasqyruam në Figurën 11.

Këto zgjedhje përveç që ishin zgjedhjet e para nacionale për krijimin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ: me tutje IPVQ) të njohura ndërkombëtarisht, ato kishin një emotiv nacional dhe emocional për të gjithë shoqërinë, e në veçanti për subjektet politike që në fushatat parazgjedhore pothuajse të gjitha në programet e tyre kishin çështjet nacionale e shumë pak programe për riparimin e dëmeve të luftës si dhe fillimin e zhvillimit të vendit. Megjithatë, pjesëmarrja e qytetarëve në këto zgjedhje ishte më e lartë se në zgjedhjet e tjera. Këtë e tregojnë dhe të dhënat e paraqitura në Tabelën 5 dhe Tabelën 6. Ndërsa, lidhur me ndarjen e mandateve dhe fuqisë politike që prodhuan këto zgjedhje për subjektet politike pasqyrohet në grafiku 5.

Grafiku 5. Mandatet sipas subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në zgjedhjet vitit 2001



Burimi: OSCE/CEC/UNMIK: 2001

Në përgjithësi efekti i vendeve të rezervuara për komunitetet minoritare është i madh mbi përfaqësimin e tyre në Kuvend. Në kuadër të grafikut 5 janë paraqitur 15 subjektet dhe numri i deputetëve sipas subjekteve politike që janë përfaqësues në Parlamentin e Kosovës. Kështu që në kuadër të Legjislaturës së Parë (17.11.2001 - 23.11.2004), janë gjashtë grupe politike parlamentare, të kryesuara nga grupi më i madh politik ai LDK-së me 48 vende; pastaj grupi i dytë është PDK-ja me 26 vende; Komuniteti serb radhitet i treti si Grupi i KP-së me 22 vende; grupi i AAK-së me 9 vende; Grupi i Komuniteteve të tjera joserbe me 11 vende dhe pa grup 4 vende (Kuvendi-Legjislatura I: 17.11.2001 - 23.11.2004).

Për krijimin e institucioneve të para demokratike sipas Kreu-t 9.1-9.3 të Konrizes Kushtetuese (Korniza Kushtetuese Kreu 9.1.-9.3) është “negociuar disa muaj midis subjekteve politike” të lehtësuara nga “organizatat ndërkombëtare” prezent në Kosovë deri në arritjen e një “marrëveshjeje për bashkëqeverisje”. Për zgjedhjen e Presidentit dhe formimit të qeverisë është krijuar një koalicion gjithëpërfshirës i përbërë nga tri subjektet e mëdha LDK+PDK+AAK, Minoritetet si dhe partnerë të tjerë strategjik. Pas një periudhe disamujore Kuvendi i Kosovës në seancën e mbajtur më 4 mars 2002, zgjodhi Ibrahim Rugovën për President të Kosovës, me “votim unik” siç thekson prof. Arsim Bajrami apo në pako me Kryeministrin dhe kabinetin qeveritar (Bajrami, A. 2005:294; Brand, M. 2003:38; IDK Forumi 2015:29). Edhe pse një procedurë e tillë e zgjedhjes së dy drejtuesve të institucioneve njëkohësisht ishte jashtë rregullores në fuqi, përcaktuar në Kreun 9.1.-9.2 dhe 9.3 të Kornizës Kushtetuese si dhe praktikave parlamentare, nuk ishte pengesë për UNMIK-un dhe institucionet e tjera ndërkombëtare prezente në Kosovë që të ndalojnë praktikat jo të mira që në fillimet e saj. Institucionet ishin nën “mbikëqyrje permanente”

nga PSSP-ja apo udhëheqës i UNMIK-ut. Sipas Kreu-t 12 të Kornizës kushtetuese PSSP-ja kishte këto kompetenca:

“Kompetencat e PSSP-së: Ushtrimi i përgjegjësi të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes nën këtë Kornizë Kushtetuese nuk ndikon ose nuk e zvogëlon autoritetin e PSSP-së në sigurimin e zbatimit të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë mbikëqyrjen e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, mbikëqyrjen e zyrtarëve dhe organizmave të tyre dhe marrjen e masave të duhura kurdo që veprimet e tyre janë të papajtueshme me Rezolutën 1244 (1999) ose me këtë Kornizë Kushtetuese”. (Korniza Kushtetuese Kreu 12) .

Përveç anëve pozitive të sistemit zgjedhor proporcional me lista të mbyllura në lehtësimin e përfaqësimit gjithëpërfshirës të të gjitha forcave dhe ideologjive politike në Kuvend, ai ka dhënë edhe efekte të tjera siç është fuqizimi i liderëve në kuadër të partisë; ka krijuar “oligarkinë” vendimmarrëse brenda partisë, vendimmarrje, qoftë brenda apo jashtë partisë duke përdorur “ligjin e hekurt” të tyre (Agani,F.1990:165-170). Funksionet kryesore dhe vendimmarrëse përqendrohen në duart e pak njerëzve. Përfaqësuesit në parlament nuk (guxojnë të) veprojnë ndryshe, përveç ashtu siç porosit lidhshipi i tyre. Çdo veprim ndryshe i deputetit, pason me mosvënje në listë, në zgjedhjet e ardhshme dhe masa të tjera. Dhe kjo ishte një nga pengesat e krijimit të institucioneve të para demokratike.

6.3.2.1.Qeveria Rexhepi. Koalicioni i LDK-së me PDK-n dhe AAK-n (2002-2004)

Në kuadër të Kreut 9.3 të Kornizës Kushtetuese është përcaktuar “përbërja” dhe “procedura e zgjedhjes së Qeverisë së Kosovës” (UNMIK/Rreg 2001/9:Kreu 9.3). Pas zgjedhjeve apo çdo rast që “pozita e Kryeministrit mbetet e lirë”, Kryetari i Kosovës në mbështetje të kompetencave të tij të dhëna në Kreun 9.2.4.a i kornizës kushtetuese, “pas konsultimeve me partitë politike parlamentare” ia propozon Kuvendit “kandidatin për Kryeministër” (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.2.4.a). Më tej, Mandatari i paraqet Kuvendit një listë me ministrat e

propozuar. Qeveria sipas Kreu 9.3.8-9 i Kornizës Kushtetuese, zgjidhet nga shumica e votave të deputetëve të Kuvendit. Mirëpo, në qoftë se kandidati i propozuar nuk merr shumicën absolute të votave, atëherë Kryetari i Kosovës sipas Kreut 9.3.9 i Kornizës Kushtetuese, “propozon” brenda dhjetë ditësh “një kandidat të ri”, i cili së bashku me kabinetin e propozuar e kërkon votëbesimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit.

Sipas kornizës kushtetuese zgjedhja e Kryeministrit dhe ministrave bëhet:

“Pas zgjedhjeve, ose në rast se Kryeministri jep dorëheqjen apo nëse vendi i tij mbetet i lirë për arsye të tjera, Kryetari i Kosovës, pas konsultimeve me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, ia propozon Kuvendit një kandidat për Kryeministër. Kandidati i propozuar i paraqet Kuvendit një listë me ministrat e propozuar. Kryeministri bashkë me ministrat zgjidhen nga shumica e deputetëve të Kuvendit. Në qoftë se kandidati i propozuar nuk merr shumicën e kërkuar të votave, atëherë Kryetari i Kosovës propozon brenda dhjetë ditësh një kandidat të ri për Kryeministër. Kandidati i ri, bashkë me listën e ministrave të propozuar nga ai ose ajo, zgjidhet nga shumica e deputetëve të Kuvendit” (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.3.8-9).

Korniza kushtetuese nuk ka ndonjë dispozitë brenda saj që përcakton se çfarë ndodh nëse dështon zgjedhja e qeverisë edhe në radhën e dytë nga Kuvendi. Megjithatë kur flitet për mocionin e votëbesimit ndaj qeverisë Korniza kushtetuese ka përcaktuar se: *“Kuvendi mund të mos ia jep votëbesimin Qeverisë vetëm nëse me një shumicë të deputetëve të tij zgjedh njëkohësisht një Kryeministër të ri bashkë me listën e ministrave të propozuar nga ai ose ajo”* (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.3.10).

Në mungesë të sigurimit të një shumice absolute nga LDK si forca e parë me 47 deputetë dhe në mungesë të gatishmërisë për koalicionë me të, për shkak të ndarjeve ideologjike të thella në mes partive pacifiste dhe atyre të dala nga lufta është bllokuar procesi i zgjedhjes së Kryetarit të Kosovës dhe i Qeverisë. Kështu që me ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar (prezent në Kosovë) është arritur “marrëveshja në mes tri subjekteve LDK, PDK, AAK dhe minoritet (Bajrami, A 2005:294) për qeveri gjithëpërfshirëse me kryeministër Bajram

Rexhepi i propozuar nga PDK. Pothuajse të gjitha subjektet ishin në pushtet dhe roli i opozitës ishte me pak ndikim për shkak të numrit të saj (shih grafikun 6). Instrumentet e kontrollit politik të qeverisë e në veçanti, mocionit të votëbesimit dhe procedura e ngritjes së tij ishte paraparë në mënyrë të veçantë. Kuvendi mund të mos ia japë votëbesimin qeverisë vetëm nëse është siguruar një shumicë e deputetëve që zgjedh njëkohësisht një Kryeministër të ri bashkë me listën e ministrave të propozuar nga ai ose ajo. Në këtë mënyrë, mandati i qeverisë që largohet përfundon me zgjedhjen e Kryeministrit dhe ministrave të rinj. Gjithashtu, dispozita e Kreut 9.312 e Kornizës i jep fuqi kushtetuese Kryeministrit në raport me anëtarët e qeverisë të bëjë “ndryshimet” në përbërjen e saj dhe të zëvendësojë çdonjërin prej ministrave “pa pëlqimin e Kuvendit” (*Korniza Kushtetuese* 9.3.12.) Kjo në njëfarë mënyre e ka pamundësuar çdo iniciativë për mocion të votëbesimit deri me Shpalljen e Pavarësisë dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Si përfundim, mund të konkludojmë se këtu fillojnë hapat e parë të demokracisë parlamentare dhe raporti i pozitës dhe opozita e vërtetë ishin në mes të IPVQ-ve ndaj atyre ndërkombëtare (PSSP) që kishin “autorizim absolut”, në shfuqizimin e çdo akti të miratuar nga ato dhe deri në “shkarkimin e drejtuesve institucionalë dhe shpërbërjes së institucioneve” (*Korniza Kushtetuese*, Kreu 12). Përveç pushtetit “sfida kryesore për udhëheqësit politikë dhe institucionalë” ishte funksionimi i institucioneve të reja për të treguar “pjekuri” se ata mund të “qeverisin me përgjegjësi” dhe se me kalimin e kohës mund t’u besohen përgjegjësi të mëtjshme (ICG 2001, Nr. 120).


6.3.3. Formimi i institucioneve sipas Kornizës Kushtetuese dhe rezultatit zgjedhor për Legjislaturën e dytë (2004-2007)

Zgjedhjet për Legjislaturën e dytë janë organizuar më 23 tetor 2004 pas përfundimit të mandatit të IPVQ-së. Sipas Kreu-t 9.1.4. të Konrizes Kushtetuese, mandati për IPVQ-të, ishte tri vjet, duke filluar nga dita e seancës së inaugurimit të Kuvendit, e cila mbahet brenda tridhjetë ditësh pas vërtetimit të rezultatit të zgjedhjeve. Kështu që, pas përfundimit të mandatit trevjeçar të përcaktuar në Kornizën Kushtetuese, PSSP-ja e cakton dhe e shpall datën e zgjedhjeve më 23 tetor 2004 për Kuvendin të cilat janë organizuar sipas sistemit proporcional (PP) me lista të mbyllura me një zonë të vetme elektorale shumanëtarëshe (OSBE/CEC/UNMIK:2004). Gjithashtu ndarja e mandateve në Kuvend bëhet duke respektuar “kuotën etnike për vendet e rezervuara” të përcaktuar të Kreu: 9.1.3 i Kornizës Kushtetuese si dhe “kuotës gjinore” të vendosur sipas Neni 5.3 dhe Neni 21 i Rregullores Nr. 2004/12 mbi zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës (*Korniza Kushtetuese*, Kreu: 9.1.3; UNMIK/REG. Nr. 2004/12, Neni 5.3, Neni 21).

Karakteristikë tjetër e përbashkët e këtyre zgjedhjeve me zgjedhjet e kaluara është rezultati zgjedhor për subjektet politike që është pothuajse i njëjtë. Edhe në këto zgjedhje LDK fiton 45.42% të votave ose 47 vende; PDK si forcë e dytë fitoi 28.85% të votës ose 30 vende, AAK fitoi 8.39% ose 8 vende, ORA 6.23% ose 7 vende. Ndërsa subjektet minoritare, e në veçanti ajo serbe i ndan vendet e rezervuara në mes të SLKM që siguroi 8 vende si dhe iniciativa qytetare serbe që siguroi 2 vende. Minoritetet e tjera morën vendet e tyre të rezervuara (OSBE/CEC/UNMIK:2004).

Në mënyrë të përmblendhur rezultatet e zgjedhjeve, subjektet politike të përfaqësuara në Parlament dhe numri i deputetëve pasqyrohen në grafikun 6.

Grafiku 6. Mandatet sipas subjekteve politike në Kuvend në zgjedhjet e vitit 2004



Burimi: OSCE/CEC/UNMIK: 2004

Struktura politike e Kuvendit sipas rezultatit zgjedhor, është përfaqësuar nga 19 subjekte politike, ashtu siç është paraqitur në grafikun 8. Mirëpo, Legjislatura e dytë (23.11.2004 - 12.12.2007) është përbërë nga tetë grupe politike në Kuvend dhe tre deputetëve pa grup. Grupi parlamentar i LDK-së është grupi më i madh me 44 vende, Grupi i PDK-së me 30 vende, grupi AAK-së me 11 vende, grupi SLKM me 8 vende, grupi Ora me 7 vende, grupi për integrim me 6 vende, grupi GP 6+ me 6 vende, grupi i LDD, 5 vende dhe pa grup 3 vende (Kuvend: Legjislatura II (23.11.2004 - 12.12.2007). Koalicioni në mes të LDK-së me AAK-n dhe minoritetet, përveç që krijoi një shumicë parlamentare, ose “koalicion dypalësh” siç thotë profesor Arsim Bajrami, “krijoi kushte për funksionimin e opozitës parlamentare” (Bajrami, A. 2010:383).

6.3.3.1. Qeveria Haradinaj I. Koalicioni LDK dhe AAK (2004-2008)

Pas certifikimit të rezultateve është krijuar një koalicion në mes LDK dhe AAK dhe partnerë të tjerë minoritarë. Ky koalicion ishte produkt i negocimit të vet politikës vendore. Të dy këto subjekte e krijojnë shumicën absolute në kuvend dhe ishte një shembull i krijimit të koalicionit të natyrshëm të partive me orientim të qendrës së djathtë. Gjatë mandatit trevjeçar të qeverisë, ajo është ndryshuar dhe drejtuar nga Kryeministri Ramush Haradinaj (3.12.2004 - 8.03.2005), për 100 ditë nga fundi i vitit 2004 dhe fillim të 2005-ës, duke dhënë dorëheqjen pas aktakuzës të ngritur nga Gjykata e Hagës (BBC: 2005, KE 2005:10-11). Në vend të tij, Kuvendi më 23 mars 2005 zgjodhi qeverinë e re me Kryeministër Bajram Kosumi me 71 vota të deputetëve (OSBE -ASI newsletter 2005:8). Ndërsa pas dorëheqjes së tij, Kuvendi e zgjodhi qeverinë e re me Kryeministër Agim Çekun, i cili ka drejtuar qeverinë (10 mars 2006-14.01. 2008) deri në zgjedhjen e qeverisë së re (OSBE: 2006:11). Praktikisht Kuvendi për një mandat trevjeçar, ka zgjedhur tri qeveri të drejtuara nga tre kryeministra të ndryshëm. Dorëheqja e Kryeministrit Kosumi e lehtësoi procesin e vështirë që përcakton Kreu 9.3.10 i Kornizës Kushtetuese, për ndryshimin e qeverisë apo shkarkimi i saj nga Kuvendi i cili mund të bëhet “vetëm atëherë kur është duke votuar një qeveri të re” (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.3.10).

Gjatë mandatit të kësaj qeverie tema kryesore ka qenë përmbushja e Standardeve për Kosovën (standardet para statusit) të vendosura në vitin 2004 nga faktori ndërkombëtar, si kushte për t’i hapur proceset e zgjidhjes të statusit Final të Kosovës¹⁷ (UNMIK, 2003-2004).

¹⁷ Shënim: UNMIK (2003-2004) Standardet para statusit: Plani i implementimit për Kosovën ka pasur tetë standarde: 1.Funksionimi i Institucioneve Demokratike (IPVQ); 2- Sundimi i ligjit; 3-Liria e lëvizjes; 4-

6.3.4. Formimi i institucioneve sipas Kornizës Kushtetuese dhe rezultati zgjedhor për Legjislaturën e tretë (2007-2010)

Zgjedhjet për Legjislaturën e tretë janë “organizuar më 17 nëntor 2007” sipas dispozitave të Kreut 9 i Kornizes Kushtetuese dhe kornizës ligjore të ndryshuar përmes Rregullores Nr. 2007/26 për Ndryshimin e Rregullores të UNMIK-ut, Nr. 2004/12 “Mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës”. Njëkohësisht me to, janë organizuar edhe zgjedhjet për Kuvendet Komunale si dhe Zgjedhjet për Kryetar të Komunave (KQZ/QNR :2007). Elementi i përbashkët i këtyre zgjedhjeve me dy legjislaturat paraprake janë “kuota etnike” apo 20 vendet e rezervuara nga 120 vendet për Komunitetet pakicë dhe “kuota gjinore” prej 30% si dhe “sistemi zgjedhor proporcional” dhe “një zonë e vetme elektorale shumanëtarëshe”. Megjithatë, ndryshimet janë të konsiderueshme nga zgjedhjet paraprake, që nga ndryshimi i listave nga ato të mbyllura në të “hapura”, “vendosja e preferencës” dhe “pragut zgjedhor”. Kjo reformë zgjedhore është bërë në bazë të Rregullores Nr. 2007/26 për Ndryshimin e Rregullores të UNMIK-ut, Nr. 2004/12 “Mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës”. Në bazë të Nenit 5 dhe Nenit 6 të kësaj rregulloreje (UNMIK.REG. Nr. 2007/26), është vendosur: për “listë të hapur”, “vota preferenciale me mundësinë për votim deri dhjetë (10) kandidatë” brenda listës së njëjtë të kandidatëve të subjektit politik si dhe “pragut elektorale prej 5%” (*Korniza Kushtetuese*, Kreu 9.1.3; UNMIK/ Reg. Nr. 2007/26, Neni 5.2.-5.5; Neni 6.2).

Kthimet e qëndrueshme dhe të drejtat e bashkësive dhe të pjesëtarëve të tyre; 5- Ekonomia; 6- Të drejtat pronësore; 7 - Dialogu dhe 8 - Trupat Mbrojtjes të Kosovës.

Zgjedhjet për Kuvendin janë mbajtur sipas kornizës së re ligjore. Rezultatet e dala nga procesi zgjedhor janë përmbledhur në kuadër të Tabelës 16 duke pasqyruar numrin e votave dhe përqindjen e tyre sipas subjekteve politike.


Tabela 16. Rezultatet përfundimtar e në Zgjedhjet e Përgjithshme të vitit 2007

Nr	Partia	Vota	Përqindje
1	PDK	196207	34.3%
2	LDK	129410	22.6%
3	AKR	70165	9.6%
4	LDD+PSHDK	57002	10%
5	AAK	54611	9.6%
6	Ora	23722	4.1%
7	PD	9890	1.7%
	Të tjerët:	30760	4%

Burimi: KQZ/QNR2007

Rezultati zgjedhor i pasqyruar në Tabelën 16 dhe konvertimi i tyre në mandate për subjektet politike dhe kandidatët e tyre të cilët e kanë kaluar pragun zgjedhor si dhe votave të mbetura nga vendet e rezervuara është pasqyruar në Grafikon 7.

Grafiku 7. Mandatet sipas subjekteve politike në Kuvend në zgjedhjet e vitit 2007



Burimi: KQZ /QNR:2007

Efekti i listave të hapura dhe i pragut zgjedhor ka ndikuar te përbërja politike e Kuvendit. Në veçanti, pragu zgjedhor ka dhënë efekt negativ për subjektet e vogla të cilët nuk e kanë kaluar prapun ndërsa efekt pozitiv për subjektet e mëdha të cilat kanë përfituar nga ndarja e votave të mbetura. Si rezultat, në Kuvend janë përfaqësuar 17 subjektet politike, pesë prej tyre përfaqësojnë shumicën shqiptare dhe dymbëdhjetë subjekte që përfaqësojnë minoritetet duke përfituar 20 vendet e rezervuara për ta (Kuvendi 2008, P-001). Sidoqoftë, Legjislatura e tretë (13.12.2007 - 03.11.2010) është e përbërë nga tetë grupe politike në Kuvend. Në këto zgjedhje PDK është subjekti i parë me 34 vende; LDK me 28 vende, AAK me 13, AKR me 9 vende, LDD me 9 vende, Grupi SLS me 9 vende, Grupi për integrim me 7 vende, Grupi 7+ me 7 vende dhe pa grup 4 vende (Kuvendi: Legjislatura III).

Duhet theksuar se zgjedhja e Kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit, Kryetarit të Kosovës dhe formimin e qeverisë është bërë duke respektuar të gjitha dispozitat e Kreu-t 9 të Konstitucionit Kushtetues. Nga studimi i procesverbalit të seancës konstitutive të Kuvendit të Kosovës P- 001, i mbajtur më 04 dhe 09 janar 2008, vërehet se “Marrëveshja e Koalicionit” në mes të Partisë Demokratike të Kosovës dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës ka siguruar shumicën absolute parlamentare e domosdoshme për formimin e institucioneve (Kuvendi 2008, P-001 :5-11)

Kosova në këtë fazë ka qenë në procesin e definimit të statusit finale të saj. Kjo Legjislaturë ka shpallur “Pavarësinë më 17 shkurt 2008” dhe ka miratuar “Kushtetutën e Republikës më 9 prill 2008” (Kuvendi, 2008 Ttranskript 17 shkurt & 9 prill) e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, duke fuqizuar me kompetenca institucionet dhe drejtuesit e saj. Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe në kuadër të respektimit dhe zbatimit të saj, një grup prej 32

deputetëve duke u bazuar në Nenin 113, pika 6, si palë e autorizuar ka ngritur çështjen e mocionit të Impeachmentit të Presidentit në Gjykatën Kushtetuese, me pretendimin se Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës duke mbajtur funksione të dyfishta në kundërshtim me nenin 88 pika 2. Kjo dispozitë përcakton që presidenti pas zgjedhjes “*nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike*” (Kushtetuta, neni 88.2). Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të kërkesës me Aktgjykimin e saj nr. KI47/10, vendosi se “*ka shkelje serioze*” të Kushtetutës së Kosovës, respektivisht të Nenit 88.2 të Kushtetutës nga Fatmir Sejdiu, duke mbajtur njëkohësisht postin e Presidentit të Republikës së Kosovës si dhe postin e Kryetarit të Partisë Politike- Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK-së (Gjykata Kushtetuese 2010, Rasti nr. KI47/10). Sipas Nenit 116 i Kushtetutës “Vendimet” e Gjykatës Kushtetuese janë të “detyrueshme për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës” (Kushtetuta, Neni 116). Në këtë rast “Kuvendi është i obliguar të zbatojë këtë vendim dhe me 2/3 e votave” do të duhej ta shkarkonte Presidentin siq përcaktohet në dispozitën e Nenit 91.3 i Kushtetutës (Kushtetuta, Neni 91.3). Ndërsa subjekti politik i Presidentit e paragjykonte vendimin e gjykatës duke konsideruar se vendimi është i padrejtë dhe i motivuar politikisht. Vendi po shkonte në krizë të thellë institucionale, kushtetuese dhe politike. Megjithatë, Presidenti për të evituar çdo krizë të mundshme politike dhe kushtetuese, bëri një deklaratë publike para qytetarëve duke njoftuar dorëheqjen (Presidenti Sejdiu, F. 2010). Në pajtim me nenin 90 të Kushtetutës, ushtrimin e detyrave të Presidentit e mori Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, deri në zgjedhjen e presidentit të ri.

6.3.4.1. Qeveria Thaçi I. Koalicioni PDK dhe LDK (2008-2010)

Zgjedhja dhe formimin e qeverisë është bërë duke respektuar të gjitha dispozitat e Kreut 9 të Kornizës Kushtetuese. Kjo mund të vërehet edhe nga studimi i procesverbalit të seancës konstitutive të Kuvendit të Kosovës P- 001, i mbajtur më 04 dhe 09 janar 2008 gjatë procedurës së nominimit dhe zgjedhjes të bartësve më të lartë të Institucioneve. Kësaj i ka ndihmuar një “Marrëveshja e Koalicionit në mes të Partisë Demokratike të Kosovës dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës” që ka siguruar shumicën absolute parlamentare e domosdoshme për formimin e institucioneve (Kuvendi 2008, P-001:5-11).

Në Legjislaturën e tretë kemi një bashkëqeverisje (kohabitacion) në mes dy partive rivale PDK si partia e parë fituese në zgjedhje dhe LDK si partia e dytë, të cilat bëjnë marrëveshje për koalicion bashkëqeverisës. Kjo marrëveshje e bashkëqeverisjes është reflektuar edhe në mbështetjen që mori Qeveria në zgjedhjen e saj nga deputetët duke votuar “Për 85 vota, Kundër 22 dhe 2 abstenim” (Kuvendi 2008, P-001:10). Kjo qeveri është e njohur edhe si qeveria Thaçi I. Kryeministri Hashim Thaçi, ka drejtuar vendin në periudhën para dhe pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Ky koalicion i madh si vendim të madh historik kishte të siguronte një shumicë absolute parlamentare. Sidoqoftë, efekti i vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe dorëheqja e Presidentit u reflektua te qeveria dhe krijoi krizë qeveritare. Me këtë rast, dy partitë e koalicionit qeverisës PDK dhe LDK përfunduan në bashkëqeverisje midis tyre. Me tërheqjen e LDK nga qeveria, humbet edhe shumica parlamentare në Kuvend. Me kërkesën e opozitës AKR, e mbështetur edhe nga Partia në pushtet (PDK) është ngritur Mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë. Sipas kushtetutës: “*Mocioni i mosbesimit vihet në rendin e ditës të Kuvendit, jo më vonë se pesë (5) ditë e as më herët se dy (2) ditë nga data e*

parashtrimi të tij (Kushtetuta: Neni 100:3). Për këtë arsye Kryesia e Kuvendit më 2 nëntor 2010, thirri seancën e veçantë ose të jashtëzakonshme me një pikë të vetme të rendit të ditës, “Shqyrtimi i Mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, i Grupit Parlamentar të AKR-së në mbështetje të 40 deputetëve”. Sipas Nenit 100.4 të Kushtetutës “Konsiderohet se mocioni i mosbesimit është pranuar, nëse për të kanë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës” (Kushtetuta 2008: Neni 100.4).

Në studimin e transkripin e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të mbajtur më 2 nëntor 2010, gjejmë se mocioni ndaj qeverisë është “mbështetur nga 66 deputetë, dy vota kundër dhe një abstenim”.(Kuvendi 2010, transkript 2-46). Pas votimit të mocionit të votëbesimit të qeverisë, ushtruesi i detyrës së Presidentit, duke u bazuar në nenin 82.2 të Kushtetutës, e cila përcakton “Kuvendi mund të shpërndahej nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë” e shpërndan Kuvendin dhe dërgon vendin në zgjedhje të jashtëzakonshme (Kushtetuta, Neni 82.2). Në këtë mënyrë Legjislatura e parë e Republikës e përfundoi mandatin duke ia ndërprerë mandatin qeverisë dhe njëkohësisht vetvetes (Kuvendi 2010, transkript 2-46).

6.3.5. Formimi i institucioneve sipas Kushtetutës së Republikës të Kosovës dhe rezultatit zgjedhor për Legjislaturën e katërt (2010-2014)

Formimi i institucioneve sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës fillon më Legjislaturën e katërt. Edhe zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës janë zgjedhjet e para që organizohen sipas kornizës ligjor të Republikës së Kosovës. Ato janë mbajtur më datë 12 dhjetor 2010 sipas sistemit të njëjtë zgjedhor sikurse zgjedhjet e vitit 2007, me një zonë të vetme zgjedhore dhe me lista të hapura. Megjithatë, në këto zgjedhje pas miratimit të Ligjit Nr. 03/L-256 për “Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është vendos mundësia e preferencave deri në 5 preferenca brenda listës që dallohet nga zgjedhjet paraprake. Siç është thënë edhe në këtë punim (Kapitulli III) se ndryshimet e ligjit zgjedhor ose reformës zgjedhore janë bërë çdo herë pak kohë para zgjedhjeve. Edhe ky ndryshim është bërë disa ditë para mocionit të votëbesimit të qeverise dhe shpërndarjes së Kuvendit (Kuvendi: 2010: Transkript i dt. 29 nëntor). Kështu që Kuvendi në seancën e mbajtur më 29 tetor 2010, miratoi Ligjin për plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (Kuvendi: 2010: Transkript i dt. 29 tetor) dhe pastaj brenda javës është shpërndarë Kuvendi. Në zgjedhjet e Jashtëzakonshme nacionale për Kuvendin e Republikës së Kosovës kanë garuar gjithsej 29 subjekte politike. Në kuadër të Tabelës 17 është paraqitur rezultati përfundimtar i certifikuar nga KQZ/QNR me të dhëna nga numri i votave dhe mandateve që kanë siguruar subjektet politike në procesin zgjedhor (KQZ/QNR :2010).


Tabela 17. Rezultatet e përfundimtare në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010

Emri i Partisë /koalicionet	Votat	Përqindja	Mandate
PDK	224,339	32.11%	34
LDK	172,552	24.69%	27
VV	88,652	12.69%	14
AAK	77,130	12.04%	12
Koalicioni AKR-PD-PSD-PPI-PPK-PNDSH-PGJK	50,951	7.29%	8
SLS	14,352	2.05%	8
JSL	6,004	0.86%	4
KDTP	8,548	1.22%	3
VAKAT	5,296	0.76%	2
PDAK	2,871	0.41%	1
NDS	2,478	0.35%	1
BSDAK	1,818	0.26%	1
IRDK	1,690	0.24%	1
PAI	1,386	0.20%	1
SDSKIM	1,008	0.14%	1
GIG	787	0.11%	1
PREBK	690	0.10%	1
FER	15,156	2.17%	0
LDD	14,924	2.14%	0
SDA	1,602	0.23%	0
KTB	1,364	0.19%	0
LEK	1,010	0.14%	0
S.SDS	829	0.12%	0
CDS	771	0.11%	0
SNS	749	0.11%	0
SDSG	598	0.09%	0
SKMS	505	0.07%	0
SNSD	486	0.07%	0
GIKN	205	0.03%	0

Burimi : KQZ/QNR 2010

Nga 29 subjektet politike pjesëmarrëse në zgjedhje vetëm 17 prej tyre kanë siguruar vende në Kuvend (KQZ/QNR 2010). Gjithashtu ky numër do të ishte shumë më i vogël sikur të mos ishin vendet e rezervuara për komunitetet minoritare. Në kuadër të grafikut 8, pasqyrohet numri i subjekteve që kanë kaluar pragun zgjedhor, të vendeve të rezervuara si dhe numrin e vendeve sipas subjekteve në Kuvend sipas rezultatit zgjedhor.

Grafiku 8. Mandatet sipas subjekteve politike në Kuvend në zgjedhjet e vitit 2010



Burimi: autori bazuar në rezultatet KQZ /QNR 2010

Legjislatura e katërt (12.12.2010 - 07.05.2014) është përfaqësuar nga 17 subjekte dhe është përberë nga shtatë grupe politike në Kuvendin e Kosovës. PDK është grupi i parë me 32 vende, LDK-ja me 29 vende, LVV- me 13 vende, AAK-ja me 13 vende, KKR me 8 vende, SLS me 8 vende, grupi 6+ me 6 vende dhe pa grup 11 vende (Kuvendi 2010: Legjislatura IV (12.12.2010 - 07.05.2014).

Në kuadër të traskriptit të seancës se jashtëzakonshme vërehet se për të formuar një shumicë parlamentare PDK e AKR dhe së bashku me minoritetet krijuan koalicion qeverisës. Në kuadër të marrëveshjes, është vendos edhe zgjedhja e Presidentit të vendit, e

që sipas saj i takonte subjektit të AKR-se, konkretisht, kryetarit të saj. Në seancën e jashtëzakonshme të datës 22 shkurt 2011, në raundin e tretë Kuvendi me shumicë absolute të votave zgjedhi Presidentin e Republikës, Bexhet Pacolli (Kuvendi: Transkript, 2011:16). Këtë proces zgjedhor të Kuvendit apo vendimin e tij, opozita e kontestoj në Gjykatën Kushtetuese. Ajo kërkoi interpretim të Nenit 86 të Kushtetutës për zgjedhjen e presidentit dhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit, me të cilin e zgjedhi Presidentin.

Neni 86 i Kushtetutës në dispozitën e saj përcakton se:

“Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjidhet President i Republikës së Kosovës” (Kushtetuta: Neni 86, 4- 5).

Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin e saj vlerëson se: “Vendimi i Kuvendit, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës, më 22 shkurt 2011, është jokushtetues, meqenëse është në kundërshtim me kërkesat e Nenit 86 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty. Sipas këtij Aktgjykimi, Gjykata:

“vëren se lidhur me numrin e votave që kërkohet për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, neni 86-4 i Kushtetutës siguron se Presidenti i Republikës së Kosovës do të zgjidhet me dy të tretat(2/3-at) e "votave të të gjithë deputetëve" të Kuvendit, që do të thotë se të gjithë 120 deputetët duhet të votojnë, minus ata deputetë të cilët kanë marrë leje nga Kryetari i Kuvendit, dhe kandidati i cili merr 80 ose më shumë vota nga votat e të gjithë deputetëve (në raundin e parë dhe të dytë) do të zgjidhet. Vetëm nëse nuk arrihen dy të tretat e shumicës, mbahet raundi i tretë. Neni 27 i Ligjit për deputetë dhe neni 27-4 i Rregullores së punës së Kuvendit, përmban formulim identik të fjalëve: "dy të tretat(2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit" (Gjykata Kushtetuese (2011): AKTGJYKIM në Rastin Nr. KO 29/11, pika 85).

Subjektet politike për të evituar krizën pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në Kuvend si dhe për të realizuar mandatin e saj zgjedhor për zgjedhjen e Presidentit është arritur marrëveshja e njohur si “Memorandumi për Marrëveshje” e kthyer në REZOLUTË të

miratuar nga Kuvendi, në mbledhjen e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 7 prill 2011, për zgjedhjen konsensuale të Presidentit dhe reformës kushtetuese dhe zgjedhore. Në pikën 2 të kësaj rezolute përcaktohet :

Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit të ndërlidhur në mënyrë që Presidenti i Republikës së Kosovës të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Kuvendi mbështet afatin kohor të përmbajtur në Memorandum sipas të cilit zgjedhjet e para presidenciale në Kosovë do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legjislative hyjnë në fuqi. Kuvendi mbështet themelimin e një komisioni, të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit i identifikuar nga koalicioni qeverisës, për këtë qëllim ashtu siç është paraparë në Memorandum. Në pajtueshmëri me Memorandumin, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 6-9 muajsh nga data e themelimit (Kuvendi i Kosovës 2011, Rezoluta Nr. 04 - R -02, pika 2).

Pas miratimit të kësaj Rezolute, vazhdohet me zgjedhjen konsensuale të Presidentit. Në këtë proces zgjedhor për zgjedhjen e presidentit të vendit janë propozuar dy kandidatë për të përmbushur kushtet e përcaktuara nga aktgjykimi i sipërpërmendur i Gjykatës Kushtetuese (AKTGJYKIM në Rastin Nr. KO 29/11). Pas përfundimit të votimit të fshehtë të deputetëve dhe numërimit të votave të tyre për zgjedhjen e Presidentit të Republikës sipas rezultatit përfundimtar, Komisioni votues, konstaton si vijon:

“Në votim kanë marrë pjesë 100 deputetë. Për Atifete Jahjaga kanë votuar 80 deputetë, për Suzan Novobrdalija kanë votuar 10 deputetë, të pavlefshme janë 10 fletëvotime.... Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se Atifete Jahjaga zgjidhet Presidente e Republikës së Kosovës”... (Kuvendi: Transkripti 2011: 11-12).

Reforma kushtetuese dhe zgjedhore dështoi në mungesë të vullnetit politik. Pas presionit nga opozita, shumica parlamentare pranoi si kompromis vetëshpërndarjen e Kuvendit dhe vajtjen në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Kështu që, Kuvendi në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 7 maj 2014 e kishte një pikë të rendit të ditës *“Shqyrtimi i kërkesës së Grupit të deputetëve për shpërndarjen e Legjislaturës IV të Kuvendit të Republikës së Kosovës”*. Pas debatit pro dhe kundra për shpërndarjen e Kuvendit, deputetët

“me 90 vota pro, 4 kundër dhe 3 abstenime, vendosën për shpërndarjen e Kuvendit” (Kuvendi: 2014 Transkripti 1-32). Sipas Kushtetutës, “nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës” (Kushtetuta 2008, neni 82.1.2).

6.3.5.1. Qeveria *Thaçi II*. Koalicioni PDK dhe AKR (2010-2014)

Fituesi i zgjedhjeve apo subjekti i parë i dalë nga zgjedhjet në bazë të dispozitave të Kushtetutës i takon e drejta për formimin e institucioneve. Nga ky proces zgjedhor subjekti i parë doli PDK, e udhëhequr nga Hashim Thaçi, i cili bëri “marrëveshje për koalicion qeverisës” me AKR-ën e drejtuar nga Bexhet Pacolli (Lajmetshqip.com, 2011). Një marrëveshje e tillë për formimin e institucioneve është kundërshtuar nga opozita që në seancën e parë konstitutive. Mirëpo pas një debati në mes të pozitës dhe opozitës për procesin zgjedhor, duke vlerësuar se procesi zgjedhor, për opozitën, ishte me “plot parregullsi”, për këtë arsye kërkonin një marrëveshje gjithëpërfshirëse për krijimin e institucioneve. Sidoqoftë zgjedhja e presidentit dhe formimi i qeverisë, nuk hasi në përkrahje të mazhorancës nga opozita e cila lëshon seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të mbajtur më 22 shkurt 2011. Megjithatë, shumica parlamentare në Kuvend, e përbërë nga PDK e AKR dhe minoritetet “zgjodhën Qeverinë e Republikës së Kosovës”, “me 65 vota “pro”, 1 “kundër”, pa asnjë abstenim” (Kuvendi 2011:33, Transkripti i seancës së jashtëzakonshme). Kjo ishte një qeveri me një shumicë jo stabile parlamentare dhe me një opozitë aktive dhe të fuqishme. Në shumicën e seancave të Kuvendit vendimmarrja ishte e opozitës për shkak të numrit më të madh të votave pro propozimit të tyre. Meqenëse, kjo shumicë parlamentare ishte jo stabile, prodhoi kriza parlamentare gjatë legjislaturës për mungesë të fuqisë së

vendimmarrjes apo kourumit në Kuvend. Kuvendi në mungesë të votave të mjaftueshme për të krijuar kourum, u përball gjatë gjithë mandatit të saj, të kryej funksionin legjislativ, zgjedhor dhe mbikëqyrës. Ndërkohë kur pozita e as opozita nuk e kishin shumicën parlamentare, është arritur marrëveshja e subjekteve politike për shkuarjen në zgjedhje të parakohshme duke e vetëshpërndarë kuvendin me 2/3 e votave të tyre. Çdo shpërndarje e Kuvendit para kohe ose shkarkim të qeverisë ajo (Qeveria) “konsiderohet në dorëheqje” (Kushtetuta 2008, Neni 100).

6.3.6. Formimi i institucioneve sipas Kushtetutës së Republikës të Kosovës dhe rezultatit zgjedhor për Legjislaturën e pestë (2014 -2017)

Formimi i institucioneve në Legjislaturën e pestë ka elemente të përbashkëta midis zgjedhjeve paraprake dhe atyre të radhës. Edhe këto zgjedhje janë mbajtur sipas të njëjtit kornize ligjore për zgjedhje ose sistem zgjedhor dhe “afat të shkurtuar kohor për fushatë elektorale”. Sipas legjislacionit zgjedhor*“Zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas shpërndarjes”*... (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 4.5; KQZ 2010, Nr. 15/2010, Neni 1.3, Neni 7). Në këtë proces zgjedhor për herë të parë partitë politike filluan të bëjnë “koalicione të mëdha parazgjedhore” (KQZ/QNR 2014) me qëllim daljen si “subjekti i parë paszgjedhor” dhe për të siguruar mandatin ligjor për “krijimin e institucioneve”, qoftë në “propozimin e Kryetarit të Kuvendit” apo edhe për propozimin e “mandatarit për formimin e qeverisë” (Gjykata Kushtetuese: Rasti Nr. KO119/14 & Rasti Nr. KO103/14). Në këtë proces zgjedhor kanë konkurruar 30 subjekte politike. Në kuadër të Tabelës18 pasqyrohet rezultati i përgjithshëm i subjekteve politike, numri dhe përqindja e votave të fituara, mandatet e siguruara sipas subjekteve politike për Kuvend (KQZ/QNR 2014).

Tabela 18. Rezultatet përfundimtare në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014

Nr	EMRI I PARTISË	VOTAT	PËRQINDJA	Mandate
1	PDK, PD, LB,PSHDK, PKK	222.181	30,38%	37
2	Lidhja Demokratike e Kosovës	184.594	25,24%	30
3	Lëvizja Vetëvendosje!	99.398	13,59%	16
4	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	69.793	9,54%	11
5	Srpska Lista	38.199	5,22%	9
6	Nisma Për Kosovën	37.68	5,15%	6
7	Kosova Demokratik Türk Partisi	7.424	1,02%	2
8	Koalicija Vakut	6.476	0,89%	2
9	Progresivna Demokratska Stranka	5.973	0,82%	1
10	Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës	3.335	0,46%	1
11	Nova Demokratska Stranka	2.837	0,39%	1
12	Partia Liberale Egjiptiane	1.96	0,27%	1
13	Partia e Ashkalinjeve për Integrim	1.583	0,22%	1
14	Koalicija Za Gora	1.193	0,16%	1
15	Kosovaki Nevi Romani Partia	645	0,09%	1
16	Aleanca Kosova e Re	34.17	4,67%	0
17	Kosova Türk Adalet Partisi	2.349	0,32%	0
18	Pokret Za Demokratski Prosperitet	1.787	0,24%	0
19	Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës	1.456	0,20%	0
20	Centar Demokratske Unije	1.298	0,18%	0
21	Partia e Fortë	1.142	0,16%	0
22	Stranka Demokratske Akcije	1.095	0,15%	0
23	Bošnjacka Jedinstvena Lista	860	0,12%	0
24	Hasan Gashi	775	0,11%	0
25	Pokret Za Gora	754	0,10%	0
26	Bošnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova	702	0,10%	0
27	Partia Rome e Bashkuar e Kosovës	642	0,09%	0
28	Samostalna Liberalna Stranka	379	0,05%	0
29	Socijaldemokratija	325	0,04%	0
30	Lëvizja Grupimi Tradicional Shqiptar	243	0,03%	0

Burimi : KQZ /QNR2014

Efekti i pragut zgjedhor prej 5% reflektohet te numri i subjekteve politike që përfaqësohen në Kuvend. Në veçanti kjo reflektohet te subjektet politike që përfaqësojnë shqiptarët, ndërsa

numri i subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetet pakicë pothuajse është i njëjtë sikurse në legjislaturën e kaluar. Në kuadër të grafikut 9 janë pasqyruar subjektet politike të cilët e kanë kaluar pragun zgjedhor si dhe numrin e mandateve sipas përkatësisë politike.

Grafiku 9. Numri i mandateve sipas subjekteve politike në Kuvend në zgjedhjet e vitit 2014



Burimi: Autori bazuar në rezultatet KQZ/QNR 2017

Në Legjislaturën e pestë (17.07.2014 - 10.05.2017) janë përfaqësuar 15 subjekte politike, të cilat janë strukturuar në shtatë grupe politike parlamentare. Grupi më i madh është koalicioni i PDK me 36 vende; grupi i LDK-së me 33 vende, grupi i LVV-së me 16 vende, grupi i Listës Serbe me 11 vende, grupi politik i AAK-së me 8 vende, grupi Nisma me 6 vende, grupi 6+ me 6 vende dhe pa grup 4 vende (Kuvendi: Legjislatura V: 17.07.2014 - 10.05.2017).

Edhe pse koalicioni PDK-së doli subjekti i parë, ajo për një kohë të gjatë nuk arriti të gjente aleat për të siguruar shumicën parlamentare për krijimin e institucioneve që nga zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit dhe më pastaj zgjedhja e qeverisë. Ky subjekt refuzohej nga partitë e

tjera për të bërë koalicion. Mirëpo, subjektet e tjera, LDK, AAK, Nisma, minoritetet dhe LVV krijuan VLAN-in, d.m.th. arritën marrëveshje të koalicionit pas zgjedhor për të formuar institucionet. Kjo marrëveshje është e njohur si “Marrëveshja Parimeve ndërmjet Koalicionit LDK-AAK-Nisma për Kosovën dhe Levizjes Vetëvendosje” ku palet janë dakorduar për ndarjen e pozitave të pushtetit qendror në Kosovë (Telegrafi.com 2014). Sipas marrëveshjes, Isa Mustafa, Kryetari i LDK-së është përcaktuar të zgjidhet Kryetar i Kuvendit dhe Ramush Haradinaj të zgjidhet Kryeministër. Ndërkohë Presidentja, çështjen se kujt duhet t’i jepet mandatarin për formimin e qeverisë e dërgoi në Gjykatën Kushtetuese (Aktgjykimi në Rastin Nr. K0103/14), për të interpretuar dy dispozitat kushtetuese (Neni 84 dhe Neni 95) rreth formimit të saj.

Kushtetuta përcakton se Presidenti sipas Nenit 84, paragrafi 14:

“cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;.. dhe Neni 95 paragrafi 1, përcakton se: “Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”....(Kushtetuta: Neni 84 dhe Neni 95)

Ndërsa Gjykata Kushtetuese i interpretoi dispozitat e lartpërmendura që ndërlidhen me procedurën për zgjedhjen e qeverisë, kuptimin e “shumicës absolute” dhe “shumicës relative” si dhe përdorimin e termave koalicione, në këtë mënyrë:

- a. ... “Përdorimi i termave “parti politike ose koalicion”, kur përmenden në lidhje me nenin 84 (14) dhe me nenin 95, paragrafët 1 dhe 4, të Kushtetutës, nënkupton partinë politike ose koalicionin që është regjistruar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, merr pjesë si subjekt zgjedhor, është i përfshirë në fletëvotim të zgjedhjeve, e kalon pragun dhe, rrjedhimisht, fiton vende në Kuvend”;
- b. “Partia ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend, siç përcaktohet në nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, nënkupton partinë ose koalicionin që ka shumicën e vendeve në Kuvend, qoftë shumicën absolute, qoftë atë relative;”
- c. “Presidenti Republikës, në bazë të nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër të nominuar nga partia politike ose nga koalicioni që ka numrin më të madh të vendeve në Kuvend”... (Gjykata Kushtetuese, Aktgjykimi në Rastin Nr. K0103/14)

Rrjedhimisht, në bazë të aktgjykimit del se partia që ka numrin më të madh në Kuvend është PDK dhe asaj i takon e drejta për të propozuar mandatarin e qeverisë të Presidentja.

Gjithashtu, sipas dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese:

- a. *“Presidenti i Republikës nuk e ka diskrecionin të refuzojë caktimin e kandidatit të propozuar për Kryeministër”;*
- b. Mirëpo, *“në rast se kandidati i propozuar për Kryeministër nuk merr votat e nevojshme, Presidenti i Republikës, në diskrecionin e tij/saj, në bazë të nenit 95, paragrafi 4, të Kushtetutës, emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, pas konsultimit me partitë ose me koalicionet ..., që kanë plotësuar kriteret e lartpërmendura, pra me parti ose me koalicion që është regjistruar si subjekt zgjedhor në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, e ka emrin në fletëvotim të zgjedhjeve, ka marrë pjesë në zgjedhje dhe ka kaluar pragun”;*
- c. Megjithatë, *“nuk përjashtohet që Presidenti i Republikës të vendosë t’i japë partisë ose koalicionit të pare, sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, mundësinë të propozojë kandidatin tjetër për Kryeministër”;* (Gjykata Kushtetuese (2014), Aktgjykimi në Rastin Nr. K0103/14)

Sidoqoftë, koalicioni i PDK-së nuk arriti të sigurojë shumicën absolute për të zgjedhur Kryetarin e Kuvendit dhe përfunduar konstituimin e tij dhe për t’i hapur rrugë proceseve për zgjedhjen e qeverisë. Ajo veprimi sipas mundësisë së vetme që kishte duke mos “propozuar kandidatin e tyre për Kryetar të Kuvendit”. Kjo ishte mënyra për t’i detyruar partitë e tjera për të bërë koalicione me të, por kjo refuzohej nga subjektet e tjera. Koalicioni paszgjedhor VLAN- e kishte shumicën absolute në Kuvend dhe nuk pranonte ofertat e PDK-së. Më 17 korrik 2014 është filluar seanca konstitutive e Kuvendit. Pas Betimit të deputetëve grupi VLAN e lëshon seancën dhe Kryesuesja, që ishte nga PDK, në mungesë kourumi e mbyll seancën e Kuvendit. Mirëpo, VLANI, “kthehet menjëherë në sallën e Kuvendit për të vazhduar seancën. Ata së pari kanë zgjedhur kryesuesen e re, për drejtimin dhe vazhdimin e seancës konstituive dhe me “votat e 83 deputetëve të Kuvendit është zgjedhur Isa Mustafa, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës” (Kuvendi 2014: Transkripti i dt 17 korrik, 18 shtator, 8 dhjetor).

Këtë vendim të Kuvendit për zgjedhjen e Kryetarit, grupi parlamentar i PDK e kontestoi në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurës e zgjedhjes së Kryetarit. Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin në Rastin Nr. KO119/14, për “Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit” konstatoi se propozimi nuk është bërë nga grupi më i madh parlamentar.

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese: ... *“Vendimi Nr. 05-V-001, i 17 korrikut 2014, është jokushtetues, si për nga procedura e ndjekur, ashtu edhe për nga përmbajtja, pasi nuk ishte grupi më i madh parlamentar ai që propozoi Kryetarin e Kuvendit dhe, rrjedhimisht, është i pavlefshëm”* (Gjykata Kushtetuese: 2014, Rasti Nr. KO119/14).

Pas rrëzimit të vendimit të Kuvendit për Zgjedhjen e Kryetarit të saj nga Gjykata Kushtetuese, në Kosovë është krijuar një realitet i ri politik dhe juridik. Në radhët e VLAN-it filluan tentativat për ndryshimin e marrëveshjes për ndarjen e posteve drejtuese të institucioneve. LDK si subjekti më i madh në kuadër të VLAN-it kërkonte pozicionin e Kryeministrit. Mirëpo, refuzohej kategorikisht nga Kryetari i AAK-së. Kjo periudhë gjashtëmujore e bllokimit të formimit institucional përfundoi pas ndërhyrjes ndërkombëtare për të arritur një “marrëveshje të Koalicionit” për bashkëqeverisje në mes të PDK-së dhe LDK-së. Në kuader të njëzet (20) pikave të marrëveshjes, ndër të tjera është edhe ndarja e pozitave të larta të pushteteve ndërmjet dy subjeteve politike (Kallxo.com 2014). Pas kësaj marrëveshjeje përmbyllet seanca konstituive e Kuvendit në datën 8 dhjetor, e cila kishte filluar më 17 korrik 2014 (Kuvendi 2014: Transkripti i datës 17 korrik, 18 shtator, 8 dhjetor). Në përgjithësi kjo legjislaturë e njohur si koalicioni i madh dhe i vendimeve të mëdha, në kuadër të saj kishte shumicë të kualifikuar (mbi 2/3) të votave dhe një opozitë të vogël për

nga numri i tyre në Kuvend. Megjithatë, Kuvendi shumicën e seancave i ka mbajtur në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme, nën presionin e opozitës duke hedhur gaze lotsjellës në sallë për të pamundësuar mbajtjen dhe funksionimin e rregullt të seancave. E gjithë kjo në emër të mbrojtjes së kauzës kundër krijimit të “asociacionit me shumicë serbe”¹⁸ dhe “ratifikimi i demarkacionit”¹⁹ me Malin e Zi. Gjithashtu, edhe zgjedhja e presidentit të radhës (Presidentit H. Thaçi, 2016) është bërë në kushte dhe rrethana të tensionuara (me hedhje gazi lotsjellës) në Kuvend dhe protesta jashtë tij (Kuvendi 2016 transkript i dt. 26 shkurt; & transkripti i dt. 22, 23, 28 shkurt dhe 20 e 21 mars 2018).

Mirëpo, pas zgjedhjes së presidentit, ish liderit të PDK-ës ky subjekt e ndryshoi liderin e saj dhe kështu që bashkë me të ndryshoi edhe qëndrimi për koalicionin midis PDK dhe LDK. Kuvendi në seancën e mbajtur më 10 maj 2017 si rend dite kishte “Shqyrtimin e Mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë”. Pas votimit të suksesshëm të Mocionit të mosbesimit të Qeverisë “me 78 vota pro në mënyrë elektronike, 34 kundër, 3 abstenime”, Kuvendi e miratoi Mocionin e mosbesimit për Qeverinë” (Kuvendi 2017, transkript i datës 10 maj). Më tutje Presidenti i Republikës konform dispozitave Kushtetuese sipas Nenit 82 dhe 84, ka shpërndarë Kuvendin e Kosovës dhe ka shpallur zgjedhjet e jashtëzakonshme në datën 11 qershor 2017.

¹⁸ Shënim: “Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementët kryesorë” është derivat i Marrëveshjes së Qeverisë së Kosovës dhe ajo e Serbisë. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin, Rasti nr. KO130/15, konstatoi që parimet, siç janë elaboruar në "Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementët kryesorë", nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

¹⁹ Shënim: Miratimi i Demarkacionit e cila ishte penguar në çdo formë është ratifikuar pas dy viteve nga Kuvendi në seancë të jashtëzakonshme e cila është mbajtur në 22, 23, 28 shkurt dhe 20 e 21 mars 2018.

6.3.6.1. Qeveria Isa Mustafa. Koalicioni PDK dhe LDK (2014-2017)

Formimi i qeverisë vjen pas një maratone zhvillimesh politike dhe juridike. Dispozitat kushtetuese që përcaktojnë “propozimin e mandatarit për Kryeministër”, “grupi më i madh parlamentar”, “koalicionet” ishin çështjet që u komentuan në dy krahët e politikës, PDK dhe VLAN-it. Presidentja e vendit për t’i hequr dilemat e saj se kujt duhet t’i jepet mandati për formimin e qeverisë, çështjen e dërgoi në Gjykatën Kushtetuese për të interpretuar dispozitat kushtetuese rreth formimit të qeverisë. Përgjigjja e Gjykatës Kushtetuese në aktgjykimin e saj në Rastin Nr. K0103/14, ka vendosur që Presidenti e nominon mandatarin për formimin e qeverisë nga “*subjekti fitues i zgjedhjeve pa marrë parasysh a ka fituar shumicën relative apo absolute*” në Kuvend. Nëse i emëruari për mandatar nuk ka sukses në marrjen e votëbesimit në Kuvend, Presidenti e ka diskrecionin për ta emëruar nga i “*njëjti subjekt*” apo “*ndonjë subjekt tjetër që siguron shumicën*” në Kuvend (Gjykata Kushtetuese, Rasti Nr. K0103/14).

Pas presionit të faktorit ndërkombëtar (ambasadorëve të SHBA, Gjermanisë, Britanisë së Bashkuar) për të zgjidhur krizën institucionale (bllokadën e formimit të institucioneve) partitë politike PDK dhe LDK nga skajet ekstreme të spektrit politik bënë aleanca të papritura, lidhin “Marreveshje Koalicioni” midis tyre, për qeverisje dhe ndarje të pozitave drejtuese në qeveri dhe institucionet tjera në nivel Republike (Kallxo.com, 2014). Edhe pse këto dy parti rivale e kishin një përvojë jo të mirë në bashkëqeverisje gjatë viteve 2008-2010. Ndaj kundërshtitë e deputetëve të të dy forcave politike për këtë koalicion janë reflektuar në seancën e jashtëzakonshme dy ditore për zgjedhjen e qeverisë. Megjithatë në

përfundim të seancës, Kuvendi me “73 vota”, “zgjodhi qeverinë e re me kryeministër Isa Mustafën” (Kuvendi 2014 :59, Transkripti 8 dhe 9 dhjetor). Zgjedhja e qeverisë nuk i mori të gjitha votat e deputetëve të koalicionit në shenjë të pakënaqësisë për një koalicion të tillë. Modele të tilla të koalicioneve të mëdha midis partive rivale apo kohabitacioneve janë në kundërshtim me pritjet e qytetarëve dhe si pasojë ato në zgjedhjet pasuese kanë marrë ndëshkimin e qytetarëve me votë (shih rezultatin e zgjedhjeve 2017) për devijimin nga ideologjia politike. Si rezultat i “mocionit të votëbesimit ndaj qeverisë e iniciuar nga opozita dhe që u mbështet edhe nga partneri i koalicionit PDK-ja, qeveria shkarkohet nga Kuvendi” dhe bëhet shpërndarja e tij nga presidenti. Vendi shkon në zgjedhje të jashtëzakonshme (Kuvendi 2017: transkript i datës 10 maj).

6.3.7. Formimi i institucioneve sipas Kushtetutës së Republikës të Kosovës dhe rezultatit zgjedhor për Legjislaturën e gjashtë (2017-)

Formimi i institucioneve në Legjislaturën e gjashtë ka disa karakteristike të përbashkëta në mes këtyre zgjedhjeve me ato paraprake janë se organizohen si zgjedhje të jashtëzakonshme pas votëbesimit të qeverisë dhe shpërndarjes së kuvendit nga Presidenti i Republikës. Përveç kësaj e përbashkëta tjetër e këtyre zgjedhjeve me ato paraprake të vitit 2010 dhe 2014 është se organizimi i tyre bëhet sipas të njëjtit sistem zgjedhor dhe Rregullores për zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe zgjedhjet e parakohshme. (KQZ: Rreg. nr. 15/2013). Sipas normativës ligjore zgjedhjet e parakohshme dhe jashtëzakonshme duhen të mbahen jo më larg se 45 ditëve, e as para 30 ditëve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve. Për këtë arsye të gjitha

procedurat pranë KQZ, sipas Nenit 1.3 të Rregulles Nr. 15/2010 të saj, “certifikimi i subjekteve politike dhe listave të kandidatëve” si dhe “fushatat” janë me afat më të shkurtër (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 4.5; KQZ, 2010 Nr. 15/2010, Neni 1.3).

Një karakteristikë tjetër e këtij procesi zgjedhor është se për herë të parë në Kosovë janë krijuar koalicione të mëdha parazgjedhore. Impakti i këtyre koalicioneve është krijimi i tri blloqeve të mëdha politike që prezantohet në Tabelën 19. Mirëpo, determinant për krijimin e këtyre koalicioneve të mëdha përveç efektit të pragut zgjedhor të lartë (5%), janë edhe fryma e Aktgjytimeve të Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO119/14 dhe Rastin Nr. K0103/14 me të cilin është përcaktuar procedura e” formimit të institucioneve që nga nominimi i kandidatit të kryetarit të Kuvendit si dhe mandatarin për formimin e qeverisë”. Sipas atkgjytimeve të lartpërmendura është përcaktuar që, “subjekti politik që del i pari në zgjedhje”, pa marrë parasysh se ka fituar “shumicën absolute apo relative”, ka të drejtën që ta propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit dhe mandatarin për formimin e qeverisë. Rezultati përfundimtar në zgjedhjet e përgjithshme është pasqyruar në kuadër të Tabelës 19, e cila paraqet fuqinë elektorale të çdo subjekti politik pjesëmarrës në zgjedhje (KQZ/QNR 2017)

Tabela 19. Rezultatet përfundimtare në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017

Nr	Subjekti	Votat	Përqindja	Mandate
1	PAN	245.627	33,74%	39
2	LVV	200.135	27,49%	32
3	LAA	185.884	25,53%	29
4	L Serbe	44.499	6,11%	9
5	KDTP	7852	1,08%	2
6	K, Vakant	6443	0,89%	2
7	NDS	36.52	0,50%	1
8	SLS	3540	0,49%	1
9	PDAA	2.425	0,33%	1
10	PLE	2.415	0,33%	1
11	JGP	2369	0,33%	1
12	PAI	2107	1,10%	1
13	PRBK	955	0,13%	1
14	Fjala	7.852	1,08%	0
15	PKS-AGI	2126	0,29%	0
16	PDS	1698	0,29%	0
17	IDK e re	1521	0,23%	0
18	Koalicioni SDA	1355	0,21%	0
19	KTAP	1347	0,19%	0
20	P. GORA	1020	0,19%	0
21	KNRP	951	0,13%	0
22	GIG	813	0,11%	0
23	PDU	478	0,07%	0
24	GI. PK	311	0,04	0
25	GI. EA	244	0,03	0
26	NSK	227	0,03	0

Burimi: KQZ/QNR: 2017

Në kuadër të tabelës së mësipërme prezantohen votat e 26 subjekteve pjesëmarrëse në garën zgjedhore, 13 subjekteve që kanë kaluar pragun apo që kanë siguruar mandate në Kuvend, si dhe atyre që kanë mbetur jashtë parlamentit. Ndërsa mandatet parlamentare sipas

subjekteve politike janë prezantuar në kuadër të grafikut 10 dhe në bazë të tyre është determinuar krijimi i institucioneve.

Grafiku 10. Numri i mandateve sipas subjekteve politike në Kuvend në Zgjedhjet e vitit 2017



Burim: Autori bazuar në rezultatet e KQZ/QNR 2017

Efekti i sistemit zgjedhor dhe rregullat juridike në këto zgjedhje krijuan një realitet të ri në historinë e parlamentarizmit kosovar. Një koalicion i tri subjekteve shqiptare (PAN) së bashku me minoritetet nuk krijoi shumicën absolute parlamentare. Ndërsa, dy subjektet e tjera (LVV dhe LAA) së bashku krijuan shumicë absolute parlamentare por nuk kanë të drejtë për të filluar krijimin e institucioneve.

Një shumicë parlamentare sipas rezultatit zgjedhor të datës 11qershor 2017, ka mundur të krijohet në disa mënyra:

1. Qeveria e mbështetur nga 61 deputetë (PAN 39 plus Minoritetet 20 dhe AKR –me 4 deputetë), ndërsa opozita e bashkuar me 57 deputetë (LVV 32, LDK +AL 25) .

2. Qeveria e mbështetur nga 65 deputetë (PAN 39, plus Minoritet 20, plus AKR 4 dhe AL 2) ndërsa opozita e bashkuar me 55 deputetë (LVV 32, LDK 23).
3. Qeveria e mbështetur nga 82 deputetë (PAN 39 plus Minoritet 20 dhe LDK 23) , ndërsa, opozita e bashkuar me 38 deputetë (LVV 32, AKR 4, AL 2)
4. Qeveria e mbështetur nga 91 deputetë (PAN 39, LVV 32 dhe Minoritet 20), ndërsa, opozita me 29 deputetë (LAA)) ose
5. Qeveria e mbështetur nga PAN 39 plus Minoriteti 20 dhe dy apo më shumë deputetë të pavarur (kontrabanduar) që mundësojnë një shumicë parlamentare.

Megjithatë, krijimi i një shumice është e domosdoshme që nga zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit. Në bazë të nenit 67.2 të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit propozohet nga *“grupi më i madh parlamentar dhe zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit”* (Kushtetuta, Neni 67.2). Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO119/14 ka sqaruar se cili grup parlamentar konsiderohet më i madh. Kështu që, primati i takon çdo herë subjektit që ka dalë i pari të zgjedhë aleatin e tij për bashkëqeverisje. Edhe në rast se ajo nuk ka vullnet për kompromis, subjektet e tjera janë të detyruara ta votojnë kandidatin e tyre nëse dëshirojnë të zhbllokojnë procesin e konstituimit të kuvendit dhe fillimit të krijimit të institucioneve sipas rezultatit zgjedhor. Sidoqoftë, indiciet e para të krizës politike në procesin e konstituimit të kuvendit janë ngjashmërisht të njëjta si në vitin 2014. Kjo pasqyrohet në transkriptin e Mbledhjes Konstituive të Kuvendit të mbajtur më 3,4, 10, 14, 24 gusht dhe më 7 shtator 2017. Kriza politike është shfaqur që në fillim të seancës konstituive të mbajtur më datën 3 gusht, ku Koalicioni PAN së bashku me minoritetet (59 mandate) nuk siguronin një shumicë parlamentare në Kuvend. Kjo është

përsëritur gjithashtu edhe në vazhdimin e mbledhjeve të mbajtura më datën 4, 10, 14, 24 gusht 2017. Kriza politike dhe institucionale mori fund pas arritjes së “Marrëveshjes për koalicion” edhe me AKR”-ën (Gazeta Blic 2017). Pas kësaj është vazhduar mbledhja konstituive e Kuvendit të mbajtur më datën 7 shtator, ku është propozuar kandidati i PAN-it për Kryetar të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit është zgjedhur me 62 vota pro dhe 52 vota kundër nga 114 deputetë që ishin prezent në sallë (Kuvendi i Kosovës 2017, Transkript i dt: 3,4, 10, 14, 24 gusht dhe dt. 7 shtator). Megjithatë, konstituimi i kuvendit dhe formimi i qeverisë është i varur nga kompromisi politik dhe kalimi i deputetëve nga një parti në parti apo koalicion tjetër. Kalimi i AKR-ës nga koalicioni LAA-ës në koalicionin PAN mundësoi krijimin e një shumice parlamentare (jo stabile) për krijimin e institucioneve që nga zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit dhe qeverisë së Kosovës.

Subjektet politike ndër vite kanë ndërruar primatin e tyre në skenën politike (rrotacion politik). Kështu që, sistemi zgjedhor proporcional me një zonë të vetme dhe pragu prej 5% po determinon një skemë politike ku ardhja në pushtet e një subjekti politik i vetëm është i pamundur pa lidhje të koalicioneve me subjekte të tjera politike. Sipas Sartorit partitë që nuk fitojnë vende në parlament nuk merren parasysh për koalicione (paszgjedhore) dhe se fuqitë e partive maten me numrin e mandateve parlamentare dhe vetëm ato parti duhet të llogaritet si komponentë të sistemit partiak që janë të "rëndësishme" në kuptimin e "potencialit të koalicionit" (Sartori, G.1976:122-23). Një parti ka potencial të koalicionit në qoftë se ajo ka marrë pjesë në koalicionet qeverisëse si pjesëmarrëse në qeveri ose në qoftë se partitë e mëdha e konsiderojnë atë subjekt si një partner të mundshëm të koalicionit. Partitë që janë ideologjikisht të kundërta, duke përfshirë partnerët e tyre të koalicionit, nuk kanë mundësi të krijimit të koalicionit me kundërshtarët ideologjik (Lijphart A, 1999: 64).

Megjithatë, ky rregull në Kosovë ka përjashtime, pasi, koalicionet midis subjekteve me ideologji dhe programe diametralisht të kundërta si dhe me individë apo subjekte joparlamentare bënë të mundur formimin e Qeverisë në vitin 2017. Kjo nuk është pengesë kryesore për koalicione sepse nuk kanë alternativa të tjera të zgjedhjes së partnerëve qeverisës. Kjo dëshmon se që nga përfundimi i luftës, në Kosovë të gjitha institucionet (qeveritë) janë formuar me koalicione paszgjedhore.

Në përgjithësi Legjislatura e gjashtë është përfaqësuar nga 13 subjekte politike elektorale, të cilat janë strukturuar në shtatë grupe politike parlamentare. Subjektet politike që formuan PAN-in, pas konstituimit të institucioneve vazhdojnë të funksionojnë si grupe parlamentare më vete. Grupi më i madh në këto zgjedhje ka dalë LVV-se me 32 vende, Grupi i dytë LDK (LA) me 27 vende, grupi i tretë PDK me 24 vende, pastaj grupi politik i Listës Serbe me 10 vende, grupi politik i AAK-së me 9 vende dhe grupi Nisma me 6 vende ishin pjesë e PAN-it, grupi 6+ me 6 vende dhe pa grup 6 vend (Kuvendi 2017-Legjislatura VI).

Kuvendi me një dizajnim të tillë politik dhe me një shumicë parlamentare jo stabile ka prodhuar shumë herë mungesë kourumi dhe jofunksionalitet të tij. Gjate analizës së transkriptit të seancave të Kuvendit të datës 2, 8, 15, 16, 23, 30 mars, 20 prill, 31 maj, 1 dhe 4 qershor 2018, vërehet se, Kuvendi për mungesë të kourumit është detyruar të ndërpresë seancat, ndërsa vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara janë shtyrë në vazhdimësi për seancat e radhës dhe votimi i tyre do të realizohet në momentin kur do të ketë kourumin e nevojshëm për vendimmarrje (Kuvendi 2018).

Në përfundim të kësaj analize mund të arrijmë në përfundimin se është e domosdoshme të ndryshohet Neni 67.2 dhe 95.1 i Kushtetutës që rregullon mënyrën e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit dhe zgjedhjes së qeverisë. Për këtë rekomandohet që dispozita e ardhshme të

hapë mundësinë e propozimit të Kryetarit të Kuvendit nga grupi apo grupet parlamentare që sigurojnë shumicën absolute në Kuvend. Madje, si propozime për dispozitën e re ose Projekt amendamenti do të ishte kështu: *Kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Kandidat për Kryetar mund të propozohen nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhet ai kandidat që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.* Rrjedhimisht, kjo do të lehtësonte krijimin e shumicës parlamentare dhe formimin e institucioneve. Përndryshe nëse paraqitet një rezultat hipotetik pas zgjedhor me subjektet politike që dalin në numër të barabartë të mandateve nga procesi zgjedhor si për shembull: Partia A, 30 mandate; Partia B, 30 mandate; Partia C, 20 mandate; Partia D, 11 mandate; Partia E, 9 mandate si dhe subjektet politike që përfaqësojnë të gjitha minoritetet në 20 vende (të garantuara) në Kuvend që gjithsej janë 120, çështja që shtrohet është se: cila nga këto subjekte politike do të kishte të drejtën për të filluar procesin e ndërtimit të institucioneve, së pari propozimin e kandidatit për kryetar të Kuvendit dhe pastaj propozimin e mandatarit të qeverisë nga Presidenti gjithmonë bazuar në logjikën e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese (Gjykata Kushtetuese, 2014, Rasti Nr. KO119/14&Rasti Nr. K0103/14); Apo çështja se kujt i takon kjo e drejtë, sipas rezultatit hipotetik, duhet të dërgohet te Gjykata Kushtetuese për interpretim të interpretimit të kornizës normative që përcaktojnë procedurat e formimit të institucioneve. Sepse kjo paqartësi juridike mund të prodhojë bllokada institucionale dhe kriza politike në vend.

Sipas kornizës ligjore në fuqi apo logjike juridike, është e rëndësishme që në procesin pas zgjedhor të jesh njëshi (subjekti i parë) dhe të gjithë numrat e tjerë janë zero dhe ato prodhojnë efekte vetëm kur i bashkohen subjektit të parë. Pastaj, nëse Partia ose koalicioni i cili ka dalë i pari në procesin zgjedhor nuk gjen aleat dhe nuk arrin të krijojë një shumicë

absolute në Kuvend për konstituimin e institucioneve prodhon kriza dhe destabilitet në sistemin politike dhe juridik në vend. Andaj reforma kushtetuese dhe zgjedhore është mëse e domosdoshme, e dobishme dhe efektive për krijimin e institucioneve dhe stabilitetin e tyre. Sistemi zgjedhor mixt determinon një shumicë absolute në Kuvend si dhe mundëson profilizimin e partive politike duke lehtësuar krijimin e koalicioneve të natyrshme programore dhe qeverisëse.

6.3.7.1. Qeveria Haradinaj II. Koalicioni PAN- me AKR dhe Minoritet- Qeveri e shumicës apo qeveri stabile?

Qeveria Haradinaj është krijuar pas një “Marrëveshje për bashkëqeverisje në mes të koalicionit PAN, minoriteteve dhe AKR-së”(Gazeta Blic 2017), Kuvendi në seancën e jashtëzakonshme me datën 9 shtator 2017 me 62 vota zgjodhi Qeverinë e Kosovës të drejtuar nga Ramush Haradinaj. Kalimi i AKR-së nga koalicioni LAA në koalicionin me PAN-in siguroi një shumicë parlamentare (jo stabile) për formimin e qeverisë. Megjithatë, ajo (AKR) për sigurimin e shumicës parlamentare dhe krijimin e qeverise është e (mbi) përfaqësuar në ekzekutiv me “tri dikastere ministrore” si dhe pozitën e “zëvendëskryeministrit ”(Gazeta Blic 2017) edhe pse në kuvend ka mbetur me dy deputetë nga katër që ishin në fillim. Nga këta katër deputetë njeri ka marrë pozitë në qeveri dhe ka humbur mandatin në kuvend ndërsa nga tre deputetët e mbetur (Korab Sejdiu) në shenjë pakënaqësie për koalicionin me PAN-in është larguar nga ky subjekt politik (Kuvendi 2017: Transkripti i dt. 9 shtator). Sidoqoftë, është demokratike që partitë të lidhin marrëveshje për koalicione pavarësisht nga orientimet programet apo preferencat ideologjike. Mirëpo, përvojat e gjertanishme tregojnë


se stabiliteti i qeverisë nuk varet çdo herë nga ajo se është pakicë parlamentare apo e ka të siguruar shumicën e kualifikuar (2/3) në Kuvend, sepse, fuqia e numrave në Kuvend jo çdo herë ia krijon stabilitetin një Qeverie. Ky fakt ishte në mandatin e qeverive të viteve 2008 dhe 2014 ku koalicioni i PDK-së me LDK-ën bashkë me minoritetet i kishin 2/3 (afër 90) e vendeve në Kuvend, por, në disa raste nuk ishin votat e mjaftueshme për kourum parlamentar si mungesë e vullnetit politik të koalicionit si për shembull ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi. Megjithatë, e rëndësishme për partitë politike është të sigurojnë një shumicë parlamentare pavarësisht nga dallimet programore dhe ideologjike apo numrat minimalë të vendeve që kanë ato në Kuvend për formimin e qeverisë. Kjo determinohet nga pragu zgjedhor dhe sistemi kushtetues për krijimin e institucioneve.

6.4.Gjetjet e hulumtimit për mungesë të relacionit votues -përfaqësues dhe të përfaqësimit jo të drejtë të vullnetit të tyre në Kuvend

Një nga çështjet e hulumtuara për qëllim të këtij punimi është gjetja e mënyrës së lidhjes të raporteve midis votuesit dhe përfaqësuesit të tyre në Kuvend si dhe përfaqësimit të drejtë të vullnetit të tyre, performanca e subjekteve politike në përgjithësi dhe Kuvendit në veçanti. Në përgjithësi, qytetarët përveç votës dhe përmes opinionit publik bëjnë vlerësimin e performancës të subjekteve politike dhe institucioneve përfaqësuese. Megjithatë, të dhënat e nxjerra nga hulumtimi reflektojnë qëndrimet e qytetarëve për realizimin e premtimeve dhe pritshmëritë e tyre nga Kuvendi. Ndaj për këtë qëllim është hulumtuar opinioni lidhur me funksionimin dhe performancën e Parlamentit vitet e fundit.

Lidhur me këtë qytetarët janë pyetur: *Kuvendi në tërësinë e tij, sa mirë ose keq mendoni Ju se ka funksionuar në këto vitet e fundit?* Në përgjithësi të dhënat e rezultatit tregojnë se performanca dhe funksionimi i Kuvendit gjatë viteve të fundit është jo i mirë. Për këtë janë deklaruar mbi 64% e të anketuarve; që Kuvendi nuk është në nivelin e dëshiruar apo ka performancë të keqe është vlerësim nga 40.1% e respondentëve ose vlerësimi i performancës si shumë i keq deklarohen 24% e tyre. Ndërsa, 33.3% e respondentëve janë deklaruar se performanca e Kuvendit është e mirë apo performanca e Kuvendit është shumë e mirë është mbështetur nga 2.6% e tyre. Kjo është e pasqyruar në figurën 12.

Figura 12. Opinioni i qytetarëve lidhur me performancën e Parlamentit në vitet e fundit




Burimi: Autori bazuar në rezultatet e hulumtimit 2017

Si përfundim mund të konkludojmë se ky rezultat negativ mbi performancën e Kuvendit reflekton pakënaqësinë e qytetarëve ndaj institucionit përfaqësues, për mënyrën e udhëheqjes dhe funksionimit të tij si dhe për mospërmbyshjen e funksionit (legjislativ, zgjedhor dhe mbikëqyrës) dhe ngjarjet jo të pëlqyeshme që janë zhvilluar në Kuvend. Megjithatë, qytetarët janë vëzhgues të drejtpërdrejtë të zhvillimeve në Kuvend dhe opinioni i tyre duhet të vlerësohet drejt dhe të merret në konsideratë. Përndryshe ata, në zgjedhje të reja me votë do bëjnë vlerësimin apo ndëshkimin e tyre.

Një çështje tjetër e hulumtuar është se sa sigurojnë zgjedhjet përfaqësim të drejtë të vullnetit të votuesve në Kuvend, duke pasur në konsideratë sistemin zgjedhor preferencial me një zone të vetme, prapësi prej 5% si dhe praktikën e proceseve paszgjedhore në Kosovë. Në lidhje me këtë qytetarëve iu është shtruar pyetja: *sa e sigurojnë zgjedhjet përfaqësimin e drejtë të vullnetit të votuesve në parlament prej deputetëve?* Të dhënat e nxjerra lidhur me përfaqësimin e mirë apo jo të mirë të vullnetit të qytetarëve në Kuvend është si vijon: 46.1% e respondentëve janë deklaruar se nuk është i kënaqshëm përfaqësimi nga deputetët, kundrejt 39.1% që kanë një vlerësim të mirë për përfaqësim të drejtë të vullnetit të tyre; pastaj 9.4%

deklarohen se nuk përfaqësohet aq mirë vullneti i tyre si dhe 5.4% deklarojnë se përfaqësohet shumë mirë vullneti i tyre nga deputetët në Kuvend. Të dhënat nga hulumtimi i pasqyron figura 13.

Figura 13. Opinioni i qytetarëve lidhur me përfaqësimin e drejtë të vullnetit të votuesve në parlament prej deputetëve.




Burimi: Autori bazuar në rezultatin e hulumtimit 2017

Në kuadër të figurës 13, shfaqen dallime të theksuara midis opsioneve që janë të kënaqur me përfaqësimin dhe për këtë janë deklaruar 44.5% si dhe atyre që nuk janë të kënaqur me përfaqësimin e vullnetit të tyre në Kuvend, 55.5%. Kjo ndodh për arsye se Kosova është një zonë e vetme dhe disa komuna apo regjione nuk përfaqësohen drejt në Kuvend. Qytetarët përmes votës përzgjedhin kandidatët e partive politike që t'i përfaqësojnë qëndrimet politike në institucionet publike.

Në kontinuitet me çështjet e hulumtuara me lart, respondentët janë pyetur se: *A mund të pohoni se pikëpamjet tuaja përfaqësohen në mënyrë të kënaqshme nga ndonjë prej partive politike në Kosovë?* Të dhënat e nxjerra tregojnë se qytetarët nuk janë të kënaqur me përfaqësimin e pikëpamjeve të tyre në kuvend nga ata që kanë marrë votën. Një shumicë

prej 64.9% e respondentëve janë deklaruar se pikëpamjet e tyre nuk përfaqësohen kënaqshëm nga partitë politike ndërsa 35.1% e respondentëve deklarohen se partitë politike përfaqësojnë kënaqshëm pikëpamjet e tyre. Këto të dhëna janë pasqyruar në figurën 14.

Figura 14. Opinioni i qytetarëve lidhur me përfaqësimin e pikëpamjeve të votuesve në mënyrë të kënaqshme nga ndonjë prej partive politike në Kosovë




Burimi : Autori bazuar në rezultatin e hulumtimit 2017

Duke u bazuar në rezultatet e prezantuara në kuadër të figurës 13, arrijmë në përfundimin se mospjesëmarrja në zgjedhje e qytetarëve është si pasojë e zhgënjimit të përfaqësimit apo nuk përfaqësohen kënaqshëm pikëpamjet e tyre nga ndonjë parti politike.

Në fund një çështje tjetër e hulumtuar për këtë punim është lidhja e votuesit me përfaqësuesit e zgjedhur në institucionet publike. A vazhdojnë kontaktet me zyrtarët e zgjedhur politikë dhe sa bashkëpunojnë ata me zgjedhësit pas marrjes së mandatit. Lidhur me këtë qytetarëve iu është shtruar pyetja: *A keni kontaktuar ndonjë deputet ose zyrtar qeveritar personalisht, duke i shkruajtur, ose në rrugë të tjera?* Sipas të dhënave të nxjerra nga hulumtimi rezultojnë se mungon kontakti në mes të zgjedhësve dhe përfaqësuesve të tyre. Këtë e pohon një shumicë prej 64.1% e respondentëve të cilët nuk kanë pasur kontakte me zyrtarët e zgjedhur ose të emëruar si dhe 35.9% e tyre, e pranojnë që kanë pasur kontakte me zyrtarët politikë. Kjo pasqyrohet në figurën 15.

Figura 15. Opinioni i qytetarëve lidhur me kontaktet e tyre me deputetë ose zyrtarë qeveritarë



Burimi: Autori bazuar në rezultatet e hulumtimit 2017

Bazuar në rezultatin e prezantuar në Figurën 15 arrijmë në përfundimin se mungon kontakti i vazhdueshëm midis përfaqësuesve politikë dhe votuesve të tyre. Kjo vjen si pasojë e sistemit proporcional preferencial në një zonë të vetme zgjedhore që nuk lejon hapësirë për mundësinë e krijimit të raporteve, lidhjes në mes të përfaqësuesit të zgjedhur dhe votuesve të tyre. Kjo argumenton se sistemi proporcional me një zonë të vetme nuk ka prodhuar një përfaqësim gjeografik dhe të drejtë si dhe nuk ka mundësuar lidhjen e përfaqësuesit me votuesit apo mbështetësit e tij. Prandaj, ndryshimi i sistemit zgjedhor në sistem gjysmëproporcional apo i kombinuar me variantin 50% me 50%, ku gjysma e deputetëve zgjidhen sipas modelit mazhoritar i pari i listës merr postin në zonën e tyre dhe gjysma tjetër e përfaqësuesve zgjidhen sipas parimit proporcional që mundëson edhe sigurimin e përfaqësimit të vendeve të garantuara si dhe përfaqësimit adekuat të gruas dhe subjekteve më të vogla në Kuvend. Kjo do të mundësonte që votuesi i zonës të kishte përfaqësuesin e tij për të shprehur kërkesat dhe opinionet për çështjet që i interesojnë.

KAPITULLI VII: ANALIZË KORNIZËS NORMATIVE DHE EFEKTIT TË SISTEMIT ZGJEDHOR PROPORCIONAL NË ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT NGA KUVENDI: krizat politike dhe evitimi i tyre

7.1. Analizë kornizës normative për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës

Korniza normative e nxjerrë nga UNMIK apo ajo e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk kanë ndonjë ndryshim të madh sa i përket procedurës së zgjedhjes së Kryetarit apo Presidentit të Kosovës. Në të dy sistemet kushtetuese është përcaktuar se “Presidenti zgjidhet nga Kuvendi me 2/3 në dy raundet e parë, ndërsa në raundin e tretë me shumicën absolute të votave të Kuvendit”. Gjithashtu, edhe për shkarkimin e tij nga funksioni kërkohen jo më pak se 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.2.3-9; Kushtetuta, Neni 86). Kushtetuta në krahasim me Kornizën Kushtetuese, e cila nuk ka pasur ndonjë dispozitë të veçantë për pasojat institucionale nëse në votimin e tretë nuk zgjidhet Presidenti, e ka të përcaktuar në Nenin 86/6 se nëse Kuvendi nuk e zgjedh Presidentin në raundin e tretë, ai shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja (Kushtetuta, Neni 86/6). Disa karakteristike të tjera dalluese në mes tyre janë: mënyra e propozimit, moshë e kandidatit; numri i kandidatëve për garën presidenciale dhe mandati i tij si dhe shkarkimi nga funksioni. Përderisa Korniza Kushtetuese i jep mundësi partisë që ka siguruar numrin më të madh të deputeteve ose ka të paktën 25 deputetë për të propozuar kandidatin, Kushtetuta sipas nenit 85 dhe nenit 86.3 të saj i jep mundësi “çdo shtetasi kosovar mbi moshën 35 vjeç” i cili “siguron paraprakisht 30 nënshkrime të deputetëve”, mund të jetë kandidat. Kështu që në garën për president mund të jenë më së shumti 4 kandidatë sipas Kushtetutës. Përveç kësaj mandati i kryetarit sipas Kreu-t 9.2.3 i Kornizës Kushtetuese

është tri vjet ndërsa sipas Nenit 87.2 -3 të Kushtetutës është 5 vite me vetëm një mundësi të rizgjedhjes. Gjithashtu, edhe procedura e shkarkimit sipas Nenit 91.3 të Kushtetutës në krahasim me Kornizën Kushtetuese, përveç që “kërkohet 2/3 e deputetëve pro shkarkimit”, kjo mund të ndodhë “vetëm pas aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese i cili konstaton se Presidenti ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës” (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.2.3-9; Kushtetuta, Neni 86, 2-6, Neni 87.2 dhe Neni 9.1, Gjykata Kushtetuese 2011, Rastin Nr. KO 29/11 pika 85 dhe 86; & Rasti nr. KI47/10, pika II).

Sipas Kornizës Kushtetuese, Kryetari i Kosovës:

“...zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës me votim të fshehtë. Emërimi i Kryetarit të Kosovës kërkon mbështetjen e partisë që ka siguruar numrin më të madh të vendeve në kuvend ose e cila ka të paktën 25 deputetë. Kuvendi zgjedh Kryetarin e Kosovës me shumicën e 2/3 të votave të deputetëve të Kuvendit. Nëse pas dy votimesh nuk arrihet shumica e dy të tretave, në votimin që vijon kërkohet shumica e votave të gjithë deputetëve” (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.2.8)

Ndërsa sipas Kushtetutës për “Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës” është përcaktuar që:

“Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidat për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidat për President të Republikës së Kosovës. Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjidhet President i Republikës së Kosovës. Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë” (45) ditësh. (Kushtetuta, Neni 86, 3-6)

Zgjedhja e Presidentit që nga viti 2001 e deri më tani (2017), ka krijuar një praktikë jo dhe aq të mirë për t’u vlerësuar. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi ka zgjedhur shtatë Kryetar/Presidentë dhe dy ushtrues të detyrës së përkohshme të Kryetarit/Presidentit. Prej tyre, katër (4) Kryetar dhe një ushtrues detyre i Kryetarit janë zgjedhur sipas Kornizës

Kushtetuese dhe tre Presidentë dhe një ushtrues detyre janë zgjedhur sipas Kushtetutës së Republikës (Presidentët e Kosovës, 2002-2017). Në përgjithësi zgjedhja e tyre është shoqëruar me kriza institucionale dhe politike në vend (KDI 2015: 5).

7.2.Zgjedhja e Kryetarit të Kosovës sipas Kornizës Kushtetuese (2002-2008)

Duke u bazuar në Kornizën Kushtetuese dhe rezultatin zgjedhor të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001, konfigurimi i Kuvendit (OSBE/CEC2001) dhe situata politike ishin të tillë që nuk mundësonin krijimin e shumicës absolute pa konsensus të gjerë politik dhe etnik. Pas konstituimit të Kuvendit procedura e konstituimit të institucioneve sipas Kreu-t 9.1-9.2 të Kornizës Kushtetuese është “zgjedhja e Kryetarit të Kosovës” (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.1-9.2). Polarizimi politik dhe ideologjik si dhe mosbesimi etnik në mes komuniteteve ishte në shkallë shumë të lartë. Megjithatë, LDK si subjekti më i madh parlamentar me 47 deputetë inicioi procedurën e zgjedhjes së kryetarit dhe si kandidat i vetëm dhe i pakontestueshëm i saj ishte lideri i Partisë, Ibrahim Rugova. Votimi i parë në Kuvend për zgjedhjen e Kryetarit është realizuar në dhjetor të vitit 2001. Pas dështimit të zgjedhjes në raundin e parë, meqë nuk u arrit që të siguroheshin votat e 2/3 të deputetëve, votimi i dytë është organizuar pas një muaji më 10 janar 2002, me të njëjtin kandidat dhe përsëri Kuvendi nuk arriti që të siguronte 2/3 e votave të të gjithë deputetëve. Institucionet ndërkombëtare dhe liderët e tri subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend, me numër të madh të deputetëve duke parë se Kryetari i Kosovës nuk mund të zgjidhej as në votimin e tretë në Kuvend, pasi kërkohet një shumicë absolute e votave (61vota) të deputetëve, arrijnë

marrëveshje për koalicion në mes tri subjekteve LDK-së, PDK-së dhe AAK-së duke siguruar shumicën absolute në Kuvend për formimin e institucioneve.

Kështu që, Kuvendi në seancën e mbajtur më 4 mars 2002, njëkohësisht me votim unik ka zgjedhur Ibrahim Rugovën për Kryetar të Kosovës dhe Bajram Rexhepin, Kryeministër me kabinetin e tij qeveritar (Paçarizi, R. 2002; IDK- Forumi 2015). Kryeadministratori ose PSSP, e toleroi një praktikë joparlamentare të zgjedhjes në votim unik të kryetarit dhe njëkohësisht të qeverisë, pasi ishte e vetmja mënyrë për të krijuar institucionet e përkohshme të dala nga zgjedhjet.

Kryetari i Kosovës, kishte kompetenca simbolike dhe të kufizuara²⁰ në ushtrimin e funksionit të tij (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.2.4), ndërsa mandati i Kryetarit të Kosovës sipas Kornizës Kushtetuese është i njëjtë sikurse mandati i deputetëve trevjeçar përveç mundësisë së dorëheqjes, pushimi i funksionit ka mundur të bëhet edhe përmes shkarkimit me votat e jo më pak se 2/3 e Kuvendit (Korniza Kushtetuese: Kreu 9. 2.2; 9.2.8-9).

Rrjedhimisht, pas organizimit të zgjedhjeve të dyta të përgjithshme edhe formimi i IPVQ-ve është bërë sipas Kornizës Kushtetuese. Kështu që, Legjislatura e dytë (2004-2007), në seancën konstituive të mbajtur më 3 dhjetor 2004, zgjodhi për herë të dytë Ibrahim Rugovën për Kryetar të Kosovës. Ai u zgjodh në raundin e tretë të votimit, pasi në dy raundet e para asnjëri nga kandidatët, ai i LDK-së Ibrahim Rugova dhe Ramë Buja si kundërkandidat nga PDK si partia e dytë në Kuvend nuk arritën 2/3 e votave të deputetëve

²⁰ Shënim: Kryetari i Kosovës, sipas Kornizës Kushtetuese ushtron këto funksione: Në koordinim me PSSP-në merr masa në fushën e bashkëpunimit me jashtë; Pas konsultimeve me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend ia propozon Kuvendit Kryeministrin e Qeverisë; Ia dorëzon PSSP-së kërkesën e Kuvendit për shpërndarjen e Kuvendit në pajtim me paragrafin 8.1 (b); Të paktën njëherë në vit ia paraqet një raport Kuvendit të Kosovës mbi gjendjen e përgjithshme në Kosovë dhe jep medalje dhe shpreh mirënjohje. (UNMIK/REG. Nr. 2001/9 Kreu 9. 2.4)

(Korniza Kushtetuese, Kreu 9.2.8; KDI 2015:5). E veçanta e këtij procesi zgjedhor, është se janë respektuar të gjitha procedurat parlamentare për krijimin e institucioneve në bazë të Kornizës Kushtetuese. Së pari, është zgjedhur Presidenti i Kosovës dhe më pastaj, ai konform Kreu 9.2.4.b i Kornizës Kushtetuese “nominoi kandidatin për kryeministër”, Ramush Haradinajn për të krijuar qeverinë (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.2.4.b).

Mandati i dytë i Presidentit I.Rugova, mbeti në gjysmë për shkak të vdekjes së tij më 21 janar 2006. Sipas Kornizës Kushtetuese: *“Nëse Kryetari i Kosovës përkohësisht nuk është në gjendje t’i kryejë detyrat e tij, funksionet e Kryetarit të Kosovës i ushtron kryetari i Kuvendit të Kosovës”* (Korniza Kushtetuese, Kreu 9.2.5). Në këtë periudhë, Kryetari i Kuvendit ishte Nexhat Daci dhe njëkohësisht mori dhe funksionin si Ushtrues i detyrës së Kryetarit të Kosovës. Për periudhën e mbetur, Kuvendi më 10 shkurt 2006, zgjodhi Kryetarin e ri, Fatmir Sejdiun nga radhët e LDK-së. Edhe ai është zgjedhur në raundin e tretë të votimeve kur kërkohen së paku 61 vota të deputetëve të pranishëm. Në këtë raund “ai mori 80 vota të deputetëve” (OSBE 2006:9).

Pas zgjedhjeve të vitit 2007, dhe në bazë të marrëveshjes për koalicion qeverisës në mes PDK dhe LDK është vendosur që edhe posti i Kryetarit të Kosovës të bëhet pjesë e procesit zgjedhor. Kështu që, në seancën e mbajtur më 9 janar 2008, Kryetari i Kosovës Fatmir Sejdiu jep dorëheqje nga posti i Kryetarit të vendit, për t’u kandiduar përsëri për mandat të ri kushtetues (Presidenti Fatmir Sejdiu, 2008). Sipas procesverbalit të seancës konstitutive në këtë proces zgjedhor janë propozuar dy kandidatë, ai i LDK Fatmir Sejdiu dhe kundërkandidati i tij që vinte nga AAK-së Naim Maloku, subjekti i të cilit ka siguruar 25 nënshkrimet e nevojshme për të paraqitur kandidatin e tyre. Kryetari i Kosovës është

zgjedhur pas raundit të tretë të votimit ku mori votën e 68 deputetëve me një mandat 5-vjeçar (Kuvendi 2008: Seancë konstitutive P- 001, Procesverbali).

Me Shpalljen e Pavarësisë dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës (15 qershor 2008), deputetët duke u bazuar në Nenin 113, pika 6, si palë e autorizuar e kanë ngritur çështjen në Gjykatën Kushtetuese, me pretendimin se Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës duke mbajtur funksion të dyfishtë në kundërshtim me Nenin 88 pika 2, që përcakton se pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike (Kushtetuta). Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin e saj (Rasti nr. KI47/10), vendosi se: “*ka shkelje serioze*” të Kushtetutës së Kosovës, respektivisht të Nenit 88.2 të Kushtetutës, nga Fatmir Sejdiu, duke mbajtur njëkohësisht postin e Presidentit të Republikës së Kosovës si dhe postin e Kryetarit të Partisë Politike, LDK-së. Presidenti ofroi dorëheqjen më 27 shtator 2010 (Presidenti Fatmir Sejdiu, 2010) dhe sipas detyrës zyrtare Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi është bërë ushtruesi i detyrës së Presidentit nga 28 shtator 2010-22 shkurt 2011 deri në zgjedhjen e Presidentit të ri (Presidentët e Kosovës, 2017).

7.3.Zgjedhja e Presidentit sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Kriza politike e krijuar pas dorëheqjes së Presidentit dhe largimit të LDK nga qeveria e çoi vendin në zgjedhje të jashtëzakonshme. Kështu që, pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010 (KQZ/QNR:2010), dy subjektet politike PDK dhe AKR arritën “marrëveshje për bashkëqeverisje” dhe siguruan shumicën parlamentare. Në kuadër të “marrëveshjes së koalicionit”, dy postet kryesore të vendit janë ndarë në mes dy liderëve, përkatësisht posti i “kryeministrit t’i takojë liderit të PDK-së, Hashim Thaçi”, ndërsa posti i “Presidentit” atij

të AKR-së Bexhet Pacolli” (Lajmetshqip.com 2011). Kështu që Kuvendi në seancën e jashtëzakonshme më 22 shkurt 2011, në raundin e tretë me 64 vota, zgjodhi President Bexhet Pacollin (Kuvendi: Transkript, 2011:16). Mirëpo me këtë vendim të Kuvendit nuk është pajtuar opozita e cila kundërshtoi zgjedhjen e Presidentit dhe apeloj vendimin e Kuvendit në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se është shkelur Neni 86 i Kushtetutës në rastin e zgjedhjes së Presidentit. Sipas Nenit 86 të Kushtetutës:

“ Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjidhet President i Republikës së Kosovës” (Kushtetuta 2008: Neni 86, pika 4 dhe 5)

Ndërsa Gjykata Kushtetuese në kuadër të Aktgjykimit të saj, ka vendosur se ka konstatuar shkelje të Nenit 86 të Kushtetutës:

”Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, më 22 shkurt 2011, është jokushtetues, meqenëse është në kundërshtim me kërkesat e Nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty.” (Gjykata Kushtetuese 2011: AKTGJYKIM në Rastin Nr. KO 29/11).

Për më tepër Gjykata Kushtetuese, në aktgjykimin e saj thotë se nuk janë siguruar votat e mjaftueshme prej dy të tretave apo 80 vota të deputetëve dhe mungesë të kourumit në dy raundet e para (Gjykata Kushtetuese 2011:AKTGJYKIM në Rastin Nr. KO 29/11, pika 85).

Pas këtij Aktgjykimi Presidenti Pacolli pas vetëm 37 ditësh në pozicionin e tij, jep dorëheqje dhe ushtrimi i detyrës së përkohshme të presidentit kalon tek Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi. Sipas Kushtetutës *“Posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj”* (Kushtetuta 2008, Neni 90.3). Pas dorëheqjes së Presidentit vendi shkoi drejt një krize institucionale, sikurse herën e parë (në vitin 2010) ngase në rast të dështimit të zgjedhjes së Presidentit brenda afatit të paraparë kushtetues prej 60 ditësh, siç e përcakton Kushtetuta në

Nenin 82, “Kuvendi do të duhej të shpërndahej” dhe vendi të shkonte në zgjedhje të jashtëzakonshme (Kushtetuta 2008: Neni 82.1.3). Mirëpo kjo krizë u zgjidh me ndërmjetësim të ambasadorit të SHBA-se në Prishtinë, Christopher Dell, më 6 prill 2011, tre liderët politik, Hashim Thaçit - PDK, Isa Mustafa - LDK dhe Bexhet Pacolli – AKR, arritën marrëveshje për tejkalimin e krizës institucionale. Këto tri subjekte politike për të evituar krizën institucionale dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese si dhe për të realizuar mandatin e Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit konsensual e paraparë në marrëveshjen e njohur si “Memorandumi për Marrëveshje” e kthyen në REZOLUTË të miratuar nga Kuvendi (Rezoluta Nr. 04 - R -02), në mbledhjen e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 7 prill 2011 për zgjedhjen konsensuale të Presidentit si dhe reformës kushtetuese dhe zgjedhore.

Në pikën 2 të kësaj rezolute përcaktohet :

“Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit të ndërlidhur në mënyrë që Presidenti i Republikës së Kosovës të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Kuvendi mbështet afatin kohor të përmbajtur në Memorandum sipas të cilit zgjedhjet e para presidenciale në Kosovë do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legjislative hyjnë në fuqi. Kuvendi mbështet themelimin e një komisioni, të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit i identifikuar nga koalicioni qeverisës, për këtë qëllim ashtu siç është paraparë në Memorandum. Në pajtueshmëri me Memorandumin, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 69 muajsh nga data e themelimit ” (Kuvendi i Kosovës 2011, Rezoluta Nr. 04 - R -02, pika 2).

Kuvendi pas kësaj marrëveshjeje si rend dite vendosi dy pika: e para, Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe e dyta Rezoluta në mbështetje të “Memorandumit të Marrëveshjes” në mes të Bexhet Pacollit, Isa Mustafës dhe Hashim Thaçit, të nënshkruar më 6 prill 2011 (Kuvendi: Transkripti 2011:2). Në pikën e parë të rendit të ditës për zgjedhjen e Presidentit janë propozuar dy kandidatë për të përmbushur kushtet e përcaktuara nga aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese (AKTGJYKIM në Rastin Nr. KO 29/11). Sipas

transkriptit të seancës, rezulton se pas përfundimit të votimit të fshehtë të 100 deputetëve: “Për kandidaten Jahjaga kanë votuar 80 deputetë, ndërsa kundërkandidatja ka marrë 10 vota si dhe 10 fletëvotime të pavlefshme (Kuvendi: Transkripti , 2011: 11-12).

Kështu që, më 7 prill 2011, Kuvendi i Kosovës në një seancë të jashtëzakonshme zgjodhi për President të ri të vendit, Atifete Jahjaga. Presidentja Jahjaga për herë të parë në historikun e parlamentarizmit në Kosovë, kishte arritur të zgjidhet qysh në raundin e parë me votat e 2/3 të deputetëve (Kuvendi: Transkripti 2011:16). Zgjedhja e Presidentes Jahjaga në krye të vendit, rezultoi që ajo të jetë, gruaja e parë që drejton Kosovën dhe njëkohësisht ishte e para presidente grua, në të gjitha vendet e rajonit, si dhe është Presidentja e parë që nuk vjen nga partitë politike. Përkundër se në marrëveshjen e liderëve është përcaktuar se Presidentja Jahjaga u zgjodh për të shërbyer për një periudhë kalimtare, deri sa të bëheshin ndryshimet kushtetuese për zgjedhjen e drejtpërdrejt, ajo vazhdoi ta mbajë mandatin e rregullt prej pesë vite (Kuvendi: Transkripti 2011: 11-12) ashtu siç kishte vendosur Gjykata Kushtetuese në Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012 (Gjykata Kushtetuese AKTGJYKIM Rastet Nr. K.O. 29/12 dhe Rastin Nr.K.O. 48/12 pika 252-256).

Në përfundim të mandatit të saj, sipas Kushtetutës, Kuvendi fillon procedurën e zgjedhjes së presidentit të ri. Në bazë të marrëveshjes për koalicion në mes të PDK-së dhe LDK-së, posti i presidentit i takonte liderit të PDK-së. Kështu që, Kuvendi në një seancë të jashtëzakonshme (26 shkurt 2016) dhe në një situatë shumë të acaruar brenda dhe jashtë Kuvendit, duke përjashtuar deputetët e opozitës nga seanca për shkak të hedhjes së gazit lotësjes dhe pengimit të mbarëvajtjes së seancës parlamentare, pas shumë ndërprerjeve të

seancës, Kuvendi ka vazhduar procesin e zgjedhjes së Presidentit të vendit. Sipas transkriptit të kësaj seance në garën zgjedhore janë propozuar dy kandidatë, Hashim Thaçi dhe Rafet Rama për të respektuar të gjitha procedurat që kërkohet sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Rasti Nr. KO 29/11 pika 85 dhe 86. Edhe pse në seancë ishin 2/3 (81) e deputetëve në të dy raundet e votimit, asnjëri nga kandidatët nuk mori numrin e kërkuar prej 2/3 e votave. Kështu që, “zgjedhja e Presidentit është bërë në raundin e tretë me 71 vota dhe kundërkandidati nuk mori asnjë votë të vetme” (Kuvendi: transkripti 2016:44).

Zgjedhja e Presidentit Thaçi, është kontestuar nga opozita dhe vendimi i Kuvendit u apelua në Gjykatën Kushtetuese me kërkesën se zgjedhja e tij *“është përcjellë me shkelje përmbajtësore dhe të procedurave të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”* (Gjykata Kushtetuese 2016: Rasti nr. K047/16). Megjithatë, Gjykata me aktvendimin e saj deklaroi “kërkesën të papranueshme” dhe e hodhi poshtë pretendimin e opozitës për proces jo kushtetues gjatë zgjedhjes së Presidentit në Kuvend (Gjykata Kushtetuese 2016, Rasti nr. K047/16, pika II). Mirëpo, opozita vazhdoi format e veta të kontestimit të zgjedhjes së Presidentit duke bojkotuar ndaj ftesave për takime nga Presidenti.

Nga çfarë u tha më lart në përgjithësi, mund të konkludojmë se zgjedhja e Presidentit të vendit nga Kuvendi ka prodhuar kriza politike dhe sociale. E kjo është si rezultat i sistemit zgjedhor proporcional i cili nuk prodhon një mazhorancë të qëndrueshme dhe institucione funksionale dhe stabile. Gjithashtu, në shfaqjen e krizave institucionale gjatë procesit zgjedhor kontribuojnë në mënyrë të veçantë edhe dispozitat normative në fuqi.

7.4.Gjetjet e hulumtimit: Zgjedhja e Presidentit drejtpërsëdrejti nga populli domosdoshmëri e kohës dhe opion i mbështetur nga opinioni


Pas vendosjes së administrimit ndërkombëtar në Kosovë, në fillimet e saj, kompetencat e Kryetarit të Kosovës më shumë ishin ceromoniale (Korniza Kushtetuese: Kreu 9,2). Si rezultat i kësaj është ndikuar që edhe Kushtetuta e Republikës të përcaktoj zgjedhjen e Presidentit nga Kuvendi. Sfidat e zgjedhjes së Presidentit ka detyruar subjektet politikë pas rastit të Presidentit Pacolli, që të arrijnë një marrëveshje për ndryshim të Kushtetutës që Presidenti të zgjidhet drejtpërdrejt nga popull, si rezultat i “Memorandum Marrëveshjes” (7 prill 2011) në mes të tre liderëve partiak (PDK, LDK dhe AKR), që parasheh zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit. Kjo marrëveshje shndërrohet në rezolutë në Legjislaturën IV të Kuvendit të Kosovës përmes së cilës shpreh përkrahjen për këtë marrëveshje dhe mbështet zotimet dhe afatet kohorë që ajo përmban. Në kuadër të pikës së dytë të kësaj rezolute, parashihet themelimi i një komisioni të veçantë i cili do të merret me propozimin e ndryshimeve të nevojshme kushtetuese dhe ligjore që ndërlidhet me mënyrën që Presidenti të zgjidhet drejtpërdrejt nga populli. Pas hartimit të amendamenteve bëhet dërgimi i tyre në Gjykatën Kushtetuese për t’i vlerësuar se mos këto amendamente i pakësojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kaptinën II (Kushtetuta 2008: Neni 144).

Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin e saj në Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12 për vlerësimin e amendamenteve të propozuara, vëren se “shkurtimi i mandatit të Presidentit” është pakësim i të drejtave të njeriut dhe shkelje e Kushtetutës. Kështu që, këto propozime për zgjedhjen e Presidentit nga populli nuk u proceduan në Kuvend për miratim dhe për të realizuar ndryshimet kushtetuese. Zgjedhja e Presidentit nga populli ka “mbështetje nga

subjektet politike siç janë PDK, LKD, AKR, Nisma”, ndërsa, “LVV dhe AAK, akoma mbështesin zgjedhjen e presidentit nga Kuvendi” (IND 2015:14).

Në hulumtimin empirik të realizuar për qëllime të kësaj teme, respondentët janë pyetur se: *kush duhet me e zgjedh presidentin e vendit?* Në përgjithësi, respondentët mbështesin alternativën që Presidenti të zgjidhet drejtpërdrejt nga vota e popullit dhe për këtë janë deklaruar 86.7% e tyre, kundrejt, 13.3% që janë të mendimit se Kuvendi duhet të zgjedhi presidentin. Opinioni i respondentëve pasqyrohet në figurën 16.

Figura 16. . Opinioni i respondentëve se kush duhet të zgjedhë Presidentin e Kosovës



Burimi: Autori bazuar në rezultatin e hulumtimit 2017

Si përfundim mund të konkludojmë se ndryshimi i zgjedhjes së Presidentit nga populli do të ishte i mirëpritur nga qytetarët dhe subjektet politike. Reformimi i zgjedhjes së presidentit nga populli i eviton krizat (pazaret) politike dhe institucionale. Kjo në njëfarë mënyre i jep më shumë legjitimitet Presidentit në ruajtjen e unitetit dhe funksionalitetit kushtetues të institucioneve. Prandaj rekomandojmë që në kuadër të reformës kushtetuese dhe institucionale, të reformohen dispozitat e Nenit 86 të Kushtetutës që përcaktojnë mënyrën e zgjedhjes së presidentit nga Kuvendi dhe të ndryshohet që Presidenti të zgjidhet nga populli.

Gjithashtu, rekomandohet që të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend pa dallime etnie apo ideologjie të arrijnë konsensus për përmbylljen e reformës kushtetuese ku një pjesë e theksuar është edhe zgjedhja e presidentit drejtpërdrejt nga populli.

KAPITULLI VIII: ANALIZË KORNIZË NORMATIVE MBI KONTROLLIN POLITIK TË QEVERISË DHE PRESIDENTIT NGA KUVENDI (2001-2017)

3.1. Analizë kornizës normative mbi kontrollin politik të Qeverisë dhe Presidentit nga Kuvendi i Kosovës

Në kuadër të analizës së kornizës ligjore mbi kontrollin politik të Qeverisë dhe Presidentit nga Kuvendi i Kosovës janë dispozitat kushtetuese të Kornizës Kushtetuese (UNMIK) dhe Kushtetutës së Republikës të Kosovës. Në bazë të dispozitave të Kreu-t 9.2.9; 9.3.10-11 të Kornizës Kushtetuese, kontrollin politik të Kryetarit të Kosovës dhe Qeverisë i takon Kuvendit dhe ai mund ta “shkarkojë Kryetarin e Kosovës” nga “*funkcioni me anë të votës së jo më pak se dy të tretave të shumicës së deputetëve*”, gjithashtu, Kuvendi “mund të mos ia japë votëbesimin qeverisë vetëm nëse me një shumicë të deputetëve të tij zgjedh njëkohësisht një Kryeministër të ri bashkë me listën e ministrave të propozuar nga ai ose ajo” (Korniza Kushtetuese 9.2.9; 9.3.10-11). Kështu që, sipas Kornizës Kushtetuese mocioni i votëbesimit ndaj qeverisë është i lidhur me zgjedhjen e qeverisë së re ,ndërsa sa i përket shkarkimit të Kryetarit të Kosovës, nuk kërkohet ndonjë procedurë tjetër e veçantë përveç sigurimit të 2/3 e votave të deputetëve.

Kontrolli politik i Presidentit të Kosovës dhe Qeverisë sipas Kushtetutës të Republikës së Kosovës rregullohet përmes dispozitave të Nenit 65.7-9, Nenit 91.3 dhe Neni 100 i Kushtetutës, duke përcaktuar se Kuvendi përveç që i “zgjedh” “Presidentin dhe Qeverinë” edhe “mund të shkarkojë” ata si dhe “mbikëqyr punën e Qeverisë dhe shpreh mosbesimin” ndaj saj në pajtim me ligjin në fuqi (Kushtetuta: Neni 65.7-9, Neni 91.3, Neni 100).

Në dispozitat e Nenit 100 pika 1 dhe 4 e Kushtetutës është e përcaktuar se “mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë mund të ngrihet me propozimin e dyzet deputetëve dhe konsiderohet se “mocioni” është pranuar, nëse për të kanë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Po ashtu, Kushtetuta përmes nenit 100 pika 5 e saj ka rregulluar edhe rastet kur “mocioni i mosbesimit dështon”, nuk mund të ringrihet gjatë nëntëdhjetë (90) ditëve të ardhshme ndonjë mocioni tjetër i mosbesimit. (Kushtetuta, Neni 100).

Procedura e kontrollit politik apo shkarkimi i Presidentit nga funksioni i tij është rregulluar më Nenin 91 i Kushtetutës që përcakton kushtet për të cilat mund të shkarkohet ai/ajo.

Shkarkimi i Presidentit mund të bëhet nëse:

1. dënohet për kryerjen e krimit të rënd;
2. nuk është i/e aftë për shkak të sëmundjes së rëndë për të ushtruar përgjegjësitë kushtetuese e këtij posti; dhe nëse
3. Gjykata Kushtetuese ka gjykuar se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës (Kushtetuta, Neni 91.1).

Duhet theksuar se përveç respektimit të dispozitave kushtetuese për kontroll politik nga Kuvendi kërkohet vullnet politik apo marrëveshje politike për të siguruar një shumicë absolute apo të kualifikuar parlamentare (2/3 në rast të shkarkimit të Presidentit) për të realizuar mandatin e tij kushtetues për mbikqyrjen parlamentare. Në historinë e parlamentarizmit të Kosovës deri më sot, asnjë nga subjektet politike nuk ka arritur t'i fitojë zgjedhjet mbi 50+1% dhe të formojë e vetme institucionet qeverisëse. Në këtë mënyrë subjektet politike gjithnjë kanë qenë të detyruara të bëjnë koalicione me subjekte aleate ose rivale për të arritur shumicën parlamentare për formimin e institucioneve. Rrjedhimisht, formimi i koalicioneve ka determinuar edhe kontrollin politik të institucioneve. Në këtë

punim kemi hulumtuar mocionet e votëbesimit të qeverisë dhe impeachmentin ndaj Presidentit.

3.2. Mocioni i votëbesimit dhe shkarkimi i qeverisë

Përderisa korniza kushtetuese nuk përcakton ndonjë dispozitë të veçantë për procedurën e ngritjes së mocionit ndaj qeverisë dhe pasojat nga ky mocion janë të rregulluara në kuadër të Kushtetutës së Republikës dhe rregullores së Kuvendit. Sipas këtyre akteve “mocionin e votëbesimit” ndaj qeverisë mund ta “kërkojë Kryeministri dhe një e treta (1/3) e të gjithë deputetëve” apo 40 nënshkrime të deputetëve të Kuvendit. Pavarësisht se cili nga këto dy institucione e kanë dhënë propozimin, Kuvendi sipas Neni 100 pika 3 e Kushtetutës dhe dispozitave të rregullores së saj është i obliguar që të vendosi në rend të ditës, “jo më vonë se pesë (5) ditë e as më herët se dy (2) ditë nga data e parashtrimit të tij” (Kushtetuta, Neni 100.1-2; Kuvendi (2010) Rregullorja, Neni 30-31). Megjithatë, mocioni i mosbesimit konsiderohet se është i suksesshëm, nëse për të kanë votuar shumica absolute e deputetëve të Kuvendit. Në të kundërtën, mocioni tjetër i mosbesimit mund të propozohet vetëm pas nëntëdhjetë ditëve (Kushtetuta, Neni 100.3-5). Efekti i votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë nga Kuvendi, sipas 100.4 i Kushtetutës në fakt sipas Neni 82.2 të saj është “shpërndarje e Kuvendit” nga Presidenti si dhe bazuar në Nenin 100.6 i kushtetutës “Qeveria konsiderohet në dorëheqje” (Kushtetuta Neni 82.2; Neni 100.4-6).

Në historinë e parlamentarizmit të Kosovës janë ngritur dy mocione të suksesshme të votëbesimit të Qeverisë nga Kuvendi. Sipas studimit të transkripteve të seancave Kuvendit të datës 2 nëntor 2010 dhe 5 maj 2017 mund të konstatojm se: mocioni i parë i votëbesimit i suksesshëm ndaj qeverisë të udhëhequr nga Kryeministri Hashim Thaçi është realizuar në

seancën e mbajtur më 2 nëntor 2010 (Kuvendi 2010: Transkripti), ndërsa mocioni i dytë i suksesshëm është ia ndaj Qeverisë së Kryeministrit ISA Mustafa, i realizuar në seancën plenare të Kuvendit të mbajtur më 5 maj 2017 (Kuvendi 2017 Transkripti). Në fakt, shpërbërja e Legjislaturës e tretë 2007-2010, dhe e pestë 2014-2017 për shkak të mocionit të suksesshëm të votëbesimit ndaj qeverisë e kanë përfunduar mandatin para kohe ose përfundimit të afatit kalendarik katërvjeçar. Ndërsa, Legjislatura e katërt ka përfunduar mandatin e saj si pasojë e votimi për vetëshpërndarje. Shpërndarja e Kuvendit është rregulluar më Kushtetutë dhe Neni 82 pika 2 të saj që përcakton se *“Kuvendi shpërndahet nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës”* (Kushtetuta Neni 82.2). Kështu që bazuar në transkriptet e seancës të mbajtur më 7 maj 2014 të Kuvendit, ai është vetëshpërndarë pas votimit me 2/3 e votave për shpërndarjen e Kuvendit, d.m.th. ndërprerjen e mandatit para kohe (Kuvendi 2014 Transkripti). Në Legjislaturën e tretë dhe të katërt, qeveria kishte një shumicë parlamentare jo stabile. Ndërsa, në Legjislaturën e pestë qeveria kishte një shumicë të kualifikuar (2/3) në kuvend, megjithatë mocioni pati sukses duke u mbështetur nga aleati i koalicionit. Kur studiohen transkriptet e dy seancave të Kuvendit të mbajtura më 2 nëntor 2010 dhe ajo më 10 maj 2017 për mocionet e votëbesimit si dhe transkriptet e seancave konstituive të Kuvendit të mbajtura më 22 shkurt 2011 dhe ajo më 7 shtator 2017 gjejmë dy karakteristika të përbashkëta të mocioneve ndaj qeverisë në Kosovë. Ato janë, e para, iniciativa për të ngritur mocionin e votëbesimit ndaj qeverisë për të dy rastet (në Legjislaturën e tretë dhe të pestë) është organizuar nga AKR në vitin 2010 dhe Nisma për Kosovën në vitin 2017, parti opozitare të vogla ose parti me numër më të vogël të deputetëve në Kuvend. Këto mocione janë mbështetur nga PDK si drejtuese e qeverisë apo

si pjesë e saj (qeverisë); si dhe e dyta, të dy subjektet iniciuese të mocionit ndaj qeverisë, pas rrëzimit të saj kanë bërë koalicione parazgjedhore ose paszgjedhore me PDK për formimin e institucioneve të reja (Kuvendi, 2010; 2011; 2017).

Në logjikën e kësaj analize mund të vijmë në përfundimin se kjo mënyrë e determinimit të ndërprerjes së mandatit të Kuvendit çdo herë kur ka mocion të suksesshëm të votëbesimit të qeverisë, duhet ndryshuar. Për këtë arsye rekomandohet të bëhen ndryshime të dispozitës së Nenit 82.2 të Kushtetutës që ndërlidhet me mocionin e votëbesimit dhe shpërndarjes së Kuvendit. Madje propozohet që Kuvendi pasi e shkarkon qeverinë dhe akoma ruan një shumicë parlamentare duhet të shkohet në krijimin e qeverisë së re. Dhe në rast se nuk sigurohet një shumicë parlamentare atëherë Presidenti në konsultim me subjektet parlamentare dhe konform Kushtetutës të shpërndajë Kuvendin dhe të shpallë zgjedhjet e jashtëzakonshme. Në këtë mënyrë Kuvendi duke përdorur këtë instrument kontrollues, përveç që kryen mandatin e tij kushtetues, ai njëherësh shpreh realitetin e ri politik në Kuvend.

3.3. Procedura e Impeachment-it ndaj Presidentit

Korniza normative në të dy sistemet kushtetuese, ai i UNMIK-ut dhe ajo e Republikës së Kosovës kanë përcaktuar dispozita për mënyrën e kërimit të përgjegjësisë apo shkarkimit të shefit të shtetit. Sipas Kreu-t 9.2.9 i Kornizës Kushtetuese “*Mandati i Kryetarit të Kosovës pushon: ...me shkarkimin nga funksioni me anë të votës së jo më pak se dy të tretave të shumicës së deputetëve të Kuvendit*” (Korniza Kushtetuese 9.2.9). Ndërsa sipas Nenit 4 i Kushtetutës të gjitha “pushtetet janë të pavarura dhe të kontrollueshme” për të ruajtur

funksionimin e institucioneve demokratike dhe siguruar demokracinë kushtetuese. Ky atribut kushtetues i takon Presidentit si “garantuesi i funksionimit demokratik të institucioneve” të Republikës së Kosovës (Kushtetuta, Neni 4).

Mirëpo, edhe ai sipas nenit 66.7 i Kushtetutës mund t’i nënshtrohet kontrollit politik dhe të “shkarkohet nga detyra e tij nga Kuvendi” (Kushtetuta: Neni 66.7) “pas një verdikti të Gjykatës Kushtetuese”. Dispozitat e nenit 91.3 të Kushtetutës e përcakton se në cilat raste mund të shkarkohet Presidenti:

“Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është dënuar për ndonjë krim të rëndë ose kur nëse Kuvendi, në pajtim me këtë nen, konstaton që Presidenti nuk është i aftë të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi mund të shkarkojë Presidentin me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij” (Kushtetuta: Neni 91.3).

Mirëpo për thirrjen në përgjegjësi të presidentit, Kushtetuta përmes Nenit 113.6 të saj, i ka dhënë mandat “Tridhjetë a më shumë deputetë të Kuvendit” për të iniciuar çështjen në Gjykatën Kushtetuese “nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës” (Kushtetuta: Neni 113.6). Rrjedhimisht, deputetët këtë të drejtë kushtetuese e kanë realizuar vetëm një herë në vitin 2010, në rastin e Presidentit Fatmir Sejdiu. Kjo iniciativë e mocionit për impeachment ndaj presidentit është mbështetur nga 32 deputetë në parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese. Mirëpo, pas presionit nga liderët partiakë ndaj deputetëve²¹ nënshkrues të peticionit, disa prej tyre i tërheqin nënshkrimet nga lista e mbështetësve të kërkesës me qëllim që lënda të mos vazhdojë më tutje për shqyrtim

²¹ Shënim: Korrespondenca që ka marrë Gjykata nga një numër i deputetëve, të cilët kanë qenë nënshkrues të kësaj kërrese. Deputetët Dragisa Mirig, Mihailo Sgepanovig, Vladimir Todorovig, Berat Luzha (PDK) dhe Muzejene Sefmani (AKR), njoftojnë Gjykatën se kanë "tërhequr nënshkrimin" nga peticioni.

në Gjykatën Kushtetuese. Argumentin se ka pasur presion e gjejmë në një nga deklaratat e dorëzuara në Gjykatën Kushtetuese ku e njoftojnë atë se tërheqin nënshkrimin e tyre nga peticioni i deputetëve. Shembull është edhe deklarata e deputetit Berat Luzha. Ai në arsyetimin e tij për tërheqje nga mocioni deklaron se: *“është në dijeni dhe i bindur për shkeljen e Kushtetutës nga Presidenti por ai kërkon të tërhiqet nga peticioni për të shmangur krijimin e krizave politike”* (Gjykata Kushtetuese: Rasti nr. KI47/10, pika 7). Kjo tërheqje nga mocioni është konsideruar si një “argument” nga pala e atakuar (Presidenti) në Gjykatën Kushtetuese dhe në përgjigjen e tij, duke thënë se: *“Deputetët nuk e plotësuan kriterin për të qenë palë e autorizuar në pajtueshmëri me Nenin 113.6 të Kushtetutës”*. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese ka vendosur se *“rasti është i pranueshëm”* i “referuar në mënyrë të rregullt” pranë saj. Gjithashtu, ajo (Gjykata kushtetuese e ka pranuar kërkesën në datë 25 qershor 2010) dhe pas hetimit të çështjes ka ardhur në përfundim se: *“ka shkelje serioze”* të Kushtetutës së Kosovës, respektivisht të Nenit 88.2 të Kushtetutës, nga Fatmir Sejdiu, duke mbajtur njëkohësisht postin e Presidentit të Republikës së Kosovës si dhe postin e Kryetarit të Partisë Politike të LDK-së (Gjykata Kushtetuese 2010, Rasti nr. KI47/10).

Ndërsa sipas Nenit 35 të Rregullores së Kuvendit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese kërkohet që: *“Kryetari i Kuvendit i njofton deputetët dhe Qeverinë me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese”* si dhe *“kërkon nga sponsorizuesi i aktit dhe nga trupat e punës së Kuvendit ta fillojnë përgatitjen e aktit në tërësi ose në pjesët e tij, sipas përmbajtjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese* (Kuvendi, 2010, Rregullorja, Neni 35). Rrjedhimisht, pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi është i obliguar të fillojë procedurën që të *“shkarkojë Presidentin me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij”* i përcaktuar

sipas Nenit 91.3 e Kushtetutës (Kushtetuta: Neni 91.3), dhe sipas Nenit 116.1 të Kushtetutës që përcakton se: “Vendimet” e Gjykatës Kushtetuese “janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës” (Kushtetuta: Neni 116.1). Mirëpo, kjo nuk ndodhi për shkak të konstelacionit politik në qeveri (koalicionit PDK +LDK e Minoriteteve) dhe të mungesës së vullnetit politik të subjekteve politike si dhe votave të pamjaftueshme (2/3 e votave) për të shkarkuar Presidentin, reflektoi brishtësinë e demokracisë dhe institucioneve kosovare për të zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa gatishmëria e Presidentit për ta zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese është reflektuar më 27 shtator 2010, duke dhënë dorëheqje nga posti i tij.

Duhet potencuar se Kushtetuta nuk ka ndonjë dispozite të veçantë që përcakton përfundimin e mandatit të Presidentit me dorëheqje. Megjithatë, Presidenti Fatmir Sejdiu, përmes një “Deklarate”, për dhënien e dorëheqjes drejtuar qytetarëve ndër të tjera ka thënë se “ai ka menduar ndryshe nga ajo që ka vendosur Gjykata si dhe nuk e ka pranuar aktgjykimin e saj, unë jap dorëheqje nga funksioni i Presidentit”.

Presidenti në deklaratën e dorëheqjes ka thënë:

“Sot unë kam dhënë dorëheqje nga pozita e Presidentit të Republikës së Kosovës. Që nga 10 shkurti i vitit 2006, si President i Republikës së Kosovës dhe i të gjithë qytetarëve të saj, kam ushtruar këtë funksion me përgjegjësi, me përkushtim të plotë dhe ndërgjegje të pastër, gjithnjë duke pasur si udhërrëfyes themelor interesin e qytetarëve dhe të vendit tonë të dashur”.... , “kam pasur rastin të punoj për së afërmi në procesin e hartimit të aktit më të lartë juridik të vendit, Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pikërisht për shkak të kësaj përvojë, debateve dhe vendimeve që janë marrë gjatë atij procesi, përkrahjes e konsultimeve të vazhdueshme, si dhe marrëveshjes me forcat politike në vend dhe me faktorin ndërkombëtar, unë kam besuar se mbajtja e postit të Kryetarit të LDK-së, duke mos e ushtruar atë funksion, siç e përcakton Kushtetuta, nuk përbën shkelje të kësaj Kushtetute. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese ka menduar ndryshe, dhe unë e respektoj këtë vendim, pavarësisht faktit se ende nuk më është dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës me arsyetim”... (Presidenti Fatmir Sejdiu, 2010).

Dorëheqja, përveç që evitoi krizën institucionale dhe kushtetuese në Kosovë, ajo ka dhënë efekt në prishjen e koalicionit qeverisës në mes të PDK dhe LDK, rrëzimin e qeverisë nga Kuvendi dhe shkuarjen në zgjedhje të jashtëzakonshme. Në përfundim mund të konkludojmë se përveç dispozitave kushtetuese, efekti i sistemit zgjedhor proporcional me një zonë të vetme zgjedhore dhe me shumë vota preferenciale brenda listës, përveç që është determinant për formimin e institucioneve ajo reflekton edhe në kontrollin e tyre. Gjithashtu, për t'i evituar krizat e mundshme institucionale dhe kushtetuese rekomandohet që të ndryshohen dispozitat kushtetuese të lartpërmendura që ndërlidhen me shkarkimin e Presidentit nga Kuvendi me 2/3, e të gjithë deputetëve dhe të ndryshohet se Presidenti pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese si shkelës i Kushtetutës, konsiderohet i shkarkuar nga detyra e tij.

KAPITULLI IX : PËRFAQËSIMI I GRAVE NË INSTITUCIONE SIPAS KORNIZËS NORMATIVE PER KUOTËN GJINORE DHE REZULTATIT ZGJEDHOR

9.1.Barazia gjinore vlerë kushtetuese

Një shoqëri demokratike vlerësohet atëherë kur sigurohen dhe trajtohen të gjithë pjesëtarët e saj në mënyrë të barabartë, në veçanti përfshirja në politikëbërjen dhe përfaqësimin e vendit. Promovimi për pjesëmarrje të grave në politikë është e njohur me Kushtetutë dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës. Barazia gjinore është vlerë kushtetuese e përcaktuar në Nenin 7 të Kushtetutës ku përcaktohet se: *“Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore”* (Kushtetuta, Neni 7.2).

Në realizimin e plotë të saj, kërkohet angazhim e vullnet politik dhe institucional si dhe mbështetje e shoqërisë kosovare për arritjen e barazisë gjinore, e në veçanti, avancimin e pozitës së gruas në pozitë drejtuese të institucioneve publike. Vërehet një zhvillim në angazhimin dhe vendosmërinë e vetë gruas, jo vetëm për emancipimin e saj, por edhe për vlerësimin e kontributit të saj në shoqëri, pjesëmarrjes në qeverisje dhe avancimin e pozitës së saj në vendimmarrje (ZKM/ABGJ, 2014).

Barazia gjinore është vendosur në fokus të legjislacionit që në formimin e institucioneve të para të pas luftës në Kosovë. Kështu që, institucionet e Kosovës në dy periudhat e qeverisjes si atë nën administrimin ndërkombëtar (UNMIK-ut) po edhe pas saj përveç legjislacionit zgjedhor që përcakton kuotën 30% për gratë në institucionet përfaqësuese

(UNMIK/REG, Nr. 2000/39, Neni 4.2; UNMIK/ REG. 2001/33; Neni 4, UNMIK/REG /2002/1: Neni 5.5; UNMIK/REG/2004/12, Neni 21; UNMIK/REG/2007/26, Neni 6.6. UNMIK/RREG. Nr. 2007/27, Neni 6.4; Ligji Nr. 03/L-256, Neni 8.2, Ligji Nr. 03/L-072, Neni 8.4), ka nxjerrë akte ligjore të veçanta për barazi gjinore (Ligji për Barazi Gjinore) dhe kanë ndërmarrë veprime për të siguruar mundësi dhe trajtim të barabartë pa dallime, përfshirë edhe dallimet gjinore. Përmes dispozitave normative dhe masave afirmative për arritjen e barazisë gjinore, janë caktimi i “kuotave gjinore” apo të ngjashme te sistemi i drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese (Kushtetuta Neni 104; Neni 108.2; Neni 110.3 dhe Neni 114.1).

Hulumtimet tregojnë se janë bërë hapa të rëndësishëm për rritjen e numrit të grave në udhëheqjen politike të vendit (ABGJ: 2014). Edhe pse numri i grave në pozicione drejtuese mbetet i ulët, prania e grave me ndikim në një pjesë të konsiderueshme të pozitave kyçe, si Kuvend, Presidencë, Gjykatë Kushtetuese, qeveri dhe Pushtet lokal është duke e ndryshuar qëndrimin publik në lidhje me gratë dhe çdo ditë krijohen rrethana për rritjen e lidershit të grave në të ardhmen. Zbatimi i legjislacionit për kuotën gjinore, ka krijuar hapësirë më të gjëra për pjesëmarrjen e grave në politikë si dhe i ndihmon ato në tejkalimin e pengesave për pjesëmarrje në përfaqësim dhe vendimmarrje. Në këtë mënyrë do t'i qasemi analizës së legjislacionit që garanton përfaqësimin dhe fuqizon pozitën e gruas në institucionet përfaqësuese si dhe përvojat dhe praktikat e mira në Kosovë.

9.2. Analizë Kornizës ligjore për kuotën gjinore që promovon përfaqësimin e grave në institucionet e Kosovës

Fuqizimi i gruas në pozitë vendimmarrëse fillon me aktin me të lartë juridik dhe politik të Kosovës, Kushtetuta, e cila sipas Neni 2.1 përcakton se “Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur”.... (Kushtetuta, Neni 2.1). Ndërsa sipas Neni 7, pika 2 e Kushtetutës siguron barazinë gjinore si “vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore”. Një dispozitë tjetër fuqizuese është edhe Neni 71, pika 2 e Kushtetutës, e cila kërkon se “përbërja e Kuvendit do të respektojë parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuar në pajtim me parimet ndërkombëtare”(Kushtetuta, Neni 71.2).

Përveç, përcaktimit të parimeve kushtetuese të respektimit të barazisë gjinore, legjislacioni në fuqi mundëson dhe promovon fuqizimin e barazisë gjinore, duke përcaktuar edhe masa afirmative. Kështu që në kuadër të sistemit ligjor, një numër aktesh dhe dispozitash promovojnë barazinë gjinore, të cilat obligojnë institucionet publike të ndërmarrin veprime konkrete, që sigurojnë zbatimin e barazisë gjinore si në përfaqësim, punësim dhe në menaxhim institucional. Një qasje analitike të dispozitave ligjore që promovojnë drejtpërdrejtë barazinë gjinore, e në veçanti atyre ligjeve që promovojnë përfaqësimin politik janë Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ai për Zgjedhjet Lokale. Në bazë të Nenit 27.1 i Ligjit Nr. 03/L-072, subjektet politike obligohen të përmbushin kuotën gjinore prej 30% në listat e kandidatëve të tyre dhe sipas Nenit 8.2 i Ligjit Nr. 03/L-256, dhe Nenit 8.4 i Ligjit Nr. 03/L-072, KQZ-ja gjatë ndarjes së mandateve në Kuvend, kujdeset t'i ndajë së

paku 30% për kandidatët e gjinisë pakicë nga numri i përgjithshëm i vendeve për atë subjekt politik. Sipas Ligjit:

“ Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë”. (Ligji Nr. 03/L-072, Neni 27.1).

...”Nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara për kandidatët në listën e një subjekti politik, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të ndarë për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidati i radhës i gjinisë pakicë në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30% (Ligji Nr. 03/L-256, Neni 8.2, Ligji Nr. 03/L-072, Neni 8.4).

Këto janë norma që nxisin dhe sigurojnë përfaqësimin gjinor në institucionet përfaqësuese duke përcaktuar “kuotën prej 30% për përfaqësim gjinor në organet legjislative si në nivel qendror” dhe në atë lokal. Në veçanti, Neni 6 i Ligjit (Nr. 05/L -020) për Barazi Gjinore, obligon institucionet publike që të marrin masa të veçanta dhe të përkohshme me qëllim të përshpejtimit të avancimit dhe realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi. Këto masa të veçanta përfshijnë²²: “kuotën për të arritur përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve”. Kjo nënkupton që: “përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse” (Ligji Nr. 05/L -020, Neni 6). Megjithatë, ky ligj është më avancues dhe vendos barazinë e plotë për të gjithë dhe kërkon trajtim të barabartë për dy gjinitë, për dallime nga ligji paraprak (Ligji, Nr.

²² Shënim: Ligji për barazi gjinore përveç kuotës për të arritur përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve, parasheh këto masa të veçanta; programe për të ndihmuar dhe mbështetur rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe jetën publike; fuqizimin ekonomik dhe hapat për të përmirësuar pozitën e femrave apo meshkujve në fushën e punës, në arsim, në shëndetësi, kulturë dhe shpërndarjen dhe/ose rishpërndarjen e burimeve; dhe trajtim preferencial, rekrutimin, punësimin dhe ngritjen në detyrë, dhe masa të tjera në secilën fushë ku ka pabarazi (Ligji Nr. 05/L -020, Neni 6.2.1-4).

2004/2) për barazi gjinore i cili ka përcaktuar se *“përfaqësimi i pabarabartë ... , është atëherë kur përfaqësimi i njërës gjini, në një fushë të posaçme shoqërore apo në një segment të kësaj fushe, është më i ulët se 40%”*(Ligji Nr. 2004/2, Neni 2.12). Përveç ligjeve për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale si dhe ligjit për barazi gjinore, janë edhe një mori aktesh ligjore, nënligjore që promovojnë drejtpërdrejt apo në forma të tjera barazinë gjinore në Kosovë (AGJB/ZKM 2014:29). Megjithatë në përfundim të analizës ligjore për barazi gjinore mund të themi se është i domosdorshme harmonizimi i ligjislacionit më dispozat e Nenit 6 i Ligjit (Nr. 05/L -020) për Barazi Gjinore.

9.3.Përfaqësimi i grave në institucionet e Kosovës - kuota gjinore

Kuota gjinore²³ është kategori kushtetuese dhe ligjore për institucionet qendrore dhe lokale në Kosovë. Kushtetuta përveç që barazinë gjinore e përcakton si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ajo përmes dispozitave të Nenit 71.2; Neni 104.2; Neni 108.2; Neni 109.4; Neni 110.1 dhe Neni 114.1 të saj, përcakton edhe kuotën minimale për institucionet kushtetuese, Kuvend, Sistem të drejtësisë dhe Gjykatë Kushtetuese (Neni 71.2; Neni 104.2; Neni 108.2; Neni 109.4; Neni 110.1; Neni 114.1).

Ndërsa Ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale përmes Nenit 27.1 i Ligji Nr. 03/L-073; Neni 8.2 i Ligji Nr. 03/L-256 dhe Neni 8.4i Ligjit Nr. 03/L-072, kanë përcaktuar “kuotat gjinore prej 30% për listën e kandidatëve” të secilit subjekt politik si dhe pas

²³ Shënim: Pjesë të veqanta për kuotën gjinore janë trajtuar nga autori Xhavit Shala (2015) “GENDER QUOTE IN THE KOSOVO ELECTORAL LAW”, in the “European Journal of Research in Social Sciences”, Vol. 3 No. 5, 2015, PP 102-108.

ndarjes së vendeve të përcaktuara për kandidatët në listën e një subjekti politik, kandidatëve të gjinisë pakicë nëse nuk u janë ndarë së “paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të ndarë për atë subjekt politik”, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidatët e radhës të gjinisë pakicë në listën e rirenditur të tyre, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30% në nivelin nacional apo lokal. Sipas ligjit të gjitha votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e hapur të subjektit politik numërohen ndaras për kandidat dhe listat e tyre rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat deri sa të plotësohet kuota 30% për organin përfaqësues përcaktuar me ligj (Ligji Nr. 03/L-073, Neni 27.1; Ligji Nr. 03/L-256, Neni 8.2, Ligji Nr. 03/L-072, Neni 8.4).

Demokracia elektorale në Kosovë është në fund të dekadës së dytë dhe vendosja e kuotës gjinore në politikë si strategji apo mekanizëm për ngritjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në institucionet përfaqësuese dhe qeverisëse është zbatuar që nga zgjedhjet e para lokale dhe nacionale në Kosovë. Kjo ka sjellë ndryshime pozitive duke ndikuar në rritje të përfaqësimit të përgjithshëm të grave në Kuvend. Tabela e mëposhtme pasqyron përfaqësimin gjinor në Kuvend nga zgjedhjet e para nacionale të vitit 2001 e deri te ato të fundit të vitit 2017.


Tabela 20. Numri i deputetëve sipas gjinisë në Kuvendin e Kosovës (2001 – 2017)

Viti	Mandatet	Burra	Përqindje	Gra	Përqindje
2001	120	88	73.333 %	32	26.666 %
2004	120	85	70.833 %	35	29.166 %
2007	120	84	70 %	36	30%
2010	120	80	66.666%	40	33.333%
2014	120	81	67.5%	39	32.5%
2017	120	82	68.333%	38	31.666%

Burimi: OSBE/CEC/UNMIK: 2001, 2004 KQZ/QNR, 2007,2010.2014,2017

Vendosja e kuotave, ka dhënë një rezultat pozitiv në rritjen e përfaqësimit të gruas në institucionet përfaqësuese. Si rezultat i kuotës të përcaktuar me Kushtetutë dhe ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, në Kuvendin e Kosovës nga numri i përgjithshëm prej 120 vendeve në Kuvend, afërsisht një e treta e tyre gjithmonë janë gra përfaqësuese (ABGJ/ZKM 2014:19). Përfaqësimi sipas gjinisë në Kuvend nga zgjedhjet e vitit 2001-2017, pasqyrohet në grafikun 11.

Grafiku 11. Përfaqësimi sipas gjinisë në Kuvendin e Kosovës (2001-2017)



Burimi: OSBE/CEC: 2001, 2004 KQZ/QNR: 2007;2010.2014, 2017

Ky është një shembull i mirë drejt rritjes së përfaqësimit i cili është duke reflektuar edhe në Kryesinë e Kuvendit. Kuvendi nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe pesë nënkryetarë që përbejnë kryesinë ku dy prej tyre janë gra (Kuvendi: 2014-2017). Nga ky aspekt, mund të themi se është bërë veprimi i duhur drejt fuqizimit dhe promovimit të barazisë gjinore në Kryesinë e Kuvendit. Gjithashtu një veprim shumë i rëndësishëm në rritjen e numrit të grave në udhëheqjen politike të vendit është zgjedhja e një gruaje shefe të shtetit. Kështu Kuvendi i Kosovës, më 7 prill 2011 zgjodhi një grua në drejtimin e shtetit, Atifete Jahjaga,

Presidente e Republikës së Kosovës, e para grua që udhëheq shtetin në rajon (Kuvendi: 2011 procesverbal, 7 prill). Më vonë një grua është kryetare e Gjykatës Kushtetuese²⁴ ku nga nëntë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese katër (4) janë gra; kreu i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve²⁵ është një grua. Në qeveri 4 dikastere udhëhiqen nga gratë ministre* dhe vazhdojnë të mbajnë poste kyçe (Qeveria e Kosovës, 2015). Ndërsa, në zgjedhjet lokale të 2013-ës, për herë të parë në pushtetin lokal, një grua është zgjedhur kryetare (Mimoza Kusari Lila) e komunës së Gjakovës (KQZ/QNR 2013). Megjithatë, një nga shkaktarët që ndikon në një rezultat negativ të përfaqësimit është “jo fuqizimi i gruas nga partitë politike” dhe mosvendosja e tyre si bartëse të listës në zgjedhje apo kandidate për kryetare të Komunës. Në ato raste që është kandidat për kryetar (rasti i Gjilanit dhe i Gjakovës) një grua me kundërkandidat një mashkull, fushata dhe kultura politike ishte më demokratike si asnjëherë më parë. Kjo u tregua edhe në zgjedhjet lokale të 2013-ës, nga 38 komunat e Kosovës vetëm një grua drejton komunën (KQZ/QNR/2013). Ndërsa në zgjedhjet e vitit 2017, nuk fitoi asnjë kandidat grua për Kryetare Komune (KQZ/QNR 2017). Megjithatë, ndër shkaktarët kryesorë për pozitën e pabarabartë të gruas në qeverisje apo vendimmarrje janë partitë politike që nuk u japin hapësirë dhe mbështetje të mjaftueshme grave politikane. Edhe pse është detyrim ligjor për partitë politike që me aktet e tyre statutoire obligohen të zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në organet dhe

²⁴ Shënim: Gjykata Kushtetuese, Arta Rama-Hajrizi, kryetare Snezhana Botusharova, gjyqtare Selvete Gerxhaliu- Krasniqi, gjyqtare dhe Gresa Caka-Nimani, gjyqtare. Njoftim për medie 21 maj 2015, <http://www.gjk-ks.org/?cid=1,28,424> (8.11.2015)

²⁵ Shënim: Valdete Daka Kryetare e KQZ-së, <http://www.kqz-ks.org/sq/valdete-daka> (6 .11.2015)

* Shënim: Edita Tahiri, ministre dhe Hykmete Bajrami ministre, Dhurata Hoxha, Ministre, Mimoza Ahmetaj, Ministre, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,43> (2017)

radhët e partive, ku sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini (Ligji Nr. 05/L -020 Neni 14).

Lidhur me rëndësinë dhe përmbushjen e parimeve dhe kuotave, janë organizuar debate të ndryshme me pjesëmarrje të përfaqësuesve të institucioneve, shoqërisë civile dhe ekspert të kësaj fushe. Një mbështetje për ruajtjen e kuotës në Kosovë është edhe Drude Dahlerup profesoreshe në Universitetin e Stokholmit dhe njohëse e çështjeve dhe kuotave gjinore. Ajo në një prononcim në gazetën “Koha ditore” ka deklaruar se “*Kosova është një rast i mirë sa i përket sistemit të kuotave... që është gati më i miri në botë...* Ajo rekomandoi për Kosovën sistemin zinxhiror, që nënkupton përfaqësim 50 me 50 të femrave dhe meshkujve dhe renditjen e tyre në kuvend sipas radhës, një femër, një mashkull (Koha ditore 2011). Sot në botë sistemet e kuotave zgjedhore apo përfaqësuese janë të ndryshme, 20, 30, 40 apo 50% për burra po aq për gra (50%). Kuotat synojnë që të sigurojnë një përfaqësim sipas balancës gjinore. Bazuar sipas juridiksionit në të cilën shtrihet fuqia e sistemeve të kuotave ato ndahen në kuotat e parashikuara për Kuvendin apo nivelin Kombëtar dhe sistemi i kuotave të parashikuara për organet e qeverisjes lokale (Anastasi, A., Oldashi E., 2006: 140). Kuotat klasifikohen si: kuota kushtetuese, legislative dhe kuotat e vendosura nga partitë politike (Dahlerup, D. 2003:1-6; Anastasi, A. Oldashi, E. 2006: 141). Për Drude Dahlerup, sistemi me kuota, është një trend botëror dhe gratë që janë të kualifikuara po kërkohen nga partitë. Në botë janë 102 shtete të cilat i kanë të vendosura kuotat gjinore (Dahlerup, D. et al., (2011: 22). Prej tyre janë 52 vende, të cilat i kanë të vendosura me ligj, ndërsa 50 vendet e tjera i kanë të vendosura në bazë vullnetare nga partitë politike (Koha ditore, 2011). Gjithashtu, Kosova me Parimet e Prishtinës, të dala nga Samiti Ndërkombëtar për Fuqizimin e Grave: “Zotohet të fuqizojë monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe politikave për barazi

gjinore, duke bërë plotësimin e legjislacionit ekzistues dhe politikave sociale për përmbushjen e Parimeve të Prishtinës. Inkurajon Qeverinë dhe institucionet e Republikës së Kosovës që të nxisin dhe mbështetësin zbatimin e Parimeve të Prishtinës në nivel rajonal dhe global” (Kuvendi 2012, Nr. 04-R-09). Realizimi praktik i kuotave do të mund të bëhej realitet vetëm nëse kuotat si vlerë bëhen si traditë politike përfaqësimi dhe angazhimi politik dhe institucional i grave. Megjithatë, rritja e kulturës politike demokratike dhe një legjislacion zgjedhor avancues, që determinon konkurrencën zgjedhore ku çdo i dytë të jetë i gjinisë tjetër në lista zgjedhore apo kandidat për drejtimin institucional (Shala, Xh. 2/2012:291). Për më tepër, ekzistenca e vullnetit politik të liderëve dhe strukturat e subjekteve politike për avancim dhe mbështetje të gruas në politikë dhe vendimmarrje është mënyra e vetme për një demokraci të mirëfilltë si dhe praktika më e mirë për të siguruar përfaqësim të drejtë, prezantim adekuat të realitetit demografik në vend.

6.4. Të gjeturat e hulumtimi për mënyrat se si të veprohet në të ardhmen për avancimin e gruas në pozitat vendimmarrëse


Partitë politike kanë një rol kyç në fuqizimin e gruas në politikë në përpjekje që të krijojnë një sistem përfaqësues duke u zhvilluar sipas praktikave më të mira ndërkombëtare në vlerësimin dhe zbatimin e barazisë për të gjithë qytetarët. Një proces i tillë ka filluar që në gjenezën e pluralizmit politik në Kosovë (vitet 90-të), madje duke marrë edhe poste drejtuese partiake duke udhëhequr Partinë politike dhe kandidatë** për Kryetarë të Republikës. Në

** Shënim: Luljeta Pula Beqiri, kryetare e Partisë Socialdemokrate të Kosovës (PSDK). Kandidate për Kryetar të Kosovës në zgjedhjet e vitit 1998 (në momentin e fundit ka tërhequr kandidaturën).

fakt, bazuar në numrin e madh të partive politike, sot udhëheqëse të partisë nga gratë *** në Kosovë janë më pak se partitë që drejtohen nga burrat. Megjithatë, partitë politike që tentojnë për balancë gjinore, fuqizim të femrës në drejtimin e partisë, rritjes së anëtarësisë në kryesitë e partive gradualisht po rritet. Rritja e numrit të grave të zgjedhura në institucionet përfaqësuese është përcaktuar me kuotën ligjore që ndikon edhe në ndryshime brenda vetë partive politike. Kjo ka bërë që partitë politike të fillojnë ndryshimin e balancës gjinore edhe brenda strukturës partiake, duke zgjedhur nënkryetar, apo zëvendës të parë të Kryetarit të Partisë. Vështirësitë për arritjen e balancës gjinore brenda organeve partiake dhe institucioneve publike janë aktuale. Në kuadër të hulumtimit për gjetjen e faktorëve që ndikojnë në avancimin e pozitës së gruas në politikë dhe vendimmarrje, respondentët janë pyetur lidhur me pjesëmarrjen e gruas në politikë dhe vendimmarrje? Ata janë deklaruar se pjesëmarrja e gruas në politikë dhe proceset e vendimmarrjes është i ulët.

Kjo pasqyrohet në figurën 17.

Figura 17. Opinioni i qytetarëve për pjesëmarrjen e gruas në politikë dhe në vendimmarrje



Burimi: Autori bazuar në Rezultatit e hulumtimit 2017


*** Shënim: Kaqushë Jashari, Kryetare e Partisë Socialdemokrate të Kosovës (PSDK) 1998-2008. Kjo parti ka qenë dhe është parti parlamentare; Edita Tahiri, është Kryetare e Partisë Alternativa Demokratike e Kosovës (ADK) 2004 e më tej. Kjo parti është pjesë e qeverisë, në koalicion me PDK-në; Rada Trajkoviç është kryetare e Listës Unike Serbe (LSJ) deputete në Kuvendin e Kosovës i dalë nga zgjedhjet e vitit 2010; Mimoza Kusari Lila, Kryetare e Alternatives, Kryetare e Komunës së Gjakovës.

Në kuadër të figurës 17, vërejmë deklaratimet e respondentëve lidhur me nivelin e pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje, e cila është shumë e diferencuar midis atyre që deklarojnë se pjesëmarrja e gruas është e ulët. Për këtë, deklarohen 66.8% e respondentëve, në dallim nga 33.2% e tyre që deklarojnë se gruaja është e përfaqësuar kënaqshëm në pozitat e larta politike dhe vendimmarrëse. Ndaj rekomandohet që aktorët vendimmarrës të marrin masa në ndryshimin e realitetit ekzistues dhe kjo më pas do të vlerësohet edhe nga opinioni publik.

Si një nga barrierat kryesore, është moskandidimi për pozicionet e larta zgjedhëse, vendosja në listat zgjedhore dhe mungesa e përkrahjes në mënyrë të njëjtë si burrat dhe gratë gjatë fushatës zgjedhore. Këtë e argumentojnë edhe përgjigjet e respondentëve të dy target grupeve në pyetjen: *A mbështeten njësoj nga partia si kandidatet gra ashtu edhe burra?* Të dy grupet e pohojnë se nuk ka mbështetje të barabartë.

Kjo pasqyrohet në Figurën 18.

Figura. 18. Opinioni i qytetarëve lidhur me mbështetjen e njëjtë nga partia për burrat dhe gratë



Burimi : Autori bazuar në rezultatin e hulumtimit 2017


Në kuadër të figurës 18, prezantohet opinioni i respondentëve qytetarë të cilët deklarohen se nuk ka mbështetje dhe trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët në mënyrë të njëjtë.

Ata mendojnë se kandidatet gra nuk e kanë mbështetjen e njëjtë sikurse kandidatët burra nga partia politike. Një opinion të tillë mbi pabarazinë e kanë deklaruar 77.2% e respondentëve, kundrejt 22.8% e respondentëve që vlerësojnë se të gjithë kandidatët mbështeten njësoj nga subjekti politik.

Në mënyrë të njëjtë është pothuajse edhe opinionin e respondentëve me funksione politike lidhur me mbështetjen e barabartë nga partia si për burrat edhe për gratë. Dallimi i opinionit pro et contra është se 61.8% e respondentëve deklarojnë se gratë nuk kanë mbështetje të barabartë me kandidatët burra, përkundër 38.2% e respondentëve që janë deklaruar se mbështetja nga partia është e barabartë si për burrat ashtu edhe për gratë.

Kjo pasqyrohet në figurën 19.

Figura 19. Opinioni i përfaqësuesve politikë lidhur me mbështetjen e njëjtë nga partia për kandidatet gra ashtu edhe burra



Burimi: Autori bazuar në rezultatin e hulumtimit 2017

Në bazë të rezultatit të hulumtimit të nxjerrë nga dy target grupet të prezantuara në dy figurat e mësipërme mund të konkludojmë se partitë politike nuk i japin mbështetje të njëjtë kandidatëve të dy gjinive. Prandaj, ata duhen t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë kandidatët duke pasur një vëmendje të veçantë për kandidatet gra në fushatën zgjedhore

dhe pas fushatës. Pastaj vendosja në fillim të listës zgjedhore në sistemin PP me lista të hapura, ka efektin e saj në opinion. Sidoqoftë, kandidatet e fuqishme e përmbysin hipotezën se vetëm kush është në fillim të listës, lehtësisht mund të përfitojë shanset për mandat parlamentar, është e gabuar. Argument për këtë është rezultati zgjedhor për Kuvendin e Kosovës (2017), ku kandidatja edhe pse ishte e renditur e 81 në listën zgjedhore nga Partia politike, ajo doli ndër pesë (5) kandidatët më të votuar në këto zgjedhje si dhe e para në Listën e Kandidateve Femra (LDK, Vjosa Osmani me 64147 vota) si gruaja më e votuar në Kosovë. Gjithashtu, janë mbi 15 kandidate gra që kanë marrë mbi dhjetëmijë (10.000) vota, ku dhjetë prej tyre nuk janë të radhitur në pesë (5) numrat (emrat) e parë të listës (KQZ/QNR 2017). Kështu që listat e hapura e kanë fuqizuar rolin e gruas në politikë (parti politike), përfaqësim dhe opinionin publik. Në këtë mënyrë vlera e kuotës për gratë çdo herë po bëhet cilësi e jo sasi. Me fjalë të tjera kandidatet gra çdo ditë po reflektojnë përfaqësim të fuqishëm popullor e më pak numër partiake apo kuotë ligjore.

Partitë politike rekomandohen që duhet të koncentrohen në përmirësimin dhe avancimin e pozitës së gruas në të gjitha nivelet, qofshin zgjedhore apo emëruese dhe në të dy nivelet e qeverisjes. Gjithashtu, fuqizimi i gruas nga partitë politike dhe vendosja e tyre e barabartë në listën zgjedhore ose si bartëse e listës në zgjedhje nacionale apo lokale, duke marrë në konsideratë edhe të zgjedhurit apo emërimet që bëhen nga organet përfaqësuese, edhe pse kuotat gjinore e kanë rritur dhe siguruar numrin e grave në institucionet përfaqësuese në Kuvend, lidërshipi politik dhe institucional rekomandohen që të ndërmarrin veprime për reformë kushtetuese dhe ligjore të përshtatshme për fuqizimin edhe më tej të pozitës së gruas në pozitë vendimmarrëse dhe qeverisëse. Ajo mund të realizohet në këtë mënyrë: aty ku drejtuesi i institucionit është i njëjës gjini, zëvendësi i parë të jetë i gjinisë tjetër. Duke

filluar nga Kuvendi i Kosovës, gjatë procesit të zgjedhjes së Kryetarit apo kryetares, zëvendësi zgjidhet i gjinisë tjetër. Kjo të praktikohet në Qeveri dhe të gjitha institucionet politike dhe publike. Në qeverisjen lokale, partitë politike gjatë nominimit për Kryetar të Komunës, të bëhet edhe nominimi për zëvendës të tij. Në rast së është kandidati grua, zëvendësi të jetë burrë apo anasjelltas. Gjithashtu, partitë politike gjatë zgjedhjes së strukturave drejtuese të saj, të aplikojnë parimin e barabartë dhe fuqizues për gratë duke i dhënë pozita të barabarta në strukturat drejtuese të partisë. Për të realizuar këto veprime propozohet të ndryshohet dhe plotësohet: Neni 67 dhe Neni 95 i Kushtetutës; Neni 27, Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme; Neni 8.2 i Ligji Nr. 03/L-256 për Ndryshimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 8.4 dhe Neni 9 i Ligjit Nr. 03/L-072, për Zgjedhjet Lokale si dhe Neni 58 i ligjit (NR. 03/L-040) për qeverisje lokale që të vendoset mënyra e zgjedhjes të nënkryetarit të komunës nga populli. Më tej kuota (statutore) partiake dhe kuotat ligjore për kabinetet qeveritare dhe atyre të komunës, do të mundësojnë pasqyrimin e drejtë mbi barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e gruas në jetën politike. Subjektet politike rekomandohen që të ndërmarrin aktivitete prioritare dhe të hartojnë programe strategjike të cilat synojnë përmirësimin e barazisë gjinore, në kuadër të subjektit të tyre politike si dhe promovimin dhe fuqizimin e pozitës dhe pjesëmarrjes së gruas që nga bashkësitë lokale (pushtetin vendor) e më lart duke vendosur kuotën për gr 50% dhe 50% për burra në çdo proces zgjedhor... Partitë politike në statutet e tyre të ndërmarrin veprime të hapura për barazi, drejtësi shoqërore, balancës gjinore dhe ndërgjegjësim gjinor.

KAPITULLI X: PËRFAQËSIMI I MINORITETEVE NË INSTITUCIONE SIPAS KORNIZËS NORMATIVE PËR KUOTAT ETNIKE DHE REZULTATIT ZGJEDHOR

10.1. Analizë Kornizës Ligjore për kuotat etnike që sigurojnë përfaqësim të komuniteteve Minoritarë në Kosovë

Në kuadër të analizës të dispozitave normative që siguron dhe garanton (rezervon) përfaqësimin e komuniteteve pakicë në institucionet e Kosovës fillon nga Kushtetuta, ligjet zgjedhore dhe aktet e veçanta për mbrojtjen dhe promovimin e komuniteteve minoritare²⁶. Megjithatë, fokusi kryesor është përfaqësimi sipas kuotave të përcaktuara kushtetuese e ligjore si dhe mënyrës se përfaqësimit të tyre në bazë të rezultateve zgjedhore. Nga vështrimi përmbajtësor i kornizës ligjore në Kosovë do të shohim se ajo garanton dhe promovon barazi për të gjithë qytetarët që jetojnë në Kosovë. Në fakt, Kushtetuta është në përputhje me standardet evropiane²⁷, duke garantuar demokraci, përfaqësim, stabilitet të institucioneve, sundim të ligjit, të drejta të njeriut, respekt dhe mbrojtje të minoriteteve. Sipas nenit 1.2 i Kushtetutës “Kosova është shtet i shtetasve të vet”,... (Kushtetuta, Neni 1.2). Përveç kësaj ajo përmes nenit 3 përcakton se Kosova “është shoqëri shumëetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore” si dhe

²⁶ Shënim: Pjesë të veçanta për Kornizën Ligjore për kuotat etnike që sigurojnë përfaqësim të komuniteteve minoritare në Kosovë është trajtuar nga autori Xhavit Shala (2015), “Constitutional and legal basis of representation of minorities in Kosovo and experiences from the region”, f.38-51, në “The Eighth International Scientific Conference on Private and Public Law”, 10th October, 2015, Vienna, «East West» Association for Advanced Studies and Higher Education GmbH, Vienna, 2015, 86.

²⁷ Shënim: Draft Kushtetuta, së pari, është certifikuar nga Piter Feith, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, i paraparë nga propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit Final të Kosovës (Plani i Presidentit Ahtisaarit), më pastaj është miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 9 prill 2008.

qeverisja e saj “bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre” që jetojnë në Kosovë (Kushtetuta, Neni 3).

Kosova nëpërmjet dispozitave kushtetuese të Neni 60, Neni 64.2, Neni 67.4, Neni 77.3, Neni 78.1, Neni 81.1, Neni 96.3-5, Neni 101, Neni 103.3,6, Neni 104.3, Neni 108.6, Neni 109.4, Neni 110, Neni 114.3, Neni 128.4 Neni 129. 2, Neni 133.2 dhe Neni 139.4 i Kushtetutës dhe aktet e tjera ligjore nëpërmjet Nenit 2 i Ligjit Nr. 04/L-020, Neni 10 i Ligjit Nr. 04/L-44, Neni 25 i Ligjit Nr. 04/L-046, Neni 11 i Ligjit Nr. 03/L-149, Neni 54 i Ligji Nr. 03/L-040, si dhe e Neni 111. i Ligjit Nr. 03/L- Për Zgjedhjet e Përgjithshme, garanton dhe promovon pjesëmarrjen dhe përfaqësimin politik të komuniteteve minoritare në dy nivele në atë lokal dhe qendror siç janë vendet e rezervuara apo të garantuara për minoritetet. Ata kanë të drejtë pjesëmarrjeje efektive në vendimmarrje politike në të gjitha nivelet e qeverisë, përfshirë vendimet që janë me rëndësi të veçantë për to ose për zonën në të cilën ata jetojnë. Një pjesëmarrje e tillë sigurohet dhe garantohet përmes përfaqësimit në Kuvend, Qeveri,

pushtetin gjyqësor dhe organet e tjera të Republikës së Kosovës që parashihen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi.²⁸

²⁸ Shënim: Përfaqësimi i Komuniteteve në Zyrën e Presidentit dhe në institucionet e pavarura: Në kuadër të zyrës së Presidentit funksionon Këshilli Konsultativ për Komunitete: Presidenti i shtetit i cili përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës dhe udhëheq (Kushtetuta, Neni 84). Ky Këshill vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet dhe përbëhet, përveç të tjerësh, nga “përfaqësues të asociacioneve të komuniteteve” (Kushtetuta: Neni 60). Ai përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve të Kosovës dhe të Qeverisë, Zyrës së Presidentit dhe agjencive të tjera relevante. Në përbërjen e këshillit janë nga dy përfaqësues të komunitetit rom, egjiptian, goran, ashkali, malazez dhe atij kroat, prej të cilëve nga një mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pastaj, tre (3) përfaqësues të komunitetit boshnjak dhe turk, prej të cilëve nga një mund të jenë deputetë në Kuvend. Si çdo kund tjetër edhe këtu pesë përfaqësues vijnë nga komuniteti serb, prej të cilëve dy mund të jenë deputetë të Kuvendit. Gjithashtu, përveç anëtarëve, ligji ia mundëson të emërohet një zëvendës anëtar. Ata anëtarë të cilët nuk janë deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë zakonisht kryesues a zëvendës kryesues apo të emëruar të tjerë të lartë të organizatave përfaqësuese të komuniteteve apo përfaqësues të shoqatave ose OJQ-ve që kanë të bëjnë me komunitetin e caktuar (Ligji Nr. 04/L-020, Neni 2). Përfaqësimi i komuniteteve në institucionet e pavarura: Kuota e përfaqësimit në sistemin e drejtësisë sipas Kushtetutës janë të përcaktuar që së paku pesëmbëdhjetë përqind e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por jo më pak se tre gjyqtarë, kërkohet të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Ndërkaq, të paktën pesëmbëdhjetë përqind e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër, e themeluar me jurisdiksionin e apelit, por jo më pak se dy gjyqtarë do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë (Kushtetuta, Neni 103). Po ashtu, Këshilli Gjyqësor sipas Kushtetutës përbëhet nga trembëdhjetë anëtarë, prej tyre katër janë të garantuara për minoritetet. Prej tyre dy anëtarë për përfaqësuesit e komunitetit serb, si dhe dy anëtarë për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera (Kushtetuta, Neni 108). Përveç sistemit të drejtësisë, vende të garantuara për minoritete ka edhe në Gjykatën Kushtetuese e cila përbëhet nga nëntë gjyqtarë, në mesin e tyre dy gjyqtarë zgjidhen vetëm pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet që janë garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë (Kushtetuta, Neni 114). Kështu që aktualisht përbërja e Gjykatës është si vijon: katër gjyqtarë janë nga komuniteti shqiptar, një është nga komuniteti serb, një gjyqtar është nga komuniteti turk dhe tre gjyqtarë janë ndërkombëtarë (Gjykata Kushtetuese, 2016). Pastaj KQZ është organ i përhershëm kushtetues dhe përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë. Prej tyre gjashtë (6) anëtarë që emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, por që nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të garantuara si dhe një anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb dhe tre anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë (Kushtetuta, Neni 139). Mandej Kuvendi gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Pavarur i Medie (KPM) i cili është organ i pavarur kushtetues dhe që përbëhet nga shtatë anëtarë, së paku dy anëtarë të tij zgjidhen nga radhët e komuniteteve joshqiptare (Ligji Nr. 04/L-44, Neni 10). Kriter i njëjtë vlen gjithashtu, edhe për Bordin e Radio Televizionit të Kosovës, i cili përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë. Kuvendi gjatë zgjedhjeve, së paku dy anëtarë të Bordit i zgjedh nga komuniteti serb dhe një anëtar emërohet nga komunitetet e tjera jo shumicë (Ligji Nr. 04/L-046, Neni 25). Në përgjithësi kuota të tilla janë përcaktuar edhe për bordet e tjera të themeluara me Kushtetutë apo ligj. Kjo vlen edhe për përfaqësimin e komuniteteve (OSBE 2013) në shërbimin civil (Ligji Nr. 03/L-149, Neni 11) dhe sektorin e sigurisë etj. (QKSS, 2/2014).

10.2.Përfaqësimi në Kuvendin e Republikës

Vendosjen e kuotës etnike në Kuvend përveç Kornizës Kushtetuese e ka përcaktuar edhe Kushtetuta e Republikës, po thuajse në mënyrë të njëjtë. Në kuadër të Kuvendit janë përcaktuar kuota etnike për përfaqësuesit e komuniteteve pakicë. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet e përgjithshme. Megjithatë, në kuadër të kësaj ndarjeje, prej njëqind e njëzet vendeve, njëzet janë të (rezervuara) garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Sipas Kushtetutës në kuadër të ndarjes së njëzet vendeve, janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve minoritare si vijon:

“partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10); partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t’i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara”(Kushtetuta, Neni 64.2)

Në kuadër të Tabelës 21, pasqyrohet përfaqësimi në Kuvend i shqiptarëve dhe minoriteteve në gjashtë legjislaturat.


Tabela 21. Numri i deputetëve shqiptarë dhe minoritarë në Kuvend (2001 - 2017)

Viti	Mandatet	Komunitet/Etnia			
		Shqiptar	Përqindje	Minoritar (Mn)	Përqindje
2001	120	85	70.833 %	35	29.166%
2004	120	98	81.666	22	18.333%
2007	120	96	80%	24	20%
2010	120	94	78.333%	26	21.666%
2014	120	100	83.333%	20	16.666%
2017	120	100	83.333%	20	16.666%

Burimi : OSBE/CEC/UNMIK: 2001, 2004, KQZ/QNR 2007, 2010, 2014, 2017

Në kuadër të tabelës mund të vërehet ndryshimi gradual në rritje i përfaqësimit të komunitetit shqiptar si dhe ulja e numrit apo përqindjes së komuniteteve pakicë. Duhet të sjell në vëmendje edhe një herë se nga zgjedhjet e para, Legjislaturës së parë (2001) e deri në Legjislaturën e Katërt (2010), kanë qenë në fuqi “vendet e rezervuara” dhe çdo votë tjetër i ka sjellë bonus në vende, komuniteteve (Kushtetuta, Neni 148). Pas përfundimit të mandatit të përfaqësuesit civil ndërkombëtar dhe përfundimit të mbikëqyrjes së Pavarësisë së Kosovës (2013) si dhe përfundimit të afateve kushtetuese për vendet e rezervuara e cila ka qenë për dy mandate dhe pas reformimit të Kushtetutës, këto mandate kalojnë sipas Nenit 64 në vende të “garantuara” për komunitete (Kushtetuta, Neni 64, Aneks: Amendamentet I-XXII). Në dy legjislaturat e fundit aplikohen vendet e garantuara dhe pothuajse ata përfaqësohen në mënyrën më të drejtë dhe sipas fuqisë së votës dhe fuqisë ligjore të kuotës etnike. Ndërsa në mënyrën grafike është paraqitur përfaqësimi i shumicës shqiptare dhe së bashku të gjitha minoritetet etnike në Kuvendin e Kosovës. Kjo pasqyrohet në grafikun 12 .

Grafiku 12. Numri i deputetëve sipas përkatësisë etnike shqiptare dhe minoritetet e tjera



Burimi: Bazuar në publikimin e OSBE/CEC/UNMIK: 2001, 2004, KQZ/QNR 2007, 2010, 2014,

Efekti i vendeve të rezervuara ka qenë shumë i lartë në zgjedhjet e vitit 2001. Përqindja e përfaqësimit në Parlamentin e Kosovës është i ndarë në përqindje ku 70.833% e vendeve i takojnë partive politike dhe subjekteve të tjera shqiptare dhe 29.166% partive politike të minoriteteve që jetojnë në Kosovë. Minoritetet me numër të popullsisë janë shumë më pak sesa janë të përfaqësuar në parlament. Ata kanë përfituar, përveç njëzet (20) vendeve të rezervuara, edhe 15 vende në zgjedhje (OSBE/CEC/UNMIK: 2001). Një diskriminim tejet pozitiv, që nuk e hasim në asnjë vend tjetër të rajonit. Kjo prezantohet në Tabelën 23, e cila pasqyron përbërjen e Kuvendit në të gjitha legjislaturat.


Tabela 22. Përbërja e Kuvendit sipas përkatësisë etnike (2001- 2017)

Viti	Mandatet	Shqiptar	Serbe	Boshnjake/Turke/Goran	Rome/Ashkali/Egjiptase
2001	120	85	22	8	5
2004	120	98	10	8	4
2007	120	96	12	7	5
2010	120	94	14	8	4
2014	120	100	10	6	4
2017	120	100	10	5	5

Burimi: OSCE/CEC/UNMIK: 2001, 2004; KQZ/QNR: 2007-2017

Në mënyrë grafike janë pasqyruar përbërja e Kuvendit sipas përfaqësimit etnik nga Legjislatura e parë deri te e gjashta. Kuptohet se efekti i vendeve të rezervuara për minoritetet ka dhënë mundësinë e mbipërfaqësimit për minoritetet siç ishte Legjislatura e parë. Faktikisht kjo pasqyrohet në grafikun 13.

Grafiku 13. Pasqyra etnike e përfaqësimit në Kuvend 2001-2017



Burimi: Autori bazuar në rezultatet e OSBE/CEC/UNMIK: 2001, 2004, KQZ QNR: 2007-2017

Ka pasur propozime nga Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, që të shtohen edhe nga një vende për komunitetin kroat dhe malazez në vendet e garantuara në Kushtetutë. Ai për mediet ka theksuar se: “*Me rikonstruktimin që pritet të ndodhë, komuniteti malazez dhe ai kroat do të jenë pjesë të Kushtetutës së Kosovës*” (Thaçi, 2014). Gjithashtu, dispozitat e Nenit 67 të Kushtetutës “garantojnë vende për dy përfaqësues të minoriteteve në Kryesinë” e Kuvendit që përbëhet nga Kryetari dhe pesë nënkryetarët. Tre nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, dhe “dy nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend” dhe ata zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri

nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të garantuara të “komunitetit serb”, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të garantuara nga “komunitetet e tjera” që nuk janë shumicë (Kushtetuta, Neni 67). Gjithashtu, kjo vazhdon edhe në Komisionin parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve që është Komisioni i Përhershëm i Kuvendit. Në kuadër të Nenit 78 të Kushtetutës përcaktohet se komisioni përbëhet nga një e treta e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb, nga një e treta e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, dhe një e treta e anëtarëve nga komuniteti shumicë, të përfaqësuar në Kuvend (Kushtetuta, Neni 78).

10.3.Përfaqësimi i komuniteteve në Qeveri

Sipas Kushtetutës, Qeveria e Kosovës përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Megjithatë, në kuadër të Nenit 96 të Kushtetutës është përcaktuar se në Qeveri do të ketë së paku “një Ministër nga komuniteti serb dhe një Ministër nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë në Kosovë”. Ndërsa, në rast se qeveria është më e madhe apo janë më shumë se “dymbëdhjetë ministra”, ajo duhet të ketë edhe “një ministër të tretë”, i cili përfaqëson një nga komunitetet joshumicë në Kosovë si dhe do të jenë së paku dy zëvendësministra nga komuniteti serb dhe dy zëvendësministra nga komunitete të tjera joshumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe “një zëvendësministër të tretë”, i cili përfaqëson “komunitetin Serb”, dhe një tjetër zëvendësministër, i cili përfaqëson një nga “komunitetet e tjera joshumicë” në Kosovë


(Kushtetuta, Neni 92.1, Neni 96). Aktualisht, Qeveria përbëhet nga 21 anëtarë, me një zëvendëskryeministër, dy ministra të komunitetit serb dhe dy ministra të tjerë, një boshnjak dhe një turk. Ndërsa, numri i zëvendësministrave nga komunitetet pakicë është 10 anëtarë (Qeveria 2015, 2017). Zgjedhja e këtyre ministrave dhe zëvendësministrave të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë (Kushtetuta: Neni 96).

10.4.Përfaqësimi i komuniteteve në pushtetin lokal: Qeverisjen e Komunave

Në kuadër të legjislacionit të Kosovës, ekzistojnë disa ligje të cilat drejtpërsëdrejti trajtojnë mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë në vend (Ligji Nr. 03/L-047). Pjesëmarrja në qeverisjen lokale garantohet përmes Kushtetutës dhe ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji nr. 03/L-040) përfshirë themelimin e zyrës së Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete dhe nënkryetarit të Komunës për Komunitete. Sipas Neni 54 i Ligji Nr.. 03/L-040 në komunat në të cilat jetojnë së paku dhjetë për qind e banorëve dhe i përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit të komunës do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve (Ligji Nr.. 03/L-040, Neni 54). Zëvendëskryetari kur vlerëson se vendimi i komunës përbën shkelje të të “drejtave të garantuara” me Kushtetutë, ai/ajo mund të “parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese”, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës. Në këto komuna “përfaqësimi në organin ekzekutiv për komunitetet” që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës është i garantuar me Nenin 62 të Kushtetutës (Kushtetuta, Neni 62) .

Në zgjedhjet lokale të vitit 2013 dhe 2017 nga 38 komuna, dhjetë prej tyre udhëhiqen nga komuniteti serb dhe një nga komuniteti turk, ndërsa 27 udhëhiqen nga shqiptarët (KZQ/QNR 2013, 2017). Kjo pasqyrohet në grafikun 14.

Grafiku 14. Përbërja etnike e Kryetarëve të Komunave 2013-2017



Burimi: KQZ/QNR 2013-2017

Bazuar në këto statistika të rezultateve, vijmë në konkludim se reformimi i sistemit zgjedhor, duke kaluar nga proporcionali në sistem të kombinuar (Mix- në variantin 50% e deputetëve zgjidhen sipas sistemit mazhoritar dhe 50% sipas proporcionalit) nuk e zvogëlon përfaqësimin e minoriteteve në Kuvend e Kosovës. Kjo argumentohet me faktin se pushteti lokal është i përbërë prej 38 komunave dhe në mënyrë hipotetike nëse këto komuna kthehen në zona zgjedhore plus efekti i proporcionalit e lehtëson plotësimin e vendeve të garantuara në Kuvend.

Në përfundim të kësaj analize mund të konkludojmë se korniza normative e Kosovës është më avancues në krahasim me vendet e tjera në regjion sa i përket garantimit dhe promovimit

të të drejtave të komuniteteve pakicë. Kjo konstatohet që në dispozitat e para të Kushtetutës ku përcaktohet se Kosova është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera. Ajo përcakton të gjitha garancitë për të drejtat individuale të njeriut dhe për minoritetet etnike. Mandej, garantimi i barazisë në mes të të gjitha grupeve etnike minoritare që jetojnë në Kosovë, si dhe promovimi i të drejtave individuale të njeriut dhe i komuniteteve minoritare është pjesë esenciale e sistemit juridik. Një pjesë e legjislacionit e trajton drejtpërsëdrejti mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë. Korniza kushtetuese dhe ligjore e ka lehtësuar integrimin e të gjitha komuniteteve në institucionet përfaqësuese në masë proporcionale, ose promovimit të diskriminimit afirmative për komunitetet pakicë në dy nivelet e pushtetit lokal dhe qendror. Përderisa vëmendje e madhe i është kushtuar integritit dhe përfshirjes së pakicës serbe, vëmendje më e vogël i kushtohet integritit dhe përfshirjes së komuniteteve të pakicave të tjera në Kosovë. Në përgjithësi, të gjitha vendet e rajonit²⁹ në mënyra të ndryshme e kanë të përcaktuar me dispozita kushtetuese dhe

²⁹ Shënim: Kuotat etnike dhe krahasimi i tyre me vendet e rajonit. Përveç Kosovës, vendet e garantuara apo kuota etnike janë vendosur edhe në Slloveni dhe Kroaci. Përderisa Sllovenia i ka garantuar dy komuniteteve: një deputet i popullit italian dhe një i bashkësive kombëtare hungareze gjithmonë i garantohen vendet në Parlament (Constitution, Article 80). Për zgjidhjen e deputetëve të komunitetit italian ose hungarez caktohen zonat e veçanta në të cilat jetojnë këto komunitete (National Assembly Elections Act, 1992 as amended 2000, Article 20). Ndërsa **Kroacia** në bazë të kushtetutës etnitë specifike njihen si pakica në shtetin kroat: duke përcaktuar si shtet kombëtar i kombit kroat dhe shteti i anëtarëve të pakicave kombëtare: serbët, çekët, sllovakët, italianët, hungarezët, hebrenjtë, gjermanët, austriakët, ukrainasit, rusët, boshnjakët, sllovenët, malazezët, maqedonasit, rusët, bullgarët, polakët, romët, rumunët, turqit, vlllehët, shqiptarët dhe të tjerët që janë qytetarë dhe të cilëve u garantohet barazia me qytetarët e kombësisë kroate dhe ushtrimin e të drejtave të tyre (Constitution 2010, preambula). Parlamenti është një organ përfaqësues i popullit (Kushtetuta 2010, Neni 71) dhe përbëhet nga 140 përfaqësues që zgjidhen në atë mënyrë që territori ndahet në dhjetë zona elektorale në bazë të listave (Ligji zgjedhor për Kuvendin, Neni 35). Të gjitha pakicat kombëtare kanë të drejtë të zgjedhin tetë (8) përfaqësues në Kuvend, të cilët zgjidhen në një zonë të veçantë (Ligji zgjedhor, Neni 15). Nga komuniteti serb zgjidhen tre përfaqësues në Parlament ndërsa hungarezët e italianët do të zgjedhin nga një përfaqësues në Parlament. Pakica çeke dhe sllovae së bashku zgjedhin një përfaqësues. Pastaj anëtarët e pakicës austriake, bullgare, gjermane, polake, rome, rumune, ruse, turke, ukrainase, vallaciane dhe judease së bashku zgjedhin një përfaqësues. Po ashtu, edhe shqiptarët, boshnjakët, malazezët, maqedonasit dhe sllovenët së bashku zgjedhin një përfaqësues në Parlament (Ligji zgjedhor, Neni 16). Në zgjedhjet e fundit, bashkësitë e lartpërmendura përfaqësohen në kuvend nga deputetja shqiptare Ermina Lekaj Perlaskaj (Gazeta Fokus, 2016) ndërsa vendet e tjera si Serbia, Maqedonia, Mali i zi dhe Shqipëria nuk kanë të vendosur ndonjë kuotë të caktuar

për komnitetet jo shumicë. Mirëpo ato përmes ligjeve të veçanta u garantojnë të drejtat komuniteteve minoritare. Në këtë mënyrë Serbia në Kushtetutën e saj përcakton se do të mbrojë të drejtat e pakicave kombëtare, duke garantuar mbrojtje të veçantë për pakicat kombëtare me qëllim të ushtrimit të barazisë së plotë dhe ruajtjes së identitetit të tyre (Serbi, Kushtetuta 2006, Neni 14). Sipas Nenit 100 të Kushtetutës, Parlamenti përbëhet nga 250 deputetë, të cilët zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta me votim të fshehtë, në pajtim me ligjin. Në Parlament do të sigurohet barazia dhe përfaqësimi i gjinive të ndryshme dhe pjesëtarëve të pakicave kombëtare, në përputhje me ligjin. Çdo listë zgjedhore do të shpërndahej në një numër mandatesh proporcional me numrin e votave të fituara (Ligji për zgjedhjet e Parlamentit, Neni 80). Partitë politike dhe koalicionet e partive politike të pakicave etnike marrin pjesë në shpërndarjen e mandateve edhe kur marrin më pak se 5% të numrit të përgjithshëm të votave. Të gjitha partitë, qëllimi kryesor i të cilave është të përfaqësojnë dhe të qëndrojnë për interesat e një pakice etnike, mbrojtjen dhe përmirësimin e të drejtave të pjesëtarëve të pakicave tyre, në përputhje me standardet e përcaktuara me të drejtën ndërkombëtare, do të konsiderohen si parti politike të pakicave etnike. Komisioni zgjedhor vendos, me shpalljen e listës zgjedhore, nëse parashtuesi i listës zgjedhore duhet të konsiderohet si parti politike ose koalicionit të partive politike të pakicave etnike, me kërkesë të parashtuesit të Listës zgjedhore që duhet të bëhet kur të dorëzohet ajo (Ligji për zgjedhjet e Parlamentit, Neni 13). Shqiptarët përfaqësohen me një përfaqësues në Kuvend të Serbisë (National Assembly, 2016). Pastaj Mali i Zi, me Kushtetutë, popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave kombëtare, ia garanton të drejtat dhe liritë, të cilat ata mund të ushtrojnë individualisht ose kolektivisht me të tjerët, të drejtën për përfaqësim autentik në Parlamentin e Malit të Zi dhe në kuvendet e njësive të vetëqeverisjes lokale në të cilat ata përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, në bazë të parimit të aksionit afirmativ (Kushtetuta, Neni 79). Megjithatë sipas ligjit mbi të drejtat dhe liritë e popujve pakicë, “Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale kanë të drejtën e përfaqësimit proporcional në shërbimet publike, organet e pushtetit shtetëror dhe të qeverisjes lokale” (Ligji mbi të drejtat dhe liritë e popujve pakicë, Neni 25). Ndërsa sipas Nenit 94 të Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe përfaqësuesve, listat e kandidatëve që kanë fituar jo më pak se 3% të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme në një zonë zgjedhore marrin pjesë në ndarjen e vendeve. Pavarësisht nga paragrafi i parë i këtij neni: listat e kandidatëve për zgjedhjen e një komune të pakicës specifike ose deputetit të komunitetit të pakicës të specifikuar në aplikimin zgjedhor ose bartësin e listës së kandidatëve, individualisht fitojnë jo më pak se 0.7% të votave të vlefshme, do të fitojnë të drejtën për të marrë pjesë në ndarjen e vendeve si listë e vetme kolektive e kandidatëve me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të fituara, me kusht që të shtohet kjo që siguron fitoren deri në tre vende. Në rast se asnjë nga listat e kandidatëve për zgjedhjen e deputetëve të anëtarëve kroatë nuk përmbush kërkesat nga paragrafi i parë i këtij neni, me jo më pak se 0.35% të votave të vlefshme, fiton të drejtën për një vend të deputetëve (Law on Election of Councillors and Members of Parliament, Article 94). Në bazë të Kushtetutës Maqedonia përcaktohet shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe kombësitë e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë (Kushtetuta 1991, AMENDAMENTI I- XXXII, 2011). Kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve. Mënyra dhe kushtet për zgjedhjen e deputetëve rregullohen me ligj për zgjedhjet që përcakton se “në Parlament zgjidhen 123 deputetë, prej të cilëve 120 deputetë zgjidhen sipas modelit proporcional, me ç’rast territori i Maqedonisë ndahet në gjashtë njësi zgjedhore të përcaktuara me kodin zgjedhor dhe në secilën zonë zgjidhen nga 20 deputetë dhe tre deputetë zgjidhen sipas modelit të shumicës në rrethin e parë të zgjedhjeve dhe atë nga një deputet nga tre njësitë zgjedhore jashtë Maqedonisë: në Evropë dhe Afrikë, në Amerikën Veriore dhe Jugore dhe në Australi dhe Azi të vërtetuara me kodin zgjedhor. Në njësitë zgjedhore numri i zgjedhësve mund të shmanget më së tepërmi prej minus 5% deri plus 5% në raport me numrin mesatar të zgjedhësve në njësinë zgjedhore me përjashtim të njësive zgjedhore në Evropë dhe Afrikë, në Amerikën Veriore dhe Jugore e në Australi dhe Azi (Kodi Zgjedhor, Neni 4). Aktualisht, përbërja e Kuvendit është 120 përfaqësues ku 20 prej tyre janë shqiptarë (Kuvendi i Maqedonisë, 2016). Mandej edhe sistemi kushtetues në Shqipëri nuk ka të përcaktuar ndonjë kuotë për komunitetet e veçanta. Sipas Kushtetutës, Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore shumëmemërore. Zona zgjedhore shumëmemërore përputhet me ndarjen administrative të një prej niveleve të organizimit administrativo-territorial (Kushtetuta, Neni 64). Ndërsa, Kodi Zgjedhor përcakton kriteret dhe procedurat për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore. Kjo përcaktohet në raport me numrin e shtetasve të secilës zonë zgjedhore dhe çdo mandat përfaqëson një numër afërsisht të njëjtë shtetasish (Kodi Zgjedhor, Neni 75).

ligjore, garantimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut e në veçanti të komuniteteve minoritare. Megjithatë, sistemi kushtetues dhe ligjor i Kosovës sa i përket garantimit dhe promovimit të përfaqësimit të komuniteteve etnike ka qasje afirmative për komunitetet minoritare dhe kjo mund të vlerësohet një nga praktikat më të mira të regjionit. Kështu që ky model mund të rekomandohet jo vetëm për vendet e regjionit por edhe më gjerë.

Në bazë të hulumtimit teorik e empirik dhe analizës normative argumentohet nevoja e reformës elektorale dhe kushtetuese për të lehtësuar e krijuar institucione përfaqësuese dhe stabile, duke fuqizuar votuesit dhe deputetin e tyre të zgjedhur në Kuvend si dhe në strukturat partiake. Një reformë që mundëson përfaqësimin ideologjik, gjeografik, etnik, gjinor dhe lehtëson krijimin e institucioneve dhe qeverisjes stabile, funksionale dhe llogaridhënese para institucioneve dhe qytetarëve të saj si dhe krijon stabilitet politik të qëndrueshëm në Kosovë.

KAPITULLI XI: KONKLUZIONE DHE PROPOZIME

Përfundime dhe Rekomandime

Sistemi politik dhe i qeverisjes në Kosovë përfaqëson një demokraci konsensuale bazuar në modelin parlamentar. Historia e parlamentarizmit (2001-2017) tregon se procesi i formimit dhe funksionimit të institucioneve është përballur në vazhdimësi me vështirësi, bllokada dhe kriza politike dhe institucionale. Përveç faktorëve të tjerë që kanë ndikuar për një gjë të tillë, dy faktorët që konsiderohen më kryesoret janë: sistemi zgjedhor i përfaqësimit proporcional (votimi preferencial, një zonë të vetme zgjedhore dhe prag prej 5 përqind) dhe korniza normative për formimin e institucioneve.

Historia e demokracisë elektorale, përfaqësuese dhe institucionale në Kosovë e zhvilluar për afër dy dekada ka paraqitur nevojat e domosdoshme për reform të kornizës ligjore dhe institucionale. Në kuadër të kësaj periudhe (2000-2017) janë mbajtur dymbëdhjetë cikle zgjedhore për të dy nivelet e përfaqësimit, atë qendrore dhe lokale. Prej tyre gjashtë procese zgjedhore për nivelin qendrore dhe gjashtë për nivelin lokal, duke përfshirë edhe katër cikle zgjedhore nga viti 2007-2017, për zgjedhjen e Kryetarëve të Komunave në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Në përgjithësi, të gjitha këto procese zgjedhore për të dy nivelet e pushtetit, përveç zgjedhjes së kryetarëve të komunave janë organizuar sipas sistemit të përfaqësimit proporcional me lista të hapura me tri përjashtime të zgjedhjeve të vitit 2001, 2002 dhe 2004 (shih: tabelat 2, 3 dhe 4) që janë mbajtur me lista të mbyllura si dhe me një zonë të vetme zgjedhore dhe me prag zgjedhor prej 5 përqind nga zgjedhjet e vitit 2007 e deri më sot.

Politika kosovare me vendosjen e sistemit proporcional kishte për qëllim arritjen e proporcionalitetit në dizajnimin e një sistemi demokratik, të qeverisjes konsensuale dhe një parlament pluralist, legjitimitetin e sistemit politik dhe të qeverisjes gjithëpërfshirës me përfaqësim etnik, gjinor dhe shumëpartiak, ku asnjëra parti nuk do të mund të krijonte qeverinë dhe të udhëhiqte e vetme me institucionet qendrore të Kosovës. Gjithashtu, ideja e vendosjes të një zone të vetme zgjedhore sipas të cilës do të zgjidhen të gjithë (120) deputetët e Kuvendit, kishte për qëllim që të ofrohet mundësia përfaqësuese dhe integruese për të gjithë komunitetet politike dhe etnike në vend dhe që partitë politike të grupeve të vogla dhe etnike të kishin një përfaqësim përveç fuqisë së votës elektorale edhe përmes (20) vendeve të rezervuara/garantuar në sistemin politik dhe ndërtimin e institucioneve në Kosovë.

Ndikimi i sistemit zgjedhor proporcional është shfaqur në gjashtë legjislaturat, ku asnjë nga subjektet politike nuk ka arritur që të sigurojë shumicën absolute në Kuvend për të formuar institucionet si parti e vetme por gjithmonë në koalicione për të krijuar një shumicë parlamentare.

Megjithatë sistemi zgjedhor aktual me një zonë të vetme zgjedhore dhe me votë preferenciale nuk po e reflekton drejt shprehjen e vullnetit të popullit përmes zgjedhjeve në Kuvend. Ky sistem nuk po krijon dhe reflekton lidhjen komunikuese mes përfaqësuesve të zgjedhur në Kuvend dhe votuesve në rajone (komuna) gjeografike të ndryshme në Kosovë. Kjo argumentohet nga të dhënat statistikore të pasqyruar (në tabela 9) dhe rezultati i hulumtimit empirik (i paraqitur të dy figurat: Figura 8 dhe Figura 15) që tregon “se mungon kontakti apo bashkëveprimi në mes të zgjedhurve dhe qytetarëve”.

Të gjitha proceset zgjedhore në Kosovë, e në veçanti ato pas Pavarësisë kanë rezultuar me “vlerësime pozitive dhe negative” nga vëzhgues të ndryshëm, aktorët pjesëmarrës në zgjedhje dhe shoqëria civile për “zgjedhjet dhe sistemin zgjedhor” (EU EOM 2014:4; EU EOM 2017; KE 2010:7; KE 2011:6); KE-2012:7; KE 2013:8; KE 2014:6; KE 2016:6 KIPRED 2011/7;4-5; IPOL 2012:8-9). Ndër kritikrat më të shpeshta që janë bërë ndaj procesit zgjedhor në përgjithësi dhe sistemit zgjedhor në veçanti është “manipulimi i votës ose preferencës, votimi disa herë i një votuesi si dhe ai familjar, listat e votuesve dhe mashtrimeve të raportuara në zgjedhje nga administruesit zgjedhor” etj. (OSBE 2012: 4-8; IKD 2014: 8-30; DnV 2011: 12-33 & DnV2014:13-39; Forumi 2015:25).

Për të ngritur dhe siguruar integritetin në një proces zgjedhor prej manipulimeve të votës preferenciale i përcaktuar sipas Nenit 7 i Ligji nr. 03/l-256 që një votues *“mund të votoj deri në pesë kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik”* duhet ndryshuar. Edhe pse rezultati i hulumtimit empirik të paraqitur në figuren 1 dhe 2 që pasqyron preferencën për mënyrën e votimit, del se respondentet e të dy fokus grupeve i japin një përparësi pak më të madhe votimit për disa kandidat brenda listës. Megjithatë, për të ngritur dhe siguruar integritetin në një proces zgjedhor, rekomandohet që kjo dispozite të ndryshohet dhe të vendoset parimi një qytetar një votë. Në dispozitën e re propozohet që “votuesi voton për një subjekt politik të certifikuar dhe mund të votoj për një kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik. Nëse në fletëvotim janë shënuar më shumë se një kandidat, vetëm vota për subjektin politik llogaritet”

Kosovës, përveç vlerësimeve për procesin dhe sistemin zgjedhor, i janë dhënë edhe rekomandime për “evitimin e të metave të sistemit zgjedhor”, “procesin e zgjedhjeve”,

“reformë të kornizës ligjore zgjedhore” nga Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM) mbi Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë (EU EOM 2014:26; EU EOM 2017: 35) dhe Komisioni Evropian (KE 2010:7; KE 2011:6); KE-2012:7;KE 2013:8;KE 2015:6; KE 2016:6).

Në Kosovë ndikimi i kornizës normative për ndertimin e institucioneve është se të gjitha përgjegjësitë për formimin e institucioneve duke filluar nga propozimi dhe zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit dhe formimin e Qeverisë ia ka dhënë subjektit politik që del i pari në zgjedhje, pa marr parasysh nëse ajo ka fituar shumicën absolute apo relative parlamentare. Sipas kësaj logjike juridike, për subjektin politik është shumë e rëndësishme që në procesin zgjedhor, përveç që fiton zgjedhjet dhe del subjekti i parë në mënyrë automatike merr primatin për formimin e institucioneve. Kjo e drejtë buron nga neni 67.2 i Kushtetutës, që rregullon se Kryetari i Kuvendit propozohet nga “grupi më i madh parlamentar dhe zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit” (Kushtetuta, Neni 67.2). Ndërsa, së cili konsiderohet grupi më i madh parlamentar është sqaruar nga Gjykata Kushtetuese përmes Aktgjykimi të saj në Rastin Nr. KO119/14. Madje edhe nëse subjekti politik i grupit më të madh nuk e ka shumicën apo nuk gjen aleat që të krijojë një shumicë absolute në Kuvend për konstituimin e institucioneve, konform dispozitës të Nenit 67, ata mund të bllokojnë procesin duke mos dhënë propozimin për kandidatin për kryetar të Kuvendit. Kështu që, pa zgjedhjen e kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit nuk përmbyllet seanca konstituive dhe si pasojë e kësaj reflektohen krizat në sistemin politik dhe juridik në vend. Me një proces të tillë Kosova është duke u përballur në dy legjislaturat e fundit. Ky është një argument i mjaftueshëm se reforma kushtetuese dhe zgjedhore është më se e domosdoshme, e dobishme dhe efektive për krijimin e institucioneve dhe stabilitetin e tyre.

Në këtë aspekt, rekomandohet të ndryshohet Neni 67.2 dhe 95.1 i Kushtetutës që rregullon mënyrën e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit si dhe zgjedhjes së qeverisë. Madje propozohet që dispozita e ardhshme të hapi mundësinë e propozimit të kandidatëve për Kryetar të Kuvendit nga grupi apo grupet parlamentare që sigurojnë shumicën absolute në Kuvend. Për këtë propozohet që dispozita e re të përcaktojë që: *Kandidat për Kryetar të Kuvendit mund të propozohen nga tri grupet më të mëdha parlamentare, dhe zgjidhet ai kandidat që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.* Rrjedhimisht, kjo e lehtëson krijimin e shumicës parlamentare dhe formimin e qeverisë.

Për afër dy dekada (2001-2017) të parlamentarizmit pluralist të Kosovës, institucionet janë qeverisur nga gjashtë kryeministra (Bajram Regjepi, Ramush Haradinaj, Bajram Kosumi, Agim Çeku, Hashim Thaçi dhe Isa Mustafa) që kanë drejtuar me qeveri të koalicionit si dhe Zyra e Presidentit është udhëhequr nga pesë presidentë, të cilët janë zgjedhur në mënyrë konsensuale dhe pas marrëveshjeve të subjekteve politike për koalicion dhe bashkëqeverisje. Në veqanti zgjedhja e Presidentit të Kosovës nga Kuvendi nxjerr në pah së të gjithë Presidentët: Ibrahim Rugova, Fatmir Sejdiu, Behgjet Pacolli dhe Hashim Thaçi janë zgjedhur në raundin e tretë të votimit përveç Atifete Jahjaga e cila është zgjedhur në raundin e parë. Kjo praktikë, po e ndjek procesin zgjedhor të zgjedhjes së Presidentit nga Kuvendi dhe në shumicën e rasteve ka kaluar nëpër vështirësi si dhe ka prodhuar kriza politike dhe institucionale. E kjo është si rezultat i sistemit zgjedhor proporcional i cili nuk prodhon një mazhorancë të qëndrueshme dhe institucione funksionale dhe stabile. Përveç sistemit zgjedhor, dispozitat e Nenit 86 i kushtetutës dhe pika 85 dhe 86 i Aktgjykimit të Gjykatës

Kushtetuese në Rastit Nr. KO 29/11 për zgjedhjen e Presidentit po kontribuojnë në mënyrë të veçantë në këtë proces.

Në lidhje me këtë propozimi për zgjedhjen e Presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë, se pari, eviton krizat institucionale, së dyti, rrit konkurrencën në procesin zgjedhor dhe i jep më shumë legjitimitet Presidentit në ruajtjen e unitetit dhe funksionalitetit kushtetues të institucioneve, së treti, e faktorizon votuesin dhe nxit atë për pjesëmarrje në votime, si dhe është një proces që mbështetet nga shumica e subjekteve politike dhe afër 90% e opinionit i pasqyruar në (figurën 16) këtë hulumtim. Për të realizuar këto masa, propozohet që të reformohen dispozitat e Nenit 86 të Kushtetutës që përcakton mënyrën e zgjedhjes së Presidentit nga Kuvendi dhe rekomandohet të vendoset që Presidenti të zgjidhet drejtpërdrejt nga populli. Përveç mënyrës së zgjedhjes së Presidentit, propozohet që të ndryshohet edhe dispozita kushtetuese e Nenit 91.3 që ndërlidhet me shkarkimin e Presidentit nga Kuvendi me 2/3 e të gjithë deputetëve, si dhe rekomandohet që në dispozitën e re të vendoset se Presidenti pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese si shkelës i Kushtetutës, konsiderohet automatikisht i shkarkuar nga detyra e tij.

Përveç kompleksitetit politik që ndodh gjatë zgjedhjes së bartësve të pushtetit, gjithashtu, edhe kontrolli politik i tyre përmes mocionit të votëbesimit ndaj qeverisë dhe Impeachmenti ndaj Presidentit nga Kuvendi, reflekton kulturen politike, gadishmerinë dhe mungesën e vullnetit politike të subjekteve parlamentare për përmbushjen e mandatit të mbikqyrjes parlamentare. Është gjetur e hulumtimit se në tri rastet e shpërndarjes së Kuvendit (2010, 2014, dhe 2017), dy prej tyre janë nga mocionet e suksesshme të votëbesimit ndaj qeverisë dhe një nga vetëshpërndajra e Kuvendit me 2/3 e votave të deputetëve. Këto tri rastet kanë një element të përbashkët, ai i koalicionit të heshtur apo publik parazgjedhor në mes të

inicuesit të mocionit dhe subjektit politik në qeveri apo si drejtues i saj. Dhe në tri qeveritë ardhshme paszgjedhore inicuesit janë bërë pjesë e qeverisë apo si drejtues i saj.

Ndërsa, venia para Imeachmentit të Presidentit dhe shkarkimit të tij, pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese ka rezultuar me presion politik ndaj deputeteve nënshkrues të petitionit si dhe ka munguar gadishmeria politike për të siguruar 2/3 e të gjithë deputetëve për shkarkimin e tij nga Kuvendi. Për këtë propozohet që të ndryshohet dispozita kushtetuese që ndërlidhet me shkarkimin e Presidentit nga Kuvendi.

Gjithashtu, ndërprerja e mandatit të Kuvendit çdo herë kur ka mocion të suksesshëm të votëbesimit të qeverisë duhet ndryshuar. Për këtë arsye rekomandohet të bëhen ndryshime të dispozitës të Nenit 82.2 të Kushtetutës që përcakton se pas mocionit të suksesshëm të votëbesimit të qeverisë Presidenti mund ta shpërndajë Kuvendin. Propozohet që Kuvendi, pas mocionit të suksesshëm ndaj qeverisë nëse akoma e ruan një shumicë parlamentare, duhet të tentoj krijimin e qeverisë së re. Mirëpo në rast se nuk sigurohet një shumicë parlamentare atëherë Presidenti në konsultim me subjektet parlamentare dhe konform (Nenit 82.2) Kushtetutës të shpërndajë Kuvendin dhe të shpallë zgjedhjet e reja.

Në demokracinë parlamentare të Kosovës, përformanca e qeverisë së koalicionit dhe subjektëve politike qeverisëse është vlerësuar përveç instrumenteve të rregullta të kontrollit politik parlamentare edhe përmes mocionit të votëbesimit ndaj qeverisë si dhe për varësinë e votave për vendimmarrje si dhe gadishmeria e opozitës në Kuvend për vendime të rëndësishme për vendin. Qytetarët përmes listave të hapura të votimit kanë mundur ta vlerësojnë përformancën e subjektëve politike dhe kandidateve të tyre apo të ndërshkojë një subjekt politik apo kandidatin e saj që i ka dhënë besimin në zgjedhjet e kaluara jo vetëm

duke votuar për një kandidat tjetër në listë apo parti tjetër, por edhe duke abstenuar në zgjedhje. Në lidhje me këtë të dhënë e hulumtimit empirik që paraqiten në figuren 12 për performancën e Kuvendit rezulton më vlerësim negativ ndaj institucionit përfaqësues për mënyrën e mbikqyrjes dhe funksionimit të tij.

Në përgjithësi dalja e qytetarëve në zgjedhje sipas të dhënave statistikore të pasqyruar në tabelat 5, 6 dhe 7 është e ulët, përveç zgjedhjeve të para historike lokale dhe qendrore të vitit 2000 dhe 2001. Ndërsa sa i përket abstenimit të qytetarëve dhe mosdaljes në zgjedhje dhe çka ka çuar në rënien e pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje, nga gjetjet e hulumtimit, të pasqyruar në figuren 3 del se është mosbesimi të partitë politike si dhe mosbesimi tek vota për ndryshim janë ndër faktoret me kryesor. Pastaj listat zgjedhore nuk pastrohen nga qytetarët e vdekur dhe ata që humbin shtetësinë si dhe regjistrimi i atyre që jetojnë jashtë Kosovës dhe që e mbajnë shtetësinë, i bën automatikisht me të drejta të plota për pjesëmarrje në votim. Të gjeturat nga hulumtimi për mënyrat e nxitjes dhe rritjes së votuesve në zgjedhje i pasqyruar të figurat 4 dhe 5 janë llogaridhënia politike, rritja e besimit, organizmit takimeve dhe kontakti i drejtpërdrejtë me votuesit që duhen të ndërmerren nga partitë politike për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në zgjedhje.

Të dhënat e hulumtimit empirike që pasqyrohet në Figurën 3 për shkaqet e daljes së ulët të qytetarëve në zgjedhje ka rezultuar se “koha e shkurtër e fushatës zgjedhore prej dhjetë ditëve” është konsideruar si një ndër pengesat kryesore për mos daljen e qytetarëve në votime. Për ndryshimin e kësaj gjendje paraprakisht duhet të ndryshohen dispozitat normative të Nenit 86.6 dhe Nenit 95.4 i Kushtetutës që përcaktojnë afatet kohore për zgjedhje të reja (parakoheshme apo jashtëzakonshme), për organizimin e tyre kërkohet të

bëhet “brenda 45 ditëve” të kalohet më së paku në 60 ditë dhe kjo e rrit automatikisht “koha për fushatë zgjedhore” sipas Nenit 7 i Rregulles Nr. 15/2010 të KQZ-se nga 10 ditë në së paku 20 ditë për zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe parakohshme.

Korniza ligjore zgjedhore, e cila tani është e rregulluar në ligjet për zgjedhjet e përgjithshme dhe ligjin për zgjedhjet lokale si dhe akteve nënligjore të KQZ për zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtëzakonshme, apo akte nënligjore të ndonjë institucioni tjetër të reformohet dhe fuzionohen në një KOD ZGJEDHOR me të cilin do të rregullohet në tërësi proceset zgjedhor.

Në përgjithësi, trendin e rritjes së votave të humbura/të pavlefshme të pasqyruara në tabelat 5, 6 dhe 7 dhe sipas analizës dhe interpretimit logjik të tyre vijmë në përfundim se gjatë organizimit të zgjedhjeve të parakohshme dhe të jashtëzakonshme nuk i ofrohet kohë e mjaftueshme për të vetëdijesuar votuesit për mënyrën e votimit dhe trajnimit të administratorëve në procesin zgjedhor. Në Kosovë del si domosdoshmeri një angazhim më i fuqishëm i KQZ-së dhe i të gjithë aktorëve relevantë si dhe shoqërisë civile për ngritjen e vetëdijes qytetare për fuqinë dhe rëndësinë e votës, pjesëmarrjes në procesin zgjedhor si dhe mënyrës së votimit.

Në Kosovë, ka një disbalanc në mes të numrit më të drejtë votë në listat e votuesve dhe numrit të popullësisë në përgjithësi. Në zgjedhjet e fundit nacionale (2017), Kosova ka pasur një trup elektoral prej 1,888,059 votues (shih Tabela 5) dhe popullsi të regjistruar në vitin 2011 prej 1.783.531 banorë. Kështu që, “numri i votuesve të regjistruar” është më i madh se “numri i popullsisë në përgjithësi i regjistruar” në Kosovë (KQZ/QNR: 2017; ASK 2017:27). Përveç kësaj ka një disbalanc në mes të numrit në listat e votuesve dhe numrit të

pjesëmarrjes në zgjedhje. Ky dallim është i madh si rrjedhojë e një numri të madh të qytetarëve me të drejtë vote që jetojnë jashtë Kosovës. Për këta qytetarë me të drejtë vote me banim jashtë Kosovës, është e domosdoshme që tu mundësohet atyre që të votojnë në zyrat e ambasadës apo konsullatat e Kosovës dhe Shqipërisë ose me postë kur, nuk ka përfaqësi aty.

Kosova për plotësimin e standardeve për zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe për të pasur impakt në vlerësimin pozitiv të vëzhguesve ndërkombëtarë e vendor gjatë procesit zgjedhor është e domosdoshme reforma e menaxhimit të procesit zgjedhor, që nga formimi i administratës zgjedhore deri tek mënyra se si administrohet vota e çdo votuesi në procesin zgjedhor. Për zvogëlimin e ndikimit të partive politike në administratën zgjedhore është i nevojshëm që përbërja e Komisionit Qendror i Zgjedhjeve e deri tek administratori i fundit në qendrën e vendvotimit, të mos jetë politik. Për këtë propozohet që të ndryshohet mënyra e propozimit, e zgjedhjes dhe përbërjes së anëtarëve të KQZ-së si dhe të ulet numri i anëtarëve nga 11 në 9 anëtarë. Nga nëntë anëtarët e saj gjashtë të vijnë nga komuniteti shumice dhe tre të propozohen nga komunitetet minoritare në Kosovë. Kryetarin e KQZ e zgjedh Kuvendi me mandat 7 vjeçar ndërsa mandati i anëtarëve të jetë 6 vjeçar. Zgjedhja e tyre të bëhet pas shpalljes publike, të zgjedhjes nga Kuvendi dhe të dekretohen nga Presidenti i Kosovës. Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së të bëhet me 2/3 e votave të deputetëve prezentë në seancë duke përfshirë edhe 2/3 e deputetëve minoritarë në Kuvend (në mënyrë të njëjtë sikurse anëtarët e Gjykatës Kushtetuese).

Anëtarët e KQZ-s duhen të jenë profesional e jo zyrtar drejtues (politik) të partive politike. Po ashtu, edhe anëtarët e KKZ-s dhe KVV-s të jenë profesional dhe jo politik apo partiak dhe mandati i tyre përfundon me përmbylljen e procesit zgjedhor. Ajo (KQZ) përzgjedh

kandidatët për KKZ dhe KVV sa më profesional për administrimin e procesit zgjedhor. Ato të zgjidhen përmes shpalljes publike nga KQZ e jo përmes propozimeve të subjekteve politike për personat që ata dëshirojnë t'i emërojnë anëtarë të KVV-ve. Ndërkaq, përfaqësuesit e subjekteve politike rekomandohen të jenë vetëm vëzhgues në procesin zgjedhor.

Pas reformimit të KQZ dhe depolitizimit apo departiakizimit të saj dhe rritjes së integritetit dhe besimit ndaj saj, ajo mund të jetë shkalla e parë e vlerësimit të shkeljes ose abuzimit të procesit zgjedhor dhe më pastaj, palët e pakënaqura ndaj vendimit të KQZ i drejtohen Kolegjit Elektoral apo PZAP-it si shkallë e dytë. Për realizimin e kësaj reforme, rekomandohet që të ndryshohen Neni 139 i Kushtetutës dhe Neni 59, Neni 60, Neni 61, Neni 67, Neni 74, Neni 75, Neni 76 dhe Kreu XX i Ligjit Nr. 03/L-073 si dhe Neni 4, Neni 6, Neni 9; Neni 10 dhe 12 i Ligjit Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës që kanë të bëjnë me përgjegjësitë, strukturën, zgjedhjen dhe mandatin e anëtarëve të KQZ, KKZ dhe KVV, si dhe të PZAP-it.

Lidhur me drejtësinë zgjedhore dhe me qëllim të realizimit të procesit në mënyrë sa më efikase dhe zvogëlimin e mundësive për vonesa në certifikimin përfundimtar të rezultateve të zgjedhjeve propozohet të reformohet institucioni për trajtimin e ankesave në proceset zgjedhore. Ankesat për shkeljet e supozuara nga KKZ dhe KVV si dhe ato të lidhur me administrimin e numërimit në QNR, të dorëzohen për shqyrtim së pari, pranë KQZ-së, si shkallë e parë. Pastaj palët e pakënaqura ndaj vendimit të KQZ e apelojnë të Kolegji Elektoral (PZAP) si shkallë e dytë. Propozohet të ndryshohet mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor (PZAP) në mënyrë që propozimi të bëhet nga Këshilli

Gjyqësor i Kosovës dhe emërimi të behet nga Presidenti i Republikës e jo nga Kryetari i Gjykatës Supreme sic është në fuqi. Në realizimin e kësaj reforme, rekomandohet që të ndryshohen dhe plotësohen dispozitat ligjore, konkretisht Neni 59 dhe Neni 64 mbi Përgjegjësitë dhe Funkcionet e KQZ-së dhe Kreu XX i Ligjit Nr. 03/L-073 ; si dhe Neni 4, Neni 6, Neni 9; Neni 10 dhe Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e Përgjithshme me të cilat funksionon aktualisht PZAP-i. Historia e pluralizmit dhe sistemit partiak në Kosovë fillon nga fundi i viteve 80-të të shekullit të kaluar. Mirëpo, zhvillimi i pluralizmit, sistemit partiak dhe proceseve politike në Kosovë janë të veçanta nga vendet e rajonit për shkak të okupimit të saj nga Serbia si dhe administrimit ndërkombëtar (UNMIK-u). Administrimi dhe mbikëqyrja ndërkombëtare e Kosovës kanë krijuar një traditë, e cila duhet avancuar në shumë sfera. Megjithatë, në mungesë të ligjit për Partitë politike, Regjistrimi dhe veprimtaria e subjekteve politike është e rregulluar përmes Rregullores së KQZ (KQZ 2013, Nr. 01/2013). Sipas kësaj rregulloreje, regjistrimi i partive politike është përgjegjësi e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike në kuadër të KQZ-së.

Në lidhje me këtë propozohet një reformë ligjore dhe institucionale me qëllim të rregullimit dhe avancimit të sistemit partiak. Për këtë, rekomandohet që të hartohet ligji për regjistrimin, funksionimin e partive politike. Në kuadër të këtij ligji të propozohet kalimi i përgjegjësisë nga KQZ-ja te Gjykata Apelit në Prishtinë: për Regjistrimin e Partive politike; interpretimi i statutit dhe zgjidhjen e kontesteve statutoire të partive politike pasi ato të jenë shteruar para organeve të partisë. Gjithashtu, rekomandohet të rriten kriteret që lidhen me numrin e mbështetësve për të krijuar një parti politike nga 500 në 1000 anëtarë me

të drejtë vote dhe të nënshkruar në listë si dhe rritet eficensa në mbikëqyrjen e respektimit të rregullave statutore gjatë funksionimit të tyre si dhe të formohet një Zyre për auditim të financave të partive politike e cila duhet të pozicionohet pranë Auditorit Gjeneral.

Te gjeturat nga hulumtimi empirik të pasqyruar në figurat 6-10, për sa i përket raportit në mes të partive politike dhe kandidatët e tyre, pas procesit zgjedhor rezulton se ata e humbin kontaktin me mbështetësit e tyre, Kështu që partitë politike rekomandohen që të vazhdojnë të komunikojnë dhe të ruajnë bashkëpunimin me bazën e tyre zgjedhore gjatë gjithë kohës së veprimit, e jo vetëm në kohë parazgjedhore. Po ashtu, anëtarësia e partive politike si dhe qytetarët e kanë më të preferuar që kandidati i propozuar për garën zgjedhore së pari të jetë i pranueshëm për të gjitha strukturat partiake nëse dëshirojnë që ai të marr mbështetjen maksimale në procesin zgjedhor. Dhe për këtë partitë politike rekomandohen që gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për garën zgjedhore, paraprakisht të hapin debatin me strukturat e tyre dhe të respektohen propozimet që vijnë nga strukturat e saj. Mandej, partitë politike në kuadër të reformave rekomandohet që të japin hapësirë më të madhe për anëtarët e rinj, apo prurjet e reja si mundësi e mirë për të rritur dhe zhvilluar kapacitetet humane në parti si dhe integrimi i tyre në strukturat partiake, përveç që e lehtëson ndërrimin e elitave drejtuese, reflektohet në ruajtjen e anëtarësisë dhe njëkohësisht në mbështetjen politike të saj në shoqëri.

Sistemi partiak në Kosovë është sistem i konsoliduar dhe i qëndrueshëm shumëpartiak dhe me orientime të ndryshme programore. Sistemi LPP me një zone të vetme dhe vendet e rezervuara/garatuara për minoritetet ka ndikuar në zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit të pluralizmit partiak në Kosovë. Megjithatë, sistemi LPP me një zonë të vetme zgjedhore në

Kosovë ka prodhuar “parti elektorale” më shumë se sa “parti politike përfaqësuese” (KQZ 2017:38 & KZQ/QNR 2017). Kjo ka bërë që shumë subjekte politike të shfaqen disa ditë para zgjedhjeve ndërsa, pas përfundimit të ciklit zgjedhor nuk shfaqen me ndonjë aktivitet për të treguar ekzistencën e tyre si parti jashtëparlamentare.

Pragu i lartë zgjedhor prej 5% i ka defaktorizuar shumë partitë e vogla politike. Duke ndikuar që partitë e vogla politike të strukturuar dhe me anëtarësi të shpërndarë, për të ruajtur subjektivitetin e tyre politik dhe përfaqësues, detyrohen të hyjnë në koalicione me partitë e mëdha si shans i vetëm për të hyrë në Kuvend. Në këtë mënyrë ato më shumë kanë kontribuar në rritjen e numrit të votuesve për koalicionin, se sa për subjektin e tyre, sepse çdo votë për koalicionin automatikisht e rrit proporcionalitetin e votës e cila është e disfavorshme për kandidatët e tyre brenda listës zgjedhore të koalicionit. Për të krijuar një qëndrueshmëri të sistemit partiak (elektoral dhe postelektoral) rekomandohet të ulet pragu zgjedhor nga 5% në 3% për subjektet politike, dhe të caktohet pragu një përqind (1%) për kandidatët e pavarur.

Përfundimisht, parlamentarizmi, pluralizmi dhe demokracia në Kosovë mund të zhvillohet në mënyrë stabile vetëm duke lidhur sistemin politik-modelin parlamentar të demokracisë konsensuale me një element konkurrues mazhoritar. Gjetjet e hulumtimit të pasqyruar në figurat 12-15, tregojnë se ka pakënaqësi ndaj përfaqësimit, funksionimit të Kuvendit, dhe mos përfaqësimit të drejtë të bindjeve apo vullnetit të qytetarëve si dhe mungon një relacion i drejtpërdrejtë mes qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre. Për këtë rekomandohet të ndryshohet sistemi zgjedhor proporcional dhe kalimi te sistemi mixt zgjedhor 50%

mazhoritar dhe 50% proporcional, duke kombinuar vlerat pozitive të proporcionalit me atë mazhoritar si dhe duke ruajtur vlerat kushtetuese të barazisë gjinore dhe kuotës etnike.

Barazia gjinore sipas legjislacionit në Kosovë, është përcaktuar si një nga “vlerat kushtetuese” e sanksionuar me Nenin 7 pika 2 e Kushtetutës. Mirëpo, hulumtimet tregojnë se përfaqësimi dhe fuqizimi i gruas në politike dhe institucione është i ulët, edhe pse ka një legjislacion që garanton (kuotat) dhe promovon avancimin e pozitës së gruas në vendimmarrje në institucionet publike. Madje, sipas raporteve statistikore të nxjerra nga rezultatet e zgjedhjeve të paraqitur në tabelen 20 si dhe nga hulumtimi empirike për përfaqësimin e gruas në pozitat drejtuese institucionale të paraqitura në këtë punim, mund të konkludojmë se ka rritje të numrit të grave në pozitat drejtuese institucionale vetëm atëherë kur ka vullnet politik dhe institucional.

Megjithatë, hulumtimi tregon se mungon mbështetja politike dhe partiake në proceset zgjedhore dhe paszgjedhore për fuqizimin e gruas në politikë. Një nga barrierat kryesore, është moskandidimi për pozicionet e larta zgjedhëse, vendosja në listat zgjedhore dhe mungesa e përkrahjes në mënyrë të njëjtë si burrat dhe gratë gjatë fushatës zgjedhore. Ky argument del nga rezultati i hulumtimit empirik të paraqitur të figura 18 dhe 19 se nuk ka pasur mbështetje të njëjtë si për burrat ashtu edhe për gratë në proceset zgjedhore. Megjithatë në të gjitha rastet kur ka pasur mbështetje apo janë trajtuar në mënyrë të njëjtë, kandidatet gra kanë fituar bindshëm garën për Kryetare Komune, deputete në Kuvendin e Kosovës duke marrë vota shumë herë më shumë se kandidatët burra që janë radhitur në listë para tyre (shih KQZ/QNR 2014, 2017). Kështu që, listat e hapura nuk e kanë defaktorizuar pjesëmarrjen dhe fuqinë e gruas në procesin zgjedhor por përkundrazi e kanë fuqizuar duke e avancuar në pozitat politike dhe partiake, bazuar në fuqinë e votës.

Për më tepër, partitë politike rekomandohen që duhet të fokusohen në përmirësimin dhe avancimin e pozitës së gruas në të gjitha nivelet, qofshin zgjedhore apo emëruese dhe në të dy nivelet e qeverisjes. Mandej fuqizimi i gruas nga partitë politike dhe vendosja e tyre e barabartë në listën zgjedhore ose si bartëse e listës në zgjedhje nacionale apo lokale, duke marrë në konsideratë edhe të zgjedhurit apo emërimet që bëhen nga organet përfaqësuese. Edhe pse kuotat gjinore e kanë rritur dhe siguruar numrin e grave në institucionet përfaqësuese në Kuvend, lidhshipi politik dhe institucional i propozohet që të ndërmarrin veprime për reformë kushtetuese dhe ligjore të përshtatshme për fuqizimin edhe më tej të pozitës së gruas në pozitën vendimmarrëse dhe qeverisëse. Ajo mund të realizohet duke vendosur që aty ku drejtuesi i institucionit është i njërës gjini, zëvendësi i parë të jetë i gjinisë tjetër. Kjo duke filluar nga Kuvendi i Kosovës, gjatë procesit të zgjedhjes së Kryetarit apo Kryetares, zëvendësi të zgjidhet nga gjinia tjetër. Mandej, kjo të praktikohet në Qeveri dhe të gjitha institucionet politike dhe publike. Ndërsa në qeverisjen lokale, partitë politike gjatë nominimit të kandidatit për Kryetar të Komunës, të bëhet edhe nominimi për zëvendës të tij. Në rast se është kandidati grua, zëvendësi të jetë burrë apo anasjelltas. Gjithashtu, partitë politike gjatë zgjedhjes së strukturave drejtuese të saj, të aplikojnë parimin e barabartë dhe fuqizues për gratë duke i dhënë pozita të barabarta në strukturat drejtuese të partisë. Kjo është obligim i detyruar sipas Nenit 6 i Ligjit (Nr. 05/L-020) për Barazi Gjinore që përcakton kuotën 50% për secilën gjini në përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.

Për të përmbushur këtë detyrë ligjore për barazi gjinore, kërkohet të ndryshohet dhe plotësohet: Neni 67 i Kushtetutës që rregullon përbërjen e Kryesisë të Kuvendit dhe Neni 95 i Kushtetutës që rregullon zgjedhjen e Qeverisë, pastaj Neni 27, i *Ligjit Nr. 03/L-073 për*

zgjedhjet e përgjithshme, Neni 8.2 i Ligjit Nr. 03/L-256, për ndryshimin e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme; Neni 8.4 dhe Neni 9 i Ligjit Nr. 03/L-072, për zgjedhjet lokale si dhe 58 i ligjit (Nr. 03/L-040) mbi qeverisjen lokale që rregullon Përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës për pasqyrimin e drejtë mbi barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e gruas në qeverisje dhe jetën politike.

Një propozim tjetër për avancimin e demokracisë së drejtëpërdrejtë dhe fuqizimit politik të gruas në nivelin drejtues lokal është ndryshimi i Nenit 58 i ligjit (Nr. 03/L-040) mbi qeverisjen lokale që rregullon Përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës në zgjedhjen e nënkryetit të Komunës nga Kryetari të reformohet mënyra e zgjedhjes së tij dhe të vendoset që zgjedhja e nënkryetarit të komunës të bëhet nga populli sikurse edhe Kryetari i saj.

Më tutje, propozohet që të vendoset kuota statutore partiake dhe kuotat ligjore për kabinetet qeveritare dhe atyre lokale, do të mundësonte pasqyrimin e drejtë mbi barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e gruas në jetën politike. Po ashtu, partitë politike rekomandohen që të ndërmarrin aktivitete prioritare dhe të hartojnë programe strategjike të cilat synojnë përmirësimin e barazisë gjinore, në kuadër të strukturave të subjekteve të tyre politike si dhe promovimin dhe fuqizimin e pozitës dhe pjesëmarrjes së gruas që nga bashkësitë lokale e më lart duke vendosur kuotën për grua 50% dhe 50% për burra në çdo proces zgjedhor konform ligjit për Barazi gjinore. Ato në programet dhe statutet e tyre të ndërmarrin veprime të hapura për barazi, drejtësi shoqërore, balancë gjinore dhe ndërgjegjësim gjinor. Mandej, sistemi i kombinuar me opsionet 50% mazhoritar dhe 50% proporcional do të fuqizojë gruan akoma më shumë në proceset politike, përfaqësuese dhe në pozitat vendimmarrëse.

Kosova një kujdes të veçantë i ka kushtuar përfaqësimit të të gjitha grupeve etnike, e në veçanti atij minoritar i është rezervuar vendi dhe pozicioni që nga formimi i institucioneve

të para demokratike të pasluftës në Kosovë. Korniza ligjore e nxjerrë paslufte nga UNMIK-u (1999-2008) e më pastaj edhe ajo e pas pavarësisë së Kosovës (2008-2017) krijoi bazën institucionale për përfaqësimin e grupeve etnike duke përcaktuar edhe kuotën e mbipërfaqësimit apo vendet e rezervuara për komunitetet minoritare. Në veçanti, mbipërfaqësimi për komunitetin serb, ka ndikuar në ngadalësimin e integritetit të tyre në shoqëri dhe institucione.

Fryma e Kushtetutës të Republikës së Kosovës e garanton përfaqësim të të gjitha komuniteteve e në veçanti atyre minoritare. Përveç Kushtetutës edhe disa norma ligjore janë pjesë e legjislacionit që përcaktojnë dhe sigurojnë një kuotë të veçantë për komunitetet minoritare, për institucionet lokale dhe qendrore. Në Kosovë për dhjetë vite pas Shpalljes së Pavarësisë, pjesëmarrja dhe integriteti i minoriteteve ka arritur një nivel të kënaqshëm por jo të dëshirueshëm.

Korniza ligjore e Kosovës është në përputhje, me të gjitha praktikat më të mira ndërkombëtare sa i përket sigurimit dhe garantimit të përfaqësimit të komuniteteve etnike. Ajo nëpërmjet dispozitave kushtetuese të Nenit 60, Neni 64.2, Neni 67.4, Neni 77.3, Neni 78.1, Neni 81.1, Neni 96.3-5, Neni 101, Neni 103.3-6, Neni 104.3, Neni 108.6, Neni 109.4, Neni 110, Neni 114.3, Neni 128.4 Neni 129. 2, Neni 133.2 dhe Neni 139.4 i Kushtetutës dhe aktet e tjera ligjore nëpërmjet Nenit 2 të Ligjit Nr. 04/L-020, Nenit 10 të Ligjit Nr. 04/L-44, Nenit 25 të Ligjit Nr. 04/L-046, Nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-149, Nenit 54 të Ligjit Nr. 03/L-040, si dhe dispozitat e Neni 111. i Ligjit Nr. 03/L- Për Zgjedhjet e Përgjithshme specifikojnë përfaqësimin e komuniteteve etnike në Kosovë në nivelin qendror e lokal.

Në Kuvend sipas Nenit 64.2 i Kushtetutës janë të “garantuara 20 vende për komunitetet minoritare”. Në qeveri sipas Nenit 96.3-5 të Kushtetutës, jo më pak se “dy ministri” duhen të drejtohen nga përfaqësues të komuniteteve minoritare dhe kjo rritet varësisht nga “numri i dikastereve” të saj. Ndërsa në pushtetin lokal udhëheqin në “dhjetë komuna” (KQZ/QNR 2013-2017). Gjithashtu, i sigurohen vende sipas Nenit 103.3-6, Nenit 104.3, Nenit 108.6, Nenit 109.4, Nenit 110 në sistemin e drejtësisë; sipas Nenit 128 në sektorin e sigurisë; sipas Nenit 101 në shërbim civil si dhe sipas Nenit 114.3 “dy anëtar nga komuniteti minoritar” duhen të zgjedhen në Gjykatë Kushtetuese apo edhe institucionet e tjera të pavarura vendet janë të garantuara për komunitetet pakicë e në mënyrë specifike për komunitetin serb.

Në përgjithësi korniza ligjore e Kosovës sa i përket përfaqësimit të minoriteteve në institucione është më afirmative nga të gjitha vendet e rajonit. Megjithatë ky model mund të rekomandohet edhe për vendet e rajonit, në veçanti për Serbinë dhe Malin e Zi për t’i siguruar përfaqësim të minoriteteve në institucionet e vendit. Gjithashtu, aplikimi i sistemit të kombinuar në Kosovë, e ruan mundësinë e përfaqësimit të komuniteteve në mënyrë të drejtë në institucione përfaqësuese dhe nuk e zvogëlon fuqinë e tyre politike dhe përfaqësuese. Autori i këtij punimi mbështet iniciativën që t’i garantohet nga një vend në Kuvend edhe për komunitetin kroat dhe malazez.

Në Kosovë është e domosdoshme arritja e një konsensusi politik të të gjitha forcave politike qofshin ato në pozitë apo opozitë parlamentare, jo parlamentare dhe shoqërisë civile si dhe mekanizmave të tjerë institucional për të bërë një reforme të plotë zgjedhore dhe institucionale dhe të hapin debatin politik dhe shoqëror për sistemit zgjedhor dhe kornizës normative dhe institucionale që ndërlidhet me proceset elektorale. Në kuadër të kësaj reforme rekomandojmë modelin gjysëmproporcional apo sistemin mixt 50 me 50 dhe kjo

nënkupton që Kosova rekomandohet të ndahet në 60 plus një zonë zgjedhore, uljen e pragun zgjedhor në 3 përqind, për subjektet politike dhe 1 përqind për kandidatët e pavarur. Të gjithë 120 deputetët do të zgjidhen drejtpërdrejt nga populli. Në mesin e tyre 60 deputetë do të zgjedhin sipas sistemit mazhoritar (IPLMP) në 60 zona njëanëtarëshe si dhe 60 deputetë të tjerë do të zgjedhin sipas sistemit proporcional me lista të hapura në një zonë të vetme zgjedhore.

Ky sistem do t'i mundësojë votuesit që gjatë procesit zgjedhor të shënojnë dy fletëvotime, në njërën për deputetin e zonës së tyre si dhe fletëvotimin tjetër për subjektin politik dhe kandidatin e preferuar brenda listës. Ky model zgjedhor do të jetë më gjithëpërfshirës dhe integrues për të gjitha komunitetet pa dallime etnie, gjuhe, kulture apo prejardhje sociale. Njëkohësisht ky model zgjedhor mundëson më lehtë zbatimin e kuotës kushtetuese për minoritetet dhe integrimin e tyre për dallim nga çdo variant tjetër zgjedhor me 5, 7, 10, 38 zona zgjedhore, apo me ndonjë zonë të veçantë për minoritetet për faktin se në çdo variant tjetër do të jetë izolues apo dezintegrues për komunitete si dhe më i vështirë për të realizuar kuotën etnike në veçanti dhe përfaqësimin gjeografik në përgjithësi.

Efektet e Sistemit të kombinuar do të reflektohen së pari në dizajnimin (krijimin) e institucioneve përfaqësuese gjithëpërfshirëse, të përgjegjshëm dhe llogaridhënës, qeverisje më stabile si dhe krijon hapësirë për kontroll politik të institucioneve. Përveç aplikimit të instrumenteve të kontrollit politik të qeverisë, ky model rrit fuqizimin e votës së qytetarit dhe njëkohësisht forcimin e demokracisë. Votuesit përmes këtij sistemi, do të kenë relacione më të mëdha me deputetët e tyre të zonës dhe njëkohësisht llogaridhënia dhe përfaqësimi do të rritet. Po ashtu, ky model, e lehtëson apo mundëson që në kuvend të përfaqësohen edhe deputetë të pavarur nga 60 deputetët të cilët zgjidhen duke u bazuar

në votat e zonës apo në nivel vendi, nëse ai ka siguruar kalimin e pragut zgjedhor prej 1 përqind.

Integrimi i komuniteteve minoritar në një sistem të tillë e mundëson integrimin e subjekteve politike që përfaqësojnë minoritetet në koalicionet parazgjedhore me subjektet politike që përfaqësojnë shumicën shqiptare si dhe në menaxhimin e votës së përbashkët të votuesit e pakicave minoritare dhe atyre të shumicës për zona të caktuara dhe nivel vendi. Në këtë mënyrë do të mund të inkurajohen votuesit e komuniteteve pakicë në zonat e veçanta për të votuar kandidatin e përkatësisë tjetër. Gjithashtu ky model krijon mundësinë që 60 deputetët e tjerë të zgjidhen duke u bazuar në votat e zonës shumëmemërore apo zonës në nivel vendi ku do të sigurohet ruajtja e kuotës etnike, gjinore si dhe proporcionaliteti në ndarjen e vendeve për të gjitha subjektet politike dhe në veçanti për subjektet e vogla politike në nivel vendi.

Është e kuptueshme se përveç efekteve pozitive ky model zgjedhor ka vështirësitë e saj siç është ndarja në gjashtëdhjetë zona njëmemërore dhe me numër të votuesve të përafërt në mes tyre. Një vështirësi tjetër është administrimi i procesit të numërimit si dhe rritja e dizbalancuar e votave në mes deputetëve të zonave dhe atyre që zgjidhen në nivel vendi. Megjithatë, ky model zgjedhor do të reflektojë më mirë mozaikun e diversitetit të shoqërisë shumëetnike në Kosovë si dhe integrimin e plotë të tyre në institucionet dhe shoqëri.

Sa i përket sistemit zgjedhor për nivelin lokal për zgjedhjen e Asambleistëve Komunal rekomandohet që të vazhdohet sistemi i përfaqësimit proporcional të votimit me lista të hapura sipas parimit një qytetar një votë, duke përjashtuar mundësinë që të përfitoj prijësi i listës, sepse ai duke qenë bartës i listës, përfiton nga votat e partisë, pothuajse pa qenë kandidat në garë. Kjo krijon pabarazi në garën zgjedhore së pari, brenda listës dhe së dyti,

e ngulfatë konkurrencën e brendshme partiake sepse diskriminon pozitivisht, bartësin e listës me kandidatët e tjerë të listës. Për këtë rekomandohet të ndryshohet dispozita e nenit 7.5 e Ligjit për zgjedhjet lokale, i cili favorizon bartësin e listës në krahasim me kandidatët e tjerë në listë pasi në mënyrë automatike ai siguron të gjitha votat të cilat i takojnë subjektit të tyre. Në këtë aspekt propozohet që me dispozitën e re të vendoset që edhe bartësi i listës t'i nënshtrohet garës zgjedhore si pjesëmarrës i barabartë me kandidatët e tjerë brenda listës zgjedhore. Mirëpo nëse në fletëvotim është shënuar vetëm votë për partin apo janë shënuar më shumë se një kandidat, llogaritet vetëm vota për subjektin politik. Vota e hedhur për subjektin politik të konsiderohet si votë për kandidatet gra në listën e kandidatëve të subjektit politik.

Zgjedhja e kryetarëve të komunave sipas sistemit mazhoritar dy raundesh, tashmë ka krijuar një traditë elektorale dhe kjo formulë nuk është e panjohur për qytetarët e Kosovës si dhe i ka mundësuar menaxhimin e votës në balotazh duke dhënë efektet e saj në disa raste për kandidat të cilët në raundin e parë nuk kanë marrë një shumicë absolute të votave për Kryetar Komune (KQZ/QNR 2013-2017). Propozoj të vazhdohet ky sistem edhe në të ardhmën.

Kosova për të realizuar zgjedhje të drejta dhe të ndershme në të gjitha proceset zgjedhore, propozohet ngritja e kapaciteteve humane në institucionet publike dhe brenda subjekteve politike të cilat administrojnë proceset zgjedhore dhe kërkohet një angazhim më i fuqishëm i të gjitha institucioneve përgjegjëse, Medias dhe shoqërisë civile për ngritjen e vetëdijes qytetare për fuqinë e votës së tyre, mënyrës së votimit dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në procesin zgjedhor do të kontribuonin në rritjen e numrit të votuesve në proceset zgjedhore si dhe do të ndikonin në uljen e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme ose votat e humbura.

Për organizimin e zgjedhjeve të lira, krijimin e institucioneve funksionale dhe stabilitet të sistemit politik si dhe demokratizimit të subjeteve politike dhe integrimin e shoqërisë në përgjithësi dhe komunitetit minoritarë në veçanti në Kosovë është ngushtësisht i lidhur me sistemin zgjedhore . Megjithatë, për të krijuar kushte të përshtatshme që kjo të arrihet, është nevojë e domosdoshme për një sistem zgjedhor të reformatuar dhe me të thjeshtë, i cili do të garantonte, përfaqësim gjinor, etnik, gjeografik si dhe të gjitha ideologjitë politike dhe shtresat e shoqërisë në institucionet përfaqësuese dhe qeverisëse. Kosova me qëllim që: të sigurojë përfaqësim politik gjithëpërfshirës në Kuvend, të lehtësohet krijimi i institucioneve dhe rritet stabiliteti politik dhe demokratik i tyre, të ngritet efikasiteti i organeve qeverisëse dhe mbikqyrëse, të rritet mobilizimi i partive politike e i KQZ-se dhe institucioneve tjera për arritur standartet e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, të rritet pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje, të zvoglohen abuzimet apo manipulimet në proceset zgjedhore dhe të krijohet hapësirë të mjaftueshme për zërat e opozitës si dhe të rritet konkurrueshmëria dhe llogaridhënia politik në Kuvend dhe para qytetarëve të saj, është e nevojshme reformë kushtetuese e ligjore dhe institucionale si dhe reformë politike, që do të ndikojnë në stabilitetin e sistemit politik dhe për një qeverisje demokratike.

Rekomandimet

Gjatë hulumtimit dhe analizës së dispozitave kushtetuese dhe ligjore, hulumtimit empirik sistematik dhe qasjes krahasimore lidhur me këtë temë, janë nxjerrë dy lloje rekomandimesh për Kosovën:

- a. Reformë ligjore- kushtetuese dhe institucionale dhe

- b. Përmirësimi i politikave institucionale dhe partiake për ngritjen e vetëdijësimit publike për avancimin e demokracisë në Kosovë.

. Në lidhje me këto rekomandime përmendim:

- të amandamentohet Neni 67.2 i Kushtetutës që rregullon mënyrën e propozimit të Kryetarit të Kuvendit nga grupi ma i madh parlamentar dhe dispozita e ardhshme të hap mundësinë e propozimit të kandidatëve për Kryetar të Kuvendit nga grupi apo grupet parlamentare që sigurojnë shumicën absolute në Kuvend. Dispozita e re e Projektamendamentit Kushtetuese të përcaktojë që: *Kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Kandidat për Kryetar të Kuvendit mund të propozohen nga tri grupet më të mëdha parlamentare, dhe zgjidhet ai/ajo kandidat/e që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
- të ndryshohen dispozitat e Nenit 86.6 dhe Nenit 95.4 i kushtetues dhe të rritet afati për organizimin e zgjedhjeve që kërkohet të bëhet brenda 45 ditëve të kalohet më së paku në 60 ditë. Kjo mundëson rritjen automatike të kohës për fushatë nga 10 ditë në së paku 20 ditë i përcaktuar sipas Nenit 7 i Rregulles Nr. 15/2010 të KQZ-se për zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe parakohshme të përfshihet në kuadër të miratimit të Kodit Zgjedhor.
- Të amendamentohet Neni 65.5 dhe Neni 86 i Kushtetutës që rregullon mënyrën e zgjedhjes të Presidentit nga Kuvendi. Më projektamendamentin e ri Presidenti të zgjidhet drejtëpërdrejtë nga populli përmes zgjedhjeve të lira.
- të amandamentohet Neni 91.3 i Kushtetutës që rregullon shkarkimin e Presidentit nga Kuvendi me 2/3, e të gjithë deputetëve, me projektamendamentin e ri, të normohet se Presidenti pas aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese si shkelës i Kushtetutës, konsiderohet i shkarkuar nga detyra e tij.
- të ndryshohen Neni 139 i Kushtetutës dhe Neni 59, Neni 60, Neni 61, Neni 67, Neni 74, Neni 75, Neni 76 dhe Kreu XX i Ligjit Nr. 03/L-073 si dhe Neni 4, Neni 6, Neni 9; Neni 10 dhe 12 i Ligjit Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës që kanë të bëjnë me

përgjegjësitë, strukturën, zgjedhjen dhe mandatin e anëtarëve të KQZ, KKZ dhe KVV, si dhe depolitizimit apo departiakizimit të administrimit të procesit zgjedhore nga partitë politike. Për zvogëlimin e ndikimit të partive politike në administratën zgjedhore është i nevojshëm që përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të deri tek administratori i fundit në qendrën e vendvotimit, të mos jetë politik. Përfaqësuesit e subjekteve politike të jenë vetëm vëzhgues në procesin zgjedhor.

- Të ndryshohet mënyra e propozimit, e zgjedhjes dhe përbërjes së anëtarëve të KQZ-së si dhe të ulët numri i anëtarëve nga 11 në 9 anëtarë. Nga nëntë anëtarët e saj gjashtë të vijnë nga komuniteti shumicë dhe tre të propozohen nga komunitetet minoritare në Kosovë. Kryetarin e KQZ e zgjedh Kuvendi me mandat 7 vjeçar ndërsa mandati i anëtarëve të jetë 6 vjeçar. Zgjedhja e tyre të bëhet pas shpalljes publike, të zgjedhjes nga Kuvendi dhe të dekretohen nga Presidenti i Kosovës. Zgjedhja e anëtarëve të KQZ të bëhet me 2/3 e votave të deputetëve prezentë në seancë duke përfshirë edhe 2/3 e deputetëve minoritarë në Kuvend (në mënyrë të njëjtë sikurse anëtarët e Gjykatës Kushtetuese). Anëtarët e KQZ duhen të jenë profesional e jo zyrtar drejtues (politik) të partive politike.
- të ndryshohen dhe plotësohen dispozitat ligjore, Neni 59 dhe Neni 64 mbi Përgjegjësitë dhe Funksionet e KQZ-së dhe Kreu XX i Ligjit Nr. 03/L-073 ; si dhe Neni 4, Neni 6, Neni 9; Neni 10 dhe Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e Përgjithshme me të cilat funksionon aktualisht PZAP-i. Me qëllim trajtimit të ankesave në proceset zgjedhore për shkeljet e supozuara nga KKZ dhe KVV si dhe ato të lidhur me administrimin e numërimit në QNR, të dorëzohen për shqyrtim së pari, pranë KQZ-së, si shkallë e parë. Pastaj palët e pakënaqura ndaj vendimit të KQZ e apelojnë të Kolegji Elektorale (PZAP) si shkallë e dytë.
- të ndryshohet mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor (PZAP) nga Kryetari i Gjykatës Supreme të kalojë propozimi i tyre të Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe emërohen nga Presidenti i Republikës.
- të ndryshohet dispozita e nenit 7.5 e Ligjit për zgjedhjet lokale, i cili favorizon bartësin e listës në krahasim me kandidatët e tjerë në listë pasi në mënyrë automatike ai siguron

të gjitha votat të cilat i takojnë subjektit të tyre. Në këtë aspekt propozohet që me dispozitën e re të vendoset që edhe bartësi i listës t'i nënshtrohet garës zgjedhore si pjesëmarrës i barabartë me kandidatët e tjerë brenda listës zgjedhore.

- të miratohet një Kod zgjedhor, i cili do të rregullojë në përgjithësi procedurat e zgjedhjeve për të gjithë llojet e zgjedhjeve të përgjithshme apo lokale në Kosovë.
- të miratohet ligji për veprimtarin dhe regjistrimin e partive politike që rregullon themelimin dhe funksionimin e subjekteve politike në Kosovë. Në kuadër të këtij ligji të parashihet kalimi i përgjegjësisë nga KQZ-ja të Gjykata e Apelit në Prishtinë për: Regjistrimi i Partive politike; interpretimi i statutit dhe zgjidhjen e kontesteve statutore të partive politike pasi ato të jenë shteruar para organeve të partisë;
- të formohet një zyrë për auditim të financave të partive politike e cila duhet të funksionojë pranë Auditorit Gjeneral;
- të rritet kriteri që lidhen me numrin e mbështetësve për të krijuar një parti politike nga 500 në 1000 anëtarë me të drejtë vote dhe të nënshkruar në listë si dhe të rritet eficensa në mbikëqyrjen e respektimit të rregullave statutore gjatë funksionimit të tyre.
- Të ndryshohet Neni 27, i Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 8.2 i Ligjit Nr. 03/L-256, për ndryshimin e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme; Neni 8.4 dhe Neni 9 i Ligjit Nr. 03/L-072, për zgjedhjet lokale që përcaktojnë kuotën gjinore prej 30% dhe të harmonizohet me dispozitat e Nenit 6 i Ligjit (Nr. 05/L-020) për Barazi Gjinore që përcakton kuotën 50% për secilën gjini në përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.
- Të ndryshohet dhe plotësohet: Neni 67 dhe Neni 95 i Kushtetutës që rregullon strukturen e Kryesinë e Kuvendit dhe përcakton "Zgjedhjen e Kryetarit, Nënkyetarëve të saj si dhe Zgjedhja e Qeverisë së Kosovës si dhe Neni 27, i Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme, Neni 8.2 i Ligjit Nr. 03/L-256, për ndryshimin e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme; Neni 8.4 dhe Neni 9 i Ligjit Nr. 03/L-072, për zgjedhjet lokale si dhe Neni 58 i ligjit (Nr. 03/L-040) mbi qeverisjen lokale për "Përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës për pasqyrimin e drejtë mbi barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e gruas në qeverisje dhe jetën politike.

- Të ndryshohet dhe plotësohet Neni 9 i Ligjit Nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, për “Zgjedhjet e Kryetarëve të Komunave” dhe Nenit 58 pika e, i ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, “Përgjegjësitë e Kryetarit” në emrimin e Nënkyetarit të Komunës dhe shkarkimin e tij nga Kryetari i Komunës për vendosjen e mënyrës së zgjedhjes të Nënkyetarit të Komunës nga populli e jo ai të emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Komunës.
- Të harmonizohen të gjitha aktet e sistemit Juridik në Kosove si dhe statutet e subjekteve politike me dispozitat e Ligjit (Nr. 05/L -020) për Barazi Gjinore.
- Partitë politike rekomandohen që të ndërmarrin aktivitete prioritare dhe të hartojnë programe strategjike të cilat synojnë përmirësimin e barazisë gjinore, në kuadër të strukturave të subjekteve të tyre politike si dhe promovimin dhe fuqizimin e pozitës dhe pjesëmarrjes së gruas që nga bashkësitë lokale e më lart duke vendosur kuotën për gr 50% dhe 50% për burra në çdo proces zgjedhor. Ato në programet dhe statutet e tyre të ndërmarrin veprime të hapura për barazi, drejtësi shoqërore, balancë gjinore dhe ndërgjegjësim gjinor.
- partitë politike në kuadër të reformave partiake të japin hapësirë më të madhe për anëtarët e rinj, apo prurjet e reja si mundësi e mirë për të rritur dhe zhvilluar kapacitetet humane në parti si dhe integrimi i tyre në strukturat partiake.
- partitë politike të vazhdojnë të komunikojnë dhe të ruajnë bashkëpunimin me bazën e tyre zgjedhore gjatë gjithë kohës së veprimit, e jo vetëm në kohë parazgjedhore.
- partitë politike gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për garën zgjedhore, paraprakisht të hapin debatin me strukturat e tyre dhe të respektohen propozimet që vijnë nga strukturat e saj
- të zbatohen të gjitha rekomandimet të bëra nga Veshguesit e zgjedhjeve-organizatat ndërkombëtare dhe vendore për institucionet publike për reform elektorale, si njeri ndër kushtet për të përmirësuar dhe plotësuar standardin e zgjedhjeve të lira e demokratike në Kosovë.
- për qytetarët me të drejtë vote me banim jashtë Kosovës të mundësohet votimi në zyrat e ambasadës apo konsullatat e Kosovës dhe Shqipërisë ose me postë kur, nuk ka përfaqësi aty.

- kërkohet një angazhim më i fuqishëm i të gjithë aktorëve relevantë si dhe shoqërisë civile për ngritjen e vetëdijes qytetare për fuqinë dhe rëndësinë e votës, pjesëmarrjes në procesin zgjedhor si dhe mënyrës së votimit.
- të ulët pragu zgjedhor nga 5% në 3% për subjektet politike dhe të caktohet pragu një përqind (1%) për kandidatët e pavarur për të krijuar një qëndrueshmëri të sistemit partiak (elektoral dhe postelektoral).
- të ndryshohet sistemi zgjedhor proporcional dhe kalimi te sistemi kombinuar zgjedhor 50% mazhoritar dhe 50% proporcional, duke kombinuar vlerat pozitive të proporcionalit me atë mazhoritar si dhe duke ruajtur vlerat kushtetuese të barazisë gjinore dhe kuotës etnike.
- Në përfundim, rekomandohen që hulumtuesit e ardhshëm të merren më shumë me hulumtime shkencore rreth orientimit programor të partive politike dhe burimeve të financimit e auditimit të tyre në Kosovë.

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

Burime Parësore

Aktet Kushtetuese

- Constitution of Montenegro, SU-SK N0o.01-514/21, Podgorica, 19 Octobar 2007, [https://anayasa.tbmm.gov.tr/docs/Karada%C4%F5-EN\(19.10.2007\).pdf](https://anayasa.tbmm.gov.tr/docs/Karada%C4%F5-EN(19.10.2007).pdf) (qasur 1.10.2015)
- Constitution of the Republic of Serbia, Belgrade, 30th September 2006 http://www.parlament.gov.rs/upload/documents/Constitution_%20of_Serbia_pdf.pdf (qasur 5.10.2015)
- Constitution of the Republic of Croatia , Zagreb, 6 July 2010, <http://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/en/hr/hr060en.pdf> (qasur 30.09.2015)
- Constitution of the Republik of Slovenia Official Gazette of the Republic of Slovenia Nos. 33/91-I, 42/97, 66/2000, 24/03, 69/04, 68/06, and 47/13 <http://www.us-rs.si/media/constitution.pdf> (qasur 30.09.2015)
- Komisioni i Venecias (2002) Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, Nr.190/2002, [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2002\)023rev-alb](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2002)023rev-alb) (qasur 15.05.2016)
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (të miratuar më 9 prill 2008) me amendamentet I-XXIV Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 25, datë 7 shtator 2012; /Nr. 7 / 26 MARS 2013 dhe Nr. 20 / 5 Gusht 2015: file:///C:/Users/Dell/Desktop/Doktortura/Kushtetutat/Kushtetuta_e_Republikes_se_Kosoves_me_amendamentet_I-XXIV.pdf (qasur 10.09.2017)
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 17 nëntor 1991 Amendamenti I- XXXII 12 prill 2011, Shkup <http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/UstavRMALizmeni.pdf>, (qasur 1.10.2015)
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit. Miratuar me referendum më 22.11.1998 Shpallur me dekretin nr. 2260,

datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani, Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007, Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008, Ndryshuar me ligjin nr. 88/2012 (datë 18.09.2012),

http://www.parlament.al/web/pub/kushtetuta_perditesuar_15171_1.pdf (qasur 1.10.2015)

- Propozimi gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, 2 shkurt 2007 (Plani i Presidentit Marti Ahtisaarit)
<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Propozim%20per%20Statusin%20e%20Kosoves.pdf> (qasur 25.09.2015)
- The United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK) was established by the Security Council in its resolution 1244 (1999).
<http://www.unmikonline.org/Pages/about.aspx> (qasur 8.11.2015)
- Udhëzues për rishikimin e një kuadri ligjor për zgjedhjet (2005), OSBE-ODIHR, Varshave 2005 <http://www.osce.org/sq/odihr/elections/13960> (qasur,20.10.2015)

Aktet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

- Gjykata Kushtetuese (2010), Aktvendim për palejueshmërinë në Rastin Nr. KI 73/09, Mimoza Kusari-Lila Vs. Komisionit Qendror Zgjedhor. http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/KI%2073_vendimi_shq.pdf (qasur 11.02.2015)
- Gjykata Kushtetuese (2014): Aktgjykim në Rastin Nr. K0103/14 Parashtrues, Presidentja e Republikës së Kosovës përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së Nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. https://gazetablic.com/wp-content/uploads/2017/06/KO103-14_SHQ_aktgjykim.pdf (qasur 10.3.2015)
- Gjykata Kushtetuese (2015), AKTGJYKIM në Rastin nr. K0130/15, Parashtrues, Presidentja e Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesorë" me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe

pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_shq.pdf (qasur 10.3.2016)

- Gjykata Kushtetuese (2016): Rastin nr. K047/16, Aktvendim për Papranueshmëri, Parashtrues: Aida Derguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës. http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ko_47_16_shq.pdf (qasur 18.10.2016)
- Gjykata Kushtetuese (2010): Aktgjykim në Rasti nr. KI47/10, Parashtrues, Naim Rustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 28 shtator 2010 Nr. ref.: AGJ 43/10.
<file:///C:/Users/Dell/Desktop/Doktortura/Vendimet%20e%20gjkushtetuese/Rasti%20i%20presidentit%20sejdiu%20.pdf> (qasur 10.5.2014)
- Gjykata Kushtetuese (2014), AKTGJYKIM në Rastin Nr. KO119/14, Parashtrues Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9661> (qasur 2.2.2015)
- Gjykata Kushtetuese (2011): Aktgjykim në Rastin Nr. KO 29/11, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosoves, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011. <http://politike.al/wp-content/uploads/2016/03/Gjykata-Kushtetuese-Kosove-mbi-zgjedhjen-e-Presidentit-2011.pdf> (qasur 10.04.2015)
- Gjykata Kushtetuese (2012), Aktgjykimi, Rastet K.O 29/12 dhe K.O. 48/12 , Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012. http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/Aktgjykim%20KO29_48_12_Anex%20A%20&%20B_S_HQ.pdf (qasur 11.3.2016)

- Gjykata Kushtetuese (2018), AKIVENDIM PER PAPRANUESHMERI, ne Rasti nr. K079/18, Parashtrues Presidedti i Repuhlikes se Kosoves, Kerkese per interpretim te nenit 139. paragrafi 4 te Kushtetutes se Repuhlikes se Kosoves, Prishtine, 3 dhjetor 2018, Nr. rcf.:RK 1294/ 18. http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2018/12/ko_79_18_av_shq.pdf (qasur 15 dhjetor 2018)

Aktet e UNMIK

- Rregullore Nr. 2007/26 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/12 Mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, UNMIK/REG/2007/26 29 gusht 2007,
- Rregullore Nr. 2007/25 Për Ndryshimin e Rregullores së Ndryshuar të UNMIK-ut, Nr. 2004/9 Mbi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, UNMIK/REG/2007/25, 29 gusht 2007.
- Rregullore Nr. 2007/27, Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë, UNMIK/REG/2007/27, 29 gusht 2007,
- Rregullore Nr. 2007/28 Për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2007/26, Mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, UNMIK/REG/2007/28, 7 shtator 2007
- Rregullore Nr. 2000/16, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë, UNMIK/REG/2000/16, 21 mars 2000
- Rregullore Nr. 2000/21, Për Themelimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, UNMIK/RREG/2000/21, 18 prill 2000.
- Rregullore Nr. 2000/39, Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë, UNMIK/REG/2000/39 , 8 korrik 2000,
- Rregullore Nr. 2000/45, Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, UNMIK/RREG/2000/45, 11 gusht 2000,
- Rregullore Nr. 2001/33 Mbi Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës, UNMIK RREG/2001/33,15 nëntor 2001.
- Rregullore Nr. 2001/9, Për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, UNMIK/REG 2001/9, 15 maj 2001.
- Rregullore Nr. 2002/11, Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë, UNMIK/REG/2002/11, 10 qershor 2002

- Rregullore Nr. 2002/8 për ndryshimin e rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut, Mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë, UNMIK/REG/2002/8 , 4 prill 2002
- Rregullore Nr. 2004/12, Mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës UNMIK/REG/2004/12, 5 maj 2004
- Rregullore nr. 2004/9 e UNMIK-ut “Mbi komisionin Qendror të Zgjedhjeve”, Rregullore nr. 2000/21 e UNMIK-ut, “Për themelimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”;
- Rregullore Nr. 2006/54 Për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave Në Kosovë, UNMIK/REG/2006/54, 5 dhjetor 2006.
- Rregullore Nr. 2007/26 Për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut NR. 2004/12, Mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, UNMIK/REG/2007/26, 29 gusht 2007.
- Rregullore Nr. 2007/30 Për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2000/45, Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, UNMIK/REG/2007/30, 16 tetor 2007.
- Rregullore Nr.2000/65, Ndryshimi i Rregullores 2000/21, Për Themelimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, UNMIK/REG/2000/65, 19 dhjetor 2000.
- Rregullorja Nr. 2001/16, Ndryshim i Rregullores Nr. 2000/16, Për Regjistrimin dhe Punën e Partive Politike në Kosovë, UNMIK/REG/2000/16 4 korrik 2001.

Kodet, Ligjet dhe Aktet nënligjore:

- Act Amending and Modifying the Act on the election of deputies , Official Gazette of the Republic of Serbia", no. 18/04,
http://www.rik.parlament.gov.rs/engleski/propisi_frames.htm , (qasur 5.10.2015)
- Act on Election of Representatives to the Croatian Parliament, 013-01/03-01/04 Zagreb, 9th April 2003
file:///C:/Users/home/Downloads/Election_of_Representatives.pdf (qasur 30.09.2015)
- Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal I Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.19 / 13 korrik 2012, Prishtinë

- Kodi Zgjedhor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11 – Tekst i pastruar dhe 142/12), http://www.sec.mk/files/izbori2014/Kodi_zgjedhor.pdf (qasur 1.10.2015)
- Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Miratuar me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, dhe ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015), <file:///C:/Users/home/Desktop/Konferenca/Ligjet%20zgjedhore/KODI%20ZGJEDHOR%202015%20-%20Teksti.pdf> (qasur 1.10.2015)
- Law on Election of Councillors and Representatives (Published in the Official Gazette of the Republic of Montenegro, no. 4 of 18 February 1998, 5/98, 17/98, 14/00, 18/00, 9/01, 41/02, 46/02, 45/04, 48/06, 56/06, Official Gazette of Montenegro, no. 46 of 16 September 2011, 14/14, 47/14, 12/16 file:///C:/Users/Dell/AppData/Local/Packages/Microsoft.MicrosoftEdge_8wekyb3d8bbwe/TempState/Downloads/Montenegro_Law_elections_councillors_members_of_parliament_1998_am2016_en.pdf (qasur 3.2.2017
- Law on the Elections of representatives , Official Gazette of the Republic of Serbia", no. 35/00, http://www.rik.parlament.gov.rs/engleski/propisi_frames.htm, (qasur 5.10.2015)
- Ligj Nr. 115/2014 Për Ndarjen Administrativo-territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/137-2014.pdf (i qasur 15 janar 2018)
- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare / Prishtinë: Viti III / Nr. 28 / 04 qershor 2008,
- Ligji Nr. 03/L-047, për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare / Prishtinë: VITI III / Nr. 28 / 04 qershor 2008.
- Ligji Nr. 03/L-149, Për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare / Prishtinë: Viti V / Nr. 72 / 25 Qershor 2010,

- Ligji Nr. 03/L-174, Për Financimin e Subjekteve Politike, Gazeta Zyrtare, Nr. 82 / 21 Tetor 2010,
- Ligji Nr. 04/L-020, Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtje dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare, / Nr. 29 / 27 dhjetor 2011, Prishtinë.
- Ligji Nr. 04/L-046, Për Radiotelevizionin e Kosovës, Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 27 prill 2012, Prishtinë.
- Ligji Nr. 04/L-212, Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të Ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058, Gazeta Zyrtare, Nr. 30 / 23 gusht 2013, Prishtinë.
- Ligji Nr. 04/L-44, Për Komisionin e Pavarur të Medieve, Gazeta Zyrtare, Nr. 5 / 05 prill 2012, Prishtinë.
- Ligji Nr. 05/L -020, Për Barazi Gjinore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 16 / 26 qershor 2015, Prishtinë.
- Ligji mbi të Drejtat dhe Liritë e Popujve Pakicë në Mal të Zi
<file:///C:/Users/home/Downloads/LIGJI%20MBI%20T%C3%8B%20DREJTAT%20DHE%20LIRIT%C3%8B%20E%20POPUJVE%20PAKIC%C3%8B.pdf> (qasur 5.10.2015)
- Ligji Nr. 03/L-072, Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Gazeta zyrtare: nr 32, 15 qershor 2008.
- Ligji nr. 03/l-073, Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Gazeta zyrtare, nr. 31 / 15 qershor 2008.
- Ligji Nr. 03/l-199, Për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti V / nr. 79 / 24 gusht 2010.
- Ligji nr. 03l-256, Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03l-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 87 / 16 nëntor 2010.
- Ligji Nr. 2004/2, Për Barazi Gjinore, e shpallur përmes UNMIK/REG Nr. 2004/18.

- National Assembly Elections Act (Zakon o volitvah v Državni zbor (Ur.l. RS, št. 44/92, 60/95,14/96– odločba US, 67/97– odločba US, 70/2000), http://www.sze.hu/~smuk/Nyilvanossag_torvenyek_CEE/Valasztasi_szabalyok/Slovenia%20elections%20nat%20assembly.pdf (qasur 30.09.2015)
- National Assembly Elections Act, , *Zakon o volitvah v Državni zbor (Ur.l. RS, št. 44/92, 60/95,14/96– odločba US, 67/97– odločba US, 70/2000), http://www.sze.hu/~smuk/Nyilvanossag_torvenyek_CEE/Valasztasi_szabalyok/Slovenia%20elections%20nat%20assembly.pdf (qasur 30.09.2015)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2013) Rregulla Zgjedhore Nr.03/2013 Votimi jashtë Kosovës <http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/KQZ-Rregulla-03-2013.pdf> (qasur 25.12.2016)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2013), Rregulla Zgjedhore Nr. 04/2013 Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta, <http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/KQZ-Rregulla-04-2013.pdf> (qasur me 18.08.2017)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2013), Rregulla Zgjedhore Nr. 06/2013 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve Neni 2, Komisioni Qendror Zgjedhor http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/6_bjglntvptx.PDF (qasur 11.3.2015)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2013), Rregulla nr. 15/2013 Zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe zgjedhjet e parakohshme
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2013), Rregullën Zgjedhore Nr. 13/2013 Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2013), Rregulla Nr. 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive politike; http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Rregulla%20123072013_agalzvuxxn.pdf (qasur 11.3.2015)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011), REZOLUTË, Në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes ndërmjet Bexhet Pacolli, Isa Mustafa dhe HashimThaçi http://www.assemblykosova.org/common/docs/Rezoluta_Pacolli_Mustafa_Thaci_s_hq.pdf (qasur 15.10.2015)

- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2010), Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 29 prill 2010
- Paneli Zgjedhor i Ankesave dhe Parashtresave (2015) Rregulla nr. 02/15 Rregullat dhe Procedurat.
- Parimet e Prishtinës nga Samiti Ndërkombëtar i Gruas: “Partneriteti për Ndryshim-Fuqizimin e Gruas”, më 4-6 tetor 2012, në Prishtinë, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Rezoluta_per_fuqizimin_e_rolit_te_Gruas.pdf (qasur 10.11.2015)

Statutet/Aktet e subjekteve politike

- Statuti Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008), <http://www.aak-ks.org/?id=18> (qasur 15/01/2018)
- Statuti i Alternativës, (2017), http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Alternativa%20statuti%20i%20partise_szewlztcl.pdf (qasur 15/01.2018)
- Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje (2012), <https://www.vetevendosje.org/uploads/files/2017/May/08/Statuti1494292584.pdf> : (qasur 15/01/2018)
- Statuti i Lidhjes Demokratike e Kosovës (2012), <http://www.ldk-kamenice.com/dosjet/2016/10/Statuti-i-LDK.pdf> (qasur 15/2018)
- Statuti i Nismës për Kosovën (2015) http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Statui%20-Final%20PDF_xvczdmzlej.pdf (qasur 15/01/2018)
- Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (2013) <http://www.pdk.info/article/post/16> (qasur 15/01/2018)
- Statuti i Partisë Aleanca Kosova e Re (2017), <http://akr-ks.com/wp-content/uploads/2013/10/STATUTI-FINAL.pdf> (qasur 15/01/2018)

Raportet/Publikime

- Demokracia në Veprim (2017), Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve: Zgjedhjet për Kuvende Komunale dhe Kryetar të Komunave, <http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2018/02/Raporti-Vezhgimit-2017-Lokale-ALB.pdf> (qasur 15.01.2018)
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (2017), Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, <http://ask.rks-gov.net/> http://ask.rks-gov.net/media/3414/vjetari_statistikor_i_republikës_-së_-kosovës_-2017_-final.pdf (i qasur 10.10.2017)
- European Parliament: NOTICE TO MEMBERS No 3/2002: Ad hoc delegation for the observation of Kosovo Assembly elections from 16 to 19 November 2001 http://www.europarl.europa.eu/intcoop/election_observation/missions/20011117_kosovo_en.pdf (qasur 10.2.2015)
- Forum 2015 (2013): Analiza: Top problemet zgjedhore, Qasje praktike për të kthyer besimin në procesin zgjedhor <http://kfos.org/wp-content/uploads/2013/05/Top-Problem-et-Zgjedhore-ALB.pdf> (qasur 28.10.2015)
- International Crisis Group (2001), Europe Report, Nr. 120, KOSOVA: ZGJEDHJE HISTORIKE <https://d2071andvip0wj.cloudfront.net/120-kosovo-landmark-election-albanian.pdf> (qasur 13.01.2018)
- Instituti Demokratik i Kosovës (2013), Mbi 10 vjet parlamentarizëm në Kosovë, punuar nga KDI, publikuar 2013 nga Forum 2015 - projekt operacional i KFOS,
- Instituti i Prishtinës për Studime Politike (2012), Bashmir Xhemaj, Analiza publike (nr.1) “REFORMA ZGJEDHORE: demokracia tek listat dhe zonat”
- Instituti për Politika Zhvillimore (2012), Opsionet për Reformën Zgjedhore në Kosovë, 2012/02 ISBN 978-9951-627-02-3, http://www.indep.info/documents/75482_INDEP%20-%20Opsionet%20per%20Reforme%20Zgjedhore%20ne%20Kosove.pdf (qasur 15.10.2015)

- Komisioni Evropian (2013), Raporti i Progresit Për Kosovën, Bruksel, 16.10.2013 SWD(2013) 416, [http://www.mei-ks.net/repository/docs/1FINAL-ALB_MIE-Kosovo_Progress_Report_2013_\(alb\)_2\).pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/1FINAL-ALB_MIE-Kosovo_Progress_Report_2013_(alb)_2).pdf) (15. 10.2015)
- Komisioni Evropian (2014), Raporti i Progresit për Kosovën, Bruksel, 8.10.2014 SWD(2014) 306 final,, [http://www.mei-ks.net/repository/docs/Final_20141008-kosovo-progress-report_en_\(2\).pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/Final_20141008-kosovo-progress-report_en_(2).pdf) (qasur 15.10.2016)
- Komisioni Evropian, (2010), Raporti i Progresit për Kosovën, Bruksel, 9 nëntor 2010 SEC(2010)1329, http://www.mei-ks.net/repository/docs/KS_Report_2010_Alb.pdf (qasur 15/01/2018)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2015), Hulumtimi dhe analizimi i Fletëvotimeve të Pavlefshme për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2014, http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Raporti%20i%20hetimit%20te%20flv_al_iqtnijbzf.pdf (qasur 20.10.2015)
- European Commission (2005), Kosovo (under UNSCR 1244) 2005 Progress Report, Brussels, 9 November 2005 SEC (2005) 1423, https://www.mei-ks.net/repository/docs/Kosovo_Progress_Report_2005.pdf (qasur 10.2.2017)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2013), Rezultati përfundimtar nga QNR: për Kuvendet Komunale; <http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/04/1.Statistikat-sipas-komunave-2013.pdf> (qasur 2.8.2017)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2013), Rezultati i përfundimtar nga QNR për raundin e parë për Kryetarët e Komunave; <http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/04/1.-Rezultatet-e-kandidatëve-për-Kryetar-Komune-2013.pdf> (qasur 30.05.2016)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2013), QNR, Rezultati përfundimtar nga QNR për balotazh; <http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/04/1.-Rezultatet-e-kandidatëve-për-Kryetar-Komune-2013-1.pdf> (qasur 30.05.2016)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2017), Zgjedhjet në Kosovë 2000-2014, Prishtinë.

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2017) Zgjedhjet për Kryetar Komune, Statistikat <http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/1-1.pdf> (10.1.2018)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2010), QNR, Shpërndarja e ulëseve sipas subjekteve file:///C:/Users/Dell/Desktop/Doktortura/tema%20doktorature/Rezultatet%20KQZ/shperndarja_e_uleseve_sipas_subjekteve_kktgjgbdzv.pdf (qasur 2..8. 2017)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2007), Rezultatet e QNR për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës , <https://www.osce.org/kosovo/38258?download=true> (qasur 2.7.2014)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2007), Rezultatet e QNR për Zgjedhjet për Kuvendet Komunale; <https://www.osce.org/kosovo/38263?download=true> (qasur 12.06.2016)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2007), Rezultatet e QNR për Zgjedhjet për Kryetar të Komunave <https://www.osce.org/kosovo/38327?download=true> (qasur 12.01.2017)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2010), Raporti i punës dhe i aktiviteteve vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2017), Lista e Subjekteve Politike, Kandidatët e të cilave u çertifikuan nga KQZ <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/305> (qasur 10. 27 .05.2017)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2017), Lista e Kandidatëve Femra nga votat me të larta [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/4.%20Lista%20e%20Kandidatëve%20Femra%20nga%20votat%20me%20të%20larta%20-%20Candidate%20list%20by%20Party%20\(Highest%20to%20Lowest\)\(1\)_rpdgsctkrt.pdf](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/4.%20Lista%20e%20Kandidatëve%20Femra%20nga%20votat%20me%20të%20larta%20-%20Candidate%20list%20by%20Party%20(Highest%20to%20Lowest)(1)_rpdgsctkrt.pdf) (qasur 2 .08.2017)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2013), Rezultatet e kandidatëve nëpër komuna (lista totale e kandidatëve) http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/b_qkakhkaiid.pdf (qasur 15.02.2016)

- Komisioni Evropian, (2011), Raporti i Progresit për Kosovën, Bruksel, 12.10.2011
SEC(2011) 1207,
http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_sq.pdf (qasur 15.01.2018)
- Kuvendi i Kosovës (2008), Transkript nga Seanca Plenare e Jashtëzakonshme Solemne e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 9 prill 2008;
http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2008_04_09_10_al.pdf
(qasur 11.09.2016)
- Kuvendi i Kosovës (2008), Transkript nga Seanca Plenare e Jashtëzakonshme Solemne e Kuvendit të Kosovës, me Rastin e Shpalljes së Pavarësisë, të mbajtur më 17 Shkurt 2008;
http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2008_02_17_al.pdf
(qasur 11.09.2016)
- Kuvendi i Kosovës 2008, Legjislatura III, Procesverballi, Seancë konstitutive e Kuvendit të Kosovës P- 001 Prishtinë, më 04 dhe 09 janar 2008.
http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_s_2008_01_04_al.pdf
(qasur 10.01.2018)
- Kuvendi i Kosovës, Grupet politike në Kuvendin e Kosovës, Periudha e dytë Legjislative (23.11.2004 - 12.12.2007)
<http://kuvendikosoves.org/?cid=1,158&legid=2&secid=107> (qasur 12.2.2015)
- Kuvendi i Kosovës, Grupet Politike në Kuvendin e Kosovës. Periudha e parë Legjislative (17.11.2001 - 23.11.2004),
<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,158&legid=1&secid=107> (qasur 12.2.2015)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës,(2014), Transkript i Mbledhjes së Jashtëzakonshme Plenare e Kuvendit të mbajtur më 7 maj 2014
http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_2014_05_07_12_5642_al.pdf (i qasur 12.01.2018)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2015), Raporti Vjetor i Punës së Kuvendit

- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011), Procesverbal i mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 7 prill 2011, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/proc_s_2011_04_07_18_al.pdf (qasur 11.03.2017)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2017), Grupet politike në Kuvendin e Kosovës, Periudha e gjashtë Legjislative, <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,107> (qasur 29.01.2017)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2017), Transkript i Mbledhjes Konstitutive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 3,4, 10, 14, 24 gusht dhe më 7 shtator 2017, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2017_08_03_10_7007_al.pdf (qasur 10.10.2007)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2017), Transkript i Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 9 shtator http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_2017_09_09_16_7015_al.pdf (qasur 1.10.2017)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Grupet politike në Kuvendin e Kosovës, Periudha e katërt Legjislative (12.12.2010 - 07.05.2014) <http://kuvendikosoves.org/?cid=1,158&legid=4&secid=107> (qasur 12.12.2015)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2018), Procesverbal i Seancës së Jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 22, 23, 28 Shkurt dhe 20, 21 mars 2018 ; http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/proc_2018_02_23_10_7260_al.pdf (qasur 28.03.2018)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2018), Transkript I mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 2 dhe 15 mars 2018, http://assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2018_03_02_10_7270_al.pdf (qasur 10.06.2018)

- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2018), Transkript i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 8 dhe 15 Mars 2018, http://assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2018_03_08_10_7285_al.pdf (qasur 10.06.2018)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2018) Transkript i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 16, 23 dhe 30 mars 2018, http://assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2018_03_16_10_7296_al.pdf (qasur 11.05.2018)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2018) Transkript i Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 20 prill, 31 Maj, 1 dhe 4 Qershor 2018, http://assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_2018_04_20_12_7384_al.pdf (qasur 11.06.2018)
- Kuvendi i Kosovës: Grupet politike në Kuvendin e Kosovës, Periudha e tretë Legjislative (13.12.2007 - 03.11.2010) <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,158&legid=3&secid=107> (qasur 12.02.2015)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2012), REZULUTE (Nr. 04-R-09) Parimet e Prishtinës nga Samiti Ndërkombëtar i Gruas: “Partneriteti për Ndryshim-Fuqizimin e Gruas”, më 4-6 tetor 2012, në Prishtinë, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Rezoluta_per_fuqizimin_e_rolit_te_Gruas.pdf (qasur 10.11.2015)
- Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (2014), Raport përfundimtar, 7 korrik 2014 për Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 8 qershor 2014, http://www.eods.eu/library/eu-eom-kosovo-2014-final-report_sq.pdf (i qasur 15.10.2015)
- Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË (2006), Raporti 01/2006 i Shtyllës së III-të (OSBE) Mbi monitorimin e Kuvendit të

Kosovës 24 dhjetor 2005 - 10 mars 2006,

<https://www.osce.org/sq/kosovo/21129?download=true> (qasur 11.11.2017)

- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË (2013), Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil të Kosovës, <http://www.osce.org/sq/kosovo/99602?download=true>, (qasur 5.10.2015)
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË dhe Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Dokumentim (2004), Entitetet Politike që Garojnë në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës në vitin 2004, Broshura e Entiteteve Politik:
<file:///C:/Users/Dell/Desktop/Doktortura/Vleresimi%20i%20zgjedhjeve/Osbe%20entitetet%20politike%20qe%20garojne%20nezgjedhjet%202004.pdf> (qasur 15.05.2015)
- OSCE/CEC/UNMIK, (2004), Rezultatet e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2004 <https://www.osce.org/kosovo/25332?download=true> (qasur 10.5.2014)
- OSBE/CEC/UNMIK (20002) Rezultatet për Zgjedhjet lokale 2002 <https://www.osce.org/kosovo/20467?download=true> (qasur 10.05.2015)
- OSCE/CEC/UNMIK:(2001), Rezultatet e Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2001 <https://www.osce.org/kosovo/20466?download=true> (qasur 10.5.2015)
- OSBE/CEC/UNMIK (2000) Rezultatet përfundimtare për zgjedhjet lokale, <https://www.osce.org/kosovo/20464?download=true> (qasur 10.5.2015)
- Presidenti i Republikës së Kosovës (2010), Deklaratë e Dr. Fatmir Sejdiu, Presidenti i Republikës së Kosovës, 27 shtator 2010, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,1360> (qasur 10.05. 2014).
- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë 2/2014, Përfshirje apo përjashtim? Minoritetet në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e Pas-pavarësisë, http://www.qkss.org/repository/docs/P%C3%ABrfshtim_Minoritetet_n%C3%AB_Sektorin_e_Siguris%C3%ABn%C3%AB_Kosov%C3%ABn_e_Pas-pavar%C3%ABsis%C3%AB_805000.pdf, (qasur 5.10.2015)
- Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit /Agjencisë për Barazi Gjinore (. (2014) Plani i Veprimit në zbatim të Rezolutës 1325, “Gratë, Paqja dhe Siguria” 2013-

2015, mars 2014 , <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ%20Plani%20i%20Veprimit%20p%C3%ABr%20Implemen tim%20t%C3%AB%20Rezolut%C3%ABs%201325%20tre%20gjuh%C3%AB.pdf> (qasur 7.11.2015)

- Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit/ Agjencia për Barazi Gjinore(2014) Raporti i hulumtimit Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale, dhe në partitë politike në Kosovë, <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ%20Pjesmarrja%20roli%20dhe%20poziat%20e%20grave%20ne%20institucione%20qendrore%20lokale%20dhe%20parti%20politike.pdf> (qasur 8.11.2015)

Burime Dytësore:

- Adams, John (1852-1865), “Works IV”, Boston,
- Agani, Fehmi (1990), “Në rrjedha të mendimit sociologjik”, Rilindja, Prishtinë
- Agani, Fehmi (1999) “Pavarësia - gjasa dhe shpresë”, Biblioteka Fryma, Botues Dukagjini
- Alan Siaroff (2000), “Comparative European Party Systems, An Analysis of Parliamentary Elections Since 1945”, Garland Publishing, Inc. A Member of the Taylor & Francis Group New York and London,
- Anastasi, Aurela & Enkeleda, Olldashi (2006), “Sistemet e kuotave zgjedhore dhe rëndësia e tyre për arritjen e barazisë gjinore në jetën publike”, Revista Studime Juridike Nr. 1/2006, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë
- Bajrami, Arsim (1996), E drejta Kushtetuese -II-, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
- Bajrami, Arsim (1997), “Teoria dhe praktika parlamentare”, Prishtinë.
- Bajrami, Arsim (2002), “E drejta e Kosovës në tranzicion” (E drejta kushtetuese, libri II), Prishtinë
- Bajrami, Arsim (2005), “Demokracia Parlamentare” (Aspekti krahasimor), botimi i katërt, Botues “Flaka” Shkup, Prishtinë
- Bajrami, Arsim (2010), “Parlamentarizmi” (aspekti krahasimor) Prishtinë

- Blais, André & Louis Massicotte (1996), “Electoral Systems”, in L. LeDuc, R. Niemi & P. Norris (eds), *Comparing Democracies: Elections and Voting in Global Perspective* (Thousand Oaks: Sage Publications),
- Bobi, Gani (1994), “Konteksti i vetëkulturës”, Bibloteka FRYMA, Dukagjini, Pejë.
- Brand, Marcus (2003), “The Development of Kosovo Institutions and the Transition of Authority from UNMIK to Local Self-Government, in Cluster of Competence The rehabilitation of war-torn societies, A Project co-ordinated by the Centre for Applied Studies in International Negotiations (CASIN) Geneva, <https://www.files.ethz.ch/isn/20295/01%27%27.2003.pdf> (qasur 10.01.2018)
- Bufi, Ylli (2000), “Tempulli i Demokracisë”, OMBRA GVG, Tiranë
- Burke, Edmund, *Burke’s Politics*, Hoffman, Ross J.S & Paul Levack (eds.), (1949), (New York: Alfred A. Knopf),
- Carl J. Friedrich, (1950), *Constitutional Government and Democracy* (Boston: Ginn and Co.)
- Colomer, John (2004), “The Strategy and History of Electoral System Choice”, in J. Colomer (ed), *Handbook of Electoral System Choice* (Houndmills: Palgrave Macmillan),
- Çili, Henri (2002), “Shumica që na mund”, ESSE 3/2002, Tiranë
- Daniel-Louis Seiler (2000), “Partitë politike”, UET Press, Tiranë
- Douglas J. Amy (2000), “Behind the ballot box : a citizen’s guide to voting systems”, Library of Congress Cataloging-in-Publication Data
- Douglas W. Rae (1967) , “The Political Consequences of Electoral Laws”, (New Haven: Yale University Press).
- Drude Dahlerup (2003), “Quotas are Changing the History of Women” A paper presented at the International Institute for Democracy and Electoral Assistance (IDEA)/Electoral Institute of Southern Africa (EISA)/Southern African Development Community (SADC) Parliamentary Forum Conference, The Implementation of Quotas: African Experiences, Pretoria, South Africa, 11–12

November 2003; https://equalvoice.ca/pdf/CS_Drude_Africa_Oct_2004.pdf (qasur 12.2.2016)

- Drude Dahlerup, et al. (2011), “Electoral Gender Quota Systems and their implementation in Europe”, Editor, Policy Department C: Citizens' Rights and Constitutional Affairs European Parliament, Brussels, © European Parliament, 2011, <http://www.diva-portal.org/smash/get/diva2:467830/FULLTEXT01.pdf> (qasur 15.6.2016)
- Gallagher M & P. Mitchell, (2005), The Politics of Electoral Systems (Oxford: Oxford University Press)
- Guy S. Goodwin-Gill (1994) , Zgjedhjet e Lira dhe të Drejta: E Drejta Ndërkombëtare dhe Praktika, iter-parliamentary union 1994.
- Guy S. Goodwin-Gill, (1998), “Kodet e sjelljes në zgjedhje”, Unioni Ndërparlamentar 1998, Gjenevë
- Hague, Rod; Martin Harrop & Shaun Breslin (1998); “Comparative government and politics an introduction”, MACMILLAN PRESS LTD Hound mills, Basingstoke, Hampshire RG21 6XS, England, Fourth edition.
- Halili, Zenun, (2006), Politika dhe Qeverisja e Shteteve ë Bashkuara të Amerikës, Prishtine
- Harrop, Martin M & William W. Miller, (1987), Elections and Voters: A Comparative Introduction (Houndmills: MacMillan,
- Hasani, Enver & Çukalović, Ivan, (2013) Komentari, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Botimi I, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë
- Haxhiu, Sadik (2013), Zgjedhjet, Sistemet zgjedhore dhe proceset zgjedhore (Aspekti juridik, politik dhe krahasues) Prishtinë
- Hoti, Ukshin (1997), “Filozofia politike e çështjes shqiptare”, Prishtinë
- International Institute for Democracy and Electoral Assistance (2014), Electoral Management Design – Revised Edition,

<http://www.idea.int/es/publications/emd/loader.cfm?csModule=security/getfile&pageID=66788> (qasur 21.09.2015)

- International Institute for Democracy and Electoral Assistance (IDEA :2000), Manuel për hartimin e sistemeve elektorale; Sfiga, Prishtinë,
- International Institute for Democracy and Electoral Assistance, (2005) Electoral System Design: the New International IDEA Handbook Stockholm:),
- Ismail, Osmani (2001), Partitë politike shqiptare dhe çështja e Kosovës (1989-1998), Prishtinë
- Katz, S. Richard .(1997), Democracy and Elections (Oxford: Oxford University Press)
- Lawrence LeDuc, Richard G. Niemi, Pippa Norris (2002), Introduction: Comparing Democratic Elections 2, Comparing Democracies 2: New Challenges in the study of Elections and Voting, (Thousand Oaks: Sage Publications)
http://daviddefendi.staff.umy.ac.id/files/2013/04/Lawrence_LeDuc_Richard_G._Niemi_Pippa_Norris_CBookFi.org_.pdf (qasur 11.11.2017)
- Lawrence, Ezrow (2010), Linking Citizens and Parties, How Electoral Systems Matter for Political Representation, Published in the United States by Oxford University Press Inc., New York
- Lijphart, Arend , (1994), Electoral Systems and Party Systems: A Study of Twenty-Seven Democracies, 1945-1990(Oxford: Oxford University Press
- Lijphart, Arend, (1999) Patterns of Democracy: Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries (New Haven: Yale University Press);
- M. Farrell ,David. & Roger Scully, (2007) Representing Europe's Citizens? – Electoral Institutions and the Failure of Parliamentary Representation (Oxford: Oxford University Press
- M. Farrell, David, (2001) Electoral Systems: A Comparative Introduction (Houndmills: Palgrave),
- Madison, James, The Federalist No.10, “The Utility of the Union as a Safeguard against Domestic Faction and Insurrection (continued)”, Daily Advertiser,

Thursday, 22 November 1787, URL: <http://www.constitution.org/fed/federa10.htm>
(qasur parë 2 March 20154 dhe rishikuar 15 janar 2017).

- Mar'ia Maravall, Jos'e & Ignacio S'anchez-Cuenca (2008), "Controlling Governments" Voters, Institutions, and Accountability, Published in the United States of America by Cambridge University Press, New York
- Maurice Duverger, Maurice (1954), Political Parties, Their Organization and Activity in the Modern State (New York:Wiley
- Maurice Duverger, Maurice (1972), "Factors in a Two-Party and Multiparty System," in Party Politics and Pressure Groups (New York: Thomas Y. Crowell, 1972), pp.23-32 . <http://janda.org/c24/Readings/Duverger/Duverger.htm> (qasur 15.12.2017)
- Nassmacher, Karl-Heinz (2003), "The Funding of Political Parties" in the Anglo-Saxon Orbit , "Funding of Political Parties and Election Campaigns" IDEA, Stockholm,
- Norris, Pippa (1997), Choosing Electoral Systems: Proportional, Majoritarian and Mixed Systems, International Political Science Review / Revue internationale de science politique, Vol. 18, No. 3, Contrasting Political Institutions. Institutions politiques contrastées#. (Jul., 1997), pp. 297-312.
- Norris, Pippa (2004) Electoral Engineering: Voting Rules and Political Behavior (Cambridge: Cambridge University Press
- Omari, Luan &Anastasi, Aurela, (2010), E drejta Kushtetuese, ABC, Tiranë
- Omari, Luan (1994) Sistemi parlamentar,Tiranë
- Salihu, Kurtesh (2004), E drejta Kushtetuese, Prishtinë
- Sarah Birch (2003), Electoral Systems and Political Transformation in Post-Communist Europe, palgrave MACMILLAN
- Sartori, Giovanni(1998), Ç'është demokracia, Dituria, Tiranë
- Sartori, Giovanni, (1976), Parties and Party Systems, Cambridge University Press.
- Sartori, Giovanni,(1994) Comparative Constitutional Engineering: An Inquiry into Structures, Incentives and Outcomes (New York: New York University Press,

- Schmidt, G. Manfred (2012), Teoritë e Demokracisë, Botim universitar, Botaart, Tiranë
- Schroeder, C. Richard; Glick, Nathan et al (1989), “Veshtrim mbi SISTEMIN AMERIKAN TE QEVERISJES”, Distributed by Public Affairs Section, Embassy of the United States of America, produced by Regional Program Office Vienna, RPO-2001-0078 ALBANIAN.
- Shala, Xhavit (2014) Efekti i sistemit elektoral në avancimin e demokracisë dhe parandalimin e abuzimit të votës në Kosovë, Revistë ndërkombëtare për shkencat shoqërore “VIZIONE “ Shkup Nr.22/2014,
- Shala, Xhavit (2015) “The challenges of reforming the electoral system in Kosovo” in “The Sixth International Congress on Social Sciences and Humanities». Proceedings of the Congress (Desember 2, 2015). «East West» Association for Advanced Studies and Higher Education GmbH. Vienna. 2015. 240 P “
- Shala, Xhavit (2015), “Constitutional and legal basis of representation of minorities in Kosovo and experiences from the region”, in ” The Eighth International Scientific Conference on Private and Public Law” ,10th October, 2015 Vienna, «East West» Association for Advanced Studies and Higher Education GmbH. Vienna. 2015. 86 P.
- Shala, Xhavit (2015), “Electoral Process Management In Kosovo” in the “International Journal of Academic Research and Reflection”, Vol. 3, No. 7, 2015
- Shala, Xhavit (2015), “GENDER QUOTE IN THE KOSOVO ELECTORAL LAW”, in the European Journal of Research in Social Sciences, Vol. 3 No. 5, 2015,
- Shala, Xhavit. (2012) “E drejta e votës së gruas dhe zhvillimi historik i saj”, “Constitution” nr.2/2012, Revista për çështje juridike-kushtetuese dhe parlamentare, Prishtinë, ISSN:1409-9862
- Timothy D. Sisk (2017), Elections, Electoral Systems and Party Systems, in the “Elections, Electoral Systems and Party Systems A Resource Guide”, International Institute for Democracy and Electoral Assistance, Strömsborg SE–103 34 STOCKHOLM SWEDEN, <https://www.idea.int/gsod/files/IDEA-GSOD-2017-RESOURCE-GUIDE-ELECTIONS.pdf> (qasur 20.5.2017)

- Weller, Marc, (2009) Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për Pavarësi, Koha, Prishtinë.

Gazeta :

- Assembly Support Initiative Newsleter (2005), “Parlamentarët nuk janë nga Marsi por nga Kosova”, Debat me kryesuesit e grupeve parlamentare, OSBE Misioni në Kosovë, ASI Newsleter, Qershor 2005, Nr 17,
<https://www.osce.org/sq/kosovo/15380?download=true> (qasur 10.10.2016)
- Koha ditore (2011) Blera Aliu, Kosovarët duan përfaqësim 50 me 50 në vendimmarrje (Debatohen Kuota gjinore dhe Përfaqësimi i Barabartë politik i Grave në Kosovë), Koha Ditore, 13 dhjetor 2011, <http://www.alg-prizren.com/presse/pdfs/2011-12-13-Koha-Ditore.pdf>
- Gazeta Fokus, (2016) E. Perlaskaj: Do të jem zë i shqiptarëve në parlamentin kroat, intervistë e realizuar nga Hyrë Tejci Murati me 16.08.2016
<http://www.fokusi.org/perlaskaj-do-te-jem-ze-i-shqiptareve-ne-parlamentin-kroat/> (shikuar me 25.09.2016)
- Kosova sot (2011), Shala, Xhavit, Reforma elektorale të reflektojë përfaqësimin e drejtë të vullnetit të popullit, (vështrim), Kosova sot, 29 prill 2011
<http://www.kosova-sot.info/opinione/reforma-elektorale-te-reflektoje-perfaqesimin-e-drejte-te-vullnetit-te-popullit> (qasur 10.10.2015)
- Koha ditore: Koha.net, Publikuar: 26 Janar 2014 - 18:20
<http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=173178> (qasur 12.11.2017)
- Lajmi.net Komunitat pa asnjë deputet në Kuvendin e Kosovës. Publikuar: 19.07.2017; <http://lajmi.net/komunitat-pa-asnje-deputete-ne-kuvendin-e-kosoves/> (qasur me 15.10.2017)
- Gazeta Express (2018), Arban Abrashi: Duhet të ketë rivotim në Prishtinë, (Publikuar 6 Prill 2018) <http://www.gazetaexpress.com/lajme/arban-abrashi-duhet-te-kete-rivotim-ne-prishtine-521142> (qasur me 7.04.2018)
- Indeksonline.net (2018): Koçi dorëzon ankesën e Gani Dreshajt në Kushtetuese, Publikuar me 3 janar 2018; [http://indeksonline.net/koci-dorezon-ankesen-e-gani-dreshajt-ne-kushtetuese/\(qasur](http://indeksonline.net/koci-dorezon-ankesen-e-gani-dreshajt-ne-kushtetuese/(qasur) 15.01.2018)
- Koha.net (2014) Hashim Thaçi, Kryeministri i Kosovës, Malazezët dhe kroatët, në Kushtetutën e Kosovës, Publikuar: 26 Janar 2014 - 18:20
<http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=173178> (qasur 5.10.2015)

- BBC ALBANION.COM (2005), Haradinaj jep dorëheqjen pas padisë së Hagës, Botuar: E martë, 08 mars 2005
http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2005/03/050308_haradinaj_haga.shtml (qasja 10.10.2016)
- Lajmeshqip.com (2011), Prishtinë, nënshkruhet zyrtarisht koalicioni PDK-AKR, publikuar 11 shkurt 2011, <http://lajmetshqip.com/prishtine-nenshkruhet-zyrtarisht-koalicioni-pdk-akr/> (qasur 7.7.2016)
- Kallxo.com (2014), Ja Marrëveshja e Plotë PDK- LDK (Dokument) Publikuar:18 dhjetor 2014, <http://kallxo.com/ja-marreveshja-e-plote-pdk-ldk-dokument/> (qasur 23 01. 2017)
- Telegrafi.com (2014). Ekskluzive: Ja marrëveshja LAN–Vetëvendosje (Dokument), publikuar me 9 shtator 2014, <https://telegrafi.com/ekskluzive-ja-marreveshja-lan-vetevendosje-dokument/> (qasur 5.6.2018)
- Gazeta Blic (2017), EKSKLUZIVE: Kjo është marrëveshja e nënshkruar për ndarjen e ministrive (DOKUMENT), Publikuar:7 shtator 2017, <https://gazetablic.com/ekskluzive-kjo-eshte-marreveshja-e-nenshkruar-per-ndarjen-e-ministrive-dokument/> (qasur 5.7. 2018)
- Telegrafi.com (2018), Vetëvendosje: Thaçi po e mban peng KQZ-në, Publikuar me 4.04.2018, <https://telegrafi.com/vetevendosje-thaci-po-e-mbane-peng-kqz-ne/> (qasur 10.07.2018)
- Zeri info (2018), 15 asamblistë, peng të moskonstituimit të KQZ-së, Publikuar me 12 korrik 2018. <http://zeri.info/aktuale/207306/15-asambliste-peng-te-moskonstituimit-te-kqz-se/> (qasur 5.9.2018)
- Gazeta Tribuna (2018), KQZ dhe Kushtetuesja peng i Presidentit Thaçi, [ublikuar me 26 gusht 2018, <http://www.gazetatribuna.com/lajme/kqz-dhe-kushtetuesja-peng-i-presidentit-thaci-video/> (qasur 5.9.2018)
- Radio Evropa e Lirë (2002), Rahman Paçarizi, Kryetar - Rugova, Kryeministër – Rexhepi, Publikuar: 04 mars, 2002, <https://www.evropaelire.org/a/1036891.html> (qasur 10.5.2016)

Burimet tretësore

Vebfaqe :


- Veb faqja e Qeverisë së Republikës së Kosovës www.rks-gov.net Përbërja e Qeverisë (2014 dhe 2017)
- Vebfaqe e Kolegjit Elektoral i SHBA-ve :U.S. National Archives and Records Administration, 2016 Presidential ElectoralResults

<https://www.archives.gov/federal-register/electoral-college/2016/election-results.html> (i qasur 10.02.2017)

- Vebfaqe e Kolegjit Elektoral i SHBA-se U.S. National Archives and Records Administration, 2000 Presidential Election Results <https://www.archives.gov/federal-register/electoral-college/votes/2000.html> (i qasur 10.02.2017)
- Vebfaqja e Gjykatës Kushtetuese, <http://www.gjk-ks.org/>
- Vebfaqja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve - Vendimet, <http://kqz-ks.org/sq/vendimet-e-kqz-se>, Zgjedhjet <http://kqz-ks.org/sq/zgjedhjet> ,Publikimet <http://kqz-ks.org/sq/publikime> (qasur 10.01.2018)
- Vebfaqja e Kuvendit të Republikës së Kosovës- <http://www.assembly-kosova.org/>
- Vebfaqja e Presidentit të Republikës së Kosovës, <http://www.president-ksgov.net/>
- Vebfaqja e UNMIK www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/


Shtojca 1. Struktura e respondentëve, qytetarët dhe përfaqësuesve politikë

Figura . 20. Grup-mosha e target grupit qytetar




Burimi: Autori 2017

Figura 21 Gjinia e target grupit qytetar




Burimi: autori 2017

Figura 22. Vendbanimi i target grupit qytetar



Burimi: Autori 2017


Figura .23. Interesimi për politikën nga target grupi qytetar



Burimi: Autori 2017


Target grupi me funksion publik dhe politike

Figura . 24 . Grup-mosha e responentëve me funksion publik dhe politik




Burimi: autori 2017

Figura .25. Gjinia e responentëve me funksion publik dhe politik




Burimi: Autori 2017

Figura 26. Nivelin arsimor i responentëve me funksion publik dhe politik




Burimi: autori 2017

Figura . 27. Vendbanimi i responentëve me funksion publik dhe politik




Burimi: Autori 2017

Figura . 28 . Funksioni në parti i respondentëve me funksion publik dhe politik



Burimi: Autori 2017

Figura . 29. Niveli i Përgjegjësisë në parti i respondentëve me funksion publik dhe politik



Burimi: Autori

Shtojca 2 Pyetësorët

Pyetësor për qytetar: Studim për sistemin zgjedhor në Kosovë

Studimi është pjesë e një kërkimi shkencor. Për këtë, ne dëshirojmë të bëjmë një pyetësor me ju për të marrë opinionin tuaj për disa çështje që lidhen me zgjedhjet (sistemin zgjedhor). Ju jeni përzgjedhur në mënyrë krejtësisht rastësore midis gjithë qytetarëve të Kosovës dhe informacioni nga ky pyetësor do të mbetet plotësisht anonim dhe konfidencial.

1. Grup - mosha:

- ☐ 18-30
- ☐ 31-40
- ☐ 41-50
- ☐ 51-60
- ☐ 61- 70
- ☐ 70+

2. Gjinia

- ☐ Mashkull
- ☐ Femër

3. Niveli arsimor

- ☐ I ulët
- ☐ I mesëm
- ☐ I lartë
- ☐ Pasuniversitar

4. Vendbanimi

- ☐ Qytet
- ☐ Fshat

5. Sa i/e interesuar mund të thoni se jeni për politikën?

- ☐ shumë i/e interesuar
- ☐ jo shumë i/e interesuar
- ☐ aspak i/e interesuar
- ☐ refuzoj të përgjigjem

1. Kur mblidheni në shtëpi me anëtarët e tjerë të familjes, mund të thoni se diskutoni rreth çështjeve politike?

- ☐ vazhdimisht
- ☐ me raste
- ☐ asnjëherë

2. Për sa u përket shokëve tuaj, sa prej tyre, ua dini partinë që ata mbështesin?

- ☐ asnjërit

- disave
 - shumicës
 - të gjithëve
3. Gjatë fushatës elektorale, a keni treguar mbështetjen tuaj për ndonjë parti ose kandidat/e të caktuar, duke marrë pjesë nëpër takime, mitingje, vendosje posterash, ose në ndonjë mënyrë tjetër?
- Shpesh
 - Me raste
 - Rrallë
4. Sipas mendimit tuaj, a është e lartë pjesëmarrja e gruas në politikë dhe në vendimmarrje?
- PO
 - JO
5. Gjatë fushatës elektorale, ju ka ndodhur që ndonjë prej Liderëve, kandidatëve ose dikush nga partitë politike të ketë kontaktuar me ju për t'ju bindur për të votuar për ta?
- PO
 - JO
6. A janë mbështetur njësoj nga partitë politike si kandidatet gra ashtu edhe burra?
- PO
 - JO
7. Pas fushatës elektorale, ju ka ndodhur që ndonjë prej Liderëve, kandidatëve ose dikush nga partitë politike që votuat në qendrën (zonën) tuaj elektorale të ketë kontaktuar me ju për t'ju falënderuar apo për t'iu përgjigjur kërkesave?
- PO
 - JO
8. A mund të më thoni, e keni takuar ndonjëherë Kandidatin/Kandidaten e partisë apo deputetin/deputeten e zonës/komunës tuaj elektorale gjatë mandatit ?
- PO
 - JO
9. Duke folur në përgjithësi për performancën e Parlamentit në tërësinë e tij, sa mirë ose keq mendoni ju se ka funksionuar në këto vitet e fundit. Ka funksionuar?
- shumë mirë
 - mirë
 - keq
 - shumë keq
10. Në tërësi, a jeni i kënaqur me mënyrën se si funksionojnë Partitë politike në Kosovë?
- shumë i/e kënaqur
 - jo shumë i/e kënaqur
 - aspak i/e kënaqur

11. Sa e mirë ka qenë performanca e partisë (deputetit/deputetes) për të cilën ju votuat atëherë, gjatë viteve të fundit? A ka bërë ajo parti?
 - një punë shumë të mirë
 - një punë të mirë
 - një punë të keqe
 - një punë shumë të keqe
12. Duke patur parasysh se si funksionojnë zgjedhjet parlamentare në praktikë në Kosovë, sa mendoni e sigurojnë zgjedhjet përfaqësimin e drejtë të vullnetit të votuesve në parlament prej deputetëve?
 - shumë mirë
 - mirë
 - jo mirë
 - aspak mirë
13. A mund të pohoni se pikëpamjet tuaja përfaqësohen në mënyrë të kënaqshme nga ndonjë prej partive politike në Kosovë?
 - PO
 - JO
14. A keni kontaktuar ndonjë deputet/e ose zyrtar/e qeveritar personalisht, duke i shkruajtur, ose në rrugë të tjera?
 - PO
 - JO
15. Sipas mendimit tuaj, kush duhet të vendosë për kandidat/e potencial për deputet/e?
 - Liderët partiakë
 - Një grup brenda partisë
 - Anëtarësia, se bashku me forumet e partisë
 - Miqësia politike apo klanore
16. Presidenti i Republikës zgjidhet prej parlamentit (2/3). Sipas mendimit tuaj, kush duhet të zgjedh Presidentin e Kosovës?
 - Parlamenti
 - Populli
17. Cila është çështja apo problemi më i rëndësishëm të cilin ju do të dëshironit që Qeveria dhe Parlamenti i ardhshëm i Kosovës të merrej gjatë mandatit të ardhshëm? Shënoni disa sipas rëndësisë duke vendosur numrat 1, 2, 3,4, etj.
 - Krijimi i institucioneve,
 - stabiliteti institucional,
 - zhvillimi ekonomik,
 - sundimi i ligjit dhe luftimi i korrupsionit,
 - reforma kushtetuese dhe ligjore,
 - reforma elektorale,
 - reforma në arsim, shëndetësi
 - liberalizimi i vizave
 - punësimi
18. A keni bërë ndonjëherë pagesë anëtarësie ose donacion për partinë tuaj?
 - PO

- JO

19. Si qytetar dhe pjesëmarrës në zgjedhje, Ju me dëshirë në të ardhmen do të votoni?

- për një Kandidat/e
- për partinë dhe një Kandidat/e
- për partinë dhe disa Kandidatë apo
- vetëm për Partinë

FALEMINDERIT PËR KOHËN E VËNË NË DISPOZICION PËR PLOTËSIMIN E KËTIJ PYETËSORI!

PYETËSOR PËR BARTËS TË FUNKSIONEVE NË PARTI POLITIKE DHE INSTITUCIONE PUBLIKE

PYETËSOR për Studim për sistemin zgjedhor në Kosovë

Studimi është pjesë e një kërkimi shkencor. Për këtë, Ne dëshirojmë të bëjmë një pyetësor me Ju për të marr opinionin tuaj për disa çështje që lidhen me zgjedhjet (sistemin zgjedhor). Ju jeni përzgjedhur në mënyrë krejtësisht rastësore dhe informacioni nga ky pyetësor do të mbetet plotësisht anonim dhe konfidencial.

1. Grup-mosha:

- 18 - 30
- 31 - 40
- 41 - 50
- 51 - 60
- 61 - 70
- 70 +

2. Gjinia

- Mashkull
- Femër

3. Niveli arsimor

- I ulët
- I mesëm
- I lartë
- Pasuniversitar

3. Vendbanimi

- Qytet
- Fshat

4. Cila është mënyra më e suksesshme për të përhapur mesazhin e partisë (të preferuar) ? (zgjidhni vetëm dy përgjigje)

- Televizioni dhe Radio
 - Gazeta
 - Mediet sociale
 - Kontakte, diskutime me miqtë, familjen, fqinjët dhe anëtarë të partisë
5. Cili është funksioni më i rëndësishëm që keni (pasur) në parti (zgjidhni vetëm dy përgjigje)
- Në forumet e larta drejtuese
 - Në nivele drejtuese
 - Koordinator për zhvillimin e politikave
 - Jam Anëtar/e i/e partisë
 - Jam përkrahës/e dhe Votues/e
6. Cila është përgjegjësia më e rëndësishme që keni pasur në partinë tuaj (zgjidhni vetëm tri përgjigje)
- Për të kontribuar me para për partinë
 - Përhapja e mesazhit të partisë
 - Për zhvillimin e politikave
 - Të demonstrojë se partia ka mbështetjen e popullit, dhe të elitës
 - Të ofrojë kandidatë për zgjedhje lokale dhe kombëtare
7. Nëse partia juaj është e hapur të rekrutojë më shumë anëtarë, ajo?
- Organizon më shumë ngjarje shoqërore dhe politike
 - Krijon më shumë mundësi për karrierë
 - Cakton një udhëheqës karizmatik
 - Jep më shumë hapësirë për anëtarët e rinj
 - Nuk është e hapur për risitë
8. Sipas mendimit tuaj, Cilat cilësi janë më të rëndësishme në zgjedhjen e liderit/lideres të partisë?
- Aftësia për të kontribuar financiarisht- biznesmen
 - Ideologjikisht besnik ndaj partisë
 - Intelektual- Menaxher
 - Karizmatik
9. Sipas mendimit tuaj, kandidatët potencialë për deputet/e, a duhen të jenë anëtarë i/e partisë para se të bëhet pjesë e listës së partisë?
- Kandidatët e përshtatshëm nuk kanë nevojë të jenë anëtarë të partisë
 - Kandidatët duhet të bashkohen me partinë para se të hyjnë në listën e partisë
 - Kandidatët duhet të jetë anëtarë për disa muaj përpara se të bëheshin kandidatë
 - Kandidatët duhet të jenë anëtarë për një vit përpara se të bëhen kandidatë
 - Kandidatët duhet të jenë anëtarë për tre vjet përpara se të bëhen kandidatë
10. Cilët faktorë mendoni se ndikojnë negativisht të ketë pjesëmarrje të ulët në zgjedhje ? (shënoni sipas rëndësisë)
- Mentaliteti
 - Mosbesimi të vota për ndryshime

- Lufta e ashpër politike edhe brenda llojit
 - Koha e paktë në dispozicion për fushat elektorale
 - Anëtarësimi i ulët i grave dhe rinisë në partitë politike
 - Mosbesimi të partitë politike dhe institucione politike
11. Cilët rrugë mendoni se janë me efektive në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje? (Shënoni sipas rëndësisë)
- Futja e sistemit të votës së obliguar (përmirësimi i ligjit zgjedhor)
 - Rritja e anëtarësisë në partitë politike
 - Rritja e numrit të grave dhe rinisë në forumet drejtuese brenda partive politike
 - Ngritja e mirëqenies sociale në vendin
 - Rritja e besimit tek partitë politike dhe në vendimmarrjen politike ?
 - Llogaridhënia politike, transparence dhe sundimi i ligjit
12. Çfarë lloje të aktiviteteve të fushatës duhet të bëjnë kandidatët apo partitë në të ardhmen ?
- Kontaktimi i votuesit më telefon
 - Kontaktimi votuesit drejtpërdrejt ose dorë më dorë
 - Shpërndarja e programit në çdo hyrje-shtëpi
 - Organizimi i takimeve, mbledhjeve dhe tubime
 - Biseda më miqtë, familjen dhe fqinjët për të dalë në zgjedhje dhe votuar për partinë
13. Sipas mendimit tuaj sa bashkëveprojnë partitë politike apo kandidatët me përkrahësit/ votuesit e tyre?
- ka koordinim shumë të mirë
 - ka koordinim të mirë
 - ka pak koordinim
 - s'ka fare koordinim
14. Si qytetar/e dhe pjesëmarrës/e në zgjedhje, Ju më dëshirë në të ardhmen do të votoni?
- për një kandidat/e
 - për partinë dhe një kandidat/e
 - për partinë dhe disa kandidatë apo
 - vetëm për partinë
15. Sipas mendimit tuaj, A mbështeten njësoj nga partia si kandidatet gra ashtu edhe burra?
- PO
 - JO

FALEMINDERIT PËR KOHËN E VËNË NË DISPOZICION PËR PLOTËSIMIN E KËTIJ PYETËSORI